RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

"MBI AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË NË DREJTORINË RAJONALE TATIMORE SHKODËR"

Tiranë, 30.04.2020

PËRMBAJTJA	**Faqe**
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	**3-24**
II. HYRJA	**24-27**
a. Objektivat dhe qëllimi	**25-25**
b. Identifikimi i çështjes	**25-25**
c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	**25-25**
d.Përgjegjësitë e audituesve	**25-26**
e. Kriteret e vlerësimit	**26-26**
f. Standardet e auditimit	**26-27**
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	**27-30**
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	**30-2**
IV/1. Auditimi i saktësisë dhe rregullshmërisë sëpërpilimit të pasqyrave financiare tëtë ardhurave tatimore për vitet 2018; 2019, rakordimit periodik me Degën e Thesarit Shkodër dhe raportimit të të ardhurave në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.	**30-52**
IV/2.Respektimi i dispozitave ligjore në lidhje me emërimet dhe largimet nga puna të punonjësve; respektimi i strukturës organike të miratuar; respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, e të tjera shpenzime personeli; respektimi i dispozitave ligjore për shpenzimet për udhëtime e dieta; ndjekja dhe raportimi i ecurisë sëproceseve gjyqësore në lidhje me punonjësit e larguar nga puna, si dhe saktësia e paraqitjes së shpenzimeve të sipërcituara në pasqyrat financiare vjetore.	**52-120**
IV/3.Vlerësimi i evidentimit, saktësisë së llogaritjes së ndryshimeve në aktivet (e trupëzuara dhe qarkulluese)të institucionit, pasqyrimi i tyre në pasqyrat financiare nëpërputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, zbatimi i dispozitave ligjore për inventarizimin e pronës shtetërore si dhe rregullshmëria e procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit/asgjësimin e aktiveve.	**120-162**
IV/4.Zbatimi i dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit me vlera të vogla, që nga planifikimi i nevojave, prokurimi marrja në dorëzim dhe zbatimi i kontratave për punime/mallra/shërbime nga Autoriteti Kontraktor; rregullshmëria e kryerjes së shpenzimeve të tjera, përvec shpenzimeve të cituara në pikën 2 të programit, si dhe saktësia e paraqitjes së tyre në pasqyrat financiare vjetore.	**162-200**
IV/5.Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.	**200-211**
IV/6.Probleme të ndryshme që mund të dalin gjatë auditimit.	**211-214**
V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	**214-222**
VI. SHKURTIME	**223**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Në përputhje me objektin e auditimit, u audituа mbi bazë materialiteti dhe risku gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit; përpilimi i pasqyrave financiare të të ardhurave tatimore për vitet 2018; 2019 si dhe rakordimi periodik me Degën e Thesarit Shkodër dhe raportimi i të ardhurave në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; procedurat në lidhje me emërimet dhe largimet nga puna të punonjësve; respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, e të tjera shpenzime personeli; respektimi i dispozitave ligjore për shpenzimet për udhëtime e dieta; evidentimi dhe saktësia e llogaritjes së ndryshimeve në aktivet (e trupëzuara dhe qarkulluese) të institucionit; zbatimi i dispozitave ligjore për inventarizimin e pronës shtetërore; zbatimi i dispozitave ligjorepër realizimin e procedurave të prokurimit me vlera të vogla, etj. Bazuar në vlerën e materialitetit u filtruan: Me zgjedhje Urdhër Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat në total për vitin 2018 kapin shumën 114,483 mijë lekë dhe për vitin 2019, kapin shumën 113,139 mijë lekë ; Të gjitha Urdhër Shpenzimet për udhëtim e dieta në shumën totale 6,790,650 lekë , nga të cilat 4,709,950 lekë në vitin 2018 dhe 2,080,700 lekë në vitin 2019;Të gjitha Urdhër Shpenzimet për prokurimet me vlera të vogla në shumën totale prej 1,724,768 lekë, nga të cilat 940,012 lekë të realizuara, në vitin 2018 dhe 784,756 lekë të realizuara në vitin 2019, tëgjithë dokumentacionet e hartuara në zbatim të Ligjit për MFK, akt akordimet me Degën e Thesarit, si dhe rakordimet me DPT si dhe u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre.

I.b. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJA E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Në 3 (tre) raste punonjësit janë paguar me pagë grupi jo në përputhje me nivelin e diplomës duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit në total në shumën 515,244 lekë, nga të cilat: 203,639 lekë në vitet 2016-2017, 181,573 lekë në vitin 2018, 122,997 lekë në vitin 2019, dhe 8035 lekë në vitin 2020. Më konkretisht: a) **Në 2 (dy) raste** punonjësit janë paguar me pagë grupi, jo në përputhje me nivelin e diplomës, duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 190,972 lekë. b) **Në 1 (një) rast** punonjësi z. [redacted] është paguar me pagë grupi 10,000 lekë, ndërkohë që rezulton i papajisur me diplomë duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 324,272 lekë, për periudhën 02.08.2016-31.01.2020. Shuma 324,272 lekë, (36,866 lekë në vitin	62-65;73-75	E Lartë	1 DRT Shkodër të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 515,244 lekë, sa përfituar padrejtësisht nga z. [redacted] në shumën 132,245 lekë; z. [redacted] në shumën 58,727 lekë dhe z. [redacted] në shumën totale 324,272 lekë, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, ...".

	2016, 91,137 lekë në vitin 2017, 92,878 lekë në vitin 2018, 95,356 lekë në vitn 2019 dhe 8,035 lekë në vitin 2020) e përfituar nga z.[redacted] në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, konsiderohet dëm në Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet.			
2	Parregullësi në respektimin e dispozitave ligjore për shpenzimet për udhëtime e dieta të cilat kanë rezultuar me dëm në buxhetin e shtetit në shumën 777,735 lekë. Më konkretisht: a) 27 punonjës në 34 shërbime të kryera janë paguar për shpenzime udhëtimi (fjetje në hotel) mbi bazën e dokumentacionit financiar të parregullt (fatura tatimore për fjetje në hotel të pa vulosura nga shitësi i shërbimit, të panënshkruara nga punonjësi dhe shitësi i shërbimit) *duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit në shumën 654,500 lekë, nga* 6,353,100 lekë *të paguara në total për shpenzimet për udhëtim e dieta (prej të cilave 589,000 lekë në vitin 2018 dhe 65,500 lekë në vitin 2019),* veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 4 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar si dhe pikës 36 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. b) Gjatë vitit 2019, 10 punonjës në 3 shërbime të kryera kanë tejkaluar me nga 1 ditë secili qëndrimin me shërbim jashtë vendit të punës (vërtetuar kjo me faturë tatimore fjetje në hotel një ditë më shumë sesa është urdhëruar në urdhërin e punës). Këto ditë duhet të rezultonin mungesë në listëprezencë dhe listëpagesë por, ndërkohë punonjësit rezultojnë të jenë paguar me ditë të plota pune nga sektori i financës, *duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit, në vitin 2019, në shumën 123,235 lekë.*	84-120	E Lartë	DRT Shkodër të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 777,735 lekë, përfituar padrejtësisht nga 29 punonjës të DHT (sipas tabelës nr.26), në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, VKM-së nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
3	Parregullësi në 12 procedura rekrutimit, që përfshin të gjitha nivelet menaxheriale duke shkaktuar shpenzim në kushtet e paligjshmërisë në total në shumën 12,244,690 lekë, nga të cilat 2,795,401 lekë për vitet 2016-2017; 5,059,718 lekë për vitin 2018, 4,331,398 lekë për vitin 2019 dhe 58,173 lekë në vitin 2020 si dhe strukturë e parealizuar në masën 28% ose	55-73	E Lartë	1**:**Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të kalojë në një proces shqyrtimi tërësor, gjithë databazën e të punësuarve të DRT-së, për të vlerësuar saktësinë dhe rregullshmërinë e trajtimit financiar të çdo punonjësi si dhe përllogaritjes së komponentëve që përbëjnë pagën, të tilla si: nivelin e diplomës, shtesa

	36 vende të lira pune në fund të vitit 2018 dhe 15% ose 19 vende të lira pune në fund të vitit 2019. a) **Në 1 (një) rast** procedura e emërimit të nivelit të lartë menaxherial nga Ministri i Financave, për **z.** [redacted] (i cili zotëron diplomë të nivelitBachelor), në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DRTRV, ka rezultuar, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës....." lidhja 6/8, ku si kriter minimal i diplomës së shkollës së lartë, për efekt pranimi në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë në DRT, është 1, që do të thotë kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë dhe paga e paguar për të, për periudhën 05.02.2018-12.11.2018, ***në shumën 995,564 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.*** b) **Në 3 (tre) raste**procedurat e rekrutimit të nivelit të mesëm menaxherial kanë rezultuar me diplomë të nivelit Bachelor, në kundërshtim me përcaktimet VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësvecivilë/nëpunësve, ... aparatet eministrive të linjës,...", lidhja 6/8, ku si kriter minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt pranimi në pozicionin e përgjegjësit të sektorit në DRT, është 1 ose 2, që do të thotë kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë, ose diplomë master profesional si dhe përcaktimet e rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhepaga e paguar për punonjësit [redacted] nga momenti i emërimit, ***në shumën 3,753,681 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë nga të cilat: 1,904,675 në vitin 2017; 1,440,189 lekë në vitin 2018 dhe dhe 408, 817 lekë në vitin 2019***.			për efekt pozicioni, vjetërsinë në punë etj, me qëllim menaxhimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike. 2.Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të plotësojë dosjet personale të punonjësve me kontratë me kopje të diplomës dhe librezës së punës, për efekt të llogaritjes së elementëve të pagës, pasi për punonjësit me Status të Nëpunësit Civil të dhënat personale janë të administruara në sistemin HRMIS. 3. DRT Shkodër në bashkëpunim me DPT të fillojnë procedurat ligjore për largimin nga detyra të z. [redacted] i emëruar në detyrë ndonëse rezulton i padiplomuar. 4.DRT në bashkëpunim me DPT të kryejnë një analizë të kujdeshme në lidhje me nevojat për kapacitete njerëzore dhe të marrin masat për realizimin e tyre.

	c)**Në 1 (një) rast** procedura e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial ka rezultuar **pa diplomë**, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet eministrive të linjës,..." dhe e gjithë pagesa e bërë për periudhën 02.08.2016-31.01.2020, ***në shumën 2,336,875 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë pasi punonjësi është emëruar në detyrë i padiplomuar, nga të cilat:*** 224,108 lekë paguar në vitin 2016;666,618 lekë paguar në vitin 2017; 690,964 lekë paguar në vitin 2018; 697,012 lekë paguar në vitin 2019 dhe 58,173 lekë paguar në vitin 2020. d) **Në 2 (dy) raste** procedurat e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial kanë rezultuar ***jo në përputhje me kriterin e diplomës dhe kriterin e vjetërsisë në punë*** përcaktuar në Rregulloren "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018, pasi z[redacted], në momentin e rekrutimit në punë ka qenë i pajisur me diplomë *të nivelit Bachelor, me vjetërsi në punë 6 muaj dhe* z. [redacted] rezulton i diplomuar *në nivelin Bachelor, me 0 vite vjetërsi në punë.*Paga e paguar në total për punonjësit (**[redacted]**) ***në shumën 1,539,091 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë, nga të cilat: 287,227 lekë në vitin 2018 dhe 1,251,864 lekë në vitin 2019.*** e) **Në 2 (dy) raste** procedurat e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial kanë rezultuar ***jo në përputhje me kriterin e diplomës*** përcaktuar në rregulloren e sipërcituar. Paga e paguar në total për të dy punonjësit (**[redacted]**) ***në 510,554 lekë nga të cilat: 142,000 lekë në vitin 2018 dhe 368,554lekë në vitin 2019, konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.*** f) **Në 3 (tre) raste** procedurat e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial kanë			

	rezultuar ***jo në përputhje me kriterin e vjetërsisë në punë,*** përcaktuar në rregulloren e sipërcituar, pasi znj. [redacted] në momentin e rekrutimit rezulton me 10 muaj vjetërsi në punë, z.[redacted] me vetëm 4 muaj vjetërsi dhe z.[redacted] pa vjetërsi. Paga e paguar në total për të tre punonjësit ([redacted]) **në shumën 3,108,925 lekë nga të cilat: 1,503,774 lekë në vitin 2018 dhe 1,605,151 lekë në vitin 2019, konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.**			
4	Për punonjësit me kontratë të përkohshme janë paguar në total për të dy vitet 12,733,133 lekë, prej të cilave, 7,074,945 lekë në vitin 2018 dhe 5,658,188 lekë në vitin 2019, pagesë e cila konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë, pasi në procedurat e planifikimit, emërimit, evidentimit dhe matjes së punës së punonjësve me kontratë të përkohshme janë konstatuar parregullësi, si vijon: a)Nevojat për staf ndihmës nuk kanë kaluar fazën e planifikimit. Drejtoria Rajonale Tatimore nuk ka argumentuar dhe nuk ka mbështetur me evidencë kërkesën për staf ndihmës, si në numër ashtu edhe në pozicionet e punës ku do të punësohen. b)DPT ka kryer emërimet në punë për vitin 2018 bazuar vetëm në lista emërore, njëra prej të cilave është dërguar me email nga DRT ditën e hartimit të Vendimit të Drejtorit të PT për emërimin në punë të 21 punonjësve të shërbimit, për një periudhë 1 mujore, ndërkohë që për vitin 2019 janë emëruar në punë 23 punonjës me kontratë të përkohshme pa pasur asnjë lloj planifikimi dhe evidence mbështetëse. c)Nuk ka evidentim dhe dokumentim të punës së realizuar nga këta punonjës	78-82	E Lartë	Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të marrë masa për: planifikim real dhe të mirëstudiuar të nevojave për staf ndihmës me qëllim, eliminimin e praktikave të rekrutimit të punonjësve me kontratë të përkohshme pa justifikuar nevojat për këtë kategori hartimin e kërkesave të argumentuara dhe të mbështetura me evidencë të mjaftueshme; hartimin e përshkrimeve të punës për cdo pozicion pune që do të mbulohet nga punonjësit me kontratë të përkohshme, me qëllim menaxhimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.
5	Parregullësi në respektimin e dispozitave ligjore për shpenzimet për udhëtime e dieta të cilat kanë rezultuar me shpenzim në kushtet e paligjshmërisë në shumën 6,353,100 lekë, nga të cilat 4,294,600 lekë në vitin 2018 dhe 2,058,500 lekë në vitin 2019. Më konkretisht: a) **Në asnjë rast** "Shpenzimet e udhëtimit" (për strukturën e Hetimit Tatimor për Rajonin e Veriut), nuk janë autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT ose nga Drejtori i DRT Shkodër,	84-120	E Lartë	1.DRT Shkodër të forcojë kontrollin e brendshëm në drejtim të garantimit të gjurmës së auditimit për shpenzimet e udhëtimit, me qëllim elimimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike. 2.DHTRV të përmirësojë punën në drejtim të saktësimit në urdhrat e punës të destinacionit të inspektimit, detyrim ky që rrjedh nga zbatimi i Manualit të Drejtorisë së Hetimit

	kompetencë kjo e deleguar nga Ministri i Financave me Autorizimin nr.7448/1, datë 25.05.2018, për vitin 2018 dhe me Autorizimin nr.6159/1, datë 11.04.2019, për vitin 2019, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, gërma a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar. b) **Në 130 raste ose në 95% të rasteve,** janë kryer shpenzime për udhëtim e dieta, **në kushtet e paligjshmërisë në shumën 6,353,100 lekë** nga të cilat, 4,294,600 lekë në vitin 2018 dhe 2,058,500 lekë në vitin 2019, të pambështetur me dokumentacion vërtetues për kryerjen e detyrës, veprim ky në kundërshtim me: Përcaktimet e Udhëzimit nr.22225, datë 16.07.2015, të ish Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve; Përcaktimet e pikës 5.24 "Dokumentacioni administrativ", të Manualit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së. c) **Në 22 raste, ose në 16% të rasteve** janë konstatuar parregullsi në hartimin e urdhrave të punës të nxjerrë nga Drejtori i Hetimit Tatimor në DPT. Më konkretisht, në urdhër nuk përcaktohet territori ku do të kryhet shërbimi, por në mënyrë të përgjithshme citohet sipas rastit: në territorin e DHT Rajoni Jugor; Qendor, Verior, në territorin e Shqipërisë…, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 5.24 "Dokumentacioni administrativ", të Manualit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së.			Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së. Ky përcaktim ka impakt të drejtëpërdrejtë në përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit dhe normativave të harxhimit të karburantit.
6	Përdorimi i karburantit në kushtet jo korrekte të zbatimit të kuadrit ligjor të cilat kanë shkaktuar efekte negative në buxhetin e shtetit. **a) Për vitin 2018** gjendja e karburantit në datën 01.01.2018 është 1,002 litra. Janë bërë hyrje gjithsej 15,900 litra, janë bërë dalje 11,919 litra dhe si rrjedhimgjendja e karburantit në datë 31.12.2018 është 4,983 litra. Janë tërhequr nga programi i kartave elektronike gjithsej 10,421.49 litra (tërhequr më pak 1497,51 litra krahasuar me fletëdaljet e magazinës), nga e cila 5,168.14 litra në	176-197	E Lartë	Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të marrë të gjitha masat për garantimin e gjurmës së auditimit për dokumentimin e shpenzimeve të karburantit (për automjetet dhe kartën GOLD) me qëllim përdorimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore, moszbatimi i së cilës ka sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit gjithsej në shumën 2,810,376 lekë nga e cila 117,949 lekë nga përdorimi jo sipas

	shumën 909,593 lekë është e pajustifikuar me fletë udhëtime dhe i përket automjeteve në dispozicion të DHT-së. **b) <u>Për vitin 2019</u>** gjendja e karburantit në datën 01.01.2019 është 4,983 litra. Janë bërë hyrje gjithsej 13,950 litra, janë bërë dalje 13,600 litra dhe si rrjedhimgjendja e karburantit në datë 31.12.2019 është 5,333 litra. Janë tërhequr nga programi i kartave elektronike gjithsej 13,482.34 litra (tërhequr më pak 117.66 litra krahasuar me fletëdaljet e magazinës), nga e cila 10,233.34 litra shumën 1,782,834 lekë është e pajustifikuar me fletë udhëtime dhe i përket automjeteve në dispozicion të DHT-së. -Në lidhje me dokumentimin e harxhimt të karburantit nga mjetet në dispozicion të DHT-së për periudhën objekt auditimi është konstatuar se: për muajt shkurt, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator të vitit 2018, nuk janë plotësuar fletë udhëtimet që të vërtetojnë lëvizjen e mjeteve e për rrjedhojë sasinë e karburantit të harxhuar. Fletë e udhëtimit që i përkasin muajve të tjerë në të shumtën e rasteve nuk janë nënshkruar për çdo lëvizje, por me një ose dy nënshkrime të përgjithshme, nga një punonjës si drejtues mjeti. Për vitin 2019 prej DHT-së janë dorëzuar fletë udhëtime vetëm për muajin janar duke justifikuar vetëm sasinë prej 449 litra karburant nga 669 litra që rezulton të jetë tërhequr nga programi i kartave elektronike. Nga rakordimi i sasisë së karburantit të përdorur në programin e kartave elektronike me fletë udhëtimet e dorëzuara për mjetet e transportit në dispozicion të DHT-së konstatohet se për periudhën e audituar sasia totale prej 15,401.48 litra karburant (naftë) në shumën 2,692,427 lekë është e pajustifikuar me fletë udhëtime", veprim ky në kundërshtim me përcaktimet në nenet 9, 11, 12, 16 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar si dhe pikës 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", konsiderohet efekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit. **c)**DRT ka përdorur dhe dokumentuar për nevoja të institucionit 669.5 litra karburant në vlerën 117,949 lekë nga karta Gold			destinaconit i kartës GOLD(Gjeneratori) dhe 2,692,427 lekë nga mosjustifikimi me fletë udhëtimi nga automjetet në dispozicion të DHT-së**.**

	(Gjeneratori), kartë e cila ka destinacion përdorimi vetëm për gjeneratorin. Në asnjë rast gjeneratori nuk rezultoi të jetë vënë në punë. Përdorimi i 669.5 litra karburant (naftë) në vlerën 117,949 lekë, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 34 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik",* i ndryshuar, konsiderohet efekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit.			
7	Parregullsi në respektimin e dispozitave ligjore në realizimin e procedurave të prokurimit publik për punë/mallra/shërbime. **I.** Shkelje të afateve kohore të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik në hartimin dhe dorëzimin e regjistrit të parashikimit të prokurimit publik. a)Gjatë vitit 2018 janë konstatuar (10 herë) ndryshime të regjistrit të parashikimit të prokurimeve, ndryshime të cilat në asnjë rast nuk shoqërohen me relacion argumentues, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 4/4 të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. b)Për vitin 2018, DRT Shkodër me shkresën nr. 600 prot, datë 19.01.2018 ka dërguar në DPT regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike të vitit 2018, dhe me shkresën nr. 1369 prot, datë 07.02.2018 e ka dërguar në Degën e Thesarit Shkodër, pra DRT ka hartuar dhe dërguar me 9/28 ditë me vonesë regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike të vitit 2018 në institucionet respektive. E njëjta situatë paraqitet edhe në vitin 2019 ku DRT rezulton të ketë hartuar dhe dërguar 18/39 ditë me vonesë regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike të vitit 2019, sipas shkresës nr. 792 prot, datë 28.01.2019 dërguar në DPT dhe shkresës nr.229/1 prot, datë 8.02.2019 dërguar në Degën e Thesarit Shkodër, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 4 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. **II.** Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël është konstatuar se: nga 34 procedura prokurimi të realizuara në shumën 1,724,768 lekë,	160-176	E Lartë	1. Titullari i Institucionit të analizojë situatën në lidhje me, realizimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, mosrespektimin e afateve kohore të hartimit dhe të dërgimit të regjistrit të parashikimit të prokurimit publik për punë/mallra/shërbime, në DPT dhe në Degën e Thesarit, dhe të nxjerrë përgjegjësitë administrative. 2. Nëpunësi Autorizues të ngrejë menjëherë komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve në zbatim të kërkesave të pikave 42,43,54 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar 3. .NZ të garantojë zbatimin e gjurmës së auditimit për procedurat e prokurimit publik në zbatim të kërkesave të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, me qëllim përdorimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore, moszbatimi i së cilës ka sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit gjithsej në shumën 1,195,437 lekë. 4. Titullari i Institucionit, të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, me qëllim përmirësimin e punës së Njësisë së Prokurimit në drejtim të hartimit, dokumentimit dhe zbatimit të procedurave konform rregullave të prokurimit publik.

	janë realizuarjo në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor në fushën e prokurimeve publike 30 procedura prokurimi në shumën 1,195,437 lekë të cilat konsiderohen efejkt negative në buxhetin e institucionit,të detajuara si më poshtë: -19 procedura prokurimi në shumën 634,427 lekëose 67% e shumës gjithsej të procedurave të realizuara nga 20 procedura prokurimi të realizuara në shumën 940,012 lekë, në vitin 2018. -11 procedura prokurimi në shumën 561,010 lekë ose 71% e shumës gjithsej të procedurave të realizuara nga 14 procedura prokurimi të realizuara në shumën 784,756 lekë në vitin 2019. Konkretisht, të grupuara sipas problematikave: Më konkretisht: **Në 11 procedura prokurimi në shumën 589,713 lek**ëprej të cilave, 8 procedura prokurimi në shumën 365,973 lekë janë realizuar në vitin 2018 dhe 3 procedura prokurimi në shumën 223,740 lekë janë realizuar në vitin 2019janëkonstatuar si vijon: a) Kërkesat për mallra/punë/shërbime nuk janë hartuar nga degët përkatëse, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 dhe pikës 3 të nenit 40 të VKM-së nr.914, datë 19.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. b) Mungesë e procesverbaleve të testimit të tregut dhe të argumentimit e dokumentimit të përllogaritje së fondit limit, veprim ky në kundërshtim mepërcaktimet e nenit 59 të VKM-së nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. c) Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nuk është ngritur komisioni marrjes në dorëzim të mallit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet epikave 42, 43 dhe 54 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar. d) Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk gjendet i administruar vetëdeklarimi me shkrim i kandidatit ose ofertuesit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 15 tëVKM-së nr.914, datë			

	19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar".* e) Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara mungon relacioni përmbledhës sipas kërkesave të nenit 68 të VKM-së nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar".* f) Njësia e prokurimit (funksionale) nuk ka marrë pjesë në asnjë trajnim në fushën e prokurimeve, në kundërshtim me LPP dhe Manualin e Prokurimit ku përcaktohet se, Njësia e prokurimit duhet të kryejë minimumi 1 trajnim në vit. **Në 2 procedura prokurimi të realizuara në vitin 2018, në shumën 49,990 lekë** nuk janë përcaktuar specifikimet teknike, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4 të nenit 23 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin Publik*", i ndryshuar, si dhe përcaktimet e pikës 5 të Udhëzimit nr.3, datë 8.01.2018 "*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", i ndryshuar. **Në 12 procedura prokurimi në shumën 370,464 lekë,** prej të cilave,7 procedura prokurimi në shumën 178,464 lekë janë realizuar në 2018 dhe 5 procedura prokurimi në shumën 192,000 lekë janë realizuar në vitin 2019, janëkonstatuar si vijon: a) Nuk ka një mekanizëm kontrolli bazuar në informacionin mbi gjendjen teknike, raportet mbi dëmtimet dhe avaritë e automjeteve. b) Nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse nuk mbahen kartela për secilin automjet, si dhe nuk ka autorizime për personat që i përdorin ato. c) Në asnjë nga rastet e riparimit të automjetit nuk rezulton të jenë depozituar pranë magazinës së institucionit pjesët e dëmtuara (që janë ndërruar) të këtij automjeti veprime këto që bien ndesh me përcaktimet e pikave 4, 5, 6, 7, 10, 12 dhe 23 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar si dhe me përcaktimet e pikave 1, 2, 4, 12 të nenit 35 të Rregullores së Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore. **Në 5 procedura prokurimi në shumën**			

	185,270 lekë, prej të cilave, 2 procedura në shumën 40,000 lekë janë zhvilluar në vitin 2018 dhe 3 procedura në shumën 145,270 lekë janë zhvilluar në vitin 2019, janë konstatuar parregullsi në nënshkrimin e faturës së mallrave/shërbimeve nga personat e pranishëm për difektin e ndodhur të cilët kanë qenë prezent sipas procesverbalit të konstatimit dhe nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlerë të vogël, veprim ky në kundërshtim përcaktimin e pikës 18 të Udhëzimit nr.3, datë 8.01.2018 "*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", i ndryshuar.			
8	Parregullësi në procedurat për vlerësimin e aktiveve të evidentuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit të vitit 2017 dhe të asgjësuara/tjetërsuara në vitin 2018 të cilat kanë sjellë 151,229 lekë të ardhura të munguara, për buxhetin e institucionit. Më konkretisht: a) Komisioni i vlerësimit të aktiveve nuk ka kryer vlerësimin për aktivet e identifikuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimt, si dhe nuk ka hartuar procesverbal vlerësimi, por ka hartuar vetëm një relacion përmbledhës, në të cilin evidentohen për nxjerrje jashtë përdorimit: Inventar ekonomik nga llog.ek. "218" për 90 artikuj në vlerë fillestare 13,572,907 lekë, amortizimi i akumuluar 13,227,188 lekë dhe vlerë të mbetur 345,719 lekë dhe Instalime teknike, makineri e pajisje" nga llog.ek. 214 gjithsej 4 artikuj në vlerë fillestare 739,060 lekë, amortizimi i akumuluar 661,533 lekë dhe vlerë të mbetur 77,527 lekë, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikave 95,104 dhe 105 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*"i ndryshuar. b) Komisioni i asgjësimit/tjetërsimit të aktiveve nga 94 artikuj të evidentuar për nxjerrje jashtë përdorimit ka asgjësuar vetëm 40 artikuj me vlerë fillestare 1,398,903 lekë dhe vlerë të mbetur 272,017 lekë dhe nuk ka kryer asgjësimin e 54 artikujve me vlerë fillestare 12,913,064 lekë dhe vlerë të mbetur 151,229 lekë, që janë objekt i VKM-së nr.	148-160	E Lartë	1.NA në zbatim të menaxhimit financiar dhe kontrollit të marrë masat për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të një sistemi rregullash dhe procedurash të brendshme në lidhje me dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve të njësisë me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi, keqpërdorimi dhe në çdo rast procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit të mbikqyren dhe konfirmohen nga strukturat e DPT-së. 2. Titullari i Institucionit të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjesitë për moszbatimin e procedurës së ankandit për aktivettë vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit, moszbatimi i së cilës ka sjellë të ardhura të munguara, të paarkëtueshme për buxhetin e institucionit të vitit 2018, në shumën 151,229 lekë.

	957 datë 19.12.2018 "*Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike*", por në relacion shprehet se procedurat e mëtejshme sipas legjislacionit do të ndiqen nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse. c) Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse nuk ka zhvilluar procedurë ankandi, por ia ka dhënë për riciklim Shoqërisë "[redacted]" sh.p.k Katund i Ri Durrës, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 109 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, i ndryshuar. ***Moskryerja e procedurave të ankandit në vlerën e mbetur 151,229 lekë përbën të ardhur të munguar, të paarkëtueshme për buxhetin e institucionit.*** d)Zyra e Financës ka kryer veprimin kontabël duke pakësuar aktivin e pasqyrave financiare në vlerë totale për 14,311,967 lekë përkatësisht llogarinë 218 "Inventar ekonomik" me vlerë fillestare 13,572,907 lekë dhe llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" gjithsej me vlerë fillestare 739,060 lekë referuar vetëm fletë daljes së magazinës, pa bërë kontrollin dhe verifikimin e dokumentacionit autorizues dhe vërtetues, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikave 35 dhe 36 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar.			
9	Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Kontabilitetit të të Ardhurave rezultoi se ky sektor megjithëse ka një sërë detyrash funksionale për periudhën objekt auditimi ka rezultuar me mungesa në organikë (e konkretisht të përgjegjësit të sektorit dhe të një specialisti) pra ka funksionuar pa drejtues dhe të një specialisti, pra dy mungesa në organikë, nga 4 sipas organikës së miratuar gjë që ka ndikuar në përmbushjen të detyrave funksionale në kohë dhe në respektim të dispozitave ligjore. Nga ky sektor u evidentuan mamgësi në lidhje me ndjekjen e këtyre detyrimeve në rrugë administrative në drejtim të bashkive debitore referuar mungesë së shkresave drejtuar bashkive debitore në kohën e krijimit. Mos arkëtimi në kohë i detyrimeve tatimore ndikon dhe në	35-37	E Lartë	Titullari i Institucionit të marrë masat që deri në plotësimin e strukturës, të ndajë përgjegjësitë në punonjësit e tjerë me qëllim eliminimin e mangësive të konstatuara.

	raportimet e kryera në DPT për realizimin e të ardhurave mujore, tre mujore dhe vjetore dhe si rrjedhojë në të ardhurat tatimore vjetore të realizuara nga taksa dhe tatime të derdhura në buxhetin e shtetit, veprime që bien ndesh me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 " Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.			
10	Nga auditimi u konstatua gjendje e lartë e detyrimeve debitorëve, detyrime të cilat kryesisht të krijuar nga viti 2008 e në vazhdim, të cila mbahen në DRT Shkodër jashtë sistemit informatik C@T (sistem informatik i të dhënave sipas tatimpaguesve) por që janë të regjistruara në kontabilitetin e DRT Shkodër, referuar të dhënave nga pasqyrat financiare viti 2018 dhe të vitit 2019, e konkretisht të llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*", sipas burimeve të krijimit, kështu: Në pasqyrat financiare viti 2018, llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*", është në vlerën 19,603,327 lekë, (Aneksi nr.1) detyrime që sipas burimeve të krijimit përbëhen nga: a. Detyrime të pa arkëtuara ndër vite në shumën prej 11,913,051 lekë nga viti 2005, të mbajtura jashtë sistemit informatik tatimor C@TS, detyrime të përbëra për tatim mbi të ardhurat personale (për 1 subjekt), detyrim mbi tatim fitimin (për 1 subjekt), detyrime për TVSh (për 2 subjekte), detyrime për kontribute të sigurimeve shoqërore (për 145 subjekte). Theksojmë se detyrimet e mësipërme janë detyrime, gjoba dhe penalitete të cilat nuk janë arkëtuar deri tani pasi janë subjekte që rezultojnë pa nipt, të çregjistruar nga QKR. Gjithashtu theksojmë se për mungesë dokumentacioni në DRT Shkodër për këto subjekte nuk ka bërë të mundur hedhjen e këtyre detyrimeve në sistemin informatik C@TS të DPT. b. Detyrime në shumën prej 5,026 lekë (1% i pa derdhur), në favor të DRT Shkodër, si agjent tatimor e cila përfaqëson grande nga transferime të pa arkëtuara për detyrime nga institucione si Bashkia Shkodër dhe Fushë Arrës për 1% e në lidhje me arkëtimin pagesën e tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogël. c. Detyrimi në shumën prej 7,685,250 lekë për pulla takse pranë të tretëve (gjendje në	120-146	E Mesme	1. Të meren masa urgjente nga DRTShkodër në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në DPT për trajtimin e gjendjes së lartë të debitorëve të cilat mbahen jashtë sistemit informatik ndër vite dhe të detyrimeve të tjera të rezultuara gjendje në pasqyrat financiare në fund të vitit 2019 duke kryer analizat dhe nxjerrë përgjegjësitë individuale për veprimet dhe mosveprimet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. 2. DRT Shkodër nëpërmjet strukturës së përkatëse (Sektorit të Analizës dhe të Kontabilitetit të Ardhurave), të ndërmarrë iniciativa e duhura administrative dhe ligjore në drejtim të arkëtimit të detyrimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe të ndjekë arkëtimin e detyrimit (për takë pulle e pa përdorur në fund të vitit 2018 dhe 2019) në shumën 6,161,250 lekë,që përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

	fund të vitit e papërdorur në gjykata, prokuroria, bashki të Qarkut të Shkodrës (zyra e gjendjes civile), në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9975, datë 28.02.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.26, datë 04.09.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, të cilat përfitojnë si agjentë tatimorë, komisione në masën prej 5% (zyra e gjendjes civile) dhe gjyqësorit (nga pulla takse) në masën 5% dhe 10% që duhet të derdhin detyrimin ndaj DRT në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Drejtësisë nr.33, datë 29.12.2014 " Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e ministrisë së drejtësisë", "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor shtetëror", prokurorisë dhe noterisë, pasi përfitojnë 10% komisione nga shërbimi që kryhet në gjykatë, prokurori. Detyrimi në vlerë në fund të vitit 2018 është në vlerë 7,685,250 lekë dhe i përket viteve 2017-2018 për 10 subjekte, detyrim i cili është me shpresë arkëtimi pasi arkëtohet në vijimësi nga përdorimi i pullave gjatë vitit 2019. Në fund të vitit 2019, detyrimeve debitorëve janë në shumën prej *18,167,500 lekë (Aneksi 1/1), referuar të dhënave të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" sipas pasqyrave financiare viti 2019 në DRT, e krahasuar me gjendjen në fund të vitit 2018 ka pësuar rënie në shumën prej 1,435,827 lekë ose 7,3% dhe që ka ardhur si pasojë* a. Shtesës së detyrimeve në shumën prej 26,599 lekë, të krijuara nga viti 2017-2019, të cilat janë grande nga transferime të pa arkëtuara për detyrime për 1% e TFTH mbi biznesin e vogël dhe që i përkasin 282 subjekte që i përkasin 5 bashkive (Bashkitë Shkodër, Koplik, Fushë Arrëz, Pukë dhe Vau Dejës). Të ardhurat nga tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël të arkëtuara nga DRT, i përket Bashkisë Shkodër në shumën prej 12,965 lekë, Bashkisë Koplik në shumën prej 5,384 lekë, Bashkisë Fushë Arrëz në shumën prej 1,264 lekë, Bashkisë Pukë në shumën prej 552 lekë, Bashkisë Vau Dejës në shumën prej 6,434 lekë. Ky detyrim është e ardhur për DRT			

	Shkodër në cilësinë e agjentit tatimor në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9975, datë 28.02.2008 " Për taksat kombëtare", i ndryshuar si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.32, datë 31.12.2013 " Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", e pa arkëtuar deri më 31.12.2019. b. Uljes së detyrimit për pulla takse, në shumën 6,227,850 për vitin 2017-2019 për 12 subjekte tatimpagues, e cila përfaqëson detyrimin e pa derdhur për furnizim pulle nga institucionet të drejtësisë Qarku Shkodër dhe të zyrave të gjendjes civile pranë bashkive për përdorimin e taksës së pullës nga të tretët për akte administrative dhe certifikata të gjendjes civile. Ky detyrim i përket pullave deklaruar të pa përdorura gjendje në fund të vitit 2019. Konstatohen mos veprime nga DRT Shkodër nëpërmjet Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave për mbledhjen dhe ndjekjen e detyrimeve, procedura administrative në drejtim të institucioneve përgjegjëse debitore në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9928 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar e cila sjell efekte negative në të ardhurat e DRT Shkodër.			
11	Në DRT Shkodër u konstatua mos lëvrim të mallrave të konfiskuara nga Drejtoria e Hetimit Tatimor në DRT Shkodër nga viti 2012 sipas dispozitave ligjore në Drejtorinë e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit (DPRMSh). Nga auditimi rezultoi se në DRT Shkodër gjenden mallra të konfiskuara nga viti 2012 nga Drejtoria e Hetimit tatimor Shkodër, dhe të bëra hyrje pa fletë analize në magazinë më 31.12.2019 në vlerë prej 282,737,52 lekë të përbëra nga ar në sasi 93.4 gram, argjend në sasi prej 303 gram dhe sermë në sasi prej 497 gram. Këto mallra të konfiskuara nga viti 2012 nuk janë kaluar pranë Drejtorisë së PRMSh, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", neni 2/pika 16, pasi në DRTShkodër nuk janë kryer në kohë këtyre mallrave analizave duke dokumentuar nëpërmjet hartimit të fletë analizës dhe demostruar vërtetësinë që mallrat janë arë, argjend,sermë dhe	146-146	E Mesme	DRT Shkodër të mara masa për lëvrimin e mallrave të sekuestruara në DPRMSH. Në rast se, gjatë dorëzimit konstatohet se mallrat nuk i përgjigjen cilësimeve të bëra në momnentin e konfiskimit, cështja të adresohet në organet kompetente në mënyrë që të nxiren përgjegjësitë administrative dhe ligjore ndaj personat përgjegjës sipas dispozitave ligjore në fuqi.

	përqindjen e tyre. Nga DRT shkodër është kryer një korespondencë në vitin 2018 por pa zgjidhje ndërmjet DPT dhe Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore e cila ka në misionin e saj kryerjen e analizat kimike dhe fizike të mineraleve. Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 112/2016, datë 03.11.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 " Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë " dhe akteve nënligjore si UMF nr.7, datë 10.01.2017" Për disa shtesa në UMF nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në RShqipërisë ", aktualisht nuk parashikohen nga viti viti 2017 e në vazhdim më sekuestrim të mallrave për veprime apo mosveprime të tatimpaguesve, ajentëve tatimor, etj, që bien në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 i ndryshua dhe akteve nënligjore të tij pasi përbëjnë shkelje tatimore administrative dhe kategorizohen në dënime adminitrative. Mos kalimi i mallrave të sekuestruara në (DPRMSh)nga DRTSh nga viti 2012 , bien ndesh meligjit nr.9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", neni 2/pika 16, dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në NJSP ", i ndryshuar pasi nga shitja e tyre realizihen të ardhura të cilat derdhen në buxhetin e shtetit.			
12	Për periudhën objekt auditimi grupi i auditimit ka konstatuar problematika në funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si vijon: a) Aktet dhe dispozitat që rregullojnë funksionimin e institucionit (rregullorja dhe struktura e miratuar), nuk janë në koherencë midis tyre pasi, ndryshimet strukturore të DRT Shkodër nuk janë reflektuar me ndryshime të rregullores. Gjithashtu struktura aktuale e DRT-së, nuk i përgjigjet mbulimit të të gjitha funksioneve të parashikuara, duke krijuar konflikt interesi dhe mbivendosje detyrash. Psh, Drejtori i Funksioneve Mbështetëse që njëkohësisht është dhe NZ i institucionit ka rezultuar që të jetë pjesë e integruar e procedurave të prokurimit me vlera të vogla, që nga procesi i planifikimit të nevojave, prokurimi, marrja në dorëzim, kryerja e transaksionit financiar,	198-209	E Lartë	Titullari i Institucionit, të marrë masa për njohjen dhe implementimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, duke synuar vendosjen e procedurave dhe rregullave të qarta për parandalimin e fenomeneve negative, verifikimeve, autorizimeve, ndarjen e detyrave sipas funksioneve dhe roleve të çdo nëpunësi, zhvillimin e dedikuar profesional të punonjësve me qëllim efektivitetin e sistemeve te kontrollit.

	kontabilizimi i shpenzimeve dhe reflektimi i tyre në pasqyrat financiare të institucionit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 (b), të nenit 22, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar ku shprehimisht citohet: *"Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin".* b) Nga ana e DRT Shkodër nuk janë përgatitur dhe nuk janë dorëzuar brenda afateve ligjore Pyetësorët e Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për vitin 2018 dhe 2019, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 18, të Ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar dhe pikat nr.4 dhe 6, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.28, datë 15.12.2011. c) Procedurat e buxhetimit nuk kanë ndjekur gjurmën standarde të parashikuar në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm. Nga ana e NZ të DRT nuk është përgatitur dokumenti përfundimtar i buxhetit veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 të nenit 12 të të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010; nenit 28 të Rregullores për Funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore; nenit 19 të Rregullores për Funksionimin e Administratës Tatimore Qëndrore, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017. d) Në DRT nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale për: Identifikimin e risqeve që kërcënojnë objektivat e institucionit; Krijimin e regjistrit të risqeve; Caktimin e koordinatorit të risqeve dhe mungon një plan veprimi për menaxhimin e risqeve në fushat e këtij institucioni, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e neneve 10, 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të Ligjit nr.10296/ 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; nenit 30 tëRregullores për Funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore miratuar me			

	urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017. e) Nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e nenit 12**,** të Ligjit nr.10296/2010, i ndryshuar, mbi përgjegjësitë menaxheriale të nëpunësit zbatues për garantimin e gjurmës së auditimit**.** f) NA, NZ dhe drejtuesit e tjerë të strukturave të DRT-së Shkodër nuk zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimin dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin.			
13	Parregullsi në procedurat e inventarizimit të pasurisë për vitet 2018 dhe 2019**.** Më konkretisht: a) Komisionet e inventarizimit në të dy vitet, para fillimit të inventarizimit nuk kanë mbajtur procesverbal me përgjegjësin material, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 83 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*"i ndryshuar. b) Në përfundim të procesit të inventarizimit, komisioni i inventarizimit në vitin 2018, ka identifikuar si të papërdorshëm nga inventari ekonomik 4 artikuj në vlerë fillestare 6,737,839 lekë dhe në vitin 2019 ka identifikuar si të papërdorshëm nga inventari ekonomik 5 artikuj në vlerë fillestare 6,950,839 lekë. Komisioni i inventarizimit, në të dy vitet nuk ka mbajtur procesverbal, por rezultatet i ka pasqyruar vetëm në relacionin përmbledhës, i cili nuk është i miratuar nga titullari i institucionit duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në pikën 85 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar. c) NA nuk ka ngritur komision për vlerësimin e aktiveve, të identifikuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit, as në vitin 2018 dhe as në vitin 2019, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikave 95 dhe 96 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.	148-160	E Lartë	NA dhe NZ të marrin masat, për realizimin dhe monitorimin e procesit të inventarizimit të pasurisë së institucionit në të gjitha fazat si dhe të garantojnë pasqyrimin e saktë të gjendjes së aktiveve të institucionit në pasqyrat financiare vjetore.
14	Në lidhje me përdorimin e automjeteve në pronësi të DRT dhe dokumentimin e lëvizjes së tyre, nga auditimi u konstatua si vijon:	176-197	E Lartë	**1** Titullari i Institucionit çdo fillim viti, të ngrejë një komision për testimin e konsumit të karburantit nga mjetet e transportit i cili të

	a)DRT Shkodër ka aktualisht në përdorim 11 automjetetë cilat nuk mbulohen me drejtues mjeti sipas strukturës së miratuar. Në këto kushte automjetet janë përdorur nga punonjës të ndryshëm të DRT, por në asnjë rast nuk ka autorizim të përdorimit për automjetet të DRT-së ku të përcaktohet drejtuesi i mjetit, targa e mjetit, destinacioni, periudha e lëvizjes, veprime që bien ndesh me përcaktimet e pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik",* i ndryshuar. b) Në fletë udhëtimet e dorëzuara nuk janë evidentuar saktësisht iteneraret që do të përshkruajnë mjetet, si për lëvizjet e brendshme ashtu dhe të jashtme; kilometrat e përshkruara prej lëvizjeve të brendshme arrijnë dy/tre herë më shumë se kilometrat e përshkruara nga lëvizjet e jashtme dhe fletët e udhëtimit rezultojnë të panënshkruara nga punonjësit e administratës për lëvizjet e brendshme, veprim që bien ndesh me përcaktimet e pikës 36, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik",* i ndryshuar. c) Për të njëjtin mjet dhe itinerar sasia e karburantit të konsumuar rezulton e ndryshme në ditë të ndryshme si për lëvizjet e brendshme ashtu dhe të jashtme. d) Për periudhën e audituar nuk rezulton asnjë planifikim mbi sasinë e karburantit që do të përdoret nga institucioni për cdo mjet transporti sipas normativave të konsumit. dh) Nuk ka proces-verbal testimi mjeti për përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për 100 km. Institucioni përdor normat e konsumit të vitit 2015 të përcaktuara nga Drejtoria e Administrimit të DPT-së. e) Nuk ka asnjë urdhër të brendshëm për disiplinimin e shpenzimeve të transportit, për administrimin dhe përdorimin e karburantit. f) Nuk ka kontrolle të shpenzimeve të fondit për karburant që të verifikojnë nëse fondet publike shpenzohen me ligjshmëri, sipas qëllimit dhe afateve të përcaktuara, në përputhje me detyrimet e marra përsipër, veprime këto që bien ndesh me			dokumentohet në një raport, duke përshkruar në rrugë konkrete normativën e konsumit të karburantit për çdo kategori mjet udhëtimi. **2** Strukturat drejtuese të cilat janë përgjegjëse për përdorimin e mjeteve të transportit dhe rrjedhimisht edhe të argumentimit të përdorimit të karburantit të hartojnë fletë udhëtimet duke evidentuar destinacionet përfundimtare të udhëtimit në rrethet përkatëse, mbështetur në specifikat e tyre për inspektim (pra destinacione larg qendrave urbane), me synim shmangien e interpretimeve jo të bazuara në dokumente dhe jo korrekte me aktet ligjore në fuqi.

	përcaktimet e neneve 11,12,16 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.			

I.c.OPINIONI I AUDITIMIT:

I. Opinion mbi pasqyrat financiare

Nga ana e grupit të auditimit është kryer auditimi në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar të KLSH si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë, për pasqyrat financiare të DRT Shkodër për vitin ushtrimor 1 Janar 2019 deri më 31 Dhjetor 2019, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mos përputhshmërisë, individualisht ose së bashku, nuk janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore të kësaj periudhe, por ndërkohë që theksojmë rezervën në lidhje me disa aspekte të cilat janë përmendur gjatë auditimit të pasqyrave finaciare të institucionit.

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, për vitin ushtrimor 2019, vlerat e paraqitura në postet e bilancit dhe të pasqyrave financiare vjetore,*"Në gjykimin e audituesit, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standartet ISSAI 1700*[1]*, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Drejtorisë Rajonale tatimore Shkodër në datën 31 dhjetor 2019 në llogaritë vjetore", duke justifikuar dhënin e një* ***Opinioni të Pakualifikuar***. Nisur ngadisa çështje specifike të lidhura me raportimin financiar përgjithë periudhën nën auditim, të cilat janë materiale por jo thelbësore dhe jo të përhapura të tërheqim vëmendjen për sa cilësohet si theksim cështje.

Baza për theksim të cështjes.

Mos arkëtimi i debitorëve të ndryshëm nga viti 2005 e në vazhdim. Në pasqyrat financiare llogaria "Debitorë të ndryshëm" në vlerën 18,167,500 lekë, përbëhen nga detyrime (cilësuar nga subjekti) pa shpresë arkëtimi në shumën prej 11,913,051 lekë nga viti 2008, të mbajtura jashtë sistemit informatik tatimor C@TS, me vlerën e debitorëve me shpresë arkëtimi prej 26,599 lekë, grande nga transferime të pa arkëtuara për detyrime nga institucione publike si dhe nga detyrimi i pa derdhur për furnizim pulle institucioneve të drejtësisë për përdorimin e taksës së pullës nga të tretë në shumën prej 6,227,850 lekë, për të cilat nuk u konstatua asnjë procedurë administrative nga ana e DRT Shkodër në drejtim të institucioneve përgjegjëse deri në përfundim të periudhës së auditimit.

Mos lëvrimi i mallrave të konfiskuara nga viti 2012 në DPRM Shtetit. Mallra të konfiskuara gjendje në magazinë më 31.12.2019 janë në vlerën 282,737 lekë për ar në sasi 93.4 gram, argjend në sasi prej 303 gram dhe sermë në sasi prej 497 gram. Mallrat e konfiskuara nga viti 2012 nuk janë kaluar pranë DRShtetit në zbatim të ligjit nr.9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të

[1]*Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.*

shtetit", neni 2/pika 16 pasi mallrat nuk janë shoqëruar me fletë analiza për të demonstruar vërtetësinë që mallrat janë arë, argjend, sermë dhe përqindjen e tyre. DRT Shkodër nuk ka vepruar edhe pas konstatimit të lënë gjatë këtij auditimi.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të DRT Shkodër.
Drejtimi i DRT, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi për raportimin financiar dhe të Udhëzimit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*", si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare.
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. <u>Opinion mbi përputhshmërinë me bazën ligjore dhe rregullative në fuqi (ISSAI 4000[2]) të veprimtarisë së DRT Shkodër (pa përfshirë përputhshmërinë në mbledhjen e të ardhurave tatimore)</u>

Ne kemi audituar përputhshmërinë e subjektit sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë). Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë risku, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë operacionale të DRT-së, gjatë periudhave ushtrimore 01.01.2018 deri në 31.12.2019.
Sipas mendimit tonë, gjatë auditimit të veprimtarisë së DRT Shkodër, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur **janë materiale dhe të përhapura** efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një Opinioni të Kundërt.*** Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se: u konstatuan devijime nga kuadri rregullator përsa i përket, problematikave në funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, procedurave të rekrutimit për punonjësit në strukturë, që përfshin të gjitha nivelet

[2] **ISSAI 4000**– Udhërrëfyesi i Auditimit të Përputhshmërisë.

menaxheriale dhe punonjësit me kontratë të përkohshme, procedurat e blerjeve me vlerë të vogël, procedurat e kryerjes së inventarizimit si dhe transaksioneve të kryera për zbatimin e buxhetit të cilat nuk kanë qenë plotësisht në përputhje me kuadrin ligjor e financiar në fuqi.

Baza për Opinionin e Kundërt.

Aktet dhe dispozitat që rregullojnë funksionimin e institucionit (rregullorja dhe struktura e miratuar), nuk janë në koherencë midis tyre pasi, ndryshimet strukturore të DRT Shkodër nuk janë reflektuar me ndryshime të rregullores. Gjithashtu struktura aktuale e DRT-së, nuk i përgjigjet mbulimit të të gjitha funksioneve të parashikuara, duke krijuar konflikt interesi dhe mbivendosje detyrash. Nga ana e DRT Shkodër nuk janë përgatitur dhe nuk janë dorëzuar brenda afateve ligjore Pyetësorët e Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për vitin 2018 dhe 2019. Procedurat e buxhetimit nuk kanë ndjekur gjurmën standarde të parashikuar në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm. Nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e nenit 12**,** të Ligjit nr.10296/2010, i ndryshuar, mbi përgjegjësitë menaxheriale të nëpunësit zbatues për garantimin e gjurmës së auditimit, etj.

Nga auditimi mbi procedurat e rekrutimit të punonjësve dhe kostot e personelit, u konstatuan parregullsi në 12 procedura rekrutimit, për punonjësit në strukturë, që përfshin të gjitha nivelet menaxheriale duke shkaktuar shpenzim në kushtet e paligjshmërisë në total në **shumën 12,244,690 lekë**. Nga totali prej12,244,690 lekë, shuma 515,244 lekë, është konsideruar dëm në buxhetin e shtetit si pasojë e pagesës në 3 (tre) raste të punonjësve me pagë grupi jo në përputhje me nivelin e diplomës. Parregullsi në procedurat e planifikimit, rekrutimit dhe dokumentimit të punës për 54 punonjës me kontratë të përkohshme për të dy vitet, pagesa e të cilëve është konsideruar shpenzim në kushtet e paligjshmërisë **në shumën 12,733,133 lekë**. Parregullsi në respektimin e dispozitave ligjore për shpenzimet për udhëtime e dieta të cilat kanë rezultuar me, shpenzim në kushtet e paligjshmërisë në **shumën 6,353,100 lekë** nga ku vlefta prej 777,735 lekë konsiderohen dëm në buxhetin e shtetit.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlera të vogla,rezultuan shpenzime në kushtet e paligjshmërisë, në total në **shumën 1,195,437 lekë**. Ndërkohë, lidhur me konsumin e karburantit rezultuan shkelje të disiplinës financiare me efekt negativ për buxhetin e shtetit në vitin 2018 në **shumën 909,593 lekë** dhe në vitin 2019 në **shumën 1,782,834 lekë** (për automjetet) dhe **në shumën 77,789 lekë** në vitin 2018 dhe **40,160 lekë** në vitin 2019 (për përdorimin e kartës GOLD).

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Programit të Auditimit nr.55/1, datë 20.01.2020, ndryshuar me nr.55/2, datë 20.02.2020, miratuar nga Kryetari i KLSH, në subjektin Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër,u krye "Auditim financiar dhe i përputhshmërisë" nga Grupi i Auditimit me këtëpërbërje:

1. [redacted], Përgjegjës Grupi
2. [redacted], Audites
3. [redacted], Audites

Titulli: Mbi Auditimin Financiardhe tëPërputhshmërisë nëDrejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër.

a. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:Në zbatim të programit të auditimit objektivi kryesor është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare të institucionit për vitin 2018, 2019 dhe përputhshmëria ligjore në lidhje me prokurimin e mallra dhe shërbimeve (planifikimi i nevojave, prokurimi, marrja në dorëzim dhe zbatimi i kontratave të mallrave/shërbimeve/punimeve).
Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi nëse transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë, në çdo aspekt material, në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar në sektorin publik si dhe vlerësimi që prokurimi i mallrave dhe shpenzimeve realizohet në përputhje me ligjin e prokurimit dhe aktet ligjore në zbatim të tij.

b.Identifikimi i çështjes: Për ushtrimin e aktivitetit, DRT Shkodër mbështetet në Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë";Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore dalë në zbatim të tij si dhe vendimet teknike të DPT;Ligjin nr.9928 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar;Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006"Për Prokurimin Publik" i ndryshuar;Ligjin nr.109/2017 "Për Buxhetin e Vitit 2018";Ligjin nr.99/2018 "Për Buxhetin e Vitit 2019" dhe udhëzimet dhe aktet normative të dala në zbatim të tyre.

c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. Drejtorët Rajonale të Tatimeve (*Nëpunësi autorizues*) sipas periudhave respektive: z. [redacted], për periudhën 01.01.2018-08.07.2019 dhe z. [redacted] për periudhën 25.07.2019 -31.12.2019 si dhe Drejtori i Funksioneve Mbështetëse (NZ), znj. [redacted] janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të DRT-së si dhe janë përgjegjës për përputhshmërinë e vepimtarisë së DRT me kuadrin ligjor në fuqi për sistemin tatimor në Republikën e Shqipërisë.

d. Përgjegjësitë e audituesve.Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar. Në këtë funksion, auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri (*apo në përputhje*) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut, audituesit vlerësuan nivelin e kontrollit të brendshëm që është relevant në entitet, në mënyrë që të programonim procedurat e auditimit që janë të përshtatshme

për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit, përputhshmërinë ligjore në lidhje me prokurimin e mallra dhe shërbimeve si dhe përputhshmërinë e aktivitetit të DRT me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

e. Kriteret e vlerësimit: Për kryerjen e këtij auditmi, në lidhje me dhënien e opinionit mbipasqyrat financiare të institucionit për vitin 2018, 2019 dhe përputhshmërinëligjore në lidhje me prokurimin e mallra dhe shërbimeve (planifikimi i nevojave, prokurimi, marrja në dorëzim dhe zbatimi i kontratave të mallrave/shërbimeve/punimeve), si dhe përputhshmërinë e aktivitetit të DRT me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin bazohen në:
-Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, si dhe të gjithaaktet ligjore dhe nënligjore dalë në zbatim të tij si dhe vendimet teknike të DPT;
-Ligjin nr.9928 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar;
-Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
-Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar;
-Ligjinnr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë";
-Ligjin nr.109/2017 "Për Buxhetin e Vitit 2018", udhëzime dhe akte normative të dala në zbatim të tij;
-Ligjin nr.99/2018 "Për Buxhetin e Vitit 2019" udhëzime dhe akte normative të dala në zbatim të tij;
-VKM nr.400, datë 22.04.2009 'Për përcaktimin e detyrave dhe funksioneve të Drejtorisë së Hetimit Tatimor";
-VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar;
-Urdhri i Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 "Për miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore", i ndryshuar;
-Udhëzimi MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;
-Rregulloren e brendshme të DPT dhe Rregulloren e brendshme të DRT miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017;
-Manualin e Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së, etj.

f. Standardet e auditimit: Auditimi u bazua në Ligjin nr.154/14, datë 27.11.14 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, referenca të tjera ligjore dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit:
-ISSAI 100 - (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.
-ISSAI 200 - (Parimet themelore të auditimit financiar) që përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të pasqyrave financiare,

-Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) të Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve IFAC,
-Manualin e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve,
-Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi auditimin financiar",
-Kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS),
-Në praktikat më të mira të fushës.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

Informacioni i Përgjithshëm: Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër (DRT) është institucion publik, buxhetor, në varësi të drejtëpërdrejtë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila është në varësi administrative të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë .

Misioni i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve është mbledhja e detyrimeve tatimore, ofrimi i shërbimeve dhe asistencës për tatimpaguesit, kontrolli i deklaratave dhe pagesave, kontrolli i tatimpaguesve si dhe mbledhja e borxhit tatimor.

Objektivat e përgjithshme të DRT-së

- Të sigurojnë ndërmarrjen e të gjithë veprimeve në aktivitetin e tyre të cilat cojnë në zbatimin rigoroz të planit strategjik të administratës tatimore qëndrore.
- Të mbledhin të ardhurat tatimore në përputhje me procedurat e përcaktuara nëlegjislacionin tatimor në fuqi me koston më të ulët të mundshme, nëpërmjet nxitjes dhe vetëvlerësimit e plotësimit vullnetar të detyrimeve nga tatimpaguesit dhe nëpërmjet kontrolleve të paanshme për të gjithë tatimpaguesit, për të zbuluar dhe korrigjuar rastet e moszbatimit të ligjeve tatimore.
- Të bashkëpunojnë me drejtoritë përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e planit operacional në përputhje me objektivat e vendosura nëplanin strategjik të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Të përcaktojnë plane operacionale vjetore me shkrim për çdo funksion.
- Të bashkëpunojnë me strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për trajnimin e punonjësve.
- Të hartojnë dhe zbatojnë programe në mënyrë qëpërgjegjësit të përgatisin raporte me shkrim për vlerësimin e punës së kryer gjatë vitit nga punonjësit nën varësinë e tyre.
- Të ndjekin të gjitha procedurat standarde të punës, të përcaktuara nga drejtoritëfunksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

<u>Dokumentimi i rezultateve të auditimit:</u>
Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesive dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.
Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatitën Projekt Raporti i Auditimit dhe Raporti Përfundimtar i Auditimit.

Baza për Opinionin

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e manualit të auditimit financiar dhe manualit të auditimit të pë rputhshmë risë të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit financiar të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit. Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar tek pjesa, Përgjegjësitë e Audituesit. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet, KLSH është e pavarur nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve dhe përgjegjësitë e tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar:

Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në DRT, është realizuar në mbështetje të ligjit nr.9928 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar*"*dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara edhe shoqërohen me relacion shpjegues. (*pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare*).

Qasja dhe metodologjia e auditimit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesi e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zë rat e shpenzimeve të planifikuara për t'u audituar.
Nën gjykimin profesional të audituesit, grupi i punës ka marrë në konsideratë pragun e materialitetit prej **2%,** vlerën **2,458,337** lekë për vitin 2018 dhe pragun e materialitetit prej **2%,** vlerën **2,396,616** lekë për vitin 2019. Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti.

Mbi vlerësimin e riskut.

Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit.
Më poshtë po citojmë disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:
- Kontrolli i brendshëm:

Mungesa e një sistemi të konsoliduar të menaxhimit financiar dhe kontrollit ka bërë që kontrolli i brendshëm në DRTtë mos ketë funksionuar i plotë, duke mos përfshirë të gjithë veprimtarinë e njësisë ekonomike, si rrjedhim KB nuk ka ndihmuar në verifikimin e realizimit të detyrave dhe njësia ekonomike dhe nuk ka mundur të zbulojë ku kanë ndodhur parregullsitë, shmangiet nga normat dhe kriteret e veprimtarisë ekonomike. Zbatimi i rregullt i procedurave të kontrollit të brendshëm shërben për ti siguruar menaxherët se pasuria e njësisë është e mbrojtur, të dhënat e përpunuara në kontabilitet janë të besueshme.

- Konfirmimet nga të tretët:

Subjekti që auditohet nuk ka të konfirmuara (*Rakorduara)* me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose regjistrimeve të tjera.

- Transaksionet:

Bazuar në vlerën e materialitetit të përllogaritur **2,458,337** lekë për r vitin 2018 dhe **2,396,616** lekë për vitin 2019 u filtruan:

- Me zgjedhje Urdhër Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat në total për vitin 2018 kapin shumën 114,483 mijë lekë dhe për vitin 2019, kapin shumën 113,139 mijë lekë ;
- Të gjitha Urdhër Shpenzimet për udhëtim e dieta në shumën totale 6,790,650 lekë , nga të cilat 4,709,950 lekë në vitin 2018 dhe 2,080,700 lekë në vitin 2019;
- Të gjitha Urdhër Shpenzimet për prokurimet me vlera të vogla në shumën totale prej 1,724,768 lekë, nga të cilat 940,012 lekë të realizuara, në vitin 2018 dhe 784,756 lekë të realizuara në vitin 2019.

Urdhër Shpenzimet e filtruara u audituan në funksion të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik" për regjistrimin e veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si; Dokumentet autorizues, Dokumente vërtetues, Dokumente të kontabilitetit, etj.

- Kontabiliteti:

Ligji nr.9928 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar, përcaktohen parimet-bazë për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, në përputhje me këtë ligj, si dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, publikuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. (SKK 1) i përmirësuar.

Mosaplikimi i rregullave kontabël mbi bazën e parimit të kontabilitetit pra mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Me qëllim që të përmbushin objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj metode, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen në pasqyrat financiare kur ato ndodhin (dhe jo kur paraja ose ekuivalentet e saj arkëtohen ose paguhen) dhe regjistrohen në kontabilitet dhe raportohen në pasqyrat financiare të periudhave kontabël, të cilave u përkasin. Pasqyrat financiare, të përgatitura në bazë të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, i informojnë përdoruesit jo vetëm mbi transaksionet e shkuara të shoqëruara me arkëtime dhe pagesa, por edhe mbi detyrimet për t'u paguar në të ardhmen si dhe mbi aktive që do të sjellin arkëtime në të ardhmen. Në këtë mënyrë, ato paraqesin informacione mbi transaksionet dhe ngjarjet e shkuara të cilat u shërbejnë përdoruesve më së miri në marrjen e vendimeve ekonomike.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Konkretisht përcaktimi i riskut dhe materialitetit për DRT Shkodër për vitet 2018 e 2019, në lidhje me shpenzimet paraqitet në tabelën nr.1 si më poshtë vijon:

Materialiteti i përllogaritur mbi shpenzimet faktike të realizuara, për vitet 2018-2019.

Tabela nr.1

	Viti 2018	**Viti 2019**

Emërtimi i Shpenzimeve	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar	Vlera e Popullatës	Faktori i Riskut (0.7-2-3)	Çështje për tu shqyrtuar
Paga (600)	98,221,757	0.70	34	97,015,307	0.70	35
Sigurime Shoqërore (601)	16,260,961	0.70	6	16,124,498	0.70	6
Mallra e Shërbime (602)	8,249,506	0.70	3	5,411,032	0.70	2
Investime të brend. (230-231)	0	2.00	0	0	2.00	0
Te tjera transfer. korrente (606)	184,640	0.70	0	1,279,960	0.70	0
Total	**122,916,864**	**43**		**119,830,797**	**43**	
Materialiteti në %	2%			2%		
Materialiteti në vlerë	**2,458,337**			**2,396,616**		
Kalkulimi i precizionit						
Materialiteti	**2,458,337**			**2,396,616**		
Gabimi i lejuar (10% - 20%)	245,834			239,662		
Nëntotali	**2,212,504**			**2,156,954**		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%			90%		
Vlera e precizionit	**1,991,253**			**1,941,259**		

Burimi i të dhënave: DRT Shkodër

Çështjet kryesore të Auditimit: Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje të cilat në gjykimin tonë, kanë rezultuar më të rëndësishmet në bazë të vlerësimit të risqeve të identifikuara në fazën e parë të auditimit si dhe çështjeve të dala gjatë auditimit mbi aktivitetin e DRT Shkodër. Çështjet kryesore në auditimin e aktivitetit të këtij Institucioni në lidhje me auditimin financiar dhe të për rputhshmë risë paraqiten bazuar në Programin e Auditimit, si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

IV/1. Auditimi i saktësisë dhe rregullshmërisë sëpërpilimit të pasqyrave financiare tëtë ardhurave tatimore për vitet 2018; 2019, rakordimit periodik me Degën e Thesarit Shkodër dhe raportimit të të ardhurave në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Auditimi u bazua në:
- Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 " Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligjin nr.9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar ;
- Ligjin nr.9632, datë 19.05.2008 "Për taksat vendore ", i ndryshuar;
-Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993" Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9136, datë 11.09.2003 " Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligjin nr.109/2017, datë 30.11.2017 " Për buxhetin e vitit 2018", i ndryshuar;

- Ligjin nr.99/2018 " Për buxhetin e vitit 2019", i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr.2, datë 06.02.2012 " Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr.26, datë 04.09.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar ;
-Udhëzimi i MF nr.32, datë 31.12.2013 "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", i ndryshuar ;
- Udhëzimi i MF dhe MD nr.33, datë 29.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e ministrisë së drejtësisë , " Për shërbimin përmbarimor gjyqësor "shtetëror", prokurorisë dhe noterisë";
- Shkresa e DPT nr.2921/1, datë 16.02.2018 , drejtuar DRTShkodër;
- Shkresa e DPT nr.15 125/1, datë 27.07.2018, drejtuar DRTShkodër;
- Shkresa e DPT nr. 20537/1, datë 08.10.2018 drejtuar DRTShkodër;
- Shkresa e DPT nr. 2259/1, datë 01.03.2019 drejtuar DRTShkodër;
- Shkresa e DPT nr. 9515, datë 09.05.2019 drejtuar DRTShkodër;
- Shkresa e DPT nr. 9355, datë 03.06.2019 drejtuar DRTShkodër;
- Shkresa e DPT nr. 21474/1, datë 11.12.2019 drejtuar DRTShkodër;
- Aktrakordimet e mbajtura për të ardhurat dhe evidencave të tyre nga Sektori i Analizës dhe i Kontabilitetit të tëArdhurave dhe të Sektorit të Financës të Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse dhe Kontabilitetitnë DRT dhe raporteve të sistemit informatik C@TS.
- Informacionet të dërguara me e-mailin zyrtar, nga DPT dhe DRT .

a-*Të ardhurat tatimore, evidentimi dhe regjistrimi* .

Nga auditimi u evidentua që të ardhurat taimore në bazë (deklarate), arkëtohen në një llogari të vetme në DPT, e cila nëpërmjet strukturës përkatëse Drejtorisësë Analizës dhe të Kontabilitetit të të Ardhurave evidenton, rregjistron dhe përpilon pasqyrat financiare të të ardhurave tatimore për të gjitha DRT nëpërmjet dy sistemeve informatike Etax dhe SIFQ.
Ndërsa DRT e konkretisht nga DRT Shkodër nëpërmjet Sektori i Analizës dhe i Kontabilitetit të të Ardhura kryen ndjekjen e realizimit tëarkëtimit të ardhurave nga subjektet tatimpaguese të Qarkut Shkodër nga sistemi informatik E Tax duke përgatitur raporte për këtë qëlim me qëlim monitorimin e tyre.

E konkretisht ky proces më hollësisht paraqitet si më poshtë vijon:

DPT.
- Duke filluar nga 05 Janar 2015 DPT i arkëton të ardhurat nga tatimet në një llogari të vetme, pra në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatime **është përqëndruar arkëtimi i të ardhuravetatimore** në rang kombëtar.Shkëmbimi i të dhënave me MFE është në mënyrë automatike si rezultat i ndërveprimit automatik të dy sistemeve informtaikë, E tax dhe SIFQ. Pagesat mbërrijnë në sistemin E tax nga bankat e nivelit të dytë si pagesa të jashtme dhe nga Sistemi i Thesarit (për të gjithë subjektet që kryejnë pagesa nëpërmjet buxhetit të shtetit) si pagesa të brëndshme në mënyrë elektronike.
Pas procesit automatik të kontabilizimit të pagesave në sistemin E tax, në llogarinë e çdo Tatimpaguesi raportimi i të dhënave lidhur me arkëtimet **për llogari të DRT (ku përfshihet dhe**

DRT Shkodër) në Sistemin Informatik Qëndror Financiar (SIQF) bëhet çdo ditë në mënyrë automatike.
Në fund të çdo periudhe raportuese (mujore dhe progresive),**DPT** bën kontroll të raportimeve lidhur me arkëtimet e kontabilizuara në sistemin E Tax në nivel të DRT.
Raportimi mujor dhe progresiv finalizohet në fund viti duke nënshkruar evidencën përfundimtare nëpërmjet përfaqsuesit të Degës së Thesarit Tiranë dhe DPT.

DRT Shkodër realizon:

- Monitorimin e realizimit të të ardhurave tatimore e përqëndruar në një llogari të qendërzuar në DPT dhe ardhurave dytësore nga subjektet Tatimpagues në DRT Shkodër dhe përgatit në fund të çdo muaji dhe tremujori raporte dhe evidenca për DPT dhe Titullarin e institucionit për realizimin e treguesve të ardhurave tatimore si dhe evidencat për evidencat e detyrimeve debitore që mbahen jashtë sistemit informatic C@TS.

Për vitin 2018, Sektori i Analizës dhe i Kontabilitetit të të Ardhurave në varësi të Drejtorisë së Analizës dhe IT ka pasur strukturë në organikë tëpërbërënga tre punonjës në organikë, njëPërgjegjës Sektori dhe dy inspektorë të dytë në bazë tëUrdhrit të Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore ".

Për vitin 2019, struktura është miratuar me Urdhrin nr.49, datë 27.02.2019 të Kryeministrit kjo strukturëme emërtesë Sektori i Analizës dhe i Kontabilitetit të të Ardhurave dhe ka në përbërje 4 punonjës në organike dhe është në varësi të Titullarit të DRT e përbërë nga4 persona në organikë, një përgjegjës sektori dhe tre inspektorë të dytë.

Aktualisht në këtë sektor punojnë dy inspektorë të dytë, pra me mungesë 2 punonjës në organikë, të cilët janë e një përgjegjësi të sektorit dhe tënjë specialist gjë që ndikon në perfomancën e këtij sektori dhe në realizimin e objektivave të punës së tyre në drejtim të realizimit të të ardhurave dhe të ndjekjes së detyrimeve debitorëve dhe të detyrave të tjera të përcaktuara në rregulloren e institucionit.
Mungesa si e përgjegjësit të sektorit i cili menaxhon punën e sektorit dhe të një specilalisti ka ndikuar në realizimin në kohë dhe sipas dispozitave ligjore të detyrave që ka ky sektor në menaxhimin e të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, e konkretisht:
-Nga auditimi rezultonse kemi mosarkëtim të detyrimeve nga bashki të Qarkut Shkodër të pagesës së 1% të TFTH mbi biznesin e vogël nga viti 2017gjendje në fund të vitit 2018 nga dy Bashki dhe për vitin 2019 nga 5 Bashki të Qarkut Shkodër, gjithashtu dhe detyrime në fund të vitit 2018 dhe 2019 nga mosarkëtimi në kohë të taksës së pullave takse për subjekte dhe institucione si gjyqësori dhe zyra të gjendjes civile.
Kjo ka ardhur si rezultat se ndjekja e detyrimeve si për 1% e TFTH dhe për furnizim pulle të institucioneve gjyqësore dhe zyrat e gjendjes vivile pranë bashkive të Qarkut Shkodër, nga DRTSH nëpërmjet Sektorit të Analizës dhe i Kontabilitetit të të Ardhurave ka rezultuar problematike pasi nuk janë ndërmarrë sipas viteve të krijimit të detyrimeve procedura administrative ndaj subjekteve problematikëe cila do të analizohet si më poshtë vijon.

Konstatim: Nga auditimi rezulton se bazuar në Vendimin nr.676, datë 12.12.2018 të DPT " Për zëvëndësim për shkak të ligjit dhe ushtrim funksionesh" të zv/Titullarit të Përgjithshëm të DPT z.xxxxx aktualisht në pozicionin e përgjegjësit të Sektorit të Kontabilitetit të të Ardhurave caktohet të ushtrojë detyrën e Drejtorit të Kontrollit Tatimor dhe përfundimisht nga viti 2019 e në vazhdim Sektori i Analizës dhe i Kontabilitetit të të Ardhura rezultan i pa plotësuar me numrin e përcaktuar në organikë për një përgjegjës sektori dhe një inspektor i dytë referuar Urdhrit nr.49, datë 27.02.2019 të Kryeministrit.

Organizimi dhe funksionimi i këtij Sektori :

Ky sektor në zbatim të detyrave funksionale përgatit raporte sasiore dhe cilësore në lidhje me analizën e treguesve të realizuar nga DRTShkodër për planin e të ardhurave.Dërgimi i informacionit të pagesave për çdo ditë dhe muaj nga Sektori i Analizës dhe i Kontabilitetit të të Ardhurave nga DRT në DPT bëhet për të ardhurat tatimore të realizuara nga sistemi (në bazë deklarate) dhe jashtë sistemit si të ardhuradytësore (jo tatimore) të kryera nga shërbimet që kryen së bashku me detyrimet për katëse. Gjithashtu kryen dhe rakordimet me institucionet përkatëse për shërbimet që kryen si bashkitë e Qarkut Shkodër (për 1% e TFTH), me institucionet e drejtësisë për furnizimet e kryera me pulla, realizimin e të ardhurave , si dhe të detyrimeve përkatëse .

DRTShkodër gjatë ushtrimit të veprimtarisë kryen dhe ofron shërbime për të tretët sipas dispozitave ligjore në fuqi:

Konkretisht në rolin e agjentit tatimor, DRT Shkodër përfiton në masën 1% të të ardhurave të arkëtuara të tatimit të thjeshtuar mbi fitimi të arkëtuar për llogari të bashkive të Qarkut Shkodër në bazë të Udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013 " Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël ", neni 11/a,b, ku përcaktohet për shërbimin e kryer Administrata Tatimore Rajonale mban 1% të arkëtimit nga e kryera për llogari të qeverisjes vendores, shumë e cila derdhet për llogari të DPT në buxhetin e shtetit.

Për këto të ardhura që realizohen nga Sektori i Analizës dhe i Kontabilitetit të të Ardhurave në DRT Shkodër rregjistron shumat e arkëtuara në kredi të llogarisë 4481100 "Agjent shërbimesh të vitit në vazhdim", me kartela analitike për çdo bashki dhe Njësi Administrative për administrimin e tatim të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, dhepër këtë qëllim mbahen gjithashtuaktrakordime për të ardhurat e realizuara dhe të derdhura për llogari të DPT për në buxhetin e shtetit me degën e thesarit në fund të vitit.

Gjithashtu nga sektori i analizës dhe i kontabilitetit të të ardhurave në DRT Shkodër mbahen aktrakordime:
Për arkëtimet e 1% , të ardhura të përfituara si agjent tatimor për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin me bashkitë për shumat e transferuara nga bashkitë duke evidentuar gjithashtu dhe detyrimet për mosderdhje në kohë të këtij detyrimi dhe me degën e thesarit. Në fund të vititnga ky sektor përpilohet pasqyra financiare e të ardhurave të realizuara nga DRT Shkodër së bashku me detyrimet përkatëse duke përfshirë dhe detyrimet debitore të krijuara ndër vite (nga viti 2008 e

deri mëvitin 2011)që rezultojnë pa dokumenta të rregullta që mbahen jashtë sistemit informatik të tatimeve.
Kryerja e këtyre detyrave në kohë dhe në cilësi kërkon angazhimin e strukturës së këtij sektori ku rezulton nga auditimi me mungesa në organikëprej 2 punonjës gjë që e bën të vështirë mbajtjen dhe hartimin e akteve me cilësi dhe analitike sipas dispozitave ligjore në kohë, sikurse u evidentuan në auditimin e detyrimeve debitore në fund të vitit 2018, 2019 kundrejt bashkive problematike në derdhjen e 1% të TFTH mbi biznesin e vogël.

Titulli i gjetjes: Mosplotësimi i organikës së Sektorit të Analizës dhe i Kontabilitetit të të Ardhuarve e konkretisht të drejtuesit të saj dhe të një specialisti të të ardhurave ka ndikuar në realizimin e detyrave dhe në performancën e Sektorit të Analizës dhe të Kontabilitetit të të Ardhurave në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, i cili monitoron realizimin e të ardhurave tatimore,e jo tatimore si dhe detyrimet përkatëse.

Situata: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave rezultoi se ky sektor në përmbushje të detyrave funksionale rezultoi me mungesë të organikës së këtij sektori e cila ndikon në realizimin në kohë të detyrave të realizimit të të ardhurave tatimore dhe jo tatimore sikurse është kryerja në kohë e evidentimit me kartela analitike për çdo bashki dhe komunë të ardhurave të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël sipas subjekteve tatimpaguese, mbajtja e aktrakordimeve për realizimin e të ardhurave të taksave kombëtare nga subjekte të TFTH mbi biznesin e vogël me bashkitë e Qarkut Shkodër dhe me degën e thesarit si dhe të rakordimeve në lidhje me arkëtimet e kryera nga përdorimi i pullave nga institucionet e drejtësisë dhe zyrat e gjendjes civile të Qarkut Shkodër, dhe të detyrimeve përkatse. Në fund të **vitit 2018** rezulton se nuk kanë derdhur detyrimin në masën 1% të vitit 2018 Bashkia Shkodër në shumën prej 4,466 lekë dhe bashkia Fushë Arrës në shumën prej 560 lekë në total detyrimi në shumën **prej 5,026 lekë nga viti 2017 - 2018 që i përket 282 subjekteve tatimpaguese**dhe **për vitin 2019 në shumën prej 26,599 lekë që i përket 358 subjekteve tatimpaguese nga viti 2017-2019 për** 5 bashki(Shkodër, Koplik, Vau i Dejës, Pukë dhe Fushë Arrëz**)** sipas aktrakordimeve të mbajtura nga ky sektor, detyrim ky që duhej arkëtuar nga momenti që është transferuar fondi i arkëtuar nga DRT Shkodër nëpërmjet degës së thesarit.
Gjithashtu në zbatim të detyrave funksionale ky sektor kryen dhe evidentimin e tyre në regjistrat përkatës të detyrimeve si për TFTH sipas subjekteve tatimpaguese si dhe me institucione të gjyqësorit si gjykata dhe prokurori në lidhje me arkëtimin e taksës kombëtare së pullës në masën 90% dhe 95% si dhe ndjekjen e detyrimeve përkatëse duke kryer rakordimet përkatëse për përdorimin e pullave sipas çimeve në sasi çdo tremujor dhe në fund të vitit rezultuan problematike në kryerjen në kohë të tyre.

Rezultoi se deri në fund të auditimit nuk u arkëtuan detyrimet për 1% e TFTH gjëndje në fund të vitit 2018 dhe në fund të vitit 2019 dhe nga ky sektor nuk u evidentuan shkresa për marrje masash administrative në drejtim të bashkive debitore. Mos arkëtimi në kohë i detyrimeve tatimore ndikon dhe në raportimet e kryera në DPT për realizimin e të ardhurave mujore, tre mujore dhe vjetore dhe si rrjedhojë në të ardhurat tatimore vjetore të realizuara nga taksa dhe tatime të derdhura në buxhetin e shtetit.

Kriteri: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 " Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Urdhrit të Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore " për vitin 2018, dhe për vitin 2019 kjo strukturë është miratuar me Urdhrin nr.49, datë 27.02.2019 të Kryeministrit.

Ndikimi /Efekti: Në monitorimin e procesit të realizimit të ardhurave tatimore dhe jotatimore të planifikuara dhe detyrimeve që lidhen me to.

Rëndësia : I lartë.

Rekomandimi: Nga ana e institucionit të ndërmeren procedura ligjore në drejtim të plotësimit të organikës së këtij sektori me qëllim përmbushjen dhe realizimin e detyrave dhe objektivave në kohë, e konkretisht në monitorimin e të ardhurave dhe ndjekjen e detyrimeve tatimore.

Afati i zbatimit : Deri në fund të vitit 2020.

Procedura e mbledhjes së të ardhura në DRT dhe transferimit të të ardhurave sipas burimeve të krijimit paraqitet sipas skemës së mëposhtme:



Burimi :Të dhëna nga sistemi C@TS

DRT realizon gjatë veprimtarisë së saj për ushtrimin e detyrave dhe të ardhura dytësore të cilat janë :

a- Nga komisionet që përfitojnë agjentët e taksave në zbatim të ligjit nr.9975, datë 28.07.2008 " Për taksat kombëtare", i ndryshuar sipas nenit 8-Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave, e cila transferohet në rrugë buxhetore nëpërmjet transferimit të fondeve nga buxheti i njësive vendore dhe të Udhëzimit e MF nr.32, datë 31.12.2013 "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", i ndryshuar, pika 10,pika11.
E konkretisht DRT në zbatim të ligjit 9632, datë 30.12.2006 "Për taksat vendore"i ndryshuar me ligjin nr.181/2013, neni 17- Administrimi i tatimeve. Theksohet që DPT nëpërmjet DRT janë të ngarkuar me vlerësimin , mbledhjen , kontrollin, arkëtimin dhe transferimin e Tatimit të Thjeshtuar mbi Ftimin (TFTH) mbi biznesin e vogël dhe transferimin në llogari të buxhetit të bashkive dhe sipas nenit 18-përfiton një komision në masën 1% të të ardhura të realizuara të cilën e transferon për llogari të buxhetit të shtetit.
E konkretisht :
Ardhurat nga TFTH .
Për vitin 2018 nga komisionet e përfituara në masën 1% të TFTH mbi biznesin e vogël është realizuar një e ardhur në shumën **prej 101,100 lekë** dhe për vitin **2019** në shumën prej **60, 799 lekë** e cila është derdhur në buxhetin e shtetit. Numri i subjekteve tatimpaguese për TFTH për Qarkun Shkodër për vitin 2018 është **282 subjekte** tatimpaguese dhe për vitin 2019 është **358** subjekte tatimaguese**.**
b- Nga shitja e shtypshkrimeve si fatura tatimore, fatura shoqërimi, dëftesë tatimore si dhe bileta transporti rrugor, etj për vitin 2018 janë realizuar të ardhura në shumën prej **6,490,878 lekë** ndhe për vitin 2019 në shumën **prej 6,827,442 lekë** referuar aktrakordimeve për të ardhurat jo tatimore të mbledhura nga administrata taimore Shkodër me degën e thesarit më datën 08.01.2019 për vitin 2018 dhe për vitin 2019 më 13.01.2020. Shitjet e kryera nga DRT Shkodër të shtypshkrimeve paraqiten si më poshtë:

Shitur viti 2018	Njësia e matjes	sasi	Vlerë / lekë
Fature Tatimore	cope	9,659	3,477,240
Fature Mod.4	cope	846	106,596
Fature Shoqerimi	cope	2,408	899,280
Deftese Tatimore	cope	2,241	282,366
Bileta	cope		1,725,396
Shuma			6,490,878

Shitur viti 2019	Njesia e matjes	sasi	Vlerë / lekë
Fature Tatimore	cope	8,561	3,415,578
Fature Mod.4	cope	581	75,726
Fature Shoqerimi	cope	2,183	848,160
Deftese Tatimore	cope	1,890	284,214

Bileta	cope		2,203,764
Shuma			6,827,442

DRT referuar detyrave funksionale nëpërmjet Sektorit të Analizës dhe të Kontabilitetit të të Ardhurave është dhe evidentimi i detyrimeve debitore dhe kreditore nga zbatimi i kërkesave të :

- Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar;
- nenit 2/4- Agjenti i taksave dhe tarifave është personi i cili sipas kërkesave të ligjit është përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin, dhe transferimin në llogari të DRTatimore për t'u transferuar në buxhetin e shtetit të ardhurat nga taksa dhe tarifa;
- nenit 3-Llojet e taksave, pika 5 -Taksë kombëtare janë dhe taksat e akteve të pullës;

nenit 5- Agjentët e taksës pika d për vjeljen e taksës së pullës dhe të akteve ngarkohen**Zyrat e Gjendjes Civile pranë Bashkive** të cilat **për shërbimin** që kryejnë përfitojnë në masën prej **5%** në rrugë buxhetore.

Nga ky sektor **mbahen evidenca për detyrimet për arkëtimet të taksës kombëtare së pullës dhe të akteve për zyrat e gjëndjes civile në bashki dhe në gjykata, prokuroi dhe noteri në masën 90%, 95% , të ardhura të cilat derdhen në buxhetin e shtetit si të ardhura tatimorenë bazë të** Udhëzimit tëMF dhe MD nr.33, datë 29.12.2014 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e Ministrisë së Drejtësisë, " Për shërbimin përmbarimor gjyqësor "shtetëror", prokurorisë dhe noterisë" pika 12.- Ku përcaktohet se administrata e gjykatave, prokurorisë , Ministria e Drejtësisë dhe Posta Shqiptare në cilësinë e agjentit tatimor të mbledhjes së tarifës së pullës **dhe për shërbimet** e kryera nga gjykata, prokurori, administrata e gjyqësorit **përfitojnë 10% komision. Institucionet e gjyqësorit** derdhin për llogari të DRT arkëtime nga taksa e pullës në momentin e kryerjes së veprimeve me anë të pullës për tarifat fikse e shprehur në masën 90%,95% (që përbëjnë të ardhura tatimore) si **dhe të të ardhura jo tatimore në masën e 1% të TTHF nga bashkitë, e ardhur kjo që derdhet në buxhetin e shtetit në zbatim të kërkesave të**Udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013 " Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël ", neni 11/a,b, ku përcaktohet për shërbimin e kryer Administrata Tatimore Rajonale përfiton në masën 1% të arkëtimit për llogari të qeverisjes vendores, shumë e cila derdhet për llogari të DPT në buxhetin e shtetit**.**

Titulli i gjetjes : **Mosderdhja e detyrimeve tatimore dhe jo tatimore në fund të vitit 2018, 2019 nga bashki si dhe institucione të gjyqësorit dhe zyra të gjendjes civile të Qarkut Shkodër të 1**% e TFTH për biznesin e vogël. Gjithashtu në fund të vitit 2018 dhe 2019 në DRT Shkodër rezultojnë dhe detyrime nga mos arkëtime të ardhurash tatimore nga furnizimet me pulla të cilat rezultojnë gjendje e papërdorur në institucione të gjyqësorit dhe në zyra të gjendjes civile të Qarkut Shkodër.

a-Institucionet e bashkisë Qarku Shkodër për të ardhura që realizojnë nga shërbimet që kryen DRT Shkodër në cilësinë e agjentit tatimore duhet të derdhin detyrimet në masën 1%të TFTH në zbatim të kërkesave të Udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013 " Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël ", neni 11për DRT**.**

Aktualisht rezultojnë debitorë nga mospagimi i këtyre detyrimeve në fund të vitit 2018 në masën prej 5,026 lekë, dhe në fund të vitit 2019 në masën **26,599 lekë disa bashki Qarku Shkodër**.

-Mospagimi në kohë i detyrimit në masën 1% referuar: Udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013, vjen si rezultat pasi mungojnë afatet ligjore për pagimin e detyrimeve nga institucionet e pushtetit vendor në DRT. Gjithashu referuar udhëzimit mungojnë dhe dhe penalitete për mos derdhjen e detyrimeve tatimore për TFTH për biznesin e vogël nga institucionet përfituese.E konkretisht:

Situata:

-Referuar Udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013 " Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël ", neni 11/a,b, ku përcaktohet për shërbimin e kryer Administrata Tatimore Rajonale përfiton të ardhura në masën 1% të shumës së arkëtimit për llogari të qeverisjes vendores, të të ardhurave tatimore nga TFTH për biznesin e vogël, të arkëtuara nga DRT. Kjo shumë(pra 1% i TFTH) derdhet për llogari të DPT në buxhetin e shtetit nga të ardhurat e grumbulluara si agjent tatimor DRT nga pushteti vendor.

Gjendja e detyrimit më 31.12.2018 në shumën prej 5,026 lekë i përket Bashkisë Shkodër në shumën prej 4,466 lekë dhe Bashkisë Fushë Arrëz në shumën prej 560 lekë.

Gjendja e këtij detyrimi më 31.12.2019, në masën 1% i pa arkëtuar nga bashkitë është në total në **shumën 26,599 lekë**, i përket:

Bashkisë Shkodër në shumën prej 12,965 lekë;
Bashkisë Koplik në shumën prej 5,384 lekë;
Bashkisë Fushë Arrëz në shumën prej 1,264 lekë;
Bashkisë Pukë në shumën prej 552 lekë;
Bashkisë Vau Dejës në shumën prej 6,434 lekë .

b- Referuar aktrakordimit të datës 21.01.2019 të mbajtur nga DRT Shkodër dhe Gjykatës, Prokurorisësë rrethit Shkodër, dhe në Bashki (Zyrat e gjëndjes civile),për furnizim pulle me vlerë 200 lekë, 100 lekë dhe 50 lekë(i mbajtur në sasi dhe vleftë sipas institucioneve); rezulton e pa arkëtuar detyrimi për vitin 2018 për taksë pulle nga furnizimi tyre për gjykatë prokurori, pullë e pa përdorur gjendje në gjykatë dhe prokurori dhe zyra gjëndje civile në fund të vitit 2018 në shumën prej **7,590,250 lekë** e cila përbën të ardhura të konstatuara nga gjyqësori dhe zyrat e gjendjes civile për tu derdhur në buxhetin e shtetit për vitin 2018. Dhe për vitin 2019 ky detyrim është në shumën prej **6,161,250 lekë(pulla të pa përdorura në fund të vitit 2019** me vlerë 200 lekë, 100 lekë dhe 50 lekë) në zbatim të kërkesave të UMF nr.33, datë 29.12.2014 " Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e ministrisë së drejtësisë, " Për shërbimin përmbarimor gjyqësor shtetëror, prokurorisë dhe noterisë ", e cila përbën të ardhura të konstatuara nga gjyqësori dhe zyrat e gjendjes civile për tu derdhur në buxhetin e shtetit për vitin 2019 ;

Kriteri: Ligji për nr.9632, datë 19.05.2008 " Për taksat vendore ", i ndryshuar; Ligji nr.9975, datë 28.07.2008 " Për taksat kombëtare", i ndryshuar, UMF nr.32, datë 31.12.2013 " Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", i ndryshuar dhe UMF nr.26, datë 04.09.2008 " Për taksat kombëtare", i ndryshuar.

Ndikimi: Në rritjen e të ardhurave tatimore nga taksa dhe tatime si dhe nga të ardhurave të tjera në DPT të cilat duhet të derdhen në buxhetin e shtetit pasi janë të ardhura dytësore që përfiton DRT.

Rëndësia : I lartë

Rekomandimi : **a**-DRT Shkodër të ndërmarrë inisiativa e duhura administrative dhe ligjore në drejtim të arkëtimit të detyrimeve në shumën prej **26,599** lekë (për 1% TFTH) në fund të vitit 2019 dhe të ndjekë realizimin e të ardhurave tatimore për detyrimin e vitit 2018 në shumën **7,590,250 lekë** dhe të vitit 2019 në shumën prej **6,161,250 lekë**(për takë pulle e pa përdorur në fund të vitit 2018 dhe 2019), e pa arkëtuar gjatë vitit në masën 90% dhe 95% dhe 5%) të cilat përfaqësojnë një e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit.
b-Gjithashtu të shikohet mundësia e rishikimit të Udhëzimit të MF nr.32, datë 31.12.2013 "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël ", pika 11.Transferimi i të ardhurave në llogari të qeverisjes vendore të shumave të arkëtura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në masën 100%. Kjo shumë e cila çelet në fund të vitit nga DPT në DRT pasi arkëtohet nga DRT për tu shpërndarë njësive të pushtetit vendor pa zbritur më parë1% e komisionit të shëbimit të kryer nga DRT. Komisioni prej në masën 1% derdhet në llogari të administratës tatimore rajonale Shkodër nga bashkitë. Kjo gjë duhet rishikuar me qëllim që mbajtja e komisionit në masën 1% të shumms së arkëtuar nga DRT , të mbahet në momentin e shpërndarjes së tyre nga DPT.
E konkretisht të rishikohet pika 11/a – Transferimi i të ardhurave në llogari të bashkive me qëllim që mbajtja e këtij komisioni në masën prej 1% tëtë ardhurave të realizuara të bëhet direkt nga DPT dhe transferimi në llogari të bashkive e të ardhurave nga TFTH për biznesin e vogël të bëhet për diferencë të të ardhurave të arkëtuara duke e mbajtur 1% veprim i cili eleminon detyrimet ndërvite nga bashkitë të komisioneve prej 1% të TFTH për biznesin e vogël e ardhur e cila derdhet në buxhetin e shtetit në fund të çdo ëvitit.

Afati i zbatimit : Deri në fund të vitit 2020.

Raport mbi situatën e kreditorëve gjithsej, në fund të vitit 2017 dhe çelje për vitin vitin 2018, si dhe situata e kreditorëve jashtë sistemit të dhëna të marrë nga Sektori i Analizës sëmë 31/12/2018.
Tabela nr.2

Në lekë

Renditja sipas llojit te tatimit	**Kreditore jashte SIT 31.12.2017**	**Kreditore jashte SIT te hedhura ne sistem gjate 2018**	**Shtesa 2018**	**Kreditore jashte SIT gjendje 31.12.2018**
	1	**2**	**3**	**4**
Kreditore - per Tvsh				
Kreditore - per Tatim Fitimi	1,652,602.0	0.0		1,652,602.0
Kreditore - per Pulla Akcize (Financa)	1,190,483.0			1,190,483.0
Kreditore - per Bileta Transporti (Financa)				
Kreditore - per Sig.Shoq-Shend				
Kreditore - per Tap				
Kreditore - per divident	521,750.0			521,750.0
Kreditore - per takse qarkullimi	336,667.0			336,667.0
Kreditore - per gjoba	1,244,279.0			1,244,279.0
Kreditore - per kasa regjistruese	175,000.0			175,000.0
Totali	**5,120,781.0**	**0.0**	**0.0**	**5,120,781.0**

Të dhëna nga sektori i analizës dhe i kontabilitetit të të ardhurave

Këta kreditorë rezultojnë jashtë sistemit informatik të tatimeve pasi nuk disponohen dokumenta të rregullta ligjore ndër vite kur janë krijuar detyrimet nga DRT Shkodër e për rrjedhojë janë të pa mbyllura ndër vite.

Konkluzioni: Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit në DPT bazuar në raportet e fund vitit në sistemin E Tax harton pasqyrat financiare të të ardhurave tatimore të DPT sipas Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018 " Për procedurat e përgatitjes, paqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", dhe e dërgon për procedurë të mëtejshme në Drejtorine e Financës dhe Buxhetit këtu në DPT, ndërsa në DRT nëpërmjet sektorit të analizës dhe të të ardhurave e cila përpilon pasqyrën financiare të të ardhurave dytësore nga shtypshkrime, biletat , nga blloqet e faturave, pulla dhe nga 1% i TFTH të realizuar gjatë vitittë cilat derdhen në buxhetin e shtetit si dhe detyrimet përkatëse në lidhje me mos arkëtimin e detyrimeve për TTHF si dhe detyrimet për arkëtimin nga shitja e pullave dhe të akteve subjekte tatimpaguese (në bazë deklarate),dhe detyrimet tatimore debitore dhe kreditore jashtë sistemit informatik kryesisht nga viti 2008 e në vazhdim të personave fizike apo juridikë dhe që rezultojnë pa shpresë arkëtimi për mungesë dokumentacioni dhe nipti, dhe detyrime të krijuara nga viti 2017 e në vazhdim e cila është pjesë e pasqyrave finaciare vjetore të DRT Shkodër.

Plani dhe realizimi i të ardhurave për DRTShkodër.

Plani i të ardhurave tatimore për DRT Shkodër për vitin 2018, është akorduar në zbatim të ligjit nr.109/2017, datë 30.11.2017 "Për buxhetin e vitit 2018", me shkresën nr. 2769, datë 09.02.2018 dhe i rishikuar sipas Aktit Normative me nr.1, datë 26.07.2018 me shkresën nr. 17815 prot, datë 04.10.2018 të MFE është dërguar plani fillestar i të ardhurave të planifikuara dhe i ndryshuar për tu realizuar nga administrata tatimore.

Plani fillestar dhe i rishikuar i të ardhurave tatimore sipas zërave gjithsej të ndara në nivel DRT Shkodër paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr.3
Në 000/lekë

Nr	Ndryshimet e planit nga ana e DPT	Min. Fin. shkresat 2769; 2772; 2770/1	Min. Fin. shkr. 10682/1 dt 20.07.2018	Min. Fin. shkr. 17815 dt 04.10.2018
	Shkresat	**1729 dt 19.02.2018**	**7229 dt 31.07.2018**	**9406 dt 10.10.2018**
11	**D. R. Tatimore SHKODER TOTAL (Bruto)**	**Shk DPT 2921/1 dt 16.02.2018**	**15125/1 dt 27.07.2018**	**20537/1 dt 08.10.2018**
	(Tatimet + Rimbursime + Kontribute)	5,952,000	5,917,000	5,830,000
A	**Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)**	**2,052,000**	**2,017,000**	**2,030,000**
	Nga te cilat:			
1	**Tatimi Vleres se Shtuar**	780,000	745,000	700,000
	- Tatimi Vleres se Shtuar (neto)	420,000	385,000	340,000
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	360,000	360,000	360,000
2	Akciza	-		
3	**Tatim mbi Fitimin**	440,000	440,000	478,000
4	**Ardhura Personale**	790,000	790,000	810,000
5	**Biznesi i vogel**	-		
6	**Toka bujqesore**	-		
7	**Ndertesat**	-		
8	**Taksat kombetare**	42,000	42,000	42,000
9	**Taksa Qarkullimit Rrugor**			
10	**Taksa e solidaritetit**			
11	**Kazinote dhe lojrat e fatit**			
12	**Te tjera te paidentifikuara**			
13	**Denimet Administrative**	-		
B	**Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)**			
C	**Kontributet e Sigurimeve gjithsej**	3,900,000	3,900,000	3,800,000
	- Tarifa jo Tatimore			
D	**D. R. Tatimore SHKODER TOTAL (Neto)**	5,592,000	5,557,000	5,470,000
	(Tatimet neto + Kontributet)			

Burimi :Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave

Të ardhurat tatimore të realizuara në fund të vitit 2018 në DRTShkodër paraqiten si më poshtë :

Tabela nr.4
Në 000/lekë

E M E R T I M I	PERIUDHA - 12 MUJORE 2018						
	FAKTET		PLANI	Diferenca fakt plan		Diferenca 2018 - 2017	
	2017	2018	2018	+ ose -	Përqindje	+ ose -	Përqindje
D. R. Tatimore SHKODER TOTAL (Bruto)	**5,350,410**	**5,771,422**	**5,830,001**	-58,579	-1.00%	**421,012**	**7.87%**
(Tatimet + Rimbursime + Kontribute)				0		**0**	
Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	**1,821,912**	**2,006,626**	**2,030,001**	-23,375	-1.15%	**184,714**	**10.14%**
Nga te cilat:				0		**0**	
Tatimi Vleres se Shtuar	**668,722**	**619,871**	**700,001**	-80,130	-11.45%	**-48,851**	**-7.31%**
- Tatimi Vleres se Shtuar (neto)	340,873	327,110	340,001	-12,891	-3.79%	**-13,763**	**-4.04%**
- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	327,849	292,761	360,000	-67,239	-18.68%	**-35,088**	**-10.70%**
Tatim mbi Fitimin	406,955	557,579	478,000	79,579	16.65%	**150,624**	**37.01%**
Ardhura Personale	694,449	776,544	810,000	-33,456	-4.13%	**82,095**	**11.82%**
Taksat Nacionale	43,508	38,591	42,000	-3,409	-8.12%	**-4,917**	**-11.30%**
Taksa Qarkullimit Rrugor	0	0	0	0	0%	**0**	**0.00%**
Lojrat e Fatit	0	0	0	0	0%	**0**	**0.00%**
Te tjera pa identifikuar	0	0	0	0	0%	**0**	**0.00%**
Denimet Administrative	8,278	14,041	0	14,041	0%	**5,763**	**69.62%**
				0	0%	**0**	**0.00%**
Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)	**1,494,063**	**1,713,865**	**1,670,001**	43,864	2.63%	**219,802**	**14.71%**
				0		**0**	**0.00%**
Kontributet e Sigurimeve gjithsej	3,528,498	3,764,796	3,800,000	-35,204	-0.93%	**236,298**	**6.70%**
- Tarifa jo Tatimore	0	0	0	0		**0**	**0.00%**
D. R. Tatimore SHKODER TOTAL (Neto)	**5,022,561**	**5,478,661**	**5,470,001**	8,660	0.16%	**456,100**	**9.08%**
(Tatimet neto + Kontributet)							

Burimi :Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave

Struktura e mbledhjes së të ardhurave përbëhet nga:

- **Të ardhura tatimore neto që përbëjnë 31%të totalit të të ardhurave neto;**
- **Kontribute e sigurimeve shoqërore e shëndetësore që përbëjnë 69%të totalit të të ardhurave neto**

Analiza e mosrealizimit të planit të të ardhrave tatimore për vitin 2018 sipas zërave paraqitet si më poshtë:

Taksat Kombëtare

- Për vitin 2018 Taksat dhe Tarifat Kombëtare janë në mosrealizim kundrejt planit me 3,4 milion lekë ose 8%.
- Tek arsyet e këtij mosrealizimi mund të përmendim: rënie e përdorimi të pullave nga Zyrat e Gjendjes Civile për shkak të marrjes on-line të vërtetimeve dhe rënie e pagesës së taksës së rentës si pasoj e mosrinovimit të disa lejeve për shfrytëzimin e lumenjëve.

Arsyet e mosrealizmit TVSH

a- Për vitin 2018 TVSH Bruto është me mosrealizim kundrejt planit me 49 milion lekë ose 7,3 %.

b- Sektori i Ndërtimit ka rënie të xhiro së tatueshme me rreth 1,2 miliard lekë krahasuar me vitin 2017, po të merret një mesatare e pagesës së TVSH me 2% të xhiros atëherë pagesa e mungura nga kjo rënie xhiroje del rreth 24 milion lekë.

c- Detyrimet e papaguara nga tatimpaguesit për TVSH-në (periudhat tatimore Dhjetor 2017-Nëntor 2018) për të gjithë vitin 2018 të papaguara deri me datën 31.12.2018 janë rreth 53 million lekë për të cilat normalisht janë ndjekur edhe masa shtënguese nga ana e Dr. së Mbledhjes së Borxhit.

d- Vlera e lartë e tatimpaguesve që deklarojnë TVSH me kredi. Kur për periudhat tatimore Dhjetor 2017-Nëntor 2018 diferenca në mes të tatimpaguesve që deklarojnë me debi (detyrim për pagesë) dhe atyre që deklarojnë me kredi është vetëm 164 milion lekë.

Kontributet e Sigurimeve

a- Për vitin 2018 Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë me mosrealizim kundrejt planit me 35 milion lekë ose 1 %.

b- Detyrimet e papaguara për Sigurimet (periudhat tatimore Dhjetor 2017-Nëntor 2018) për të gjithë vitin janë të papaguara deri me datën 31.12.2018 rreth 202 million lekë, gjë që ka patur një ndikim të madh në mosrealizimin e planit.

c- Problematikë janë subjektet të fasonit ose Call Center të cila rezutojnë se nuk kanë aftësi likujduese pasi kanë probleme me pagesat nga ana e klientëve të tyre. Gjithashtu problematik janë edhe tatimpaguesit që janë në pronësi të Bashkive si psh Ujësjellësat, Klubet e Futbollit etj. Detyrimet për kontribute të analizuar sipas subjekteve mbahen në kontabilitet në DPT e konkretisht nga Drejtoria e Analizës të Kontabilitetit të Ardhurave (nëpërmjet sistemit informatik C@TS.

Lista e Kontribuesve më të mëdhenjë tatimorë për të gjitha taksat dhe tatimet gjatë vitit 2018 nëDRTShkodër si më poshtë vijon:

Tabela nr.5

Në lekë

NIPT	**Emri subjektit**	**Shuma paguar**
[redacted]	[redacted]	400,200
[redacted]	[redacted]	400,000
[redacted]	[redacted]	256,562
[redacted]	[redacted]	252,425
[redacted]	[redacted]	233,761
[redacted]	[redacted]	226,367
[redacted]	[redacted]	201,517
[redacted]	[redacted]	193,768
[redacted]	[redacted]	175,011
[redacted]	[redacted]	174,974
[redacted]	[redacted]	166,658
[redacted]	[redacted]	164,891
[redacted]	[redacted]	161,903
[redacted]	[redacted]	153,889
[redacted]	[redacted]	151,128
[redacted]	[redacted]	147,484
[redacted]	[redacted]	142,942
[redacted]	[redacted]	136,156
[redacted]	[redacted]	133,852
[redacted]	[redacted]	126,953
[redacted]	[redacted]	125,000
[redacted]	[redacted]	122,000
[redacted]	[redacted]	120,000
[redacted]	[redacted]	110,000
[redacted]	[redacted]	109,607
[redacted]	[redacted]	107,245
[redacted]	[redacted]	102,550
[redacted]	[redacted]	100,382
[redacted]	[redacted]	100,000

Tatimpagues me vlerë totale mbi 1 milion lekë, kontribues në të gjitha llojet e tatimeve në DRT Shkodër, paraqiten në tabelën mëposhtë:

Tabela nr.6

NUIS	**Tatimpaguesi**	**Detyrim 1712-1811 në lekë**	**Aktiviteti**
Totali		202,265,538	

[redacted]	[redacted]	21,187,604	Aktivitete të klubeve sportive
[redacted]	[redacted]	20,962,138	Prodhimi i këpucëve
[redacted]	[redacted]	9,647,868	Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e tekstileve, veshjeve, peliçeve, këpucëve, dhe artikujve prej lëkure
[redacted]	[redacted]	4,568,224	Aktivitete të rendit publik dhe sigurimit
[redacted]	[redacted]	3,626,369	Prodhimi i këpucëve
[redacted]	[redacted]	3,140,135	Prodhimi i telave dhe kabllove të tjerë elektrike dhe elektronikë
[redacted]	[redacted]	2,799,637	Eksportues
[redacted]	[redacted]	2,767,097	Prodhimi i këpucëve
[redacted]	[redacted]	2,752,849	Prodhimi i këpucëve
[redacted]	[redacted]	2,642,383	Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave
[redacted]	[redacted]	2,178,582	Konfeksionimi i veshjeve të brendshme
[redacted]	[redacted]	2,043,829	Prodhimi i këpucëve
[redacted]	[redacted]	1,962,351	Aktivitete të qendrave telefonike (call center)
[redacted]	[redacted]	1,752,013	Aktivitete të ndërmjetësimit për shitjen e tekstileve, veshjeve, peliçeve, këpucëve, dhe artikujve prej lëkure
[redacted]	[redacted]	1,469,464	Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit ..
[redacted]	[redacted]	1,350,287	Prodhimi i artikujve tekstile të konfeksionuar, përvec veshjeve
[redacted]	[redacted]	1,136,478	Shitje të tjera me pakicë në dyqane jo të specializuara
[redacted]	[redacted]	1,009,016	Konfeksionimi i veshjeve të tjera të jashtme

Burimi: Të dhëna nga sistemi informatik C@TS

Viti 2019

Plani i të ardhurave tatimore për DTRShkodër për vitin 2019, është akorduar në zbatim të ligjit nr.99/2018 " Për buxhetin e vitit 2019", i ndryshuar; me shkresën nr. 1913, datë 04.03.2019 dhe i rishikuar sipas Aktit Normative me nr.2, datë 02.10.2019 me shkresën nr. 21474/1 prot, datë 11.12.2019 të MFE është dërguar plani fillestar i të ardhurave të .planifikuara dhe i ndryshuar për tu realizuar nga administrata tatimore.

Plani fillestar dhe i rishikuar i të ardhurave tatimore sipas zërave gjithsej dhe të ndara, paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr.7
Në 000/Lekë

Nr	**Ndryshimet e planit nga ana e DPT**			
	Shkresat	**Shkr. nr. 1913, dt 04.03.2019**	**Shkr. nr. 4939 dt 05.06.2019**	**Shkr. nr. 11136 dt 12.12.2019**

11	D. R. Tatimore SHKODER TOTAL (Bruto)	Shk DPT 2259/1	9355/1 dt 03.06.2019	21474/1 dt 11.12.2019
	(Tatimet + Rimbursime + Kontribute)	6,086,000	6,162,000	6,157,000
A	**Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)**	2,086,000	2,072,000	2,067,000
	Nga te cilat:			
1	**Tatimi Vleres se Shtuar**	748,000	728,000	723,000
	- Tatimi Vleres se Shtuar (neto)	450,000	430,000	425,000
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	298,000	298,000	298,000
2	Akciza	-		
3	**Tatim mbi Fitimin**	435,000	446,000	446,000
4	**Ardhura Personale**	852,000	847,000	847,000
5	**Biznesi i vogel**	-		
6	**Toka bujqesore**	-		
7	**Ndertesat**	-		
8	**Taksat kombetare**	51,000	51,000	51,000
9	**Taksa Qarkullimit Rrugor**			
10	**Taksa e solidaritetit**			
11	**Kazinote dhe lojrat e fatit**			
12	**Te tjera te paidentifikuara**			
13	**Denimet Administrative**	-		
B	**Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)**			
C	**Kontributet e Sigurimeve gjithsej**	4,000,000	4,090,000	4,090,000
	- Tarifa jo Tatimore			
D	**D. R. Tatimore SHKODER TOTAL (Neto)**	5,788,000	5,864,000	5,859,000
	(Tatimet neto + Kontributet)			

Burimi :Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave

Realizimi i të ardhurave tatimore, krahasuar me planin për vitin 2019 në DRTShkodër paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr.8
Në 000/Lekë

Nr. Rd.	EMERTIMI	PERIUDHA - 12 MUJORE 2019						
		FAKTET		PLANI	Diferenca fakt - plan		Diferenca 2019 - 2018	
		2018	2019	2019	+ ose -	Përqindje	+ ose -	Përqindje

11	**D. R. Tatimore SHKODER TOTAL (Bruto)**	**5,771,421**	**5,992,155**	**6,157,000**	-164,845	-2.68%	**220,734**	**3.82%**
	(Tatimet + Rimbursime + Kontribute)							
A	**Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)**	**2,006,625**	**2,054,939**	**2,067,000**	-12,061	-0.58%	48,314	2.41%
	Nga te cilat:							
1	**Tatimi Vleres se Shtuar**	**619,871**	**655,852**	**723,000**	-67,148	-9.29%	35,981	5.80%
	- Tatimi Vleres se Shtuar (neto)	327,110	320,782	425,000	-104,218	-24.52%	-6,328	-1.93%
	- Rimbursimi i kryer (gjithsej)	292,761	335,070	298,000	37,070	12.44%	42,309	14.45%
2	**Tatim mbi Fitimin**	557,579	425,911	446,000	-20,089	-4.50%	-131,668	-23.61%
3	**Ardhura Personale**	776,544	916,209	847,000	69,209	8.17%	139,665	17.99%
4	**Taksat Nacionale**	38,591	37,244	51,000	-13,756	-26.97%	-1,348	-3.49%
5	**Taksa Qarkullimit Rrugor**	0	0	0	0	0.00%	0	0.00%
6	**Lojrat e Fatit**	0	0	0	0	0.00%	0	0.00%
7	**Te tjera pa identifikuar**	0	0	0	0	0.00%	0	0.00%
8	**Denimet Administrative**	14,041	19,724	0	19,724	0.00%	5,683	40.47%
B	**Te Ardhurat Tatimore gjithsej (neto)**	**1,713,864**	**1,719,869**	**1,769,000**	**-49,131**	**-2.78%**	**6,005**	**0.35%**
C	**Kontributet e Sigurimeve gjithsej**	3,764,796	3,937,217	4,090,000	**-152,783**	**-3.74%**	172,420	4.58%
	- Tarifa jo Tatimore	54	0	0				
D	**D. R. Tatimore SHKODER TOTAL (Neto)**	**5,478,660**	**5,657,085**	**5,859,000**	**-201,915**	**-3.45%**	**178,425**	**3.26%**
	(Tatimet neto + Kontributet)							

Burimi :Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave

Nga auditimi konstatohet:

1-Konstatojmë se për shpërndarjen e planit të të ardhurave nga DPTnë nivel drejtorie rajonale është zbatuar e njëjta metodologjimbështetur në të ardhurat faktike të viteve të mëparshme për secilën DRT, ku plani i ardhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë shpërndahet bazuar në pjesën që zë çdo drejtori në nivel 10 vjeçar dhe 3 vjeçar për secilin zë të të ardhurave dhe Sektori Statistikës në DPTi cili vendos variantin e tij të shpërndarjes së planit, dhe më pas miratohet për shqyrtim, ndryshim dhe miratim në mbledhjen e Grupit të Punës dhe më tej për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm. Kjo mënyrë e përdorur nga DPT merr parasysh vetëm të ardhurat faktike dhe nuk korrigjohet me asnjë element tjetër si numrin e tatimpaguesve për secilën drejtori, të ardhurat e realizuara prej tyre, qarkullimin gjithsej, investimet strategjike apo elemente të tjerë.

-Konstatohet se gjatë vitit janë bërë ndryshime të planit të të ardhurave në përgjegjësi të DPT, për të cilat MFE ka kërkuar ndryshimin e planit të të ardhurave dhe në periudhat e mëparshme.

Struktura e mbledhjes së të ardhurave përbëhet nga:

- **Të ardhura tatimore neto që përbëjnë 30%të totalit të të ardhurave neto;**
- **Kontribute e sigurimeve shoqërore e shëndetësore që përbëjnë 70%të totalit të të ardhurave neto**

Analiza e mosrealizimit të planit të të ardhurave tatimore të vitit 2019 sipas zërave paraqitet si më poshtë vijon:

Taksat Kombëtare

- Për vitin 2019 Taksat dhe Tarifat Kombëtare janë në mosrealizim kundrejt planit me 13,8 milion lekë ose 27%.
- Rezutati jo maksimal për Taksat dhe Tarifat Kombëtare është paralajmëruar nga ana e jonë si planifikim i gabuar.
- Tek arsyet e këtij mosrealizimi mund të përmendim: rënie e përdorimi të Pullave nga Zyrat e Gjendjes Civile për shkak të marrjes on-line të vërtetimeve dhe ndryshimet ligjore për përjashtimin nga pagesa e taksës për materialet plastike, rënie e pagesë së taksës së rentës si pasojë e mosrinovimit të disa lejeve për shfrytëzimin e lumenjëve.

Arsyet e mosrealizmit TVSH

-Për vitin 2019 TVSH Bruto është me mosrealizim kundrejt planit me 67 milion lekë ose 9,3 %.
-Nga krahasimi 12 mujor me vitin 2018 (periudhat tatimore Dhjetor 2017-Nëntor 2018 vs periudhat tatimore Dhjetor 2018-Nëntor 2019) rezulton se xhiroja e tatueshme për vitin 2019 është rritur me 5 % krahasuar me atë të vitit 2018 por kjo rritje nuk është përkthyer në pagesë TVSH-je (ka shkuar për të mbyllur gjendjet kreditore të mbartura deri në fund të vitit 2018), pasi po të shikohet pagesa e TVSH-së për vitin 2019 është pak a shumë e njëjtë me vitin 2018. Sektori i prodhimit ka rënie tek treguesi i TVSH-së së detyrueshme për pagesë në total me një vlerë prej 80,304.005 lekë ose 8,329,559 lekë në muaj. Kjo kryesisht ka ardhur si pasoj e ndryshimit ligjor, ku përpunuesit aktiv i kanë shitjet me TVSH 0 lekë. Rënie kanë patur edhe tatimpaguesit e nxjerrës së inerteve të cilëve nuk i janë rinovuar lejet dhe hidrocentralet si pasoj e rënies së prurjeve të ujit.
-Detyrimet e papaguara për TVSH-në (periudhat tatimore Dhjetor 2018-Nëntor 2019) për të gjithë vitin të papaguara deri me datën 31.12.2019 janë rreth 50 million lekë, gjë që do të thotë se edhe po të arkëtoheshin të gjitha detyrimet përsëri nuk do të realizohej plani. \

Arsyet e mosrealizmit Tatim Fitimit

- Rritja e tatimpaguesve që nuk paguajnë këstet e TF pavarësisht se penalizohen me gjobë. Kështu për periudhën Janar-Dhjetor këstet e papaguar kanë vlerën 57 milion lekë.
- Ndryshimi ligjor për tatimin e fitimit me 5% për tatimpaguesit me xhiro nga 8 deri në 14 milion. Efekti i përllogaritur kap vlerën 19 milion lekë.

Kontributet e Sigurimeve

d- Për vitin 2019 Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore paraqiten me mosrealizim kundrejt planit me 153 milion lekë ose 3,7 %.

e- Detyrimet e papaguara për Sigurimet (periudhat tatimore Dhjetor 2018-Nëntor 2019) për të gjithë vitin të papaguara deri me datën 31.12.2019 janë rreth janë 160 million lekë, gjë që ka patur një ndikim të madh në mosrealizmin e planit.

f- Problematikë janë subjektet te fasonit ose Call Center nuk paguajnë më pretendimin që nuk kanë aftësi likujduese pasi kanë probleme me palën italiane. Gjithashtu problematikë janë edhe tatimpaguesit që janë në pronësi të Bashkisë Shkdodër si Klubi i Futbollit Vllaznia apo ERGYS 2010 MS që pret pagesat për transportin e udhëtarëve brenda qytetit.

Debitorët për Kontribute në datën 31/12/2019 sipas sistemit informatik C@TS për DRTShkodër paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.9
Në lekë

NIPT	Tatimpaguesi	Debia	Statusi
[redacted]	[redacted]	96,438,120	Aktiv
		21,129,569	Aktiv
		10,384,964	Aktiv
		10,366,248	Aktiv
		10,228,539	Aktiv
		8,860,563	Aktiv
		8,822,276	Aktiv
		8,148,754	Aktiv
		7,844,682	Aktiv
		7,500,000	Aktiv

Debitorë për Kontribute më datë 31/12/2019 për detyrime të krijuara gjatë vitit 2019sipas sistemit informatik C@TS.

Tabela nr.10

Në lekë

NIPT	Subjekti	Shuma	Statusi
[redacted]	[redacted]	23,787,623	Aktiv
		6,244,236	Aktiv
		5,833,292	Aktiv
		2,927,720	Aktiv
		2,425,097	Aktiv
		2,413,641	Kërkesë për Çregjistrim
[redacted]	[redacted]	2,064,168	Aktiv
		1,830,839	Aktiv
		1,652,650	Pasiv
		1,449,505	Aktiv
		1,341,383	Aktiv
		1,265,898	Aktiv
		1,245,522	Aktiv
		1,202,804	Aktiv

[redacted]	[redacted]	1,109,259	Aktiv
[redacted]	[redacted]	955,174	Aktiv
[redacted]	[redacted]	913,445	Aktiv
[redacted]	[redacted]	911,691	Aktiv
[redacted]	[redacted]	873,178	Aktiv
[redacted]	[redacted]	825,745	Aktiv
[redacted]	[redacted]	805,589	Aktiv
[redacted]	[redacted]	772,546	Aktiv
[redacted]	[redacted]	752,719	Aktiv
[redacted]	[redacted]	728,418	Aktiv
[redacted]	[redacted]	723,311	Aktiv
[redacted]	[redacted]	680,103	Aktiv
[redacted]	[redacted]	633,342	Pasiv
[redacted]	[redacted]	631,470	Aktiv
[redacted]	[redacted]	612,835	Pasiv
[redacted]	[redacted]	493,129	Aktiv

Burimi:Të dhënat nga sistemi C@TS

Lista e tatimpaguesve për të gjitha taksat me vlerë totale mbi 1 miljon në DRT Shkodër paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela nr.11
Në lekë

NUIS	Subjekti	Detyrim Kryesor 1812-1911
[redacted]	[redacted]	10,749,865
[redacted]	[redacted]	9,882,750
[redacted]	[redacted]	8,005,849
[redacted]	[redacted]	5,346,744
[redacted]	[redacted]	4,489,584
[redacted]	[redacted]	4,111,292
[redacted]	[redacted]	3,784,860
[redacted]	[redacted]	3,468,122
[redacted]	[redacted]	3,247,437
[redacted]	[redacted]	2,802,031
[redacted]	[redacted]	2,435,657
[redacted]	[redacted]	2,290,245
[redacted]	[redacted]	1,777,069
[redacted]	[redacted]	1,711,143
[redacted]	[redacted]	1,632,542
[redacted]	[redacted]	1,311,179
[redacted]	[redacted]	1,288,431
[redacted]	[redacted]	1,021,785
[redacted]	[redacted]	1,013,468

[redacted]	[redacted]	1,012,593

Burimi:Të dhënat nga sistemi C@TS

Lista e kontribuesve për pagesa totale për të gjithë taksat gjatë vitit 2019 në DRTShkodër sipas të dhënave të sitemit inforatik C@TSsi më poshtë vijon:

Tabela nr.12
Në lekë

NIPT	Emri subjektit	Shuma paguar
[redacted]	[redacted]	23,482,069
[redacted]	[redacted]	18,520,417
[redacted]	[redacted]	12,229,293
[redacted]	[redacted]	12,025,381
[redacted]	[redacted]	11,494,857
[redacted]	[redacted]	10,932,491
[redacted]	[redacted]	9,893,809
[redacted]	[redacted]	9,541,855
[redacted]	[redacted]	8,125,180
[redacted]	[redacted]	7,727,776
[redacted]	[redacted]	7,562,865
[redacted]	[redacted]	7,297,309
[redacted]	[redacted]	6,954,530
[redacted]	[redacted]	6,053,805
[redacted]	[redacted]	5,895,851
[redacted]	[redacted]	5,787,445
[redacted]	[redacted]	5,655,780
[redacted]	[redacted]	5,641,720
[redacted]	[redacted]	5,626,199
[redacted]	[redacted]	5,330,616
[redacted]	[redacted]	4,754,825
[redacted]	[redacted]	4,740,343
[redacted]	[redacted]	4,738,452
[redacted]	[redacted]	4,543,744
[redacted]	[redacted]	4,439,181
[redacted]	[redacted]	4,309,507
[redacted]	[redacted]	4,158,347
[redacted]	[redacted]	3,894,301
[redacted]	[redacted]	3,839,840
[redacted]	[redacted]	3,745,617

Burimi:Të dhënat nga sistemi C@TS

Konstimi 2: Mos angazhimi i strukturave të DRT Shkodër dhe në përgjithësi të DRT në planifikimin e të ardhurave tatimore që do të realizohen në DRTatimore Shkodër dhe në përgjithsi në Drejtoritë Rajonale.
Nga auditimi i programimit të buxhetit të të ardhurave tatimore në DPT për vitin 2018, dhe për vitin 2019, tëcilat realizohen në DRT e konkretisht DRTShkodër, u konstatua se procesi i programimit buxhetor ka hasur problematika në realizimin e treguesve referuar programimit të buxhetit, i cili ka pësuar ndryshime gjat, vitit referuar Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.10, datë 28.02.2017 "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020*", pasi:
-*Programi i përgjithshëm i të ardhurave tatimore* për subjekte të mbledhura në përgjithësi nga DRT e konkretisht nëDRTSH është përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Makroekonomike në Ministrinë e Financave, dhe për rrjedhojë DRT **kanë marrë tregues të gatshëm për të ardhurat sipas shkresave nga DPT**. Si rezultat gjatë vitit 2018,2019 në programimin fillestar të të ardhurave tatimore ka pasur ndryshime me akte normative gjë që tregon rezerva në planifikim gjë që vështirëson realizimin e tyre. Kjo gjë ndikon në punën në drejtim të angazhimeve sa më efikase të DRT Shkodër në planifikimin sa më real të planit të të ardhurave në mënyrë që të realizohen të ardhurat tatimore në kohë, si rezultat i monitorimit të procesit nga vetë DRT dhe të bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Ministrinë e Financave në mënyrë që treguesit e programimit të të ardhurave të mos vijnë të gatshme në DPT, por të programohen referuar një analize të drejtë e pa rezerva nga të dyja strukturat.

Për mangësitë e konstatuara është mbajtur Aktkonstatimi nr.1, datë 19.02.2020.

IV/2. Respektimi i dispozitave ligjore në lidhje me emërimet dhe largimet nga puna të punonjësve; respektimi i strukturës organike të miratuar; respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, e të tjera shpenzime personeli; respektimi i dispozitave ligjore për shpenzimet për udhëtime e dieta; ndjekja dhe raportimi i ecurisë sëproceseve gjyqësore në lidhje me punonjësit e larguar nga puna, si dhe saktësia e paraqitjes së shpenzimeve të sipërcituara në pasqyrat financiare vjetore.

Fondet buxhetore për art.600, në zërin "Paga" dhe në art.601, në zërin "Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore" për vitet 2018 -2019, janë celur në zbatim të Ligjit nr.109/2017, datë 30.11.2017, "Për buxhetin e vitit 2018" dhe Ligjit nr.99/2018, datë 03.12.2018 "Për buxhetin e vitit 2019", Udhëzimit Plotësues nr.1, datë 17.01.2019, si dhe akteve të dala në zbatim të ligjeve të sipërcituara

Tabela në vijim paraqet shpenzimet në art.600, në zërin "Paga" dhe në art.601, në zërin "Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore" për vitet 2018 -2019.

Tabela nr.13
Në 000/lekë

DRT Shkodër	Plani Vjetor			Shpenzimet Faktike			Diferenca
	Paga	Sigurime	Totali	Paga	Sigurime	Totali	
Viti 2018	98,488	16,516	115,004	98,222	16,261	114,483	521

Viti 2019	97,200	16,500	113,700	97,015	16,124	113,139	561
Total	195,688	33,016	228,704	195,237	32,385	227,622	1,082

Burimi: Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT Shkodër

Në total për vitin 2018 shpenzimet për paga art 600-601 janë planifikuar në shumën 115,004 mijë lekë dhe janë shpenzuar në shumën totale 114,483 mijë lekë, me një realizim në 99.5%.
Shpenzimet për paga për vitin 2018 arrijnë në shumën 98,222 mijë lekë dhe ato për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në shumën 16,261 mijë lekë.
Në pasqyrat financiare të vitit 2018, pagat paraqiten në shumën 98,991 mijë lekë dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore në shumën 16,392 mijë lekë. Diferenca midis shpenzimeve për paga e sigurime të paraqitura në pasqyrat financiare dhe atyre të situacionit të shpenzimeve përfaqëson korektimin e shpenzimeve midis dy muajve dhjetor (dhjetor 2017 me dhjetor 2018).
Në total për vitin 2019 shpenzimet për paga art 600-601 janë planifikuar në shumën 113,700 mijë lekë dhe janë shpenzuar në shumën totale 113,139 mijë lekë, me një realizim në 99.5%.
Shpenzimet për paga për vitin 2019 arrijnë në shumën 97,015 mijë lekë dhe ato për sigurime shoqërore dhe shëndetësore në shumën 16,124 mijë lekë.
Në pasqyrat financiare të vitit 2019, pagat paraqiten në shumën 97,107 mijë lekë dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore në shumën 16,142 mijë lekë. Diferenca midis shpenzimeve për paga e sigurime të paraqitura në pasqyrat financiare dhe atyre të situacionit të shpenzimeve përfaqëson korektimin e shpenzimeve midis dy muajve dhjetor (dhjetor 2018 me dhjetor 2019).
Për secilin vit buxhetor shpenzimet faktike rezultojnë të rakorduara me situacionet vjetore me Degën e Thesarit Shkodër.
Auditimi i pikës 2 të programit të auditimit nr.55/1, datë 20.01.2020, ndryshuar menr.55/2, datë20.02.2020**,** u krye mbështetur në legjislacionin e cituar te kriteret e vlerësimit si dhe në: Strukturat e miratuara nga KM; Listëpagesat; Diplomat; Listëprezencat; Urdhërshpenzimet; Urdhrat e punës, etj.
Pagat e punonjësve të sistemit të tatimeve mbështeten në VKM nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet eministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura,institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet nëvarësi të ministrave të linjësdhe administratën e prefektit" lidhja 1; lidhja 2 dhe lidhja 6/8.
Në funksion të auditimit të respektimit të dispozitave ligjore për pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetsore, etj, grupi i auditimit auditoi në bazë risku gjithë praktikat dokumentare që shoqëronin shpenzimet e kryera.
Grupi i auditimit referuar materialitetit duhet të përzgjidhte 34 raste për të shqyrtuar, për vitin 2018, dhe 35 raste, për vitin 2019. Nisur nga fakti që peshën specifike më të lartë në emërime dhe largime nga detyra e zinin punonjësit e Drejtorisë së Hetimit Tatimor, vendosi që të përzgjedhë mbi bazë risku për shqyrtim për vitin 2018, në total 57 dosje nga të cilat: 35 dosjet e punonjësve faktik të DHTR në datë 01.01.2018 si dhe të 22 dosjet e punonjësve të rekrutuar gjatë vitit 2018. Për vitin 2019, 57 dosjeve të vitit 2018 iu shtuan edhe 22 dosjet e punonjësve të rekrutuar gjatë vitit 2019. Në total për të dy vitet u shqyrtuan 79 dosje të punonjësve të DHT.

- ***Punonjësit në strukturë***

Për vitin 2018, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka ushtruar funksionet në zbatim të strukturës organizative, miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 "Për

miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore", me numër të përgjithshëm punonjësish 130, përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr.12381/12, datë 19.12.2016.
Nga 130 pozicione pune në strukturë, për periudhën 01.01.2018-31.12.2018, 73pozicione i përkasin punonjësve, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Ligjin nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar dhe 57pozicione i përkasin punonjësve, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995"Kodi i Punës", i ndryshuar.

- Struktura e punonjësve të DRT Shkodër për vitin 2018, paraqitet si vijon:

Tabela nr.14

Nr.	Emërtimi i Drejtorive	Struktura	Statusi i punonjësve
1	Drejtor Rajonal	1	Status i nënpunësit civil
2	Sekretare	1	Me kontratë
3	D/ Sherbimit per Tatim Paguesin	15	Status i nënpunësit civil
4	Drejtoria e Mbledhjes me Force	12	Status i nënpunësit civil
5	Drejtoria Kontrollit Tatimor	32	Status i nënpunësit civil
6	Drejtoria e Analizes dhe IT	7	Status i nënpunësit civil
7	Drejtoria e Funksioneve Mbeshtetese	6	Status i nënpunësit civil
8	Drejtoria e Funksioneve Mbeshtetese	4	Me kontratë
9	Drejtoria e Hetimit Tatimor	52	Me kontratë
	Gjithësej	**130**	
	Nga këto :	73	Status i nënpunësit civil
		57	Me kontratë

Burimi: Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT Shkodër

Realizimi i strukturës në datë 31.12.2018 paraqitet si vijon:

Tabela nr.15

Nr.	Emërtimi	Shuma
1	Nr. i planifikuar i punonjësve në strukturë në datë 01.01.2018	130
2	Nr. faktik i punonjësve në strukturë në datë 01.01.2018	96
3	Realizimi në % i strukturës në datë 01.01.2018	73.8%
4	Vende të lira pune në datë 01.01.2018	34
5	Rekrutime të punonjësve me status të nënpunësit civil gjatë vitit 2018	10
6	Rekrutime të punonjësve me kontratë gjatë vitit 2018	22
7	Total rekrutime gjatë vitit 2018	32
8	Largime nga puna të punonjësve me status të nënpunësit civil gjatë vitit 2018	6
9	Largime nga puna të punonjësve me kontratë gjatë vitit 2018	28
10	Total të larguar nga puna gjatë vitit 2018	34
11	Nr. i planifikuar i punonjësve në strukturë në datë 31.12.2018	130
12	Nr. faktik i punonjësve në strukturë në datë 31.12.2018	94
13	Vende të lira pune në datë 31.12.2018	36
14	Realizimi në % i strukturës në datë 31.12.2018	72.3%

Burimi:Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT Shkodër

Realizimi i strukturës sipas pozicioneve të punës në datë 31.12.2018

Tabela nr.16

Nr.	Emërtesa e structures	Plani sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016	Realizuar në fakt	Vende të lira pune në total
1	Drejtor Rajonal	1	- I komanduar	1
2	Sekretare	1	1	-
3	D/ Shërbimit për Tatim Paguesin	15	14	1
4	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë	12	9	3
5	Drejtoria e Kontrollit Tatimor	32	27	5
6	Drejtoria e Analizës dhe IT	7	5	2
7	Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	10	9	1
8	Drejtoria e Hetimit Tatimor	52	29	23
	Total	130	94	36

Burimi:Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT Shkodër

Konstatim:

Në fund të vitit 2018, në DRT Shkodër kanë rezultuar 36 vende të lira pune, nga të cilat 23 vende ose 63.4% e vendeve të lira të punës i përkasin Drejtorisë së Hetimit Tatimor.

Vendet e lira të punës si dhe largimet e shumta në numër të punonjësve të strukturës së hetimit tatimor tregojnë mangësi në procesin e, planifikimit të numrit të punonjësve dhe realizimin e strukturës së miratuar si dhe mangësi në procesin e rekrutimeve në punë të punonjësve, duke mos respektuar kriteret e miratuara dhe të shpallura për cdo pozicion pune.

Për periudhën 01.01.2019-21.03.2019numri i punonjësve të DRT Shkodër ka qenë 130, sipas Urdhrit të Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 "Për miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore".

Me Urdhrin e Kryeministrit nr.49, date 27.02.2019 "Për disa ndryshime në Urdhrin e Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 "Për miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore", përcjellë me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, nr.106, datë 21.03.2019, numri i punonjësve të DRT Shkodër, është 127.

Me Urdhrin e Kryeministrit nr.171, datë 13.05.2019,numri i punonjësve të DRT Shkodër bëhet 126 punonjës.

Struktura e punonjësve të DRT Shkodër për vitin 2019, paraqitet si vijon:

Tabela nr.17

Nr.	Emërtimi i Drejtorive	Struktura	Statusi i punonjësve
1	Drejtor Rajonal	1	Status i nënpunësit civil
2	Sekretare	1	Me kontratë
3	D/ Shërbimit për Tatim Paguesin	15	Status i nënpunësit civil
4	Drejtoria e Mbledhjes me Forcë	12	Status i nënpunësit civil
5	Drejtoria e Kontrollit Tatimor	32	Status i nënpunësit civil
6	Sektori i Analizës dhe kontabilitetit të të ardhurave	4	Status i nënpunësit civil
7	Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	6	Status i nënpunësit civil
8	Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	4	Me kontratë
9	Drejtoria e Hetimit Tatimor	51	Me kontratë
	Gjithsej	**126**	
	Nga këto :	70	Status i nënpunësit civil
		56	Me kontratë

Burimi:Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT Shkodër

Realizimi i strukturës për vitin 2019

Tabela nr.18

Nr.	Emërtimi	Shuma
1	Nr. i planifikuar i punonjësve në strukturë në datë 01.01.2019	130
2	Nr. faktik i punonjësve në strukturë në datë 01.01.2019	94
3	Realizimi në % i strukturës në datë 01.01.2019	72.3%
4	Vende të lira pune në datë 01.01.2019	36
5	Rekrutime të punonjësve me status të nënpunësit civil gjatë vitit 2019	8
6	Rekrutime të punonjësve me kontratë gjatë vitit 2019	22
7	Total rekrutime gjatë vitit 2019	30
8	Largime nga puna të punonjësve me status të nënpunësit civil gjatë vitit 2019	7
9	Largime nga puna të punonjësve me kontratë gjatë vitit 2019	10
10	Total të larguar nga puna gjatë vitit 2019	17
11	Nr. i planifikuar i punonjësve në strukturë në datë 31.12.2019	126
12	Nr. faktik i punonjësve në strukturë në datë 31.12.2019	107
13	Vende të lira pune në datë 31.12.2019	19
14	Realizimi në % i strukturës në datë 31.12.2019	85%

Burimi:Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT Shkodër

Gjetje nga auditimi:
Në fund të vitit 2019 rezultojnë 19 vende të lira pune ose afërsisht 53% më pak se në fund të vitit 2018.

Realizimi i strukturës sipas pozicioneve të punës në datë 31.12.2019

Tabela nr.19

Nr.	Emërtesa e struktures	Plani sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.49, datë 27.02.2019	Realizuar në fakt	Vende të lira pune në total
1	Drejtor Rajonal	1	- (I komanduar)	1
2	Sekretare	1	1	-
3	D/ Shërbimit për Tatim Paguesin	15	15	-
4	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të papaguara	12	12	-
5	Drejtoria e Kontrollit Tatimor	32	27	5
6	Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit	4	3	1
7	Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse	10	10	-
8	Drejtoria e Hetimit Tatimor	51	39	12
	Total	126	107	19

Burimi:Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT Shkodër

Konstatim:
Në fund të vitit 2019, në DRT Shkodër kanë rezultuar 19 vende të lira pune, nga të cilat 11 vende ose 57.8% e vendeve të lira të punës i përkasin Drejtorisë së Hetimit Tatimor.

Nga auditimi i strukturës së miratuar me Urdhrat e Kryeministrit respektivisht, nr.126, datë 02.08.2016 "Për miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore"; nr.49, datë 27.02.2019 "Për disa ndryshime në Urdhrin e Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 "Për miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të

administratës tatimore qendrore", dhe nr.171, datë 13.05.2019, rezulton se në strukturë për të dy vitet objekt auditimi vendi i përgjegjësit të Sektorit/Zyrës së Financës nuk ekziston, ndërkohë që në Rregulloren për Funksionimin e Drejtorive Rajonale, miratuar me Urdhrin Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, në nenin 32 përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësit të Sektorit/Zyrës së Financës.
Aktualisht detyrat e përgjegjësit të sektorit të financës i kryhen Drejtori i Funksioneve mbështetëse, që njëkohësisht është edhe nënpunësi zbatues i institucionit.
Konstatim:
Mosrakordim midis pozicioneve të punës në strukturën e miratuar me Urdhrat e Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016; nr.49, datë 27.02.2019dhe nr.171, datë 13.05.2019, dhe përgjegjësive dhe detyrave të përcaktuara në Rregulloren për Funksionimin e Drejtorive Rajonale, miratuar me Urdhrin Mininistrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017. Më konkretisht në strukturë mungon pozicioni i përgjegjësit të sektorit/zyrës së financës, ndërkohë që detyrat dhe përgjegjësit e tij janë përcaktuar në nenin 32 të Rregullores për Funksionimin e Drejtorive Rajonale. Aktualisht këtë detyrë e mbulon Drejtori i Funksioneve Mbështetëse që njëkohësisht është edhe nënpunësi zbatues i institucionit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 (b), të nenit 22, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar me Ligjin nr.110/2015 datë 15.10.2015, ku shprehimisht citohet:
"Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjëstë mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin".

Titulli i gjetjes: **Në fund të vitit 2018 struktura rezulton me mosrealizim në masën 28% ose 36 vende të lira pune dhe në fund të vitit 2019 me mosrealizim në masën 15% ose 19 vende të lira pune.**

Situata: Në fund të vitit 2018, struktura e DRT Shkodër, rezulton e realizuar në masën 72 %, me 36 vende të lira pune, nga të cilat 23 vende ose 63.4% e vendeve të lira të punës i përkasin Drejtorisë së Hetimit Tatimor.
Në fund të vitit 2019, struktura rezulton e realizuar në masën 85 %, me 19 vende të lira pune, nga të cilat 11 vende ose 57.8% e vendeve të lira të punës i përkasin Drejtorisë së Hetimit Tatimor.
Në fund të vitit 2019 vendet e lira të punës janë reduktuar në masën 53% krahasuar me vitin 2018.

Kriteri: Urdhri i Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 "Për miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore", i ndryshuar.

Ndikimi: Cënohet performanca e institucionit në tërësi si dhe përmbushja e misionit përpozicionet e punës që rezultojnë të paplotësuara me staf.

Shkaku: Moskryerja e procedurave të rekrutimit në raport me pozicionet e lira tëpunës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DRT në bashkëpunim me DPT të kryejnë një analizë të kujdeshme në lidhje me nevojat për kapacitete njerëzore dhe të marrin masat për realizimin e tyre.

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Në vijimësi**

- Procedurat për emërimet dhe largimet nga puna rezultojnë të jenë kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe vendimi i marrë rast pas rasti i është përcjellë zyrtarisht Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër. Referuar rregullores së funksionimit të administratës tatimore qëndrore, miratuar me Urdhrin e Mininistrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, është detyrë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT, të ndjekë, zbatojë dhe sigurojë procedura për rekrutim, zhvillimin profesional dhe motivimin e burimeve njerëzore, me qëllim arritjen e objektivave të institucionit. Është po kjo drejtori e cila përgatit akt-emërimet, akt-largimet dhe kontratat e punës për të gjithë punonjësit e Administratës Tatimore në bazë të kërkesave ligjore në vijim të vendimeve të Departamentit të Administratës Publike dhe të Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe menaxhon procedurat e rekrutimit dhe të emërimit, të ngritjes në detyrë dhe lëvizjes paralele në përputhje me Ligjin për Statusin e Shërbimit Civil, Ligjin e Proçedurave Tatimore, Kodin e Punës dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe akteve të tjera nënligjore.

Për periudhën objekt auditimi verifikimi i emërimeve dhe largimeve nga detyra u krye duke kryqëzuar informacionin e administruar në dosjet personale të punonjësve me informacionin e marrë nga sistemi i tatimeve në rubrikën "Deklarimi i të punësuarve përe herë të parë, si dhe të larguarve nga puna". Për të dy vitet objekt auditimi informacioni rezultoi i njëjtë.

Gjithashtu dosjet personale të të punësuarve administrohen nga DPT dhe rezultojnë të pasqyruara në sistemin HRMIS që administrohet nga DAP.

Pjesë e dosjeve personale të të punësuarve në DRT Shkodër janë vetëm: vendimet e emërimit/transferimit/largimit nga detyra; libreza e punës; kopje e kontratës së punës për punonjësit me kontratë; fotokopje e diplomës, fotokopje e kartës së identitetit si dhe libreza e punës.

Nga ana e strukturave përgjegjëse në DRT është hartuar rregjistri themeltar i punonjësve dhe libri i personelit, ndërkohë që për vendimet e emërimit, tranferimit, ndryshimit të kategorisë dhe largimit nga detyra nuk është mbajtur një rregjistër i vecantë, por ato janë të pasqyruara vetëm në format excel, ndërkohë që tabela e vjetërsisë në punë të punonjësve rishikohet për cdo muaj.

Nga ana e specialistit të administratës nuk rezulton të jetë hartuar një rregjistër për masat disiplinore të njoftuara për punonjësit e DRT, veprim ky jo nëpërputhje me përcaktimet e pikës 6 të nenit 35 të rregullores së funksionimit të DRT, miratuar me Urdhrin e Mininistrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për funksionimin e administratës tatimore qëndrore".

Grupi i auditimit në lidhje me këtë cështje shqyrtoi vendimet e emërimit në punë të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si dhe pagesat e kryera nga DRT Shkodër referuar emërimeve.Nga auditimi rezultoi se në të gjitha rastet dhe për të gjitha drejtoritë, përpiloheshin

listëprezencat mujore të cilat nënshkrueshin nga titullarët e drejtorive. Bashkëlidhur listëprezencës gjendeshin raportet mjeksore të cilat ishin të reflektuara edhe në listëprezencë.
Listëpagësat hartoheshin të plota me të gjithë komponentët e pagës dhe ndalesave. Listëpagesat konfirmoheshin ngfa NA dhe NZ i institucionit.Grupi i auditimit testoi llogaritjen e pagës në raport me nivelin e diplomës., rezultatet të cilat do ti paraqesim më poshtë.
Nga auditimi i vendimeve të emërimit në punë të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, rezulton se gjatë vitit 2018 janë emëruar në total 32 punonjës, nga të cilët, për 10 punonjës marrëdhëniet e punës rregullohen me Ligjin nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar dhe për 22 punonjës marrëdhëniet e punës rregullohen me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar. Më i detajuar informacioni është paraqitur në projektraportin e auditimit. Të 22 punonjësit me kontratë të emëruar gjatë vitit 2018 janë punësuar në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, prej të cilëve 1 në pozicionin e drejtorit të DHT dhe 21 në pozicionin e Inspektorit. Në pikën 7 të nenit 140 të rregullores së funksionimit të administratës tatimore qëndrore, miratuar me Urdhrin e Mininistrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, përcaktohet se Drejtori i Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT harton kriteret specifike që duhet të plotësojnë punonjësit e strukturave të hetimit tatimor për t'u emëruar në punë, kritere të cilat i miraton te Drejtori i Përgjithshëm i DPT.
Këto kritere janë pjesë e Rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.
Grupi i auditimit, auditoi mbi bazë risku, dokumentacionin e administruar në dosjet e punonjësve në DHTRV Shkodër, dosjet e punonjësve në sistemin HRMIS të DAP si dhe evidencat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse. Mbi këtë cështje është mbajtur Akt Konstatimin nr.4 datë 26.02.2020, protokolluar në DRT me nr.331/5, datë 26.02.2020 ku konstatohet se:

- ✓ ***Në 1 (një) rast*** procedura e emërimit të nivelit të lartë menaxherial nga Ministri i Financave, e ***z.*** [redacted] në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DRTRV, ka rezultuar me diplomë të nivelit Bachelor, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura,institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjësdhe administratën e prefektit lidhja 6/8struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të tatimeve, ku si kriter minimal i diplomës së shkollës së lartë, për efekt pranimi në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë në DRT, është 1, që do të thotë kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë. ***E gjithë paga e paguar për z.*** [redacted] ***për periudhën 05.02.2018-12.11.2018, në shumën 995,564lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë pasi z.*** [redacted] ***nuk plotëson kriteret për këtë pozicion pune.***
- ✓ ***Në 3 (tre) raste*** procedurat e rekrutimit të nivelit të mesëm menaxherial kanë rezultuar me diplomë të nivelit Bachelor, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet eministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura,institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet

nëvarësi të ministrave të linjësdhe administratën e prefektit lidhja 6/8struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të tatimeve, ku si kriter minimal i diplomës së shkollës së lartë, për efekt pranimi në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit në DRT, është 1ose 2, që do të thotë kandidati duhet të zotërojë DND, ose Master Profesional. ***E gjithë paga e paguar për punonjësit ([redacted]), nga momenti i emërimit, në shumën 3,753,681 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë pasi punonjësit nuk plotësojnë kriteret për pozicionet e punës që kanë mbajtur, nga të cilat: 1,904,675 në vitin 2017; 1,440,189 lekë në vitin 2018 dhe dhe 408, 817 lekë në vitin 2019.*** Më konkretisht:

- Z. [redacted], me vendimin nr.267, datë 28.02.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve është emëruar Përgjegjës i Sektorit të Hetimit në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, në kategorinë III-b, pozicion të cilin e ka mbajtur deri në datë 05.02.2018, datë në të cilën me urdhrin e Ministrit të Financave nr.37, është emëruar Drejtor i Drejtorisë së Hetimit Tatimor për Rajonin e Veriut, në klasën III-a/1.Me shkresën nr.22531/ 2, datë 16.11.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, bazuar në kërkesën për dorëheqje, z. [redacted] largohet nga detyra.

Në dosjen personale të ***z.*** [redacted], nuk gjendet e administruar diploma, por nga listëpagesat rezulton i paguar me 10,000 lekë që i përket diplomës së ***nivelit Bachelor***.

Për periudhën 28.02.2017-05.02.2018, z. [redacted] ka ushtruar funksionet e Përgjegjësit të Sektorit të Hetimit në Drejtorinë e Hetimit Tatimor dhe është paguar në kundërshtim me përcaktimet e:

- VKM–së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet eministrive të linjës,administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura,institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet nëvarësi të ministrave të linjësdhe administratën e prefektit", lidhja 6/8 struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të tatimeve, ku si kriter minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt pranimi në pozicionin e përgjegjësit të sektorit në DRT, është 1 ose 2, që do të thotë kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë, ose diplomë master profesional;
- Rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ku kritere të posacme në shpallje për këto pozicione pune janë:

"Përgjegjës Sektori, kategoria III-b-duhet të zotërojë minimalisht diplomë Master Shkencor, në Shkenca Ekonomike ose Juridike dhe të ketë jo me pak se 2 vit përvojë pune në profesion"

E gjithë paga e paguar për z. [redacted]***, për periudhën 28.02.2017-05.02.2018, në shumën 913,007lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë, nga të cilat: 829,207 lekë në vitin 2017 dhe 83,800lekë në vitin 2018.***

- Z. [redacted], me vendimin nr.268, datë 28.02.2017, të Drejtorit të Përgjithshëmtë Tatimeve është emëruar Përgjegjës i Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit, në Sektorin e Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, në kategorinë III-b, pozicion të cilin e ka mbajtur deri në datë 23.05.2019, datë në të cilën i është zgjidhur kontrata e punës nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve me arsyen e mospërmbushjes së kritereve të vecanta të pozicionit të punës, bazuar në përshkrimin e punës në asnjë prej pozicioneve të lira të punës, pjesë e strukturës së Hetimit Tatimor.

Nga auditimi i dosjes personale të ***z.*** [redacted], rezulton se zotëron diplomë 3 vjecare të Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, diplomë kjo e barazvlershme me diplomën e nivelit Bachelor, ndërkohë që ***është paguar nga sektori i financës me pagë grupi 14,000 lekë.***
Për periudhën 28.02.2017-23.05.2019 z. [redacted] ka ushtruar funksionet e Përgjegjësit të Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit, në Sektorin e Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor dhe është paguar në kundërshtim me përcaktimet e :

- VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet eministrive të linjës,administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura,institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet nëvarësi të ministrave të linjësdhe administratën e prefektit", lidhja 6/8 struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të tatimeve, ku si kriter minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt pranimi në pozicionin e përgjegjësit të sektorit në DRT, është 1 ose 2, që do të thotë kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë, ose diplomë master profesional;
- Rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ku kriter i posacëm në shpallje për këtë pozicion pune është:

"Përgjegjës Zyre, kategoria III-b - duhet të zotërojë minimalisht diplomë Master Shkencor, në Shkenca Ekonomike ose Juridike dhe të ketë jo me pak se 2 vit përvojë pune në profesion".
Më konkretisht, z. [redacted]:

Tabela nr.20
Në lekë

Nr	Periudha kohore	Paga e grupit	Paguar	Paga e grupit	Duhej paguar	Paguar më shumë
1	28.02.2017-31.12.2017	14,000	815,150	10,000	765,122	50,028
2	01.01.2018-31.12.2018	14,000	901,824	10,000	847,248	54,576
3	01.01.2019-23.05.2019	14,000	408,817	10,000	381,176	27,641
	Totali		**2,125,791**		**1,993,546**	**132,245**

E gjithë paga e paguar për z. [redacted], për periudhën 28.02.2017-23.05.2019, në shumën 2,125,791 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë, nga të cilat: 815,150 lekë janë paguar në vitin 2017; 901,824 lekë në vitin 2018 dhe 408,817 lekë në vitin 2019.
Pagesa më tepër në shumën 132,245 lekë e përfituar nga z. [redacted] si diferencë midis pagës së grupit (14,000lekë-10,000lekë) konsiderohet dëm në Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet.

- Z. [redacted], me vendimin nr.649, datë 20.09.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm tëTatimeve është emëruar Përgjegjës i Sektorit të Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, në kategorinë III-b, pozicion të cilin e ka mbajtur deri në datë 23.05.2018, datë në të cilën me vendimin nr.319, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, lirohet nga kjo detyrë dhe emërohet Inspektor Zbatimi në Zyrën e Monitorimit dhe Koordinimit, në Sektorin e Zbatimit, në DHT Shkodër, në kategorinë e pagës IV-a. Me vendimin nr.363, datë 13.06.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, lirohet nga detyra e Inspektorit të Zbatimit në Zyrën e Monitorimit dhe Koordinimit, në Sektorin e Zbatimit, në DHT Shkodër, në kategorinë e pagës IV-a dhe emërohet inspektor në po këtë strukturë në kategorinë e pagës IV-b.

Nga auditimi i dosjes personale të ***z.*** [redacted], ***rezulton i diplomuar në Drejtësi në nivelin Bachelor*** dhe i paguar nga sektori i financës me pagë grupi 10,000 lekë. ***E gjithë paga e paguar për z.*** [redacted]***, për periudhën 20.09.2017 -13.06.2018, në shumën 714,883 lekë, nga të cilat 260,318lekë në vitin 2017 dhe 454,565lekë në vitin 2018, konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë*** pasi, z. [redacted] ka ushtruar funksionet e Përgjegjësit të Sektorit të Zbatimit, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor dhe është paguar në kundërshtim me përcaktimet e :

- VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", lidhja 6/8 struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të tatimeve, ku si kriter minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt pranimi në pozicionin e përgjegjësit të sektorit në DRT, është 1 ose 2, që do të thotë kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë, ose diplomë master profesional;
- Rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ku kritere të posacme në shpallje për këto pozicione pune janë:

"Përgjegjës Sektori, kategoria III-b - duhet të zotërojë minimalisht diplomë Master Shkencor, në Shkenca Ekonomike ose Juridike dhe të ketë jo me pak se 2 vit përvojë pune në profesion".

Për periudhën 23.05.2018-13.06.2018, ka ushtruar funksionet e Inspektorit të Zbatimit në Zyrën e Monitorimit dhe Koordinimit, në Sektorin e Zbatimit, në DHT Shkodër, në kategorinë e pagës IV-a, në kundërshtim me përcaktimet e:

- Rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ku kritere të posacme në shpallje për këto pozicione pune janë:

"Inspektor Hetimi IV-a, - duhet të zotërojë minimalisht diplomë Master Profesional në Shkenca Ekonomike ose Juridike dhe të ketë jo me pak se 1 vit përvojë pune në profesion".

- ✓ ***Në 1 (një) rast*** procedura e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial ka rezultuar pa diplomë, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet eministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura,institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet nëvarësi të ministrave të linjësdhe administratën e prefektit lidhja 6/8struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të tatimeve, ku si kriter minimal i diplomës së shkollës së lartë, për efekt pranimi në pozicionin e Inspektorit në DRT, është 1, ose 2, ose 3, që do të thotë kondidati mund të punësohet edhe kur zotëron diplomë të nivelit Bachelor,***duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit.***

Z. [redacted] punonjës ekzistues në punë përpara periudhës së auditimit, emëruar me Vendimin nr.497, datë 02.08.2016, në pozicionin: Inspektor Zbatimi me kategorinë IV-b, rezulton të jetë emëruar pa diplomë. Z. [redacted] ka paraqitur një vërtetim nga Universiteti i Shkodrës "Luigj

Gurakuqi", në të cilin vërtetohet se ka ndjekur studimet pranë këtij Universiteti, në Fakultetin e Drejtësisë, Dega Juridik, është diplomuar, por nuk i është lëshuar diplomë pasi nuk është pajisur me numër matrikullimi nga AKP. Kriter për emërimin në punë është diploma dhe jo një vërtetim i Universitetit i cili konfirmon se Z. [redacted] nuk është pajisur me numër matrikullimi nga Agjencia Kombëtare e Provimeve që ligjërisht do të thotë nuk mund të pajiset me diplomë universitare.
Përsa më sipër,
Emërimi i z. [redacted] është i paligjshëm dhe e gjithë pagesa e bërë për periudhën 02.08.2016-31.01.2020, në shumën 2,336,875 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë pasi punonjësi është emëruar në detyrë i padiplomuar, nga të cilat:

- 224,108 lekë paguar në vitin 2016;
- 666,618 lekë paguar në vitin 2017;
- 690,964 lekë paguar në vitin 2018;
- 697,012 lekë paguar në vitin 2019;
- 58,173 lekë paguar në vitin 2020;

Nga auditimi i listëpagesave, rezultoi se ***z.*** [redacted], është paguar me pagën e grupit 10,000 lekë, pagë që i korespodon nivelit të diplomës Bachelor.
Më konkretisht, z. [redacted]:

Tabela nr.21
Në lekë

Nr	Periudha kohore	Paga e grupit	Paguar	Paga e grupit	Duhej paguar	Paguar më shumë
1	02.08.2016-31.12.2016	10,000	224,108	0	187,242	36,866
2	01.01.2017-31.12.2017	10,000	666,618	0	575,481	91,137
3	01.01.2018-31.12.2018	10,000	690,964	0	598,086	92,878
4	01.01.2019-23.05.2019	10,000	697,012	0	601,656	95,356
5	01.01.2020-31.01.2020	10,000	58,173	0	50,138	8,035
	Totali		**2,336,875**		**2,012,603**	**324,272**

Pagesa më tepër në shumën 324,272 lekë e përfituar nga z. [redacted] konsiderohet dëm në Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet.

- ✓ ***Në 1 (një) rast***procedurat e rekrutimit kanë rezultuar konform përcaktimeve ligjore por pagesa është bërë, jo në përputhje me nivelin e diplomës, ***duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 58,727 lekë.***

Më konkretisht:

- ***Z.*** [redacted] është emëruar me Vendimin nr.475, datë 28.04.2017, në pozicionin Inspektor Zbatimi me kategorinë IV-b. Z. [redacted] **zotëron diplomë të nivelit Bachelor në Menaxhim Biznesi.**

Nga auditimi i listëpagesave, rezultoi se ***z.*** [redacted], është paguar me pagën e grupit 14,000 lekë, pagë që i korespodon nivelit të diplomës Master Shkencor. Me Vendimin nr.615, datë 20.11.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT është zgjidhur kontrata e punës.
Më konkretisht, z. [redacted]:

Tabela nr.22
Në lekë

Nr	Periudha kohore	Paga e grupit	Paguar	Paga e grupit	Duhej paguar	Paguar më shumë
1	28.04.2017-31.12.2017	14,000	399,126	10,000	374,518	24,608
2	01.01.2018-20.11.2018	14,000	561,397	10,000	527,278	34,119
	Totali		**960,523**		**901,796**	**58,727**

Z.[redacted] është paguar në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjësdhe administratën e prefektit", lidhja 2, ku përcaktohet vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar (Diploma Bachelor, grupi 3, vlera 10,000 lekë). **Pagesa më tepër në shumën 58,727 lekë *(24,608 lekë në vitin 2017 dhe 34,119 lekë në vitin 2018)*e përfituar nga z.[redacted] konsiderohet dëm në Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet.**

Në projektraportin e auditimit, janë trajtuardhe shqyrtuar observacionet eparaqitura nga Drejtori i Funksioneve Mbështetëse në DRT me shkresën nr.1997 prot, datë 02.03.2020, grupit të auditimit në DRT, në lidhje me akt konstatimin nr.4, datë 26.02.2020 dhe situata e emërimeve në detyrë, referuar kriterit të diplomës dhe vjetërsisë në punë, nga *5 (pesë) raste emërime në detyrë jo në përputhje me kriterin e diplomës dhe 5 (pesë) raste emërime në detyrë jo në përputhje me kriterin e vjetërsisë në punë, që ishin konstatuar në akt konstatimin* nr.4, datë 26.02.2020, u riformulua si vijon:

- ✓ ***Në 3 (tre) raste ([redacted]) janë konstatuar emërime në detyrë jo në përputhje me kriterin e diplomës dhe kriterin e vjetërsisë në punë*** përcaktuar në Rregulloren "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018 dhe paga e paguar në total për të tre punonjësit në shumën 2,087,954 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë, nga të cilat: 836,090 lekë në vitin 2018 dhe 1,251,864 lekë në vitin 2019.

- Z.[redacted] për periudhën 10.10.2018-26.07.2019 në shumën 678,527 lekë, nga të cilat: 180,727 lekë në vitin 2018 dhe 497,800 lekë në vitin 2019.

- Z.[redacted] për periudhën 13.11.2018- 31.12.2019 në shumën 860,564 lekë, nga të cilat: 106,500 lekë në vitin 2018 dhe 754,064 lekë në vitin 2019.

-Z.[redacted] për periudhën 30.04.2018- 20.11.2018 në shumën 548,863 lekë.

- ***Z.[redacted]*** është rekrutuar në pozicionin e Inspektorit të Hetimit Tatimor, në Sektorin e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut me Vendimin nr.499, datë 10.10.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT në kategorinë IV-a. Referuar rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, , ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018, kriteri i posacëm në shpallje për këtë pozicion pune është:

"Inspektor Hetimi IV-a -duhet të zotërojë minimalisht diplomë Master Profesional në Shkenca Ekonomike ose Juridike dhe të ketë jo me pak se 1 vit përvojë pune në profesion"

Nga auditimi i dosjes personale të z.[redacted], rezulton se në momentin e rekrutimit në punë ka qenë i pajisur me diplomë në Turizëm ***në nivelin Bachelor, me vjetërsi në punë 6 muaj.***
Në datë 26.07.2019 është pajisur me diplomë Master Profesional në degën Administrim Biznes.
Përsa më sipër, z. [redacted], në momentin e emërimit në detyrë nuk plotësonte kriteret e posacme për këtë pozicion përcaktuar në rregulloren e sipërcituar.

- ***Z.*** [redacted] është rekrutuar në pozicionin e Inspektorit të Hetimit Tatimor, në Sektorin e Analizës, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut me Vendimin nr.576, datë 13.11.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT në kategorinë IV-a. Referuar rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018, kriteri i posacëm në shpallje për këtë pozicion pune është: ***"Inspektor Hetimi IV-a - duhet të zotërojë minimalisht diplomë Master Profesional në Shkenca Ekonomike ose Juridike dhe të ketë jo me pak se 1 vit përvojë pune në profesion"***

Nga auditimi i dosjes personale të z. [redacted], rezulton se është i diplomuar në Turizëm ***në nivelin Bachelor, me vjetërsi në punë 0 vite.***

Përsa më sipër, z. [redacted] është rekrutuar në pozicionin e Inspektorit të Hetimit Tatimor, në Sektorin e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut në kundërshtim me kriteret e posacme për këtë pozicion përcaktuar në rregulloren e sipërcituar.

- ***Z.*** [redacted] është rekrutuar në pozicionin e Inspektorit të Hetimit Tatimor, në Sektorin e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut me shkresën nr. 867/1, datë 30.04.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT në kategorinë IV-a. Referuar rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018, kriteri i posacëm në shpallje për këtë pozicion pune është: ***"Inspektor Hetimi IV-a - duhet të zotërojë minimalisht diplomë Master Profesional në Shkenca Ekonomike ose Juridike dhe të ketë jo me pak se 1 vit përvojë pune në profesion"***

Nga auditimi i dosjes personale të z.[redacted], rezulton se është i diplomuar në Drejtësi, ***në nivelin Bachelor, me vjetërsi në punë 0.***

Përsa më sipër, z. [redacted] është rekrutuar në pozicionin e Inspektorit të Hetimit Tatimor, në Sektorin e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut në kundërshtim me kriteret e posacme për këtë pozicion përcaktuar në rregulloren e sipërcituar.

- ✓ ***<u>Në 1 (një) rast</u> është konstatuar emërim në detyrë jo në përputhje me kriterin e diplomës,*** përcaktuar në rregulloren e sipërcituar dhe **paga e paguar për *Z.*** [redacted] **për periudhën 10.10.2018- 11.12.2018 në shumën 142,000 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.**

Z. [redacted] është rekrutuar në pozicionin e Inspektorit të Hetimit Tatimor, në Sektorin e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut me Vendimin nr.502, datë 10.10.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT në kategorinë IV-a. Referuar rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018, kriteri i posacëm në shpallje për këtë pozicion pune është:

"Inspektor Hetimi IV-a - duhet të zotërojë minimalisht diplomë Master Profesional në Shkenca Ekonomike ose Juridike dhe të ketë jo me pak se 1 vit përvojë pune në profesion"

Nga auditimi i dosjes personale të z.Ajdini, rezulton se është i diplomuar në Drejtësi ***në nivelin Bachelor.***Z.[redacted] me vendimin nr.660, datë 11.12.2018 rezulton i tranferuar në Tiranë.

Përsa më sipër, z.[redacted] është rekrutuar në pozicionin e Inspektorit të Hetimit Tatimor, në Sektorin e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut, në kundërshtim me kriterin e diplomës.

- ✓ ***Në 2 (dy) raste*** *(*Znj. [redacted]*) janë konstatuar emërime në detyrë jo në përputhje me kriterin e vjetërsisë në punë,* përcaktuar në rregulloren e sipërcituar dhe **paga e paguar në total për të dy punonjësit në shumën 2,560,062 lekë nga të cilat: 954,911 lekë në vitin 2018 dhe 1,605,151 lekë në vitin 2019, konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.**

- Znj.[redacted] për periudhën 05.01.2018,- 31.12.2019 në shumën 1,706,091 lekë, nga të cilat: 842,411 lekë në vitin 2018 dhe 863,680 lekë në vitin 2019.

- Z. [redacted] për periudhën 13.11.2018- 31.12.2019 në shumën 853,971 lekë, nga të cilat: 112,500 lekë në vitin 2018 dhe 741,471 lekë në vitin 2019.

- ***Znj.[redacted]*** është rekrutuar në pozicionin e Inspektorit të Hetimit Tatimor, nëSektorin e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut me Vendimin nr.11, datë 05.01.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT në kategorinë IV-a. Referuar rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018, kriteri i posacëm në shpallje për këtë pozicion pune është:

"Inspektor Hetimi IV-a -duhet të zotërojë minimalisht diplomë Master Profesional në Shkenca Ekonomike ose Juridike dhe të ketë jo me pak se 1 vit përvojë pune në profesion"

Nga auditimi i dosjes personale të znj.XXXXX, rezulton e diplomuar në Drejtësi ***në nivelin Master Profesional, me vjetërsi në punë 0 vite.***

Përsa më sipër, znj. [redacted] në momentin e rekrutimit nuk plotësonte kriterin e eksperiencës në punë (jo më pak se 1 vit).

- ***Z.[redacted]*** është rekrutuar në pozicionin e Inspektorit të Hetimit Tatimor, në Sektorin e Hetimit Tatimor, në Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut me Vendimin nr.575, datë 13.11.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT në kategorinë IV-a. Referuar rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018, kriteri i posacëm në shpallje për këtë pozicion pune është: ***"Inspektor Hetimi IV-a -duhet të zotërojë minimalisht diplomë Master Profesional në Shkenca Ekonomike ose Juridike dhe të ketë jo me pak se 1 vit përvojë pune në profesion".***

Nga auditimi i dosjes personale të z.[redacted], rezulton se është i diplomuar ***në Master Shkencor dhe në momentin e rekrutimit ka pasur vjetërsi në punë vetëm 4 muaj.***

Përsa më sipër, z.[redacted], në momentin e emërimit nuk ka plotësuar kriterin e eksperiencës në punë (jo me pak se 1 vit përvojë pune në profesion).

Në observacionet e dërguara me email,në datat 24.04. 2020 dhe 28.04.2020, grupit të auditimit të KLSH, Drejtori i Drejtorisë Rajonale dhe Drejtori i Funksioneve Mbështetëse në DRT, në lidhje parregullsitë në procedurat e rekrutimit në punë të trajtuara në projektraportin e auditimit, ndërmjet të tjerash theksojnë:

"Në lidhje me rekrutimet sqarojmë se bazuar në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë" i ndryshuar, Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore Qëndrore miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017 si dhe Urdhërit të Drejtorit Përgjithshen Tatimeve nr. 65, datë 04.10.2017 i ndryshuar me Urdhërin nr.

65/1, date 02.02.2018, është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve organi që ndjekë dhe zbaton proçedurat e rekrutimit të punonjësve. D.R.T Shkodër nuk është institcioni i cili verifikon kriteret e rekurtimit të punonjesve. Gjithë dokumentacioni në lidhje me rekrutimin largimin si dhe masat disiplinore ndodhen në dosjen personale të secilit punonjës pranë Drejtorisë Burimeve Njerezore të cilat ***mund verifikohen pranë DPT-ve.****Në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër nuk ka të emruar specialist për burimet njerëzore, është specialisti i administratës i cili ka për detyrë të ndjekë shkresat e hyra dhe të dala në lidhje me emërimet dhe largimet e punonjësve. Sqarojmë në lidhje me :*

- [redacted] *ka diplome Master Shkencor (bashkëlidhur vertetimi i diplomës datë 18.02.2016) por nuk ka vjetërsi në punë.*
- [redacted] *në moment e rekurtimin ka rezultuar me 10 muaj ekperience pune (bashkëlidhur libreza e punës). Pas njoftimin të Projekt Kontrollit ka vënë në dispozicion vertetimin nr 213 datë 06.04.2020 në lidhje me punësimin e saj (bashkëlidhur vertetimit nr 213)"*

Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe administrimit të dokumentit të diplomës dhe librezës së punës, pranon plotësimin e kriterit të diplomës për z.[redacted] *por i qëndron konstatimit se emëriminë detyrë i z.*[redacted] *është bërë jo në përputhje me kriterin e vjetërsisë në punë, ndërkohë që për znj.*[redacted] *edhe dokumentacioni i paraqitur pas projektraportit vërteton se në momentin e rekrutimit nuk plotësonte kriterin e eksperiencës në punë (jo më pak se 1 vit).*

Fakti që z.[redacted] *në listëpagesa rezulton i paguar me pagë grupi 10,000 lekë që i përket nivelit të diplomës Bachelor vërteton edhe njëherë se DRT Shkodër nuk ka kryer kontrolle për verifikimin e nivelit të diplomave.*

Përfundimi:

Z. [redacted] *i cili zotëron diplomë Master Shkencor**,** është rekrutuar në pozicionin e Inspektorit të Hetimit Tatimor, në Sektorin e Hetimit Tatimor, në kundërshtim me kriteret e posacme të këtij pozicioni "**jo më pak se 1 vit përvojë pune në profesion".***

- Për znj. [redacted] *qëndron konstatimi i rekrutimit në punë pa plotësimin e kriterit të vjetërsisë.*

Pas trajtimit të observacionit efektet nga parregullsitë në procedurat e rekrutimit paraqiten si vijon:

- ✓ ***Në 2 (dy) raste (***[redacted]***) janë konstatuar emërime në detyrë jo në përputhje me kriterin e diplomës dhe kriterin e vjetërsisë në punë*** përcaktuar në Rregulloren "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018 dhe paga e paguar në total për të dy punonjësit në shumën 1,539,091 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë, nga të cilat: 287,227 lekë në vitin 2018 dhe 1,251,864 lekë në vitin 2019.

- Z. [redacted] ***për periudhën 10.10.2018-26.07.2019 në shumën 678,527 lekë, nga të cilat: 180,727 lekë në vitin 2018 dhe 497,800 lekë në vitin 2019.***

- Z. [redacted] ***për periudhën 13.11.2018- 31.12.2019 në shumën 860,564 lekë, nga të cilat: 106,500 lekë në vitin 2018 dhe 754,064 lekë në vitin 2019.***

- ✓ ***Në 1 (një) rast është konstatuar emërim në detyrë jo në përputhje me kriterin e diplomës,*** përcaktuar në rregulloren e sipërcituar dhe **paga e paguar për *Z.*** [redacted] **për periudhën 10.10.2018- 11.12.2018 në shumën 142,000 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.**

✓ ***Në 3 (tre) raste*** *(*Znj. [redacted]*) janë konstatuar emërime në detyrë jo në përputhje me kriterin e vjetërsisë në punë,* përcaktuar në rregulloren e sipërcituar dhe **paga e paguar në total për të tre punonjësit në shumën 3,108,925 lekë nga të cilat: 1,503,774 lekë në vitin 2018 dhe 1,605,151 lekë në vitin 2019, konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.**
- Znj. [redacted] ***për periudhën 05.01.2018,- 31.12.2019 në shumën 1,706,091 lekë, nga të cilat: 842,411 lekë në vitin 2018 dhe 863,680 lekë në vitin 2019.***
- Z. [redacted] ***për periudhën 13.11.2018- 31.12.2019 në shumën 853,971 lekë, nga të cilat: 112,500 lekë në vitin 2018 dhe 741,471 lekë në vitin 2019.***
- Z. [redacted] ***për periudhën 30.04.2018- 20.11.2018 në shumën 548,863 lekë.***

Për vitin 2019 janë emëruar në detyrë në total 30 punonjës prej të cilëve, 8 punonjës me status të nënpunësit civil (5 janë studentë të ekselencës) dhe nga 22 punonjësit me kontratë, emëruar gjatë vitit 2019 (4 janë studentë të ekselencës dhe 15 janë tranferime nga DPT). Më I detajuar informacioni është paraqitur në projektraportin e auditimit.
Grupi i auditimit, auditoi mbi bazë risku, dokumentacionin e administruar në dosjet e punonjësve në DHTRV Shkodër, në dosjet e punonjësve në sistemin HRMIS të DAP si dhe evidencat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse. Nga kryqëzimi i informacionit u konstatua si vijon:

✓ ***Në 1 (një) rast*** kualifikimet e punonjësve të emëruar në detyrë nga DPT, nuk përputhen me kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të shpallura për pozicionet vakante, të përcaktuara në Rregulloren "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.
Më konkretisht:

➢ ***Z.*** [redacted] është rekrutuar në pozicionin e Inspektorit të Hetimit Tatimor në kategorinë IV-a, në datë03.06.2019, i diplomuar me diplomë të nivelit të dytë në Marrëdhënie Ndërkombëtare, ndërkohë që kriteri i posacëm në shpallje për këtë pozicion pune është :
"Inspektor Hetimi IV-a -duhet të zotërojë minimalisht diplomë Master Profesional në Shkenca Ekonomike ose Juridike dhe të ketë jo me pak se 1 vit përvojë pune në profesion".
Nga shqyrtimi i dosjes rezulton se z. [redacted] plotëson kriterin e vjetërsisë, por nuk plotëson kriterin e diplomimit, pasi nuk zotëron diplomë në shkencat Ekonomike ose Juridike.
Si përfundim:
Në 1 (një) rast **procedura e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial ka rezultuar *jo në përputhje me kriterin e diplomës* përcaktuar në rregulloren e sipërcituar dhe paga e paguar për z.** [redacted] **në shumën *368,554 lekë* për vitin 2019, konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.**

Si përfundim nga 57 dosje të shqyrtuara për vitin 2018, në 12 raste, ose në 21% të rasteve gjithsej u konstatuan problematika në procedurat e rekrutimit, ndërkohë që 45 dosje ose 79% e rasteve gjithsej rezultuan të rregullta. Nga 22 dosjet e rekrutimeve të reja për vitin 2019 vetëm në 1 rast u konstatua me problem.

Për emërimet në 12 raste të punonjësve në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve,

zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjësdhe administratën e prefektit" dhe përcaktimet e Rregullores"Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018, për të cilat janë paguar shpenzime në kushtet e paligjshmërisë në shumën **totale 12,244,690 lekë** mbajnë përgjegjësi: ***Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve; Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT; Ish Drejtori i Drejtorisë Rajonale z.[redacted], sipas periudhave respektive.***

Për pagesat e punonjësve në 3 raste jo në përputhje me nivelin e diplomës, të cilat sëbashku kanë shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit **në shumë 515,244 lekë** mbajnë:
Ish Drejtori i Drejtorisë Rajonale z.[redacted] për periudhën 01.01.2018-08.07.2019, në cilësinë e NA;
Drejtor i Funksioneve Mbështetëse, znj.[redacted], në cilësinë e NZ.

- Nga analiza e listëpagesave të punonjësve të DRT Shkodër u konstatua se,janë llogaritur konform përcaktimeve të VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit":

- Shtesa për pozicion (lidhja 1);
- Shtesa për kushte pune (lidhja 6/8).

Gjithashtu janë llogaritur saktë kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat nga punësimi.

- Në lidhje me llogaritjen e përfitimeve për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën e trajtimit financiar nga punëdhënësi, e vërtetuar me raport mjeksor deri në 14 ditë, Ligji nr 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e shqipërisë" i ndryshuar, në pikën 1 të nenit nr.130, përcakton se:

"Kur punëmarrësi nuk mund të punojë për shkak të sëmundjes, punëdhënësi i jep atij jo më pak se 80% e pagës, për një periudhë prej 14 ditësh, të pambuluara nga Sigurimet Shoqërore".

Konstatim:
Për periudhën objekt auditimi, në të gjitha rastet, DRT ka përllogaritur përfitimet për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën deri në 14 ditë në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi, duke aplikuar masën70% të mesatares 6 mujore të pagës për punonjësit që kanë më pak se 10 vite punë, nëreferencëtëpikës 1, të nenit 23, dhe nenit 25 të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipësrisë", por duhet sqaruar se ky ligj i referohet periudhës që do të mbulohet nga Sigurimet Shoqërore dhe jo periudhës deri në 14 ditë që duhet të justifikohet meraport mjeksor dhe paguhet nga punëmarrësi.

Titulli i Gjejes: **Parregullësi në 12 raste nëprocedurat e rekrutimit në të gjitha nivelet menaxheriale të cilat kanë shkaktuar shpenzim në kushtet e paligjshmërisë në total në shumën 12,244,690 lekë.**

Situata: ***a) Në 1 (një) rast*** procedura e emërimit të nivelit të lartë menaxherial nga Ministri i Financave, për ***z.*** [redacted] (i cili zotëron diplomë të nivelit) Bachelor), në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DRTRV, ka rezultuar, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës....." lidhja 6/8, ku si kriter minimal i diplomës së shkollës së lartë, për efekt pranimi në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë në DRT, është 1, që do të thotë kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë dhe paga e paguar për të, për periudhën 05.02.2018-12.11.2018, ***në shumën 995,564lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.***

b)***Në 3 (tre) raste*** procedurat e rekrutimit të nivelit të mesëm menaxherial kanë rezultuar me diplomë të nivelit Bachelor, në kundërshtim me përcaktimet VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave tënëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet eministrive të linjës,...", lidhja 6/8, ku si kriter minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt pranimi në pozicionin e përgjegjësit të sektorit në DRT, është 1 ose 2, që do të thotë kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë, ose diplomë master profesional si dhe përcaktimet e rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe paga e paguar për punonjësit ([redacted]), nga momenti i emërimit, ***në shumën 3,753,681 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë nga të cilat: 1,904,675 në vitin 2017; 1,440,189 lekë në vitin 2018 dhe dhe 408, 817 lekë në vitin 2019***.

c) Në 1 (një) rast procedura e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial ka rezultuar **pa diplomë**, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017"Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet eministrive të linjës,..." dhe e gjithë pagesa e bërë për periudhën 02.08.2016- 31.01.2020, ***në shumën 2,336,875 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë pasi punonjësi është emëruar në detyrë i padiplomuar, nga të cilat:*** 224,108 lekë paguar në vitin 2016; 666,618 lekë paguar në vitin 2017;690,964 lekë paguar në vitin 2018;697,012 lekë paguar në vitin 2019 dhe 58,173 lekë paguar në vitin 2020.

d)***Në 2 (dy) raste*** procedurat e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial

kanë rezultuar ***jo në përputhje me kriterin e diplomës dhe kriterin e vjetërsisë në punë*** përcaktuar në Rregulloren "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018, pasi z.[redacted], në momentin e rekrutimit në punë ka qenë i pajisur me diplomë *të nivelit Bachelor, me vjetërsi në punë 6 muaj dhe* z. [redacted] rezulton i diplomuar *në nivelin Bachelor, me 0 vite vjetërsi në punë.*Paga e paguar në total për punonjësit*(*[redacted]***) në shumën 1,539,091 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë, nga të cilat: 287,227 lekë në vitin 2018 dhe 1,251,864 lekë në vitin 2019.**

e)***Në 2 (dy) raste***procedurat e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial kanë rezultuar ***jo në përputhje me kriterin e diplomës*** përcaktuar në rregulloren e sipërcituar. Paga e paguar në total për të dy punonjësit ***(***[redacted]***)në 510,554 lekë nga të cilat: 142,000 lekë në vitin 2018 dhe 368,554lekë në vitin 2019, konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.***

f)***Në 3 (tre) raste***procedurat e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial kanë rezultuar ***jo në përputhje me kriterin e vjetërsisë në punë,*** përcaktuar në rregulloren e sipërcituar, pasi znj. [redacted] në momentin e rekrutimit rezulton me 10 muaj vjetërsi në punë, z.[redacted]me vetëm 4 muaj vjetërsi dhe z.[redacted] pa vjetërsi. Paga e paguar në total për të tre punonjësit **(**[redacted]**) në shumën 3,108,925 lekë nga të cilat: 1,503,774 lekë në vitin 2018 dhe 1,605,151 lekë në vitin 2019, konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.**

Kriteri:

VKM nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet eministrive të linjës,...", lidhja 6/8 struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të tatimeve.

Rregullorja "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Shpenzime në kushtet e paligjshmërisë.

Ndikimi:
Rëndësia:

I lartë

Rekomandimi 1.1: Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të kalojë në një proces shqyrtimi tërësor, gjithë databazën e të punësuarve të DRT-së, për të vlerësuar

saktësinë dhe rregullshmërinë e trajtimit financiar të çdo punonjësi si dhe përllogaritjes së komponentëve që përbëjnë pagën, të tilla si:nivelin e diplomës, shtesa për efekt pozicioni, vjetërsinë në punë etj, me qëllim menaxhimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Rekomandimi 1.2. Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të plotësojë dosjet personale të punonjësve me kontratë me kopje të diplomës dhe librezës së punës, për efekt të llogaritjes së elementëve të pagës, pasi për punonjësit me Status të Nëpunësit Civil të dhënat personale janë të administruara në sistemin HRMIS.

Rekomandimi 1.3: DRT Shkodër në bashkëpunim me DPT të fillojnë procedurat ligjore për largimin nga detyra të z. [redacted], i emëruar në detyrë ndonëse rezulton i padiplomuar.

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë dhe në vijimësi.**

Titulli i Gjejes: **Në 3 (tre) raste punonjësit janë paguar me pagë grupi jo në përputhje me nivelin e diplomës duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit në total në shumën 515,244 lekë.**

Situata: a) ***<u>Në 2 (dy) raste</u>*** punonjësit janë paguar me pagë grupi, jo në përputhje me nivelin e diplomës, ***duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 190,972 lekë.***

Më konkretisht:

-z.[redacted] është paguar me pagën e grupit 14,000 lekë, pagë që i korespodon nivelit të diplomës Master Shkencor dhe jo me pagën e grupit 10,000 lekë që i korespodon nivelit të diplomës Bachelor që ai zotëron, pra z.[redacted] është paguar **më tepër në shumën 132,245 lekë. Shuma 132,245 lekë *(50,028 lekë në vitin 2017, 54,576 lekë në vitin 2018 dhe 27,641 lekë në vitin 2019)*** e përfituar nga z.[redacted] si diferencë midis pagës së grupit (14,000lekë-10,000lekë) në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës...", lidhja 2, ku përcaktohet vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar(Diploma Bachelor, grupi 3, vlera 10,000 lekë, **konsiderohet dëm në Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet.**

-z.[redacted], është paguar me pagën e grupit 14,000 lekë, pagë që i korespodon nivelit të diplomës Master Shkencor dhe jo me pagën e grupit 10,000 lekë që i korespodon nivelit të diplomës Bachelor që ai zotëron, pra z. [redacted] është paguar **më tepër në shumën 58,727 lekë. Shuma 58,727 lekë *(24,608 lekë në vitin 2017 dhe 34,119 lekë në vitin***

2018)e përfituar nga z.[redacted] si diferencë midis pagës së grupit (14,000lekë-10,000lekë) në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës...", lidhja 2, ku përcaktohet vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar(Diploma Bachelor, grupi 3, vlera 10,000 lekë, **konsiderohet dëm në Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet.**

b)***Në 1 (një) rast*** punonjësi ***z.***[redacted] është paguar me pagë grupi 10,000 lekë, ndërkohë që rezulton i papajisur me diplomë ***duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit në shumën totale*** **324,272 lekë,** për periudhën 02.08.2016-31.01.2020. **Shuma 324,272 lekë, *(36,866 lekë në vitin 2016, 91,137 lekë në vitin 2017, 92,878 lekë në vitin 2018, 95,356 lekë në vitn 2019 dhe 8,035 lekë në vitin 2020)*** e përfituar nga z.[redacted] në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, **konsiderohet dëm në Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet.**

Kriteri: VKM nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet eministrive të linjës,...", lidhja 6/8 struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të tatimeve.
Rregullorja "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Ndikimi: Dëm në buxhetin e shtetit.

Shkaku: Mangësi në funksionimin e kontrollit të brendshëm në drejtim tëkryerjes së pagesave në kundërshtim me përcaktimet e kuadritligjor në fuqi.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi 1.1: **1.1**DRT Shkodër të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 515,244 lekë, sa përfituar padrejtësisht nga z.[redacted] në shumën 132,245 lekë; z.[redacted] në shumën 58,727 lekë dhe z.[redacted] në shumën totale 324,272 lekë, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, ...".

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë dhe në vijimësi.**

Titulli i Gjetjes: **Parregullësi në përllogaritjen e përfitimet për paaftësi të përkohshme në punë.**

Situata: Për të gjithë punonjësit me vjetërsi më pak se 10 vite pune, DFM ka përllogaritur përfitimet për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën deri në 14 ditë në masën 70% të mesatares 6 mujore të pagës.
Këtë veprim DFM e ka kryer në referencë të pikës 1, të nenit 23, dhe nenit 25 të Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë". Grupi i auditimit sqaron se, ky ligj i referohet periudhës që do të mbulohet nga Sigurimet Shoqërore dhe jo periudhës deri në 14 ditë që duhet të justifikohet me raport mjeksor dhe paguhet nga punëmarrësi. Në lidhje me llogaritjen e përfitimeve për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën e trajtimit financiar nga punëdhënësi, e vërtetuar me raport mjeksor deri në 14 ditë, Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e shqipërisë" i ndryshuar, në pikën 1 të nenit nr.130, përcakton se: *"Kur punëmarrësi nuk mund të punojë për shkak të sëmundjes, punëdhënësi i jep atij jo më pak se 80% e pagës, për një periudhë prej 14 ditësh, të pambuluara nga Sigurimet Shoqërore".*

Kriteri: Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Ndikimi: Institucioni përballet me riskun e mosmenaxhimit dhe administrimit të drejtë të fondeve buxhetore në zërin paga e shpërblime

Shkaku: Keqinterpretim i legjislacionit në fuqi nga ana e NZ.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi 6.1: Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT të kalojë në një proces të kujdesshëm përllogaritjen e përfitimeve për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën e trajtimit financiar nga punëdhënësi, e vërtetuar kjo me raport mjeksor deri në 14 ditë, në përputhje me pë rcaktimet e Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e shqipërisë" i ndryshuar.

Rekomandimi 6.2: DPT ka përgjegjësinë për të udhëzuar të gjitha Drejtoritë Rajonale për zbatimin korrekt të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në lidhje me përfitimet për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën deri në 14 ditë.

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Në vijimësi**

- ***Largimet nga detyra për vitin 2018***, për punonjësit në strukture paraqiten si vijon:

Nga auditimi i vendimeve të largimit nga detyra të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, rezulton se gjatë vitit 2018, janë larguar nga detyra në total 34 punonjës nga të cilët 6 punonjës me status të nëpunësit civil dhe 28 punonjës me kontratë, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar. Nga 6 punonjësit me status të nëpunësit civil vetëm 2 janë larguar me motivacionin "Largim nga shërbimi civil", ndërkohë qënga 28 punonjësit me kontratë të larguar nga puna, 1 është larguar me kërkesën e tij, 7 punonjës janë transferuar ne Tiranë dhe për 20 punonjës është zgjidhur kontrata e punës. Nga 20 punonjësit të cilëve u është zgjidhur kontrata e punës, 4 punonjës ose 20% e të larguarve nga detyra janë punonjës të emëruar në punë gjatë vitit 2018. Më konkretisht: [redacted] i emëruar në detyrë në pozicionin e inspektorit të hetimit me vendimin nr.12, datë 05.01.2018 dhe larguar me vendimin nr.605, datë 20.11.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT; [redacted] i emëruar në detyrë në pozicionin e inspektorit të hetimit me shkresëne DPTnr.867/1, datë 30.04.2018dhe larguar nga detyra me vendimin nr.608, datë 20.11.2018të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT; [redacted] i emëruar në detyrë në pozicionin e inspektorit të zbatimit me vendim nr.245, datë 25.04.2018dhe larguar nga detyra me vendimin nr.620, datë 20.11.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT dhe [redacted] i emëruar në detyrë në pozicionin e inspektorit të zbatimit me vendim nr.243, datë 25.04.2018 dhe larguar nga detyra me vendimin nr.623, datë 20.11.2018të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT.
Të 20 punonjësit e larguar gjatë vitit 2018, janë pjesë e Drejtorisë së Hetimit Taimor dhe 4 prej tyre rezultojnë të jenë punësuar për herë të parë gjatë vitit 2018.
Nga 20 rastet e zgjidhjes së kontratës nga ana e DPT, grupi i auditimit testoi 5 procedura largimi nga detyra. Nga testimi rezultoi se, në të 5 rastet e testuara nga grupi i auditimit ([redacted]), në Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve "Për zgjidhjen e menjëhershme të justifikuar të kontratës së punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare", arsyeja e zgjidhjes së kontratës është mospërmbushja e rëndë e detyrave dhe moszbatimi i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale, bazuar nënenet 37,144,153 dhe 154 të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
Referuar Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nëpikën 3 të nenit 153, konsiderohen shkaqe të justifikuara rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale mefaj të rëndë, si edhe rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktualeme faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin meshkrim të punëdhënësit.
Gjithashtu referuar kontratës individuale të punës, në nenin 12 "Masa Disiplinore" përcaktohen rastet kur punëmarrësit i jepen masa disiplinore. Llojet e masave disiplinore përcaktohen si vijon:

a) Vërejtje me shkrim;
b) Vërejtje me paralajmërim, për largim nga detyra;
c) Largimnga detyra.

Nga auditimi i të gjithë dokumentacionit tëdosjes së punonjësve të larguar nga detyra, në asnjë rast për punonjësit e larguar nga puna, në dosjen personale tëtyre që administrohet nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT Shkodër, nuk rezultojnëvërejtje me shkrim, ose vërejtje me paralajmërim, për shkelje të rënda ose të lehta,në mënyrë të përsëritur, të detyrimeve kontraktuale, detyrime këto që rrjedhin nga zbatimi ipikës 3 të nenit 153 të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995

"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të nenit 12 të kontratës individuale të punës, masa këto që jepen përpara se punonjësi të largohet nga detyra.
Në praktikat që gjendeshin të administruara në DRT nuk disponohej informacion për padi gjyqësore të ngritura nga ana e DPT ose DRT ndaj këtyre punonjësve, për shkelje të rënda të punës, ndërkohë që të gjithë këta punonjës kanë paditur DPT dhe DRT për largimin nga puna tëkonsideruar nga ana e tyre të padrejtë.

Konstatim:
Nga 34 punonjës të larguar nga puna, gjatë vitit 2018, 28 punonjës ose 82% e tyre janë punonjës marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.Nga 28 punonjës me kontratë të larguar nga detyra, për 20 punonjës, ose 71.4% të tyre, largimi nga detyra është bërë duke zgjidhur kontratën në mënyrë të menjëhershme.

- ***Largime nga detyra gjatë vitit 2019***, për punonjësit në strukturë paraqiten si vijon:.

Nga auditimi i vendimeve të largimit nga detyra të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, rezulton se gjatë vitit 2018 janë larguar nga detyra në total 17 punonjës nga të cilët 7 punonjës me status të nënpunësit civil dhe 10 punonjës me kontratë, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar. Nga 10 punonjësit me kontratë të larguar nga detyra, 1 është larguar me kërkesën e tij, 5 punonjës janë transferuar ne Tiranë dhe 4 punonjës ose 40% e totalit të punonjësve të larguar nga detyra u është zgjidhur kontrata e punës.
Në total larguar nga detyra me zgjidhje të kontratës 5 punonjës nga të cilët 1 me status të nënpunësit civil dhe 4 punonjës me kontratë.Grupi i auditimit i testoi të 5 procedurat e largimit nga detyra me zgjidhje kontrate. Në 5 rastet e testuara nga grupi i auditimit([redacted]) rezulton se, në Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve "Për zgjidhjen e menjëhershme të justifikuar të kontratës së punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare", arsyeja e zgjidhjes së kontratës është mospërmbushja e rëndë e detyrave dhe moszbatimi i dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale, bazuar në nenet 37,144,153 dhe 154 të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Nga auditimi i të gjithë dokumentacionit të dosjes së punonjësve të larguar nga detyra, në asnjë rast për punonjësit e larguar nga puna, në dosjen personale të tyre që administrohet nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT Shkodër, nuk rezultojnë vërejtje me shkrim, ose vërejtje me paralajmërim, për shkelje të rënda ose të lehta, në mënyrë të përsëritur, të detyrimeve kontraktuale, detyrime këto që rrjedhin nga zbatimi i pikës 3 të nenit 153 të Ligjit nr.7961, datë12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe të nenit 12 të kontratës individuale të punës, masa këto që jepen përpara se punonjësi të largohet nga detyra.
Konstatim:
Nga 10 punonjësit me kontratë të larguar nga detyra, gjatë vitit 2019, për 4 punonjës, ose 40% të tyre, largimi nga detyra është bërë duke zgjidhur kontratën në mënyrë të menjëhershme.

Për 24 punonjësit me kontratë të larguar nga detyra, duke zgjidhur kontratën në mënyrë të menjëhershme, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 153 të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar dhe nenit 12 të Kontratës individuale të punës, mbajnë përgjegjësi:

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT për periudhën e cituar në raport.

- ***Mbi punonjësit me kontratë të përkohshme***

Në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Shkodër, për vitin 2018, në zbatim të VKM nr.60, datë 31.01.2018 "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore, lidhja 1, me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.13, datë 12.02.2018, numri i punonjësve me kontratë për DRT Shkodër është 1 punonjës protokollist/arkivist me 6 orë në ditë për 1 vit dhe 29 punonjës shërbimi me 8 orë në ditë për 6 muaj. Numri i punonjësve të shërbimit për vitin 2018, për DRT Shkodër nga 29 është ndryshuar në 30 punonjës, me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.13/2, datë 15.05.2018. Paga e punonjësve të shërbimit është përcaktuar në referencë të VKM 717, datë 23.06.2009, "Për pagat e punonjësve mbështetëstë institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar, klasa IV me pagë bazë mujore në shumën 33,400 lekë.

Me Vendimin nr.148/1, datë 21.03.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, janë emëruar në punë 29 punonjës shërbimi, për një periudhë 6 mujore. Në vendim citohet që: marrëdhëniet e punës fillojnë me nënshkrimin e kontratës.

Me vendimin nr.640, datë 27.11.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, janë emëruar nëpunë 21 punonjës shërbimi, për një periudhë 1 mujore, deri në datë 31.12.2018, mbështetur në VKM nr.60, datë 31.01.2018 "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore, VKM 717, datë 23.06.2009, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar, VKM nr.709, datë 23.11.2018 "Për një shtesë fondesh nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2018 dhe rishpërndarje të fondit të pagave për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në buxhetin e vitit 2018. Me vendimin nr.640/1, datë 03.12.2018 "Për një shtesë në Vendimin nr.640, datë 27.11.2018 "Për emërim në detyrë", të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, janë emëruar në punë 7 punonjës shërbimi, për periudhën deri në datë 31.12.2018, sipas referencave ligjore të sipërcituara.

Për vitin 2018 punonjësit me kontratë janë angazhuar si vijon:

-D/ Shërbimit për Tatim Paguesin	9
- Drejtoria e Mbledhjes me Forcë	4
- Drejtoria e Kontrollit Tatimor	5
- Drejtoria e Funksioneve Mbeshtetese	8
- Drejtoria e Hetimit Tatimor	4
- Arkiv/protokoll	1
Totali	31

Numri total i punonjësve të DRT Shkodër për vitin 2018, punonjës në strukturë dhe punonjës me kontratë të përkohshme, paraqitet si vijon:

Tabela nr.23

Nr	Emërtimi	Plan	Ndryshime	Plani me ndryshime	Realizimi në fakt	Realizimi në %
1	Struktura e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016	130	-	130	94	72.3%

2	Punonjës me kontratë të përkohshme sipas VKM nr.60, datë 31.01.2018, protokollist/arkivist me 6 orë/ditë për 1 vit	1	-	1	1	100%
3	Punonjës me kontratë të përkohshme sipas VKM nr.60, datë 31.01.2018, punonjës shërbimi 8 orë/ditë, 6 muaj	29	+1	30	28	93%
	Totali	160	+1	161	123	76.4%

Burimi: Grupi i auditimit i KLSH

Punonjës me kontratë të përkohshme për vitin 2019, për DRT Shkodër sipas VKM nr.16, datë 16.01.2019, "Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2019, në njësitë e Qeverisjes Qëndrore, janë miratuar 26 punonjës shërbimi me 8 orë/ditë, për 6 muaj dhe 2 punonjës protokollist/arkivist dhe sanitar me 6 orë/ditë, për 1 vit.
Kontratat e punës për punonjësit mekontratë të përkohshme janë lidhur dhe nënshkruar nga Drejtori Rajonal nëzbatim të Urdhërit nr.5/1, datë 31.01.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe vendimeve respektive të dërguara zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
Me Urdhrin nr.5/3, datë 07.03.2019 "Për ndryshimin e detajimit të numrit të punonjësve të shërbimit për vitin 2019, nënjësitë e Qeverisjes Qëndrore", numri i punonjësve të shërbimit për vitin 2019, nga 26, bëhet 21.
Për vitin 2019 punonjësit me kontratë janë angazhuar si vijon:

- D/ Shërbimit për Tatim Paguesin	5
- Drejtoria e Mbledhjes me Forcë	4
- Drejtoria e Kontrollit Tatimor	3
- Drejtoria e Funksioneve Mbeshtetese	8
- Drejtoria e Hetimit Tatimor	1
- Arkiv/protokoll	1
- Sanitare	1
Totali	23

Numri total i punonjësve të DRT Shkodër për vitin 2019, paraqitet si vijon:

Tabela nr.24

Nr	Emërtimi	Plani fillestar	Plani me ndryshime	Përfunduar kontratën	Numri i planifikuar në datë 31.12.2019	Numri faktik i punonjësve në datë 31.12.2019	Realizimi në %
1	Struktura e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016, ndryshuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.49, datë27.02.2019 dhe Urdhrin nr.171, datë 13.05.2019	130	126		126	107	85%
2	Punonjës me kontratë të përkohshme sipas VKM nr.16, datë 16.01.2019,	2	2		2	2	100%

	protokollist/arkivist dhe sanitar me 6 orë/ditë, për 1 vit						
3	Punonjës me kontratë të përkohshme sipas VKM nr.16, datë 16.01.2019, punonjës shërbimi 8 orë/ditë, 6 muaj	26	21	21	-	-	-
	Totali	158	149	21	128	109	85%

Burimi: Grupi i auditimit i KLSH

Nga auditimi rezulton se të 21 punonjësit e shërbimit me kontratë të përkohshme 6 mujore,janë larguar pas përfundimit të periudhës 6 mujore dhe në fund të vitit ky numër është zero.
Në urdhrin nr.14 datë 12.02.2018 'Për përcaktimin e kritereve të arsimit dhe përzgjedhjen e punonjësve me kontratë të përkohshme', janë përcaktuar si kriterarsimor, minimumi nivel Bachelor me preferencë shkenca ekonomike ose juridike, si dhe se punësimi do të bëhet në bazë të propozimeve përkatëse të Drejtorive Rajonale Tatimore.
Nga auditimi konstatohet se nevojat për këtë kategori punonjësish nuk kanë kaluar fazën e planifikimit si dhe nuk janë të argumentuara.
Në vitin 2018 numri total i planifikuar i punonjësve ka qenë 161 punonjës, nga të cilët 130 punonjës në strukturë dhe 31me kontratë të përkohshme, pra 19% të totalit të punonjësve e zenë punonjësit me kontratë të përkohshme, për pagesën e të cilët në total janë shpenzuar 7,074,945 lekë.
Në vitin 2019 numri total i planifikuar i punonjësve ka qenë 149 punonjës, nga të cilët 126punonjës në strukturë dhe 23 me kontratë të përkohshme, pra 15% të totalit të punonjësve e zenë punonjësit me kontratë të përkohshme, për pagesën e të cilët në total janë shpenzuar 5,658,188 lekë.
Ndonëse ky numër ka ardhur duke u ulur nga viti në vit përsëri është i lartë.

Konstatim:

Emërime te punonjësve me kontratë të përkohshme për vitet 2018 dhe 2019 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të DPT, konkretisht me vendimin nr.148/1, datë 21.03.2018; vendimin nr.640, datë 27.11.2018, vendimin nr.640/1, datë 03.12.2018, dhe emërimet rast pas rasti të kryera për vitin 2019si dhe lidhja dhe nbënshkrimi i kontratave iundividuale të punës nga ana e ish Drejtorit Rajonal janë kryer pa ndjekur hapat e planifikimit dhe dokumentimit me evidencë të nevojave për këta punonjës nga ana e DRT-së, si dhe pa pasur njëpërshkrim specifik të punës që do të kryejë secili punonjës.

Përsa më sipër,

Shuma totale prej 12,733,133 lekë, prej të cilave 7,074,945 lekë paguar në vitin 2018 dhe 5,658,188 lekë paguar në vitin 2019, konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë, për të cilin përgjegjësi mbajnë Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve sipas periudhave respektive dhe ish Drejtori i DRT–së, z. [redacted], pasi kanë kryer emërimet dhe kanë nënshkruar kontratat individuale të punës pandjekur hapat e planifikimit dhe dokumentimit me evidencë të nevojave për këta punonjës, si dhe pa pasur njëpërshkrim specifik të punës që do të kryejë seciliprej tyre.

Në observacionin e dërguar me email, në datë 24.04. 2020, grupit të auditimit të KLSH, Drejtori i Funksioneve Mbështetëse në DRT, në lidhje parregullsitë në procedurat e

emërimit në punë tëpunonjësve me kontratë të përkohshme trajtuara në projektraportin e auditimit, ndërmjet të tjerash thekson:

"Për punonjësit me kontratë të përkohshme është DPT organi kompetent për rekrutimin punësimin që përfshin dhe shpalljen e pozicioneve me kriter dhe afatet e aplikimit nga të interesuarit, proçesin e kualifikimit dhe proçesin e përzgjedhjes së punonjësve. Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër në zbatim të Urdhërit nr.14, datë 12.02.2018 ka dërguar propozimet me shkresën nr.1829/1 datë 27.02.2018 si dhe listën e propozuar në vijim të email datë 27.11.2018 (shkresa dhe lista bashkëlidhur)DRT Shkodër në zbatimit të Vendimit nr.60, datë 31.01.2018 "Për përcaktimin e numrit të punonëjsve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në Njësitë e Qeverisies Qëndore", Vendimin nr 148/1 date 21.03.2018 si dhe urdherit nr 13 date 10.04.2018 ka kryer pagesat e punonjeve në përputhje me me VKM nr 717 datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës te institucioneve buxhetore " i ndryshuar"

Lidhur me rekrutimet ka paraqitur observacion z.[redacted] me shkresë n nr.2993/13 datë 29.04.2020 ku ndërmjet të tjerash thekson:

"Per sa i perket rekrutimit tim si inspeklor zbatimi ne Drejtorine e Hetimit Tatimor Rajoni Verior Shkoder ku citohem se jam rekrutuar pa diplome dua te sqaroj se une kam vazhduar studimet ne fakultetin e Drejtesise Dega Juridik te Universitetit 'Luigi Gurakuqi' ne Shkoder, gjate viteve shkollore (2012-2015) sistemi me kohe te plote dhe jam diplomuar me date23.07.2015, **por nuk jam paisur me diplome**, vec me vertetim notash, per kete arsye kam paditur Qendren e Sherbimeve Arsimore, Universitetin e Shkodres "Luigj Gurakuqi" **per te me paisur me numer matrikullimi** lidhur me studimet elarta qe kam kryer pergjate viteve shkollore 2012-2015 dhe sipas vertetimit me Nr 675 Prot, date 01.09.2016 dhe paisjen me diplome nga ana e Universitetit "Luigi Gurakuqi" Shkoder. Dua te sqaroj se ceshtja ne fjale eshte ne Gjykaten e Apelit, ceshtja administrative me Nr.ceshtjet 31 138-05275-86-2017 nga data 25.l0.2017 …"

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së</u>:

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe fakteve të reja të cituara nga ana juaj, por të pavëna në dispozicion grupit të auditimit as gjatë punës në terren dhe as bashkëlidhur observacionit të dërguar nëpërmjet emailit, sjell edhe njëherë në vëmendje se, emërimi i punonjësve me kontratë të përkohshme duhet të kalojë fazat e planifikimit, të cilat nuk nënkuptojnë një listë emërore dhe për më tepër një listë e nisur me email ***(listën e propozuar në vijim të email datë 27.11.2018)*** *<u>në të njëjtën datë kur ka dale vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm nr.640, datë 27.11.2018</u> për emërimin në punë të 21 punonjësve të shërbimit, për një periudhë 1 mujore, deri në datë 31.12.2018. Për më tepër, për vitin 2019 nuk keni paraqitur asnjë propozim/listë emërore, ndërkohë që gjatë vitit 2019 janë emëruar në punë nga Drejtori i Përgjithshëm 23 punonjës me kontratë të përkohshme, kontratat individuale të së cilëve janë nënshkruar nga ish Drejtori Rajonal, pa kaluar më parë procesin e planifikimit si dhe pa përcaktuar specifikisht se cfarë pune do të kryejë gjithësecili prej tyre. Në lidhje me rekrutimin e z.[redacted], I cili e konfirmon se nuk ë shtë pajisur me diplomë , theksojmë edhe një herë se një student pa numër matrikullimi ligjë risht nuk njihet si student dhe si i tillë nuk mund të pajiset me diplomë pavarë sisht studimeve të kryera. Fakti që z.[redacted] ë shtë në proces gjyqë sor nuk e justifikon rekrutimin e tij në punë pa diplomë universitare.*

Përfundimi:

Grupi i auditimit merr në konsideratë faktin që emërimet janë kryer nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, nuk merr në konsideratë sitë pambështetura nga ana dokumentare (shkresën nr.1829/1 datë 27.02.2018 si dhe listën e propozuar në vijim të email datë 27.11.2018), të cilësuara në

obseravacion por të padisponuara grupit të auditimit. Në lidhje me z.[redacted] I që ndrojmë konstatimit se ë shtë rekrutuar në punë në kundë rshtim me kë rkesat ligore të cituara në raportin e auditimit.
Përsa më sipër, ngarkon me përgjegjësi ish Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve për emërimet dhe ish Drejtorin Rajonal për mosargumentimin dhe mosmbështetjen me evidencë të mjaftueshme të kërkesës për staf ndihmës për vitin 2018 dhe mosplanifikim për vitin 2019, si dhe për të dy vitet objekt auditimi mos hartimin e përshkrimeve të punës për punonjësit me kontratë të përkohshme.

Titulli i Gjetjes: **Parregullësi në procedurat e planifikimit, emërimit, evidentimit dhe matjes së punës së punonjësve me kontratë të përkohshme për vitet 2018-2019.**

Situata: Nga auditimi rezulton se, për punonjësit me kontratë të përkohshme janë paguar në total për të dy vitet 12,733,133 lekë, prej të cilave 7,074,945 lekë në vitin 2018 dhe 5,658,188 lekë në vitin 2019, ndërkohë që në procedurat e planifikimit, emërimit, evidentimit dhe matjes së punës së tyre janë konstauar parregullësi, si vijon:
-Nevojat për staf ndihmës nuk kanë kaluar fazën e planifikimit. Drejtoria Rajonale Tatimore nuk ka argumentuar dhe nuk ka mbështetur me evidencë kërkesën për staf ndihmës, si në numër ashtu edhe në pozicionet e punës ku do të punësohen.
- DPT ka kryer emërimet në punëpër vitin 2018 bazuar vetëm në lista emërore, njëra prej të cilave është dërguar me email nga DRT ditën e hartimit të Vendimit të Drejtorit të PT për emërimin në punë të 21 punonjësve të shërbimit, për një periudhë 1 mujore, ndërkohë që për vitin 2019 janë emëruar në punë23 punonjës me kontratë të përkohshme pa pasur asnjë lloj planifikimi dhe evidence mbështetëse.
- Puna që kryejnë këta punonjës është e paqartë, pasi nuk ka përshkrim specifik për secilin punonjës.

Kriteri: Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi punës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
VKM nr.60, datë 31.01.2018
VKM nr.16, datë 16.01.2019

Ndikimi: Shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.

Shkaku: Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kuadrit ligjor në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi : Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të marrë masa për: planifikim real dhe të mirëstudiuar të nevojave për staf ndihmës me qëllim, eliminimin e praktikave të rekrutimit të punonjësve me kontratë të përkohshme pa justifikuar nevojat për këtë kategori hartimin e kërkesave të argumentuara dhe të mbështetura me evidencë të mjaftueshme; hartimin e përshkrimeve të punës për cdo pozicion pune që do të mbulohet nga punonjësit me kontratë të përkohshme, me qëllim menaxhimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë dhe në vijimësi**

- ***Ndjekja dhe raportimi i ecurisë së proceseve gjyqësore në lidhje me punonjësit e larguar nga puna***

Në lidhje me ndjekjen dhe ecurinë e proceseve gjyqësore, u administrua informacion nga DRT Shkodër dhe me email zyrtar nga DPT.
Në të gjitha rastet palë e paditur ka qenë DPT dhe DRT Shkodër.
Nga auditimi i informacionit të administruar nga zyra juridike në DRT rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë, të Rrethit Shkodër, mbështetur në mbrojtjen që i është bërë cështjes nga ana e përfaqësuesit të DRT-së, në të gjitha rastet ka rrëzuar pjesën e padisë përsa i përket DRT, me argumentin se procedurat e largimit nga puna janë realizuar nga DPT.
Ecuria e proceseve gjyqësore për marrëdhëniet e punës, për punonjësit e larguar nga puna përgjatë periudhë 01.01.2018-31.12.2019, është paraqitur më e detajuar në projektraportin e auditimit.

Konstatim:
Për periudhën 01.01.2018-31.12.2019, janë hapur 24 procese gjyqësore nga ana e punonjësve të larguar nga puna, padi të cilat në 100% të rasteve rezultojnë të pranuara pjesërisht nga Gjykata e Shkallës së Parë, pra për të 24 rastet DPT ka zgjidhur kontratën me punëmarrësit në mënyrë të menjëhershme, pa arsye dhe pa shkaqe të justifikuara.

Në lidhje me masën e likuidimit të vendimeve gjyqësore të fituara nga punëmarrësit dhe për të cilat është marrë vendim i formës së prerë, grupi i auditimit ka kërkuar zyrtarisht informacion, i cili deri në datën e mbajtjes së këtij akt konstatimi nuk u paraqit.
Sqarojmë se ky informacion administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
DPT është struktura përgjegjëse për ekzekutimin e likuidimit të detyrimeve për proceset gjyqësore.
Deri në datën e mbajtjes së këtij raporti përfundimtar, DPT edhe pas kërkesës zyrtare të bërë nga ana e Drejtorit të DRT gjatë kohës që grupi i auditimit ushtronte detyrën në terren, nuk vuri në dispozicion asnjë lloj informacioni.

Përgjegjësi për realizimin e procedurave të largimit nga detyra dhe nivelin e përfaqësimit në gjykatë mbajnë Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT.

- Në lidhje me pagesat e kryera në zërin "Të tjera transferta tek individët", nga auditimi rezultoi se në të gjitha rastet kryerja e shpenzimit është autorizuar nga Ministria e Financave, në zbatim të VKM-së nr.493, datë 06.07.2011, "Për disa ndryshime në VKM mnr.929, datë 17.11.2010 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të vecantë" si dhe Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.
Për vitin 2018, për art.606 janë realizuar shpenzime në shumën 184,640 lekë dhe për vitin 2019, për art.606 janë realizuar shpenzime në shumën 1,279,260 lekë. Këto shpenzime janë të vërtetuara me aktrakordimin vjetor me Degën e Thesarit, Shkodër dhe të pasqyruara në pasqyrat financiare të periudhave respektive.

Për mangësitë e konstatuara në lidhje me këtë cështje është mbajtur aktkonstatimi nr.4, datë 26.02.2020, prokollouar në DRT me nr.331/5, datë 26.02.2020.

- **Respektimi i dispozitave ligjore për shpenzimet për udhëtime e dieta**

Për vitin 2018, në zbatim të Ligjit nr.109/2017, datë 30.11.2017 "Për buxhetin e vitit 2018" dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.19650/3, datë 30.01.2018 është detajuar plani vjetor i shpenzimeve korrente për vitin 2018. Për DRT Shkodër për vitin 2018 janë akorduar fonde buxhetore në artikullin 602, në fillim të vitit 5,000,000 lekë. Gjatë vitit 2018, janë akorduar shtesë fondi në shpenzimet korrente në artikullin 602, në shumën 3,500,000 lekë, nga të cilat, 2,000,000 lekë shtesë fondi me shkresën e Ministrisë së Financave nr.9216/2, datë 21.05.2018 dhe 1,500,000 lekë me shkresën e Ministrisë së Financave nr.23134, date 15.11.2018, njoftim i komunikuar DRT nëmënyrë elektronike.
Në total plani buxhetor me ndryshime në artikullin 602 për vitin 2018 rezulton të jetë 8,500,000 lekë nga të cilat, në art.602.4 në zërin "Shpenzime udhëtimi" janë planifikuar 4,808,000 lekë dhe janë shpenzuar në fakt 4,709,950 lekë, e konfirmuar kjo me akt rakordimin me Degën e Thesarit Shkodër. Në total zëri "Shpenzime udhëtimi" është realizuar në masën 98%.
Për vitin 2019, në zbatim të Ligjit nr.99/2018, datë 03.12.2018 "Për buxhetin e vitit 2019", Udhëzimit Plotësues nr.1, datë 17.01.2019 dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.23016/3, datë 14.02.2019 është detajuar plani vjetor i shpenzimeve korrente për vitin 2019. Për DRT Shkodër për vitin 2019 janë akorduar fonde buxhetore në artikullin 602, në fillim të vitit 6,500,000 lekë, nga të cilat shpenzuar 5,411,032 lekë. Nga 6,500,000 lekë të celura në art.602, për zërin "Shpenzime udhëtimi" në art.602.4, janë planifikuar 3,024,000 lekë dhe janë shpenzuar në fakt 2,080,700 lekë, e konfirmuar kjo me akt rakordimin me Degën e Thesarit Shkodër. Në total zëri "Shpenzime udhëtimi" është realizuar në masën 69%.

Tabela në vijim paraqet shpenzimet në art.602.4, në zërin "Shpenzime udhëtimi" për vitet 2018 - 2019.

Tabela nr.25
Në lekë

DRT Shkodër	Plani Vjetor	Shpenzimet Faktike	Diferenca	Realizimi në

	Art.602.4	Art.602.4		%
Viti 2018	4,808,000	4,709,950	98,050	98%
Viti 2019	3,024,000	2,080,700	943,300	69%
Total	7,832,000	6,790,650	1,041,350	87%

Burimi: Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse në DRT

Në total për vitin 2018 për art 602.4 "Shpenzime udhëtimi" janë planifikuar për t'u shpenzuar 4,808,000 lekë dhe në fakt janë shpenzuar 4,709,950 lekë, pra zëri "Shpenzime udhëtimi" në fund të vitit 2018 ka rezultuar i realizuar në masën 98%. Nga 4,709,950 lekë të shpenzuara, 4,679,980 lekë, ose 99% të totalit të shpenzimeve, e zënë "Shpenzime udhëtimi", për strukturën e Hetimit Tatimor.
Në total për vitin 2019 për art 602.4 "Shpenzime udhëtimi" janë planifikuar për t'u shpenzuar 3,024,000 lekë dhe në fakt janë shpenzuar 2,080,700 lekë, pra zëri "Shpenzime udhëtimi" në fund të vitit 2019 ka rezultuar i realizuar në masën 69%. Nga 2,080,700 lekë të shpenzuara, 2,058,500 lekë, ose 99% të totalit të shpenzimeve, e zënë "Shpenzime udhëtimi", për strukturën e Hetimit Tatimor.
Për secilin vit buxhetor shpenzimet rezultojnë të rakorduara me situacionet vjetore me Degën e Thesarit Shkodër.
Nga auditimi i pasqyrave financiare të viteve 2018-2019, rezulton se:
"Shpenzimet e udhëtimit" janë pasqyruar në pasqyrat financiare vjetore të institucionit në kapitullin "Shpenzime", në formatin nr.2 "Pasqyra e Performancës Financiare", në art.602.4;

1. Për vitin 2018 "Shpenzimet e udhëtimit" paraqiten në shumën 4,709,950 lekë nga 2,418,920 lekë që janë shpenzuar në vitin 2017, pra në vitin 2018 janë shpenzuar 2,291,030 lekë më shumë se në vitin 2017.
2. Për vitin 2019 "Shpenzimet e udhëtimit" paraqiten në shumën 2,080,700 lekë nga 4,709,950 lekë që janë shpenzuar në vitin 2018, pra në vitin 2019 janë shpenzuar për zërin "Shpenzimet e udhëtimit", 44% më pak se në vitin 2018.

- Për vitin 2018 kryerja e shpenzimeve në zërin "Shpenzime udhëtimi" është autorizuar me 23 Urdhër Shpenzimi në shumën totale 4,709,950 lekë. Përdorimi i zërit "Shpenzime udhëtimi" konsiston në:
  - Shpenzime udhëtimi për punonjësit e DRT, për pjesëmarrje në trajnim në DPT. Në cdo rast njoftimi për pjesëmarrje në trajnim është bërë me shkresë zyrtare të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve e shoqëruar me grafikun e datave dhe orëve të zhvillimit të trajnimit.
  - Shpenzime udhëtimipër punonjësit e Drejtorisë së Hetimit Tatimor.

Shpenzimet e udhëtimitpër punonjësit e Drejtorisë së Hetimit Tatimor janë shpenzime mbi 100 km dhe referuar përcaktimeve të Kreut V, pika 2, gërma a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar:

"Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga: Titullari i institucionit qëndror për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës".

Në autorizim përcaktohen koha e zgjatjes së shërbimit dhe qëllimi i tij. Titullarë institucioni qëndror, në kuptimin e këtij vendimi janë:
a) Për njësitë e qeverisjes qendrore: i) Për ministrinë dhe cdo institucion në varësi të saj, ministri ose i deleguari i tij.

Konkretisht për vitin 2018, Ministri i Financave me Autorizimin nr.7448/1, datë 25.05.2018, ka autorizuar:

1. Drejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve të miratojë kryerjen e udhëtimeve brenda vendit, për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës.
2. Drejtorët e Drejtorive Rajonale Tatimore të miratojnë kryerjen e udhëtimeve brenda vendit për punonjësit nën varësinë e tyre për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës. Ky autorizim i shtrin efektet deri në datë 31.12.2018.

Nga auditimi konstatohet se punonjësit janë dërguar me shërbim mbi bazën e urdhrave të punës, të cilat për vitin 2018 rezultojnë të jenë dhënë nga drejtues të strukturave të ndryshme. Më konkretisht, urdhra pune të nxjerra nga:

- Drejtori i Hetimit në DPT;
- Drejtori i Hetimit në DRTRV;
- Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tiranë.

Drejtoria e Hetimit Tatimor është krijuar në zbatim në nenit 105 të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe ushtron detyrat dhe funksionet e saj në zbatim të VKM nr.400, datë 22.04.2009 'Për përcaktimin e detyrave dhe funksioneve të Drejtorisë së Hetimit Tatimor", në të cilën përcaktohet se Drejtoria e Hetimit Tatimor në DPTështë përgjegjëse për drejtimin në mënyrë të unifikuar të strukturave të hetimit tatimor. Ajo varet nga zëvendësdrejtori i Përgjithshëm Operacional dhe përgjigjet para Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për të gjithë veprimtarinë e strukturave të hetimit tatimor.Në nenin 139 tërregullores së funksionimit të administratës tatimore qëndrore, miratuar me Urdhrin e Mininistrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, përcaktohet organizimi dhe funksionimi i strukturës së hetimit. Drejtorët e Hetimit Tatimor në Rajone raportojnëte Drejtori i Hetimit Tatimor në DPT.Në nenin 159 përcaktohet varësia e Drejtorive Rajonale të Hetimit.Këto drejtori kanë varësi hierarkike nga Drejtoria e Hetimit Tatimor në DPT dhe nga ana logjistike mbështeten nga Drejtoritë Rajonale Tatimore ku janë vendosur.Drejtori i Hetimit Tatimor në Rajon merr detyra dhe i raporton Drejtorit të Hetimit në DPT, i përcjell atij për miratim planet mujore dhe vjetore operacionale të strukturës që drejton dhe ndjek zbatimin e tyre, si dhe nxjerr urdhra dhe programe pune për strukturat vartëse në përputhje me kompetencat e tyre.

Drejtoria e Hetimit funksionon bazuar në Manualin e Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së. MNë pikën 5.24 "Dokumentacioni administrative", të Manualit përcaktohet se gjatë kryerjes së detyrës funksionale të veprimeve në terren, inspektorët duhet të jenë të pajisur me urdhëra pune.Urdhëri i punës është dokument administrativ dhe ligjor i cili urdhëron kryerjen e veprimeve në terren, nëambientin e aktivitetit të tatimpaguesit të identifikuar me NIPT nga strukturat e ZVTMA.Ky urdhër pune lëshohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve; Drejtori i Hetimit Tatimor në DPT dhe DHT të Rajonit. Në urdhër pune përvec objektit të punës, bazës ligjore, pjesëmarrësve në urdhër, automjetit në dispozicion, përcaktohet subjekti përkatës (***tatimpaguesi i përcaktuar ose/dhe një listë tatimpaguesish të një veprimtarie të caktuar***) që përshkruhet apo /dhe i bashkëlidhen urdhërit të punës si dhe territori ku do të kryhet inspektimi (i detajuar, vendi, adresa përkatëse për cdo subjekt, aksi rrugor i përcaktuar dhe vendi i pikës së kontrollit).

Gjatë kryerjes së detyrës funksionale të veprimeve në terren për zbatimin e Urdhërit të Punës, inspektorët duhet të jenë të pajisur me Akt Konstatimi; Procesverbal Gjobe; Procesverbal Konfiskimi; Procesverbal Sekuestrimi.

Në udhëzimin nr.22225, datë 16.07.2015, të ish Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, përcaktohet se, rast pas rasti, punonjësit e verifikimit në terren, hetimit tatimor apo cdo strukture tjetër, të cilët kryejnë verifikime apo kontrolle të tatimpaguesve, mbajnë akt konstatimin përkatës duke ju referuar dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi.
Shpenzimet për udhëtim e dieta janë inicuar si vijon:

- *Në 10 raste për pjesëmarrje në trajnim, në zbatim të shkresave të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, janë paguar shpenzime udhëtim e dieta* ***në shumën 29,970 lekë.***
- *Në 83 raste bazuar në urdhra pune për inspektime për punonjësit e DHT janë paguar shpenzime udhëtim e dieta* ***në shumën 4,679,980 lekë****, si vijon:*

a) Në 50 raste punonjësit e DHT kanë shkuar me shërbim në zbatim të urdhrave të punës nxjerrë nga Drejtori i Hetimit Tatimor në DPT.

b) Në 27 raste punonjësit e DHT kanë shkuar me shërbim në zbatim të urdhrave të punës nxjerrë nga Drejtori i Hetimit Tatimor Rajoni Verior.

c) *Në 6 raste punonjësit e DHT kanë shkuar me shërbim në zbatim të urdhrave të punës nxjerrë nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tiranë.*

Në detaje situata e shpenzimeve të udhëtimit për punonjësit e DHT për vitin 2018 paraqitet si vijon:

- Me Urdhër Shpenzimin nr.12, datë 30/01/2018, është paguar ***z.*** [redacted], në shumën 82,500 lekë, për shërbimin e kryer në datat 08-31.12.2017, urdhëruar nga DHT në DPT. Fatura tatimore e shitjes e shoqëruar me kupon tatimor, e nënshkruar në ekstremitetet e saj dhe e vulosur nga shitësi. Bashkëlidhur praktikës së shpenzimit nuk ka asnjë dokument (Akt Konstatim/Procesverbal Gjobe; Procesverbal Konfiskimi; Procesverbal Sekuestrimi), që të vërtetojë kryerjen e detyrës së ngarkuar për të cilën janë paguar "Shpenzime udhëtimi" në total ***82,500 lekë.***
- Me Urdhër Shpenzimin nr.13, datë30/01/2018, është paguar ***z.*** [redacted], në shumën 82,500 lekë, për shërbimin e kryer në datat 08-31.12.2017, urdhëruar nga DHT në DPT. Fatura tatimore e shitjes e shoqëruar me kupon tatimor, e nënshkruar në ekstremitetet e saj dhe e vulosur nga shitësi. Bashkëlidhur praktikës së shpenzimit nuk ka asnjë dokument (Akt Konstatim/Procesverbal Gjobe; Procesverbal Konfiskimi; Procesverbal Sekuestrimi), që të vërtetojë kryerjen e detyrës së ngarkuar për të cilën janë paguar "Shpenzime udhëtimi" në total ***82,500 lekë.***
- Me Urdhër shpenzimet nr.55; 56; 57; 73; 74; 88, janë paguar në total 15 punonjës në shumën totale 18,870 lekë, për pjesëmarrje në trajnim në DPT. Në të gjitha rastet njoftimiështë bërë me shkresë zyrtare nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.
- Me Urdhër Shpenzimin nr.158, datë30/10/2018, është paguar ***z.*** [redacted], në shumën 107,550lekë. Nga auditimi i dokumentacionit autorizues konstatohet se, të gjithë urdhërat e nxjerra nga DHT në DPT, nuk e kanë të përcaktuar territorin ku do të kryhet shërbimi, por në mënyrë të përgjithshme citohet sipas rastit: në territorin e DHT Rajoni Jugor; në territorin e DHT Rajoni Jugor; në territorin e DHT Rajoni Qendor, Jugor, Verior; në territorin e Shqipërisë.Nga auditimi i dokumentacionit vërtetues, konstatohet se janë paguar shpenzime për fjetje në hotel në ***shumën 24,000 lekë referuar faturës tatimore me nr. serie 58950004 e cila nuk rezulton e vulosur nga shitësi, si dhe në shumën 6,000 lekë, referuar faturës tatimore me nr. serie 58398078 e cila nuk rezulton e vulosur nga shitësi dhe e panënshkruar nga blerësi.*** Nga shuma 107,550 lekë paguar për udhëtim e dieta, ***shuma prej 30,000 lekë paguar për shpenzime fjetje***

është mbështetur në dokumentacion jo të rregullt financiar. Gjithashtu bashkëlidhur praktikës së shpenzimit nuk ka asnjë dokument (Akt Konstatim/Procesverbal Gjobe; Procesverbal Konfiskimi; Procesverbal Sekuestrimi), që të vërtetojë kryerjen e detyrës së ngarkuar për të cilën janë paguar "Shpenzime udhëtimi" në total ***107,550 lekë.***

- Me Urdhër Shpenzimin nr.159, datë30/10/2018, janë paguar 3 punonjës, në shumën 389,000 lekë. Nga të cilët:

-***Z.*** [redacted] është paguar në shumën 174,500 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit autorizues konstatohet se, të gjithë urdhërat e nxjerra nga DHT në DPT, nuk e kanë të përcaktuar territorin ku do të kryhet shërbimi, por në mënyrë të përgjithshme citohet sipas rastit: në territorin e DHT Rajoni Jugor; në territorin e DHT Rajoni Jugor; në territorin e DHT Rajoni Qendor, Jugor, Verior; në territorin e Shqipërisë. Nga auditimi i dokumentacionit vërtetues, konstatohet se janë paguar shpenzime për fjetje në hotel në ***shumën 6,000 lekë sipas faturës tatimore me nr.serie 58398075 e cila rezulton e pavulosur nga shitësi.*** Gjithashtu bashkëlidhur praktikës së shpenzimit nuk ka asnjë dokument (Akt Konstatim/Procesverbal Gjobe; Procesverbal Konfiskimi; Procesverbal Sekuestrimi), që të vërtetojë kryerjen e detyrës së ngarkuar për të cilën janë paguar "Shpenzime udhëtimi" në total ***174,500 lekë.***

-***Z.*** [redacted] është paguar në shumën 143,000 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit autorizues konstatohet se, të gjithë urdhërat e nxjerra nga DHT në DPT, nuk e kanë të përcaktuar territorin ku do të kryhet shërbimi, por në mënyrë të përgjithshme citohet sipas rastit: në territorin e DHT Rajoni Jugor; në territorin e DHT Rajoni Jugor; në territorin e DHT Rajoni Qendor, Jugor, Verior; në territorin e Shqipërisë. Nga auditimi i dokumentacionit vërtetues, konstatohet se është paguar për shpenzime fjetje ***shuma 6,000 lekë bazuar në faturën tatimore me nr.serie 58398080 e cila rezulton e pavulosur nga shitësi. Gjithashtu paguar për shpenzime fjetje shuma 39,000 lekë bazuar në faturën tatimore me nr.serie 58398118 e cila edhe kjo rezulton e pavulosur nga shitësi. Nga 143,000 lekë në total, 45,000 lekë janë paguar për shpenzime fjetje mbështetur në dokumentacion jo të rregullt financiar.*** Gjithashtu bashkëlidhur praktikës së shpenzimit nuk ka asnjë dokument (Akt Konstatim/Procesverbal Gjobe; Procesverbal Konfiskimi; Procesverbal Sekuestrimi), që të vërtetojë kryerjen e detyrës së ngarkuar për të cilën janë paguar "Shpenzime udhëtimi" në total ***143,000 lekë.***

- ***Z.*** [redacted] është paguar në shumën 71,500 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit autorizues konstatohet se, të gjithë urdhërat e nxjerra nga DHT në DPT, nuk e kanë të përcaktuar territorin ku do të kryhet shërbimi, por në mënyrë të përgjithshme citohet sipas rastit: në territorin e DHT Rajoni Jugor; në territorin e DHT Rajoni Jugor; në territorin e DHT Rajoni Qendor, Jugor, Verior; në territorin e Shqipërisë. Nga auditimi i dokumentacionit vërtetues, konstatohet se shpenzimet e fjetjes janë paguar bazuar në dokumentacin të rregullt financiar, por bashkëlidhur praktikës së shpenzimit nuk ka asnjë dokument (Akt Konstatim/Procesverbal Gjobe; Procesverbal Konfiskimi; Procesverbal Sekuestrimi), që të vërtetojë kryerjen e detyrës së ngarkuar për të cilën janë paguar "Shpenzime udhëtimi" në total ***71,500 lekë.***

- Me Urdhër Shpenzimin nr.160, datë30/10/2018, janë paguar 4 punonjës, në shumën 562,550 lekë. Nga të cilët:

- ***Z.*** [redacted] është paguar në shumën 174,500 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit autorizues konstatohet se, të gjithë urdhërat e nxjerra nga DHT në DPT, nuk e kanë të përcaktuar territorin ku do të kryhet shërbimi, por në mënyrë të përgjithshme citohet sipas rastit: në territorin e DHT Rajoni Jugor; në territorin e DHT Rajoni Jugor; në territorin e DHT Rajoni Qendor, Jugor, Verior, në territorin e Shqipërisë. Nga auditimi i dokumentacionit vërtetues, konstatohet se është paguar

për shpenzime fjetje ***shuma 6,000 lekë bazuar në faturën tatimore me nr.serie 58398074 e cila rezulton e pavulosur nga shitësi***. Gjithashtu bashkëlidhur praktikës së shpenzimit nuk ka asnjë dokument (AktKonstatim/Procesverbal Gjobe; Procesverbal Konfiskimi; Procesverbal Sekuestrimi), që të vërtetojë kryerjen e detyrës së ngarkuar për të cilën janë paguar "Shpenzime udhëtimi" në total ***174,500 lekë.***

-Z. [redacted] është paguar në shumën 107,550 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit autorizues konstatohet se, të gjithë urdhërat e nxjerra nga DHT në DPT, nuk e kanë të përcaktuar territorin ku do të kryhet shërbimi, por në mënyrë të përgjithshme citohet sipas rastit: në territorin e DHT Rajoni Jugor; në territorin e DHT Rajoni Jugor; në territorin e DHT Rajoni Qendor, Jugor, Verior, në territorin e Shqipërisë. Nga auditimi i dokumentacionit vërtetues, konstatohet se është paguar për ***shpenzime fjetje shuma 6,000 lekë bazuar në faturën tatimore me nr.serie 58398072 e cila rezulton e pavulosur nga shitësi***. Gjithashtu bashkëlidhur praktikës së shpenzimit nuk ka asnjë dokument (Akt Konstatim/Procesverbal Gjobe; Procesverbal Konfiskimi; Procesverbal Sekuestrimi), që të vërtetojë kryerjen e detyrës së ngarkuar për të cilën janë paguar "Shpenzime udhëtimi" në total ***107,550 lekë.***

"Ne lidhje me pretendimet tuaja te parashkruara ne projekt raport auditimin , per dietat e marra nga inspektoret me urdher shpenzimin nr 69 date 24.4.2019 theksoj qe : Urdheri i punes eshte dekomenti baze justifikues per treguar se ne cilin vend ka ushruar detyren inspektori dhe ne cilet data por dhe dekomentata justifikues te tjere te prodhuara ne baze te ketyre urdherave te punes si akt konstatim apo procesverbal gjobe etj jane te ngarkuara ne sistemin informative C@ts si dhe jane dekomentat fizike ne zyren e arshives ,dekomete keto qe vertetojne kryerjen e detyres nga ana e inspektoreve. Ne lidhje e faktin qe inspektoret jane paguar ne baze te lizprezences, theksoj qe bazuar rregulloren e Funksionimit te Administrates Tatimore Qendrore miraturar nga Ministri i Financave me urdherin nr 19 date 22.2.2017 ne nenin 165 pika 19 eshte pergjegjesi e pergjegjesit te sekorit te monitorimit territorial/zbatimit hartimi i lisprezencave per inspektoret e ketij sektori , dhe duke qene se ne listprezence inspektoret jane paguar per 22 dite pune te plota ,inspektoret jane konstatur ne pune nga ana e pergjegjesit te sektorit . Ndodhur ne keto kushte nuk mund te konsiderohet si page e mare me teper nga ana e inspektoreve . Ne lidhje me rastet e faturave te konstatuara nga ana juaj qe jane te pavulosura nga ana e shitesit , ky fakt nuk e ben te pavlefshme faturen perderisa shitesi e ka deklaruar ne shitje faturen dhe per te cilen ka paguar tvsh-ne si dhe bashkangjitur fatures ka qene kuponi tatimor".

Në observacionet e tyre protokolluar në DRT Shkodër dhe dërguar me email grupit të KLSH në datë 29.04.2020, [redacted] me shkresën nr.3014/1, datë 28.04.2020; [redacted] me shkresën nr.3010/1, datë 27.04.2020; [redacted] me shkresën nr.3011/1, datë 27.04.2020; [redacted] dhe [redacted] me shkresën pa prot; [redacted] me shkresën nr.2993/4, datë 29.04.2020; [redacted] me shkresën nr.2993/17, datë 29.04.2020; [redacted] me shkresën nr.2993/19, datë 29.04.2020; [redacted] me shkresën nr.2993/9 datë 29.04.2020 [redacted] me shkresën nr.2993/8 datë 29.04.2020; [redacted] me shkresën nr.2993/20 datë 29.04.2020; [redacted] me shkresën nr.2993/18 datë 29.04.2020; [redacted] me shkresën nr.2993/12 datë 29.04.2020; [redacted] me shkresën nr.2993/7 datë 29.04.2020; [redacted] me shkresën nr.2993/15 datë 29.04.2020; [redacted] me shkresën nr.2993/10 datë 29.04.2020; [redacted] me shkresën nr.2993/13 datë 29.04.2020; [redacted] me shkresën nr.2993/11 datë 29.04.2020; [redacted] me shkresën nr.2993/14 datë 29.04.2020; në lidhje me parregullsitë nërespektimin e dispozitave ligjore për shpenzimet për udhëtime e dieta, ndajnë të njëjtin qëndrim, ku ndërmjet të tjerash theksojnë:

"Urdheri i punes eshte dokumenti baze justifikues per të treguar se ne cilin vend ka ushtruar detyren inspektori dhe ne cilet data, por edhe dokumentata justifikues te tjere te prodhuara ne

baze te ketyre urdherave te punes si akt konstatim apo procesverbal gjobe etj., te cilet jane te ngarkuara ne sistemin informative C@ts si dhe jane të dorezuara si dokumente fizike ne zyren e arshives (kartotekes) prane Drejtorise se Hetimit Tatimor Rajoni Verior, dokumente keto qe vertetojne kryerjen e detyres nga ana e inspektoreve.Ne lidhje me faturat tatimore tëpavulosur nga shitesi, Fatura Tatimore permban nr rendor (Flete-Dalje) dhe nr serial identifikimi, nr e Niptit te tatimpaguesit, daten dhe vendin e leshimit, emrin dhe adresen e paleve, daten e realizimit te shitjes dhe nese eshte rasti rritjet dhe zbritjet e tjera si dhe shumat e shitura cialdo qofte menyra e likuidimit te fatures, faturat me keto elemente jane lehtesisht te verifikueshmesepse perndryshe nuk ishin pranuar nga zyra e finances. Ne rastin tim fatura eshte e firmosur nga shitesi dhe bleresi te shoqeruara me kuponin tatimor bashkengjitur fatures, faturat me keto elemente jane lehtesisht te verifikueshme sepse perndryshe nuk do te ishin pranuar nga zyra e finances. Për fjetjen në hotel nje dite pas perfundimit te sherbimit theksoj qe edhe pse ne raste te ndryshme kur nuk eshte bere e mundur kryerja e te gjitha rasteve te denoncimeve, titullari na ka urdheruar te qendrojme nje dite me shume per ezaurimin e tyre, gjithmone bazuar ne urdherin e derguar nga titullari…."

<u>Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së</u>:

*Grupi i auditimit pas shqyrtimit të observacionit dhe fakteve të reja të cituara nga ana juaj, **por të pavëna në dispozicion grupit të auditimit as gjatë punës në terren dhe as bashkëlidhur observacionit të dërguar nëpërmjet emailit,** vlerëson angazhimin tuaj në këtë situatë të fatkeqësisë natyrore që nuk ndihmon aspak procesin auditues, por thekson edhe njëherë se në këtëfazë të procedurës audituese është e pamundur nga ana jonë të testojmë përputhshmërinë e **aktkonstatimeve të pretenduara nga ana juaj** me ditët për të cilat punonjësit janë paguar me dieta, për më tepër kur nga ana juaj vetëm cilësohet se janë hartuar aktkonstatimet, janë ngarkuar në sistemin C@ts si dhe janë administruar fizikisht në zyrën e arkivës në DHTRV, **por në asnjë rast nuk janë vënë në dispozicion grupit të auditimit edhe pas kërkesave tona të herëpashershme.** Pranojmë arsyetimin tuaj se është përgjegjësi e përgjegjësit të Sekorit të Monitorimit Territorial/zbatimit hartimi i listëprezencave për inspektorët e këtij sektori, por nuk mund të pranojmë arsyetimin se meqënëse në listëprezencë inspektorët janë paguar për 22 ditë pune të plota , ata janë konstatuar në punë nga ana e përgjegjësit të sektorit dhe në këto kushte nuk mund të konsiderohet si pagë e marrë më tepër nga ana e inspektorëve. Fakti që inspektori nuk ka qenë në punë në ditën e përcaktuar në raportin e auditimit është një fakt i pamohueshëm që vërtetohet më së miri nga orari i lëshimit të kuponit tatimor që shoqëron faturën tatimore të shitjes për qëndrimin në hotel dhe **<u>fatura tatimore dhe kuponi në të gjitha rastet e paraqitura në raportin e auditimit janë lëshuar një ditë pas përfundimit të shërbimit referuar urdhërit të punës, madje në intervalet kohore 12:00-13:00</u>**. Kjo vërteton edhe njëherë se inspektori i cili në intervalet kohore 12:00-13:00 ka tërhequr kuponit tatimor në Dibër/Kukës nuk mundet që njëkohësisht të ketë qenë prezent në DHTRV në orarin 8:00-16:00.Fakti i cituar prej jush se, titullari ju ka urdhë ruar të që ndroni me shë rbim një ditë më shumë kur puna në të rren nuk ka pë rfunduar, në asnjë rast, nuk ë shtë e dokumentuar me urdhë r të titullarit dhe si e tillë nuk mund të merret parasysh.*

*Gjithashtu theksojmë edhe njëherë se **<u>në asnjë rast</u>** "Shpenzimet e udhëtimit" (për strukturën e HetimitTatimor për Rajonin e Veriut), nuk janë autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT ose nga Drejtori i DRT Shkodër, kompetencë kjo e deleguar nga Ministri i Financave me Autorizimin nr.7448/1, datë 25.05.2018, për vitin 2018 dhe me Autorizimin nr.6159/1, datë 11.04.2019, për vitin 2019, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, gërma a), paragrafi*

(i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar.

Përfundimi:

Grupi i auditimit merr në konsideratëfaktin qëpër periudhën nga data 17.06.2019-02.07.2019 periudhë në të cilën z. [redacted] ka qenë komanduar Drejtor i DHTRV nuk është nxjerrë asnjë urdhër shërbimi për kontoll në zona mbi 100 KM dhe për pasojë asnjë inspektor nuk ka përfituar dieta dhe nuk ka bërë kërkesë për dieta për periudhën e sipërcituar dhe nuk e ngarkon me përgjegjësi z.[redacted].Pranon dokumentacionin e paraqitur nga [redacted] si të bazuar ligjërisht dhe nuk e ngarkon atë me përgjegjësi.

Ngarkon me përgjegjësi Përgjegjësin e Sekorit të Monitorimit Territorial/Zbatimit për hartimin formal të listëprezencave (inspektorët të cilët kanë qëndruar me shërbim një ditë më shumë sesa është caktuar në urdhërin e punës rezultojnë që po atë ditë të jenë prezent në zyrë) dhe konbsideron dëm në buxhetin e shtetit shumën 123,235 lekë të përfituar nga 10 inspektorë në 3 shërbime të kryera dhe nuk merr parasysh pretendimin e ngritur nga ana juaj se ë shtë titullari ai që ka urdhë ruar që ndrimin në të rren një ditë më shumë sesa që rcaktohet në urdhë rin e punë s. Në asnjë rast nuk gjendet i dokumentuar një pretendim i tillë .

Në lidhje me pagesën e 27 punonjësve në 34 shërbime të kryera mbi bazën e dokumentacionionit jo të rregullt financiar (faturë tatimore shitje pa firmë dhe pa vulën e shitësit) theksojmë edhe njëherë se këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e nenit 4 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, ku shprehimisht citohet:

*"Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative", si dhe pikës 36 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar dhe konsideron dëm në buxhetin e shtetit shumën 654,500 lekë.**Justifikimi juaj se faturat e cituara janë të vulosura dhe të firmosura nuk qëndron pasi, grupi i auditimit i ka të administruara të gjitha dokumentet e cituara në raport.***

Në lidhje me arsyetimin se aktkonstatimet janë ngarkuar në sistemin C@ts si dhe janë administruar fizikisht në zyrën e arkivës në DHTRV dhe paraqitjen e tabelave statistikore të aktkonstatimeve nga ana juaj, ***nuk mund të pranohen nga ana e grupit të auditimit si të pambështetura nga ana dokumentare, pasi në asnjë rast aktkonstatimet nuk janë vënë në dispozicion grupit të auditimit edhe pas kërkesave tona të herëpashershme dhe për më tepër në këtë fazë të procedurës audituese është e pamundur nga ana jonë të testojmë përputhshmërinë e aktkonstatimeve të cituara nga ana juaj vetëm statistikisht me ditët për të cilat punonjësit janë paguar me dieta.*** Arsyetimet e mësipërme mbështesin konstatimin se:

Në 130 raste, janë kryer shpenzime për udhëtim e dieta ***në kushtet e paligjshmërisë në shumën 6,353,100 lekë*** *të pambështetur me dokumentacion vërtetues për kryerjen e detyrës, veprim ky në kundërshtim me:Përcaktimet e Udhëzimit nr.22225, datë 16.07.2015, të ish Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe përcaktimet e pikës 5.24 "Dokumentacioni administrativ", të Manualit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së, gjithashtu* ***në asnjë rast*** *"Shpenzimet e udhëtimit" (për strukturën e HetimitTatimor për Rajonin e Veriut), nuk janë autorizuar nga Drejtori i*

Përgjithshëm i DPT ose nga Drejtori i DRT Shkodër, kompetencë kjo e deleguar nga Ministri i Financave me Autorizimin nr.7448/1, datë 25.05.2018, për vitin 2018 dhe me Autorizimin nr.6159/1, datë 11.04.2019, për vitin 2019, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, gërma a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar.

Titulli i Gjetjes: **Parregullësi në respektimin e dispozitave ligjore për shpenzimet për udhëtime e dieta të cilat kanë rezultuar me,shpenzim në kushtet e paligjshmërisë në shumën 6,353,100 lekënga të cilat777,735 lekëkonsiderohen dëm në buxhetin e shtetit.**

Situata: a)**Në asnjë rast** "Shpenzimet e udhëtimit" (për strukturën e HetimitTatimor për Rajonin e Veriut), nuk janë autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT ose nga Drejtori i DRT Shkodër, kompetencë kjo e deleguar nga Ministri i Financave me Autorizimin nr.7448/1, datë 25.05.2018, për vitin 2018 dhe me Autorizimin nr.6159/1, datë 11.04.2019, për vitin 2019, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, gërma a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar, ku shprehimisht citohet:
"Dërgimi me shërbim i punonjësit autorizohet nga: Titullari i institucionit qëndror për shërbime në një largësi mbi 100 km jashtë qendrës së punës".
Nga 136 raste të kryerjes së shpenzimeve të udhëtimit për periudhën objekt auditimi:
-në 61 raste ose në 45% të rasteve, punonjësit e DHT kanë shkuar me shërbim në zbatim të urdhrave të punës nxjerrë nga Drejtori i Hetimit Tatimor në DPT;
-në 69 raste ose në 51% të rasteve, punonjësit e DHT kanë shkuar me shërbim në zbatim të urdhrave të punës nxjerrë nga Drejtori i Hetimit Tatimor Rajoni Verior;
-në 6 raste ose në 4% të rasteve, punonjësit e DHT kanë shkuar me shërbim në zbatim të urdhrave të punës nxjerrë nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tiranë.
b) **Në 130 raste ose në 95% të rasteve,** janëkryer shpenzime për udhëtim e dieta**në kushtet e paligjshmërisë në shumën 6,353,100 lekë**nga të cilat, 4,294,600 lekë në vitin 2018 dhe 2,058,500 lekë në vitin 2019, të pambështetur me dokumentacion vërtetues për kryerjen e detyrës, veprim ky në kundërshtim me:
- Përcaktimet e Udhëzimit nr.22225, datë 16.07.2015, të ish Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ku shprehimisht përcaktohet se:
"Rast pas rasti, punonjësit e verifikimit në terren, hetimit tatimor apo cdo strukture tjetër, të cilët kryejnë verifikime apo kontrolle të tatimpaguesve,

mbajnë akt konstatimin përkatës"
- Përcaktimet e pikës 5.24 "Dokumentacioni administrativ", të Manualit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së, ku shprehimisht përcaktohet se:
"Gjatë kryerjes së detyrës funksionale të veprimeve në terren për zbatimin e Urdhërit të Punës, inspektorët duhet të jenë të pajisur me Akt Konstatimi; Procesverbal Gjobe; Procesverbal Konfiskimi; Procesverbal Sekuestrimi", **nga të cilat:**

- **27 punonjës në 34 shërbime të kryera** janë paguar për shpenzime udhëtimi mbi bazën e dokumentacionit financiar të parregullt (fatura tatimore për fjetje në hotel të pa vulosura nga shitësi i shërbimit, të panënshkruara nga punonjësi dhe shitësi i shërbimit) ***duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit në shumën 654,500 lekë, nga të cilat 589,000lekë në vitin 2018 dhe 65,500 lekënë vitin 2019.****Psh:* Me Urdhër Shpenzimin nr.93, datë 17.06.2019, është paguar z. [redacted] në shumën 115,500 lekë, për shërbimin e kryer në datat 10-24.03.2019 dhe 27.03-10.04.2019 në zbatim të Planit Operacional nr.5180, datë 09.03.2019; Urdhëri i Punës është dhënë nga DHT në DPT. ***Fatura tatimore e shitjes me nr.serie 72798354, datë 02.04.2019 në shumën 6,000 lekë dhe fatura me nr.serie 72798352, datë 31.03.2019, në shumën 18,000 lekë, rezultojnë të jenë të pavulosura nga ana e shitësit. Në total janë paguar 24,000 lekë shpenzime fjetje me faturë jo të rregullt financiare.*** Gjithashtu bashkëlidhur praktikës së shpenzimit nuk ka asnjë dokument(Akt Konstatim/Procesverbal Gjobe; Procesverbal Konfiskimi; Procesverbal Sekuestrimi), që të vërtetojë kryerjen e detyrës së ngarkuar për të cilën janë paguar "Shpenzime udhëtimi" në total ***115,500 lekë,*** veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 4 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, ku shprehimisht citohet:
"Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative", si dhe pikës 36 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
- **10 punonjës në 3 shërbime të kryera**kanë tejkaluar me 1 ditë qëndrimin me shërbim jashtë vendit të punës (vërtetuar kjo me faturë tatimore fjetje në hotel një ditë më shumë sesa është urdhëruar në urdhërin e punës), ndërkohë që rezulton të jenë paguar nga sektori i financës për 22 ditë pune, ***duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit në***

vitin 2019 nëshumën 123,235 lekë. Psh: Me Urdhër Shpenzimin nr.69, datë 24.04.2019, është paguar ***z.*** [redacted] në shumën 49,500 lekë, për shërbimin e kryer: -Në datat:11-13.02.2019; 27-28.02.2019; 04-07.03.2019; 08-09.03.2019; 18-20.03.2019. Në të gjitha rastet Urdhëri i Punës është dhënë nga DHTRV. Faturat tatimore të shitjes rezultojnë të shoqëruara me kuponin tatimor, të nënshkruara në ekstremitetet e tyre dhe të vulosura nga shitësi, por në të gjitha rastet fatura është lëshuar një ditë pas përfundimit të shërbimit dhe konfirmon fjetjen në hotel një ditë më shumë sesa është urdhëruar në urdhërin e punës.

Zyra e financës rezulton të ketë paguar shpenzime për fjetje në hotel aq sa përcaktohet në urdhrin e punës, ndërkohë që nga auditimi i listëpagesave të muajve shkurt dhe mars 2019, rezulton që për ditët e vërtetuara me faturë hoteli (jashtë ditëve të urdhrit të punës), zyra e financës mbështetur në listëprezencën e DHT, e ka paguar z.[redacted] për 22 ditë të plota, ndonëse ai ka tejkaluar me 5 ditë qëndrimin me shërbim jashtë vendit të punës. Paga e paguar për këto 5 ditë në shumën 17,045 lekë (5x3,409 lekë paga ditore), përbën dëm në buxhetin e shtetit dhe si e tillë duhet të kthehet.

c) **<u>Në 22 raste, ose në 16% të rasteve</u>** janë konstatuar parregullsi në hartimin e urdhrave të punës të nxjerrë nga Drejtori i Hetimit Tatimor në DPT. Më konkretisht, në urdhër nuk përcaktohet territori ku do të kryhet shërbimi, por në mënyrë të përgjithshme citohet sipas rastit: në territorin e DHT Rajoni Jugor; Qendor, Verior, në territorin e Shqipërisë…, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 5.24 "Dokumentacioni administrativ", të Manualit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së, ku shprehimisht citohet se:

"Në urdhrin e punës përcaktohet territori ku do të kryhet inspektimi (i detajuar, vendi, adresa përkatëse për cdo subjekt, aksi rrugor i përcaktuar dhe vendi i pikës së kontrollit)".

Kriteri:

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhekontrollin" i ndryshuar.

VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar**.**

Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Autorizimet e Ministrit të Financave nr.7448/1, datë 25.05.2018, për vitin 2018 dhe nr.6159/1, datë 11.04.2019, për vitin 2019.

Udhëzimi nr.22225, datë 16.07.2015, i ish Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Manuali i Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së.

Ndikimi: Shpenzime në kushtet e paligjshmërisëdhe dëm në buxhetin e shtetit.

Shkaku: Mangësi në njohjen dhe zbatimin e ligjit për menaxhimit financiar dhe kontrollin.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi 1.1: DRT Shkodër të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 777,735 lekë, përfituar padrejtësisht nga 29 punonjës të DHT (sipas tabelës nr. X), në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, VKM-së nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Rekomandimi 1.2: DRT Shkodër të forcojë kontrollin e brendshëm në drejtim të garantimit të gjurmës së auditimit për shpenzimet e udhëtimit, me qëllim elimimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike.

Rekomandimi 1.3: DHTRV të përmirësojë punën në drejtim të saktësimit në urdhrat e punës të destinacionit të inspektimit, detyrim ky që rrjedh nga zbatimi i Manualit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së. Ky përcaktim ka impakt të drejtëpërdrejtë në përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit dhe normativave të harxhimit të karburantit.

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë**

IV/3 ***Vlerësimi i evidentimit, saktësisë së llogaritjes së ndryshimeve në aktivet (e trupëzuara dhe qarkulluese) të institucionit, pasqyrimi i tyre në pasqyrat financiare në përputhje me aktet ligjore e nënligjore përkatëse, zbatimi i dispozitave ligjore për inventarizimin e pronës shtetërore si dhe rregullshmëria e procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimi/asgjësimin e aktiveve.***

1. Vlerësimi i Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin-2018- 2019, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të DRT Shkodër, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

I. Viti 2018

Nga auditimi u konstatua :

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

Pasqyrat financiare për vitin 2018 janë hartuar dhe depozituar në Degën e Thesarit Shkodër me shkresën nr. 2396, datë 20.03.2019 brenda afatit ligjor.
Pasqyrat financiare kanë të plotësuar; pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare ose pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve; pasqyrën e flukseve monetare, pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore. Pasqyrat financiare vjetore janë shoqëruar me pasqyrat statistikore, si pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit të tyre, pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto dhe pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

Veprimet janë kaluar nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Janë mbajtur ditarët e bankës, magazinës dhe të ndryshme.

Partitarët analitik të llogarive janë mbajtur dhe azhornuar, si dhe i llogarive inventarjale të magazinës dhe është bërë rakordimi llogari-magazinë.

Gjatë auditimit kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit ku u konstatuan disa ngjarje që mund të paraqesin një risk të gabimit material:

- Evidenca kontabël është mbajtur nëpërmjet programit inforrmatik ALPFA WEB ku mbahen të dhëna të transaksioneve dhe balancave financiare, lidhur me ekzekutimin e buxhetit; të dhëna për kodifikimin dhe klasifikimin buxhetor e kontabël të të dhënave financiare, në përputhje me bazën ligjore për financat publike; të dhëna për raporte financiare dhe statistika; etj.
-*Kontrolli aritmetik.*
Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve tek DRTSHkodër).*

Shumat e llogarive të paraqitura në postet e P1 Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar me informacionin që jepet në formatet anekse (formatet për "Aktivet e Qëndrueshme", formati "Shpenzimet e Burimet për Investime", formati 3 "Pasqyra e Flukseve Monetare (CASH FLOW)" dhe formati 7 "Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata (Vlera Neto)" korrespondojnë ndërmjet tyre.

Auditimi i aktiveve afatgjata:

a. Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata, janë që të sigurohemi se:
Aktivet ekzistojnë fizikisht; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve korrente dhe aktiveve afatgjata; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe e korrekte.
Nëse aktivet afatgjata paraqiten në pasqyrat financiare vjetore me koston e tyre historike (vlerën fillestare), duke evidentuar veçmas amortizimin e tyre. Lidhur me këto aktive, njësitë e qeverisjes së përgjithshme nëse kanë analizuar e rakorduar investimet e tyre eventuale që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e ndërmarrjeve të tjera (publike ose jopublike). Për këtë qëllim, nga njësia a janë saktësuar regjistrimet kontabël në momentin fillestar dhe në fund të vitit financiar.
b. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:
Për auditimin e aktiveve afatgjata, paraprakisht u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:
U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve afatgjata në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhura ndonjë variacion anormal mbi aktivet afatgjata;
U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.
U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet, evidentimi kontabël.
c. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata:

1. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se:
- Aktivet e blera kontabilizohen sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë); Nuk ka Aktive të blera nga instutucioni
- Aktivet e prodhuara nga subjekti (Nëse ka) kontabilizohen sipas kostos së tyre të prodhimit.
- Aktivet e marra falas kontabilizohen duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;(Nuk ka)
- Aktivet e sjella në subjekt nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes (Nuk ka).
(UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik").
2. Për inventarin, duhet të sigurohemi që subjekti:
- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuara;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Nga verifikimi i pasqyrave financiare (bilancit) të vitit 2018 rezultoi:

Në analizë aktivet:

a. Në formatin nr. 1 "Pasqyra e pozicionit financiar", "Aktivet afatgjata jo materiale (Nuk ka).

b. Në formatin nr. 1 "Pasqyra e pozicionit financiar", "Aktivet afatgjata materiale" paraqitet në vlerën 112.591.516 (me kosto historike). Kjo vlerë është në zbritje krahasuar me 31.12.2017, që do të thotë se për vitin 2018 ka shtesa të aktiveve në një vlerë prej 2.811.436 lekë dhe një pakësim prej 14.311.967 lekë .

Në formatin nr. 1 "Pasqyra e pozicionit financiar", "Aktivet afatgjata materiale" në vlerën 65.126.026 leke janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë:

Tabela nr.27

Në lekë

Nr.	Nr. llog.	EMERTIMI I LLOGARIVE TE AKTIVIT	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi i Paraardhës
47	21,23,24,28	2. Aktivet afatgjata materiale		
48	210	Toka, troje, terrene		
49	211	Pyje, plantacione		
50	212	Ndërtesa e konstruksione	42.013.902	44.225.160
51	213	Rrugë, rrjete, vepra ujore		
52	214	Instalime teknike, makineri e pajisje	2.789.626	3.013.979
53	215	Mjete transporti	10.960.324	12.641.430
54	216	Rezerva shtetërore		
55	217	Kafshë pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	9.362.174	10.512.675
57	24	Aktive afatgjata të dëmtuara		
58	28	Caktime të aktiveve afatgjata		
59	25-26	3. Aktive afatgjata financiare		
60	25	Huadhënie e nënhuadhënie		
	TOTALI		65,126,026	70,393,244

Zëri "Ndërtime e konstruksione" (llog. 212) për vlerën 42.013.902lekë është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer. Inventarët për vitin 2018 janë, kryer në institucion në bazë të Urdhrit të Brendshëm nr.1072, datë 14.11.2018 " Ngritjen e komisionit të inventarizimit të pasurisë për vitin 2018 ", nga ish Titullari i DRTShkodër.
Kjo llogari (me kosto historike) paraqet të gjitha ndërtesat dhe konstruksionet që janë në Pronësi Administrimi të Drejtorise Pergjithshme Tatimeve , në vlerën prej 52,539,680 lekë që janë:
Në territorin e qytetit Shkodër (Drejtoria RajonaleTatimore Shkodër) në vlerën prej 30.470.589 lekë, me çertifikatë pronësie nr 8591, Zona Kadastrale nr. 2/170 pasurie,

- Në territorin e qytetit, me çertifikatë pronësie në Koplik, Zona kadastrale nr. 2220 nr.104/1 pasurie në vlerën 10.248.388 lekë;
- Në territorin e qytetit Pukë në vlerën 11.820.703 lekë me vertëtim pronsienr. 12 datë 26.11.2008.

Zëri "Instalime teknike, pajisje, instrumente dhe vegla pune" (llog. 214) për vlerën 8.865.498 lekë (me kosto historike) është i zbërthyer në mënyre analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer në vitin 2018 sipas urdhërit nr.1072 datë 14.11.2018.
Kjo vlerë është në zbritje krahasuar me 31.12.2017, që do të thotë se për vitin 2018 një pakësim prej 739.060 lekë (me kosto historike) me vlerë të mbetur 77.527 lekësi rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi meUrdhrin e Ish Drejtori i DRT Shkodër z.Hysen Hysaj.
Zëri "Mjete transporti" (llog. 215) për vlerën 32.800.514 lekë (me kosto historike) paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Drejtorise Pergjithshme Tatimeve dhe në përdorin të

Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer. Kjo llogari në krahasim me vitin 2017 ka shtesa brenda sistemit pa pagesë në vlerën 1.923.208 lekë bazuar nëshkresënnr. 3674 prot, datë 18.04.2018. Në vlerë neto gjëndja më 31.12.2018 është në shumën prej 10,960,324 lekë për 13 automjete (nga të cilat 11 automjete janë në përdorim dhe 2 jashtë funksionit).

Tabela nr.28

Nr.	EMERTIMI	Çmimi	Sipas të dhënave Kontabile me kosto historike	
			Sasia	Vlera/ lekë
1	Autoveture Benz	700,000	1	700,000
2	autoveture Landrover Tr2536 E	2,518,972	1	2,518,972
3	Automjet ëolsvagen TR3197 F	2,589,000	1	2,589,000
4	Automjet LAND-ROVER Tr 28 38 E	2,377,700	1	2,377,700
5	Automjet TAYOTA TR 1288E	3,522,345	1	3,522,345
6	Automjet Ëlsvagen AA697LA	3,187,094	1	3,187,094
7	Automjet Ëlsvagen AA681LA	3,187,094	1	3,187,094
8	Automjet peugeot AA 370l	1,923,208	1	1,923,208
9	Automjet peugeot AA 138L	1,923,208	1	1,923,208
10	Automjet peugeot AA375 LI	1,923,208	1	1,923,208
11	Automjet peugeot AA369 LI	1,923,208	1	1,923,208
12	Autoveturë PEOGEOT AA826LH	1,923,208	1	1,923,208
13	Automjet TAYOTA Rav. 4 AA275PK	5,102,269	1	5,102,269
	TOTALI 2018			**32,800,514**

Të dhëna nga sektori i finacës

Zëri "Inventar ekonomik" (llog. 218) për vlerën 18.385.824 lekë (me kosto historike) përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim i zbërthyer në mënyrë analitike dhe i rakorduar me inventarët e kryer. Krahasuar me vitin 2017 llogaria kontabël 218 "Inventari ekonomik" është shtuar me vlerën 888.228 lekë shtesa brenda sistemit pa pagesë, kurse pakësimet kanë ardhur nga nxjerrje jashtë përdorimit në vlerën 13.572.907 lekë sipas urdhërit të ish Titullarit të DPT znj.Ilda Koja me nr.6684/1 datë 14.06.2018 dhe të ish titullarit të DRT Shkodër z.Hysen Hysaj nr.790, datë 03.09.2018 dhe janë asgjësuar me procesverbalet përkatëse mbajtur nga komisionet e ngritura me nr.2 datë 25.06.2018 dhe me procesverbalin e datës 12.09.2018.
Tabela më poshtë:

Lëvizjet e Llog. 218 Inventar ekonomik për vitin 2018.

Tabela nr.29
Në lekë

Nr. Llog.	E M E R T I M I	Ushtrimi paraardhës	Shtesat pa pagese	Paksimet gjate vitit		Ushtrimi mbyllur
		Kosto historike	Kosto historike	Kosto historike	Vlere e mbetur	Kosto historike

210	Toka,troje,Terene					0
211	Pyje,Kullota, Plantacione					0
212	Ndertime e Konstruksione	52,539,680				52,539,680
213	Rruge,rrjete,vepra ujore					0
214	Instalime teknike,akineri,paisje,vegla pune	9,604,558		739,060	77,527	8,865,498
215	Mjete transporti	30,877,306	1,923,208		0	32,800,514
216	Rezerva shtetrore				0	0
217	Kafshe pune e prodhimi				0	0
218	Inventar ekonomik gjithsej	31,070,503	888,228	13,572,907	345,719	18,385,824
	Nga keto:					
	Orendi zyre			*1,398,903*	*272,017*	
	Paisje elektronike			*12,174,004*	*73,702*	
	T O T A L I	124,092,047	2,811,436	14,311,967	423,246	112,591,516

(Të dhëna nga sektori i financës dhe formati 7/a i aneksit të pasqyrës së perfomancës financiare)

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 21-28) në formatin nr. 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike" kolona 11 "Gjendja në mbyllje të ushtrimit" është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 7/b, "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)", kolona 8 "Kosto historike" 112.591.516 lekë.

Gjendja në mbyllje të ushtrimit (Llogaria 21-28) në formatin nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" kolona 10 "Teprica neto" është e njëjtë me vlerat e pasqyruara në formatin nr. 1, "Pasqyra e pozicionit financiar", "Ushtrimi i mbyllur" llogaria 21 "Aktive afatgjata materiale", 65.126.026 lekë.

"Amortizimi i aktiveve afatgjata" sipas pasqyrave financiare formati 7/b në fund të vitit 2018 paraqitet në vlerën 47.465.490 lekë. Krahasuar me vitin 2017 llogaria 219 "Amortizimi i aktiveve afatgjata" paraqitet me shtesë prej 7.655.408 lekë e cila ka ardhur si rezultat i llogaritjes së amortizimit vjetor për aktivet afatgjata dhe me pakësim prej 13.888.721lekë si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimi të mjeteve kryesore.

Përllogaritja e amortizimit të aktiveve afatgjata është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në VKM nr. 401 të vitit 1989 dhe UMF nr. 8, date 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme".

"Normat e Amortizimit sipas llojit të aktiveve të llogaritura nga Drejtoria rajonale tatimore Shkoder janë si më poshtë:

5%- ndërtesat dhe konstruksionet.

5% - për makineritë e pajisjet operacionale, instrumente e vegla pune

5% -inventarin ekonomik orendi zyre

25% - për pajisjet kompjuterike, informatike.

20% - për mjetet e transportit.

Tabela nr.30
Në lekë

Llog	Aktivet Afatgjata	Çelja me 1.01.018	Shtesa Amortizimi 2018	Amortizimi Vjetor 2018	Pakësim 2018	Gjendja 31.12.2018
212	Ndertime e Konstruksione	8,314,520		2,211,258		10,525,778
214	Instalimeteknike,makineri,paisje,vegla pune	6,590,579		146,826	661,533	6,075,872
215	Mjete transporti	18,235,876	691,387	2,912,928		21,840,191
218	Inventar ekonomik	20,557,828	157,400	1,535,610	13,227,188	9,023,650
	Shuma gjithsej	53,698,803	848,787	6,806,621	13,888,721	47,465,490

(Të dhëna nga sektori i financës)

Nga auditimi 219 "Amortizimi i aktiveve afatgjata materiale", (formati nr. 1) dhe pasqyrës statistikore formati 7, "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" u konstatua se, amortizimi vjetor është llogaritur e kontabilizuar i ndarë si më poshtë:
Llog. nr. 212 "Amortizim ndërtime dhe konstruksione" = 10,525,778 lekë,
Llog. nr. 214 "Amortizim Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" = 6,075,872 lekë,
Llog. nr. 215 "Amortizim Mjete transporti" = 21,840,191 lekë,
Llog. nr. 218 "Amortizim Inventar ekonomik" = 9,023,650 lekë.
Aktivet afatshkurtra, gjendje inventari qarkullues, llog. 31, zëri "Materiale" në shumën prej 1,237,600 lekë, janë pasqyruar në bilanc dhe për këta ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2018 paraqiten ne tabelën si me poshtë:

Llog. 31 Materiale,	**vlera në lekë**
Çelje e vitit 2018	844.977
Hyrje pa pagesë gjatë vitit 2018	4.825.423
Dalje nga magazina gjatë vitit 2018	4.432.800
Gjendja në 31.12.2018	1.237.600

Aktivet afatshkurtra, gjendje inventari qarkullues llogarinë 32, zëri "Inventari i imët" në shumën prej 285,488 lekë, janë pasqyruar në bilanc dhe për këta ka inventar fizik të kuadruar me atë kontabël. Në vitin 2017 kjo llogari ka vlerën 112.700 lekë. Hyrje gjatë vitit 2018 është vlera 205.488 leke, jashtë përdorimit 32.700lekë, gjendja në fund 285.488 lekë.
Lëvizjet e llogarisë 32 "Inventari i imët "paraqiten si me poshtë:

Llog. 32 Objekte inventari,	**vlera në lekë**
Çelje e vitit 2018	112.700
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2018	205.488
Dalje nga magazina gjatë vitit 2018	32.700
Gjendja në 31.12.2018	285.488

Pakësimet kanë ardhur nga nxjerrja jashtë përdorimit në vlerën 32.700 lekë miratuar me Urdhrin të ish Titullarit të DPT znj.Ilda Koja me nr.6684/1 datë 14.06.2018
Llog. 35 Mallra, paraqitet në shumën 1.364.306 lekë
Aktivet afatshkurtra, gjendje inventari qarkullues llogarinë 35, zëri "Mallra " në shumën prej 1.364.306 leke paraqet gjëndjen e shtypshkrime (Fature Tatimnore) dhe bileta si më poshtë vijon;

Çelje e vitit 2018	1.304.400 lekë
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2018	6.562.080 lekë

Dalje nga magazina gjatë vitit 2018 6.502.174 lekë
Gjendja në 31.12.2018 1.364.306 lekë

"Llogari të arkëtueshme" (Klasa 4) pasqyrohen në bilanc Formati nr. 1 për vlerën 33.700.866 lekë dhe përfaqëson detyrime subjekteve tatimpaguese ndaj DRTShkodër sipas llogarive paraqitet në mënyrë analitike si më poshtë vijon:

- "Debitorë të ndryshëm" (llog. 468) në**Aneksi 1.** e analizuar sipas subjekteve bashkëlidhur, në vlerën 19.603.327 lekë,përbëhet në analizë sipas burimeve të krijimit si më poshtë vijon:

1- Tatim mbi të ardhurat personale	Detyrim me vlerë	1.000 lekë
	Gjobë me vlerë	250 lekë
	Kamat vonesë me vlerë	30 lekë
Viti i krijimit 2011. Detyrimi nga një subjekt.		
2- Tatimi mbi Fitimin	Detyrim me vlerë	117.728 lekë
	Gjobë me vlerë	117.728 lekë
	Kamat vonesë me vlerë	69.992lekë
Viti i krijimit 2012 dhe i përket një subjekti.		
3-Tatim mbi vlerën e shtuar	Kamat vonesë me vlerë	21.590 lekë
Viti i krijimit 2009 dhe i përket 2 subjekteve.		
4- Dënime pa Tatim	Dënime (Gjoba) me vlerë	1.950.000 lekë
Viti i krijimit 2011 dhe i përket 78 subjekteve.		
5 – Sigurimet Shoqërore	Detyrime me vlerë	6.814.610 lekë
	Gjoba me vlerë	1.768.249 lekë
	Kamat vonesa me vlerë	1.051.874 lekë
Viti i krijimit 2008-2011 dhe i përket 145 subjekte.		

Në total detyrimi për vitin 2018 (nga 1-5) është në shumën **prej 11,913,051 lekë**.

Theksojmë se detyrimet e mësipërme në përgjithësi janë detyrime pa shpresë arkëtimi pasi aktualisht janë subjekte pa nipt, të çrregjistruar nga QKR. Gjithashtu theksojmë se për mungesë dokumentacioni në DRT Shkodër për këto subjekte e ka bërë të pamundur hedhjen e këtyre detyrimeve në sistemin informatik C@TS të DPT.

6- Grande nga transferimete institucioneve dhe bashkive Detyrime në vlerë 5.026 lekë
Viti i krijimit 2017-2018 dhe i përket 2 subjekteve.

Ky detyrim është me shpresë arkëtimi dhe i përket Bashkisë Shkodër në shumën prej 4,466 lekë dhe Bashkisë Fushë Arrëz në shumën prej 560 lekë , e cila përfaqëson derdhjen e 1% nga dy institucionet e sipërcituara si të ardhura të arkëtuara nga DRT në cilësinë e agjentit tatimorë në zbatim të kërkesave të ligjitnr.9975, datë 28.02.2008 " Për taksat kombëtare", i ndryshuar si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.32, datë 31.12.2013 " Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", e pa arkkëtuar deri më 31.12.2018.

7- Pulla takse pranë të tretëve(gjëndje në fund të vitit e papërdorur në gjykata, prokuroria, bashki të Rrethit të Shkodrës (zyra e gjendjes civile), në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9975, datë 28.02.2008 " Për taksat kombëtare", i ndryshuar dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave

nr.26, datë 04.09.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, të cilat përfitojnë si agjentë tatimorë komisione në masën prej 5% (zyra e gjëndjes civile)dhe diferenca e të ardhurave në masën prej 95% dhe 90% duhet të derdhin detyrimin ndaj DRT në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Drejtësisë nr.33, datë 29.12.2014 " Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e ministrisë së drejtësisë", "'Për shërbimin përmbarimor gjyqësor shtetëror", prokurorisë dhe noterisë, pasi përfitojnë 10% komisione nga shërbimi që kryhet në gjykatë, prokurori.**Detyrimi në vlerë në fund të vitit 2018 është në vlerë 7,685,250 lekë.Viti i krijimit 2017-2018 dhe i përket 10 subjekteve.**
Detyrimi është me shpresë arkëtimi pasi arkëtohet në vijimësi në vitin 2019.

-Llogaria Kreditorë me nr. 467 "Kreditorë të ndryshëm"paraqitet më 31.12.2018 (Aneksi nr.2 bashkëlidhur sipas subjekteve), paraqitetnë vlerë 5.120.781 lekë dhe i përket:
1-Kreditorë - për Tatim Fitimi në vlerë 1.652.602 lekëdhe i përket 12 subjekte;
2-Kreditorë –për Pulla Akcize në vlerë 1.190.483 lekë dhe i përket 35 subjekte;
3-Kreditorë - për dividend në vlerë521.750 lekë dhe i përket 1 subjekti;
4-Kreditorë - për taksë qarkullimi në vlerë 336.667 lekë përbëhet nga 2 subjekte;
5-Kreditorë - për gjoba në vlerë 1.244.279 lekë përbëhet nga 76 subjekte
6- Kreditore - për kasa regjistruese në vlerë175.000 lekë përbëhet nga 10 subjekte.

Këto detyrime të institucionit ndaj kreditorëve për mungesë dokumentacioni bashkëngjitur detyrimit si nipt, aktualisht rezultojnë të çrregjistruara nga QKB, nuk ekziston aktualisht lloji I tatimit i vendosur në momentin e krijimit të detyrimit gjë e ka bërë të pamundur përfshirjen e tyre në sistemin informatik C@TS dhe të mbylljes së detyrimeve kreditore.

Llog. 4342 "Të tjera operacione me shtetin (debitor)" zënë shumën 14.097.539 lekë e cila në pasiv në analizë përbëhet nga detyrimet afatshkurtra, llogari të pagueshme, të cilat trashëgohen në vitin 2019 si "Detyrime ndaj personelit" (llog. 421-423) për shumën prej 6,288,795 lekë, "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" (llog. 431) për 544.134 lekë, për "Sigurime shoqërore" (llog. 435) në vleftën 1.882.241 lekë, "Sigurime shëndetësore" (llog. 436) në vleftën 261.588 lekë, "Kreditorë të ndryshëm" (llog. 467) në vlerën 5.120.781 lekë paraqitet e analizuar si më poshtë:

Gjendja e detyrimeve kreditore për vitin 2017 dhe për vitin 2018, të cilat mbahen jashtë sistemit informatik C@TS më 31/12/2018.

Në llog. (467) "Kreditorë të ndryshëm" në vlerën 5.120.781 lekë , në mënyrë analitike paraqitet si më poshtë vijon dhe përfaqëson detyrimet e institucionit ndaj të tretëve , të pa sistemuara pasi mungojnë dokumentacionet përkatëse :

Tabela nr.31
Në lekë

Renditja sipas llojit te tatimit	**Kreditore jashte SIT 31.12.2017**	**Kreditore jashte SIT te hedhura ne sistem gjate 2018**	**Shtesa 2018**	**Kreditore jashte SIT gjendje 31.12.2018**
	1	**2**	**3**	**4**

Kreditorë - për Tvsh				
Kreditorë - për Tatim Fitimi	1,652,602.0	0.0		1,652,602.0
Kreditore - për Pulla Akcize (Financa)	1,190,483.0			1,190,483.0
Kreditore - për Bileta Transporti (Financa)				
Kreditore - për Sig.Shoq-Shend				
Kreditore - për Tap				
Kreditore - për divident	521,750.0			521,750.0
Kreditore - për taksë qarkullimi	336,667.0			336,667.0
Kreditore - për gjoba	1,244,279.0			1,244,279.0
Kreditore - për kasa regjistruese	175,000.0			175,000.0
Totali	5,120,781.0	0.0	0.0	**5,120,781.0**

Referuar të dhënave të pasqyrës financiare tek I.Pasivet afatshkurtra , llogaritë e arkëtueshme rezulton se shuma 8.976.758 lekkë (llog,42, 431, 432,435, 436, korespondon me të dhënat në llogarinë 7206, "Financim i pritshëm nga buxheti" në Formatin nr. 2, "Pasqyra e performancës financiare".

Tabela nr.32

Në lekë

Nr.	**Nr. Llog.**	**EMERTIMI I LLOGARIVE TE PASIVIT**	**Ushtrimi i Mbyllur**	**Ushtrimi Paraardhes**
66	Klasa 4	I. Pasivet afatshkurtra		
67		1. Llogari të pagueshme		
68	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to		
69	42	Detyrime ndaj personelit	6,288,795	5,613,954
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhënës		
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	544,134	537,832
73	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqërore	1,882,241	1,688,948
76	436	Sigurime Shëndetësore	261,588	235,437
77	437,438	Organizma të tjerë shtetërorë		
78	44	Institucione të tjera publike		
79	45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike		
80	464	Det. për tu paguar për bl. letrave me vlere		
81	466	Kreditorë për mjete në ruajtje		
82	467	Kreditore të ndryshëm	5,120,781	5,120,781
83	4341	Operacione me shtetin (detyrime)	19,603,327	27,968,651

Llog. (4341) "Të tjera operacione me shtetin (detyrime)" zënë shumën 19.603.327 lekë e cila përbëhet nga shumat e debitorëve e pa arkëtuar e cila korespondon me llogarinë nr. 468 "Debitorë të ndryshëm" e cila përfaqëson deturime jashtë sistemit informatik C@TS të DPT në përgjithësi pa shpesë arkëtimi si më poshtë vijon :
Aktivet afat shkurtra. "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre". Nuk ka Gjendje
Llogaria 101 "Fonde Bazë" paraqitet në vlerën 68.013.419 leke vlerë e cila përputhet me vlerën e paraqitur në formatin 4 "Pasqyra e lëvizjes së fondeve".
Krahasuar me vitin 2017 ka një ulje të fondit bazë në vlerën 5.267.219 leke duke marrë parasysh shtesat dhe paksimet. Një faktor ndikues në uljen e fondit bazë është rritja e normës së amortizimit sipas udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018.
Pakësim të fondit bazë për vitin 2018 nga konsumi vjetor (amortizimi vjetor) i aktiveve afatgjata në vlerën 6.806.618 lekë dhe 423.246 lekë si rezultat i nxjerrjes jashë përdorim dhe shtesë të fondit bazë si rezultat i transferimit pa pagesë në vlerën 1.962.645 lekë sipas shkresës nr. 516, datë 18.04.2018.
Vlera e llogarisë 101 "Fondet baze" pasqyruar në formatin nr.1 të bilancit prej 68.013.419 leke, është e njëjtë me vlerën e pasqyruar në formatin 4 "Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto".
Në pasqyrën e pozicionit financiar C. "aktivet neto" janë të barabarta me D. "fondin e konsoliduar" në vlerën 68.013.419 lekë, e cila konfirmohet si diferencë ndërmjet vlerës së aktivit 101.714.285 lekë dhe B "detyrimet" të pasivit në vlerën 33.700.866 mijë lekë.
Formati 4 "pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto", totali i fondeve korrespondon me totalin e fondeve në formatin nr. 1 "Pasqyra e pozicionit financiar" në vlerën 68.013.419 lekë.
Në Formati nr. 2, "pasqyra e performancës financiare", A "Të ardhurat" janë pasqyruar: " "Të ardhurat jo atimore" në vlerën 14,081,128lekë.Sipas burimit të krijimit paraqiten si më poshtë vijon:

Tabela nr.33
Në lekë

Nr.	Nr. Llog.	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	VITI USHTRIMOR	VITI MEPARSHEM
a	B	c	1	2
1	A	TE ARDHURAT	138,000,127	120.783,718
2	70	I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET	0	0
26	75	II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQ E SHENDETES	0	0
34	71	III.TE ARDHURA JO TATIMORE	14,081,128	9,040,544
35	710	1. .Nga ndërmarrjet dhe pronësia		
36	7100	Nga Ndërmarrjet publike jo financiare		
37	7101	Nga Ndërmarrjet publike financiare		
38	7109	Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia		
39	711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	14,081,128	9,040,544
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore		
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh		
42	7112	Takse për veprime gjyqësore e noteriale		
43	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	6.490.878	6.125.994
44	7114	Te ardhura nga biletat	7.590.250	2.914.550
45	7115	Gjoba, kamatvonesa, sekuestrime e zhdëmtime		
46	7116	Te ardhura nga transferi pronës, Legalizimi i ndërtime pa leje		

47	719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore		
48	76	IV.TE ARDHURA FINANCIARE	0	0
53	72	V. GRANTE KORENTE	123,918,999	
54	720	1.Grant korent i Brendshëm	123,918,999	
55	7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	114.8441.141	99.291.848
56	7201	Nga Buxheti për NJQP(Vendore)	101.100	84.184
57	7202	Nga Buxheti për pagesa te posaçme te ISSH		
58	7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
59	7204	Pjesëmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
60	7205	Financim shtese për te ardhurat e krijuara brenda sistemit		4.293.714
Për mangësitë e konstatuara është mbatjtur aktkonstatimi nr.8, datë 05.03.2020.

- **Zbatimi i dispozitave ligjore për inventarizimin e pronës shtetërore si dhe rregullshmëria e procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit/asgjësimin e aktiveve.**

Për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
-Rregjistri i aktiveve të DRT-së.
-Dokumentacioni mbi kryerjen e inventarizimit.
-Dokumentacioni shoqërues i inventarizimit.

Auditimi u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:
-Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".
-Ligji nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".
-Udhëzimii Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
-Udhëzimi nr.20 datë 17.11.2014 "Për një ndryshim në udhëzimin nr.30", datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
-Udhëzimi nr.24, datë 07.12.2016, Për një ndryshim në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Inventarizimi i pasurisë për vitin 2018.

I.Drejtori Rajonal i Tatimeve, z. [redacted], në bazë të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", neni 7 "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve" dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, ka nxjerrë:
Urdhër për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit nr.1072 prot, datë 14.11.2018 i përbërë me 3 anëtarë, ku janë përcaktuar detyrat e komisionit, afatet e përfundimit të inventarizimit për gjendjen fizike.

Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues të inventarizimit, konstatohet se:

- Komisioni i inventarizimit përpara fillimit të inventarit nuk ka mbajtur procesverbal me magazinierin, në të cilin fiksohen numri i fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve të bëra gjatë vitit duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", pika 83 "Përgjegjësitë për inventarizimin", ku citohet se: "*Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material".*
- SipasZyrës së Financës, gjendja kontabël e aktiveve të trupëzuara datë 31.12.2018 në total është 112,591,0516 lekë, kurse e detajuar paraqitet si më poshtë:

Ndërtesa e konstruksione gjithsej, e ndarë: 52,539,680 lekë
- Ndërtesa DRT Shkodër 30,470,589 lekë
- Ndërtesa Koplik 10,248,388 lekë
- Ndërtesa Pukë 11,820,703 lekë

Instalime teknike, makineri e pajisje 8,865,498 lekë
Mjete transporti 32,800,514 lekë
Inventar ekonomik në shumën 18,385,824 lekë
Inventar i imët (llog.32) 285,488 lekë
Mallra (dokumentacion tatimor, llog.35) 1,364,306 lekë
Krahasuar me gjendjen fizike nuk rezultojnë diferenca.

- Komisioni i inventarizimit në përfundim të procesit nuk ka mbajtur procesverbal ku të pasqyrojë të dhënat e inventarizimit, krahasimin e gjendjes fizike dhe cilësore të aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit, por rezultatet i ka pasqyruar vetëm në relacionin përmbledhës, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik",*pika 85 Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për: a.Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në proceverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit b.Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë proçesverbalet*;
- **Referuar Relacionit nr.1072/1prot, datë 05.12.2018** komisioni i inventarizimit ka informuar Drejtorin Rajonal dhe Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse mbi përfundimin e procesit të inventarizimit të mjeteve kryesore, materialeve, shtypshkrimeve dhe gjendjes në magazinë deri në datën 31.12.2018. Komisioni ka vlerësuar paraprakisht se janë të papërdorshme nga inventari ekonomik 4 artikuj në vlerë fillestare 6,737,839 lekë, shoqëruar me listën e artikujve, vitin e vënies në punë, vlerën dhe personat që i kanë në ngarkim dhese nuk janë konstatuar diferenca midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël.

Nga komisioni i inventarizimit në prezencë të personit përgjegjës është bërë verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së aktiveve në ngarkim të personelit (inventarit në përdorim) të institucionit të të gjitha aktiveve, sipas fletë inventarëve nga numri 1-38.

- Nga strukturat drejtuese të institucionit nuk është vijuar me procesine vlerësimit të aktiveve të parashikuara të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit dhe se nga nëpunësi i

autorizuarnuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", ndryshuarsipas përcaktimit të pikës 95 Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi ku citohet: *"Është një proçes që kryhet gjatë ose pas proçesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale;* pikës 96 ku citohet "*Proçesi i vlerësimit të aktiveve realizohet nga komisioni i vlerësimit, ndërsa procesi i dhënies në përdorim/tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit kryhet nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi. Këto dy komisione ngrihen me urdhër të titullarit të njësisë publike me propozim të nëpunësit autorizues. Nëpunësi Autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit*.

II. Në vitin 2018 strukturat drejtuese të DRT-së, kanë vijuar procedurat për asgjësimin/tjetërsimin e aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit të mallrave të evidentuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit të vitit 2017, në zbatim të kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 7 "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve" dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, si më poshtë:

1.Relacioni nr.560/1prot, datë 9.10.2017 mbi realizimin e inventarizimit të aktiveve nga komisioni i inventarizimit bazuar në **Urdhrin nr. 560 prot, datë 09.10.2017**. Komisioni i inventarizimit nuk ka konstatuar diferenca midis gjendjes fizike dhe asaj kontabël.

- Komisioni i inventarizimit ka vlerësuar paraprakisht se janë të papërdorshme "Inventar ekonomik"nga llog.ekonomike 218 gjithsej 90 artikuj me vlerë fillestare 13,572,907 lekë, amortizimtë akumuluar 13,227,187 lekë dhe vlerë të mbetur 345,719 lekë, shoqëruar me listën e artikujve. Bashkëlidhur relacionitështë edhe lista përmbledhëse e aktiveve tëvlerësuara paraprakisht si të papërdorshme, e cila përmban kodin e çdo artikulli sasinë, vlerën, gjendjen e tyre dhe vitin e vënies në shfrytëzim,të cilat të grupuara paraqiten si më poshtë:
- Pajisje elektronike(fotokopje, kompjuter, printer, server, tv, ups etj) 50 artikujnë vlerë fillestare 12,174,004 lekë dhe vlerë të mbetur 73,702 lekë.
- Inventar ekonomik (orendi zyre) 40 artikuj nëvlerë fillestare 1,398,903 lekë dhe vlerë të mbetur 272,017 lekë.
- Komisioni ka vlerësuar paraprakisht se janë të papërdorshme "Instalime teknike, makineri e pajisje" (motor gjenerator, dedektor, radio mobil) nga llog. ek. 214 gjithsej 4 artikujnëvlerë fillestare 739,060 lekë, amortizimi i akumuluar 661,533 lekë dhe vlerë të mbetur 77,527 lekë, shoqëruar me listën e artikujve. Bashkëlidhur relacionit është edhe lista përmbledhëse e aktiveve të vlerësuara paraprakisht si të papërdorshme, e cila përmban kodin e çdo artikulli sasinë, vlerën, gjendjen e tyre dhe vitin e vënies në shfrytëzim.

Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues të dosjes së inventarizimitkonstatohet se:

Komisioni i inventarizimit në përfundim të procesit nuk ka mbajtur procesverbal ku të pasqyrojë të dhënat e inventarizimit, krahasimin e gjendjes fizike dhe cilësore të aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit, por rezultatet i ka pasqyruar vetëm në relacionin përmbledhës, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", *pika 85"Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për : a.Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të*

personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në proceverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit b.Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë proçesverbalet; pikës 96. *Nëpunësi Autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit*".

2.Me shkresë nr. 560/2, datë 22.12.2017, të titullarit të institucionit z. [redacted], është nxjerrë **Urdhër për ngritjen e komisionit për vlerësimin e aktiveve qëdo të nxirren jashtë përdorimit,** bazuar në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", si dhe të relacionit të inventarizimit nr.560/1 prot, datë 21.12.2017 të komisionit të inventarizimit për pajisjet të vlerësuara paraprakisht të papërdorshme i përbërë me 3 anëtarë. Në urdhër citohet që pas përfundimit të vlerësimit të aktiveve, dokumentacioni të përcillet në DPT për vijimin procedurave.

3. Relacion vlerësues datë 31.12.2017 mbi realizimin e procesit të vlerësimit të aktiveve të propozuara jashtë përdorimit.Sipas tij janë vlerësuar për jashtë përdorimit:

- Inventar ekonomik nga llog.ek. "218" për 90 artikuj në vlerë fillestare13,572,907 lekë, amortizimi i akumuluar 13,227,187 lekë dhe vlerë të mbetur 345,719 lekë, të detajuara si më poshtë:
- Pajisje elektronike 50 artikuj në vlerë fillestare 12,174,004 lekë dhe vlerë të mbetur 73,702 lekë.
- Inventar ekonomik (orendi zyre) 40 artikuj në vlerë fillestare 1,398,903 lekë dhe vlerë të mbetur 272,017 lekë.
- Instalime teknike, makineri e pajisje" nga llog.ek. 214 gjithsej 4 artikuj në vlerëfillestare 739,060 lekë, amortizimi i akumuluar 661,533 lekë dhe vlerë të mbetur 77,527 lekë.

Nga auditimii dokumentacionit shoqërues të asgjësimit/tjetërsimit të aktiveve konstatohet se:

- Nga komisioni i vlerësimit të aktiveve nuk është bërë vlerësimii secilit aktiv bazuar në vlerën fillestare, vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit të tij; vlerën e mbetur;nuk është bërë vlerësimi kosto-përfitim i aktiveve të propozuara për dalje jashtëpërdorimit si dhe nuk është hartuar procesverbali i vlerësimit, por ka vijuar punën me hartimin e relacionit përmbledhës, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik",sipas pikës 95: Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuarapër dalje nga përdorimi në njësi ku citohet:*"Është një proçes që kryhet gjatë ose pas proçesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale;* pikës 104 ku citohet: "*Hartohet nga komisioni i vlerësimit pas verifikimit faktik të të gjitha aktiveve duke argumentuar arsyet për vlerësimin e secilit prej tyre: a. nëse është i nevojshëm apo jo për veprimtarinë e njësisë; b. nëse nuk rezulton i nevojshëm për njësinë, a është në gjendje të mirë fizike dhe ka mundësi përdorimi të mëtejshëm në njësi të tjera; c. nëse duhet të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturine apo asgjësimit përfundimtar;*si dhe pikës 105 ku citohet: *"Proçesverbali hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga përgjegjësi material dhe komisioni i vlerësimit. Proçesverbali miratohet nga titullari i njësisë publike*".

4. Me shkresë nr 2821 prot datë 26.03.2018 të Drejtorit të DRT-së, z. [redacted] është dërguar në DPT lista e artikujve për aktivet e vlerësuara jashtë përdorimit.

5. Me shkresënr. 6684/1 prot, datë 14.06.2018të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së znj. [redacted] është ngritur komisioni për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të institucionit i përbërë prej 5 anëtarë, prej të cilëve dy specialistë nga DPT. Afati i përfundimit 10 ditë.

6. Me shkresë nr.13902/1prot, datë 6.7.2018 komisioni i asgjësimit ka dërguar në Drejtorinë e Administrimit dhe Prokurimeve të DPT-së, relacionin përmbledhës mbi rezultatet e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të DRT Shkodërnë zbatim të Urdhërit nr.6684/1 prot, datë 14.06.2018 të Drejtorittë Përgjithshëm.Sipas kësaj shkrese njoftohet se nga komisioni i asgjësimit janë mbajtur 2 procesverbale:

- <u>procesverbal nr.1, datë 25.06.2018</u> për inventar ekonomik (orendi zyre) për 40 artikuj me vlerë fillestare1,398,903 lekë dhe vlerë të mbetur 272,017 lekë.
- <u>procesverbal nr.2, datë 26.06.2018</u> për inventar ekonomik dhe pajisje teknike për 50 artikuj me vlerë fillestare 12,174,004 lekë dhe vlerë të mbetur73,702lekë (*nga llog. 218) si* dhe pajisje teknike e elektronike për 4 artikuj me vlerë fillestare 739,060 lekë dhe vlerë të mbetur 77,527 lekë (*nga llog. 214)*. Pra, gjithsej 54 artikuj me vlerë fillestare 12,913,064 lekë dhe vlerë të mbetur 151,229 lekë.

a) Komisioni i asgjësimit/tjetërsimit të aktiveve ka vendosur të asgjësojë inventar ekonomik (orendi zyre) sipas procesverbalit nr.1, datë 25.06.2018.Sipas fletëdaljes nr.279, datë12.09.2019të magazinës, materialet janë transportuar në Landfill Bushat me qëllim asgjësimin e tyre, për të cilatka firmosur edhe përfaqësuesi i subjektit.

b) Komisioni i asgjësimit/tjetërsimit të aktiveve ka vendosur të mos asgjësojë pajisjet elektronike të procesverbalit nr.2, datë 26.06,2018, të cilat janë objekt i VKM-së nr. 957, datë 19.12.2018 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike" dhe për të cilat cilëson qëtë vazhdohen procedurat e mëtejshme ligjore bazuar në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

7. Me shkresë nr. 13902/2, date 16.7.2018 komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve ka njoftuar Drejtorin e Përgjithshëm të DPT-së mbi konkluzionet e nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi dhe të vazhdimit të procedurave të mëtejshme, sipas legjislacionit në fuqi.

8. Sipas shkresës nr. 7083 prot, datë 23.07.2018, Drejtori i DRT-së Shkodër z. [redacted] i ka dërguar subjektit "[redacted]" për të firmosur Akt Marrëveshjen midis tyre për materialet e riciklueshme që janë objekt i VKM-së nr. 957, datë 19.12.2018 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike".

9.Urdhër nr.790 prot, datë 03.09.2018 i Drejtorit të DRT-së Shkodër z. [redacted] për dhënien e materialeve të cilësuara të riciklueshme nga komisioni i asgjësimit në zbatim të VKM-së nr.957"Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike" Kompanisë"[redacted]". Dorëzimi i këtyre materialeve është bërësipas procesverbalit nr.3, datë 12.09.2018, të mbajtur midis magazinierit të DRT dhe përfaqësuesit të subjektit për 54 artikuj me vlerë fillestare 12,913,064 lekë dhe vlerëtë mbetur në shumën 151,229 lekë,

- Bashkëlidhur kësaj procedure edhe Marrëveshja e Bashkëpunimit,datë19.07.2018 midis DRT Shkodër përfaqësuar nga Drejtori Rajonal z. [redacted] dhe përfaqësuesit të Kompanisë "[redacted]"sh.p.k nga z. [redacted].

- *Nga auditimi i dokumentacionit justifikues, vërtetues dhe shoqërues tëprocesittë asgjësimit/tjetërsimit për materialet "pajisjet elektrike dhe elektronike" të dala jashtë përdorimit në vlerën e mbetur 151,229 lekëkonstatohet se:*

a-Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse e cila duhej të mbikqyrte procesin e asgjësimitnuk ka zhvilluar procedurë ankandi, por ia ka dhënë për riciklim Shoqërisë "[redacted]"sh.p.k Katund i Ri Durrës", subjekt të cilin e kapërzgjedhur si rezultat i kërkimit që ka bërë në QKR për subjektet e licensuara për materiale të riciklueshme,në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik": Dhënia në përdorim/tjetërsimi i aktiveve të panevojshme dhe/ose nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve në pikën 109 të tij citohet: "*Aktivet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira/mbeturina/materiale të riciklueshme, hiqen nga rregjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë (me përjashtim të rasteve kur sipas rregullave të shëndetësisë duhet të asgjësohen), kurse të tjerat asgjësohen nga komisioni i nxjerrjes nga përdorimi duke ndryshuar formën e tyre fillesare, groposur ose djegur"*. Procesverbali i dorëzimit për materialet e riciklueshme nuk është hartuar nga komisionipër nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve dhe nuk përshkruan procedurën e ndjekur të çdo aktivi lidhur me dhënien në përdorimnë kundërshtim me pikën 110 citohet: "*Hartohet nga komisioni për nxjerrjen nga përdorimi në tre kopje, ku përshkruhet proçedura e ndjekur sipas rastit për çdo aktiv lidhur me dhënien në përdorim ose tjetërsimin e tyre, ose nxjerrjen jashtë përdorimit dhe destinacionin përfundimtar të aktiveve, dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit*".Moskryerja e procedurave të ankandit në vlerën e mbetur 151,229 lekë përbën të ardhur të munguar, të paarkëtueshme për buxhetin e institucionit.

b- Zyra e Financës ka kryer veprimin kontabël duke pakësuar aktivin e pasqyrave financiare në vlerë totale për 14,311,967 lekë përkatësisht: llogarinë 218 "Inventar ekonomik" me vlerë fillestare 13,572,907 lekë (nga e cila 40 artikuj mevlerë fillestare 1,398,903 lekë dhe vlerë të mbetur 272,072 lekë janë asgjësuar dhe për 50 artikuj me vlerë fillestare 12,174,004 lekë dhe vlerëtë mbetur 73,702 lekëia ka dhënë për riciklim shoqërisë "[redacted]"sh.p.k) si dhe llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" gjithsej me vlerë fillestare 739,060 lekë dhe vlerë të mbetur 77,527 lekë të cilin ia ka dhënë për riciklim shoqërisë "[redacted]"sh.p.k pa bërë kontrollin dhe verifikimin e dokumentacionit autorizues dhe vërtetues, veprim ky në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik": Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve, pika 35 dhe 36, ku citohet: "*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eleminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimev*".

Inventarizimi i pasurisë për vitin 2019.

Drejtori Rajonal i Tatimeve, z. [redacted], në bazë të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", neni 7 "Inventari i aktiveve dhe detyrimeve" dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar, ka nxjerrë:

1.Urdhër për ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të institucionit me shkresë nr. 10703 prot, datë 26.11.2019,i përbërë me 3 anëtarë ku janë përcaktuar detyrat e komisionit, afatet e përfundimit të inventarizimit për gjendjen fizike.

Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues i dosjes së inventarizimit, konstatohet se:

- Komisioni i inventarizimit përpara fillimit të inventarit nuk ka mbajtur procesverbal me magazinierin, në të cilin fiksohen numri i fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve të bëra gjatë vitit duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", pika 83 "Përgjegjësitë për inventarizimin", ku citohet se: "*Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dyllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material.* Referuar Relacionit nr.10703/1 prot, datë 15.12.2019,komisioni i inventarizimit ka informuar Drejtorin Rajonal dhe Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse mbi përfundimin e procesit të inventarizimit të mjeteve kryesore, materialeve, shtypshkrimeve dhe gjendjes në magazinë deri në datën 31.12.2019. Komisioni ka vlerësuar paraprakisht se janë të papërdorshme nga inventari ekonomik 5 artikuj në vlerë fillestare 6,950,839 lekë, shoqëruar me listën e artikujve,vitin e vënies në punë, vlerën dhe personat që i kanë në ngarkim.

Nga komisioni i inventarizimit në prezencë të personit përgjegjës është bërë verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së aktiveve në ngarkim të personelit (inventarit në përdorim) të institucionit të të gjitha aktiveve, sipas fletë inventarëve nga numri 1-49, datë 31.12.2019.

SipasZyrës së Financës gjendja kontabël e aktiveve të trupëzuara datë 31.12.2019 në total është 112,590,386 lekë, kurse e detajuar paraqitet si më poshtë:

Ndërtesa e konstruksione gjithsej e ndarë:52,539,680 lekë
- Ndërtesa DRT Shkodër 30,470,589 lekë
- Ndërtesa Koplik 10,248,388 lekë
- Ndërtesa Pukë 11,820,703 lekë

Instalime teknike, makineri e pajisje 8,865,498 lekë
Mjete transporti 32,800,514 lekë
Inventar ekonomik në shumën 18,384,694 lekë
Inventar i imët (llog.32) 285,488 lekë
Mallra (dokumentacion tatimor, llog.35) 1,000,682 lekë

Për aktivet e mësipërme, krahasuar me gjendjen fizike nuk rezultojnë diferenca.

- Komisioni i inventarizimit në përfundim të procesit nuk ka mbajtur procesverbal ku të pasqyrojë të dhënat e inventarizimit, krahasimin e gjendjes fizike dhe cilësore të aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit, por rezultatet i ka pasqyruar vetëm në relacionin përmbledhës, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", pika 85 Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për *: "a.Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në proceverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit b.Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë proçesverbalet".*

- Nga strukturat drejtuese të institucionit nuk është vijuar me procesin e vlerësimit të aktiveve të parashikuara të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit dhe se nga nëpunësi autorizuar nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për*

menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ndryshuarsipas pikës 95 Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi ku citohet:*"Është një proçes që kryhet gjatë ose pas proçesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale;* pikës 96 ku citohet "*Proçesi i vlerësimit të aktiveve realizohet nga komisioni i vlerësimit, ndërsa procesi i dhënies në përdorim/tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit kryhet nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi. Këto dy komisione ngrihen me urdhër të titullarit të njësisë publike me propozim të nëpunësit autorizues. Nëpunësi Autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit"*.

- Komisioni i inventarizimit të pasurisë së institucionit të vitit 2019 gjatë inventarizimit të mallrave gjendje në magazinë ka konstatuar se në kasafortën e magazinës ruheheshin mallra ari dhe argjenditë konfiskuara nga inspektorë të Drejtorisësë Hetimit Tatimor për periudhën nga 03.05.2012deri në 31.12.2012, të mbajtura me fletë hyrje vetëm në sasi, të pa dorëzuara në DRRM tëShtetit, për mungesë dokumentacioni shoqërues, si raport analiza fiziko-kimike, të pa vlerësuara me komision të posacëm, të pa kontabilizuara sipas dispozitave ligjore në fuqi, sipas dokumentave të mëposhtme:

1- Procesverbal konfiskimi nr. 0006342,datë 03.05.2012, i mbajtur në subjektin "[redacted]" të cilit i janë sekuestruar 7 copë unaza flori, me peshë 8,2gr. Bashkëlidhur fletë hyrje nr.27, datë 03.05.2012,firmosur nga ish magazinieri z. [redacted].

2- Procesverbal konfiskimi nr.0006251,datë 23.08.2012 në subjektinArgjendari "[redacted]" të cilit i janë sekuestruar 94 copë unaza sermi,me peshë328.98gr. Bashkëlidhur fletëhyrja nr.66, datë23.08.2012 firmosur nga ish magazinieri z. [redacted].

3- Procesverbal konfiskimi nr.0006485, datë 22.08.2012 në subjektin "[redacted]" të cilit i janë sekuestruar mallrat si më poshtë:

- unaza sermi 19 copë,me peshë100.4 gr.
- byzylyk dore 8 copë, me peshë 52.8 gr.
- vathë 5 palë me peshë 15.4 gr.
- 1 orëdore NEVI
- 1 orëdore BENTINI
- 1orëdore KONTAKT

Bashkëlidhur fletëhyrja nr.67, datë24.08.2012 firmosur nga ish magazinieri z. [redacted].

4. Procesverbal konfiskimi nr.0006489, datë19.11.2012 në subjektin "[redacted]"të cilit i janë sekuestruar:

- Flori 14.4 karat 35.4 gr e përbërë nga:
- unaza flori 3 copë 14 karat,
- vathë 4 palë, 14 karat,
- kryq 3 copë, 14 karat,
- varëse 2 copë, 14 karat,
- byzylyk 1 copë 14 karat

Bashkëlidhur fletëhyrja nr.92, datë19.12.2012 firmosur nga ish magazinieri z. [redacted].

5. Procesverbal konfiskimi nr.0006437, datë20.11.2012 në subjektin "[redacted]" të cilit i janë sekuestruar 50 gr ar dhe 303 gr argjend. Bashkëlidhur fletë hyrje nr.93, datë 20.11.2012,firmosur nga ish magazinieri z. [redacted].

I. Me fletë dalje nr. 3, datë 11.04.2013 të DRT Shkodër, janë bërë dalje Drejtorisë së Rezervave të Shtetit Pukë mallrat sipas procesverbalit të datës 11.04.2013 si më poshtë:

- 1orë dore NEVI
- 1orë dore BENTINI
- 1orë dore KONTAKT

➢ Nga zyra e Financës së DRT Shkodër janë paraqitur korrespodencat për këtë qëllim, si më poshtë:

a. Shkresa nr. 1503 prot, datë 26.02.2014 e ish Drejtorit të DRT Shkodër z. [redacted] drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me objekt: Informacion mbi gjendjen e mallrave të konfiskuara dhe ka kërkuar ndihmën për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave. Nga ana e DPT-së nuk rezulton kthim përgjigje.

b. Shkresa nr. 4328 prot, datë04.05.2018e ish Drejtorit të DRT Shkodër z. [redacted] drejtuar Agjensisë Kombëtare të Burimeve Naturore, në të cilën kërkon kryerjen e analizave fiziko- kimike për mallrat prej ari dhe argjendi. Nga ana e AKBN-sëështë kthyer përgjigje me shkresë nr.4732/1 prot, datë 20.06.2018 ku i kërkohet DRTShkodër depozitimi i kampioneve të cituara për kryerjen e analizave përkatëse. Nga DRTShkodër nuk janë dorëzuar kampione të mallrave për kryerjen e analizave nga AKBNdhe si përfundim mallrat të cilat bëjnë pjesë në grupin A të mallrave rezervë materiale shtetërore nuk janë dorëzuar pranë Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit, duke ngarkuar me përgjegjësi ish Titullarin e DRT-së dhe të DPT-së.Pas paraqitjes brenda 12 orësh të procesverbalit të konfiskimit nga grupi i kontrollit, drejtori rajonal brenda 24 orëve duhej të nxirrte vendimin për vlerësimin e këtyre mallrave dhe në rast mospagimi nga ana e tatimpaguesit këto mallra i dorëzoheshin menjëherë Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit sipas nenit 2/pika16 dhe 4/c të ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008 "*Për rezervat materiale të shtetit*"; pikës 2/b të VKM nr 1128, datë 05.08.2008 "*Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë material shtetërore*" dhe sipas përcaktimit në pikën 58.2 të Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008, i ndryshuar "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" 58 Dokumentimi i mallrave, "*Kur gjatë kontrolleve që ushtrohen nga strukturat e autorizuara të administratës tatimore, konstatohet se mungon dokumentacioni i kërkuar ligjor, mbahet proces-verbali përkatës dhe mallrat konfiskohen në përputhje me dispozitat e nenit 121 të Ligjit. .. Për këtë qëllim, grupi i kontrollit i paraqet Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve të juridiksionit ku është kryer shkelja proces-verbalin përkatës brenda 12 orësh nga plotësimi i tij. Drejtori i drejtorisë rajonale, brenda 24 orësh, nxjerr vendimin e vlerësimit në lekë të mallit të konfiskuar. Vlerësimi kryhet nga një komision i përhershëm i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, i përbëre nga jo me pak se 4 punonjës. Për vlerësimin e vleftës se mallrave zbatohen dispozitat e pikës 51.3 të këtij Udhëzimi*" dhe pika 58.4 "*Në qoftë së tatimpaguesi përkatës nuk bën pagesën sipas procedurave dhe afatit të përcaktuar në pikat 58.2 dhe 58.3 të këtij udhëzimi, atëherë mallrat e konfiskuar, në mënyrë të menjëhershme, do t'i kalojnë për administrim Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, e cila do të ndjekë procedurat e mëtejshme*". Për vitin 2018 dhe 2019 nuk ka mallra të konfiskuara pasi në vitin 2017 ka ndryshuar procedura e mallrave të konfiskuara me daljen e Udhëzimit nr. 7, datë 10.01.2017 "Për disa shtesa në udhëzimin nr. 24, datë 2.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar pika 58.2 me këtë në përmbajtje: "*Kur gjatë kontrolleve që ushtrohen nga strukturat e administratës tatimore, konstatohet se mungon dokumentacioni i kërkuar ligjor për dokumentimin e mallit, zbatohen dispozitat e parashikuara në nenin 121 të ligjit dhe pikës 121 të këtij udhëzimi. Kjo procedurë shoqërohet me procesverbalet përkatës. Mallrat e padokumentuara inventarizohen dhe me qëllim dokumentimin e tyre tatimpaguesi detyrohet të*

lëshojë një faturë si faturë nga blerësi sipas nenit 53 të ligjit. Tatimpaguesi i cili në këtë rast konsiderohet se ka kryer shkelje për sa nuk ka dokumentuar mallin me faturë në rolin e shitësit ose nuk ka marrë faturë në rolin e blerësit dhe për pasojë nuk ka paguar TVSH-në përkatëse në blerje, ose nuk ka llogaritur TVSH-në në shitje, dënohet sipas nenit 121 të ligjit".

Komisioni i inventarizimit në Relacionin nr.10703/1 prot, datë 15.12.2019**,** ka informuar Drejtorin Rajonal dhe Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse mbi përfundimin e procesit të inventarizimit të mjeteve kryesore, materialeve, shtypshkrimeve, të gjendjes në magazinë deri në datën 31.12.2019, nga e cila rezultuan mallrat të konfiskuara *nga inspektorë të Drejtorisë së Hetimit Tatimor* për periudhën nga 03.05.2012 deri në 31.12.2012, të mbajtura me fletë hyrje vetëm në sasi, të pa dorëzuara në DRRM të Shtetit, për mungesë dokumentacioni shoqërues, si raport analiza fiziko-kimike, të pa vlerësuara me komision të posacëm, të pakontabilizuara.

Në bazë tëRelacionit nr.10703/1 prot, datë 15.12.2019të komisionit të inventarizimit tëpasurisë për vitin 2019 është nxjerrë Urdhër nr. 11195 prot, datë 15.12.2019 nga Drejtori i DRT Shkodër z. [redacted] është ngritur komisioni i përbërë prej 3 punonjës për kryerjen e verifikimit të çmimeve të tregut për artikujt ar dhe argjend të përdorur.

- Komisioni i ngritur për marrjen e çmimeve të tregut për artikujt ar dhe argjend të përdorur ka mbajtur procesverbal nr. 11195/1 prot, datë 24.12.2019 dhe ka testuar tre oferta ekonomike me nipte dhe ka marrë çmimin mesatar të blerjes për gram, i cili rezulton të jetë: për ar 10 karat çmimi mesatar 1,929 lekë/gram; 14 karat çmimi mesatar 3,142 lekë/gram; argjend çmimi mesatar 44 lekë/gram.
- Në zyrën e financës janë dorëzuar Urdhëri i titullarit dhe procesverbali i testimit të tregut, në bazë të të cilave është plotësuar fletëhyrje nr.50, datë 31.12.2019 për ar në sasi 93.4 gram, argjend në sasi prej 303 gram dhe sermë në sasi prej 497 gram në vlerë totale 282,737.5 lekë. Vlera 282,737.5 lekë është pasqyruar në bilancin kontabël të vitit 2019 në llogarinë ekonomike 31 "Materiale".

Konkluzion mbi inventarizimin e pasurisë së institucionit për vitin 2019:

- Komisioni i inventarizimit përpara fillimit të inventarit nuk ka mbajtur procesverbal me magazinierin, në të cilin fiksohen numri i fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve të bëra gjatë vitit duke vepruar në kundërshtim me përcaktimetnë Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*"i ndryshuar, pika 83 "Përgjegjësitë për inventarizimin".
- Komisioni i inventarizimit në përfundim të procesit nuk ka mbajtur procesverbal ku të pasqyrojë të dhënat e inventarizimit, krahasimin e gjendjes fizike dhe cilësore të aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit, por rezultatet i ka pasqyruar vetëm në relacionin përmbledhës, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 85, 96 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*"i ndryshuar.
- Nga nëpunësi autorizues nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 95, 96 të Udhëzimittë Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar.
- Mallrat e konfiskuara në vitin 2012 të cilat janë prodhime ari dhe argjendi dhe bëjnë pjesë në grupin A të mallrave rezervë materiale shtetërore nuk janë dorëzuar pranë Drejtorisë së Rezervave Rajonale Materiale të Shtetit sipas përcaktimeve të nenit 2 /16 dhe 4/c të ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit"; pikës 2/b të VKM nr 1128, datë 05.08.2008 "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë material shtetërore" dhe pikës 58.2, 58.4 të Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008, i ndryshuar "*Për procedurat tatimore në*

Republikën e Shqipërisë" 58 Dokumentimi i mallrave, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi ish titullarët e institucionit të DPT-së dhe DRT Shkodër.
Këto mallra edhe pse kanë qenë në ruajtje nuk janë pasqyruar në inventarët e viteve të mëparshëm, duke mos pasqyruar realisht gjendjen fizike tëaktiveve në institucion dhe duke mos vepruar që prej vitit 2012, sipas dispozitave ligjore për mallrat e konfiskuara, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi ish titullarët e DRTShkodër, ish Drejtor i DRT z. [redacted] (për periudhën 11.05.2012-20.01.2014), ish Drejtor i DRT z. [redacted] (për periudhën 20.01.2014-08.07.2014), Drejtorin e DRT z. [redacted] (për periudhën 16.07.2019 e në vazhdim), Drejtoren e Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse, znj. [redacted], veprime që bien ndesh me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" pika 49 ku citohet: "*Aktivet e marra në ruajtje dokumentohen menjëherë me fletëhyrjen që përmban shënimin "vlera në ruajtje*"; pika 60 ku citohet: "*Bëhet regjistrimi i dokumentave në librat e kontabilitetit dhe kartelat e aktiveve, jo më vonë se dita e nesërme e paraqitjes së tyre. Në dokument shënohet numri i faqes së librit dhe si fraksion numri rendor që ka marrë regjistrimi i kryer. Në fund të çdo muaji dokumentat e regjistruar vendosen në dosjen përkatëse*".
(Konfiskimi i mallrave është trajtuar edhe në pikën III/3.Vlerësimi i evidentimit, saktësisë së llogaritjes së ndryshimeve në aktivet (e trupezuara dhe qarkulluese)të institucionit, pasqyrimi i tyre në pasqyrat financiare nëpërputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e:
-Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".
-Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"i ndryshuar.
-Udhëzimit nr. 24, datë 07.12.2016, Për një ndryshim në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
-Neni 2/16 dhe 4/c i ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit" dhe pikës 2/b të VKM nr 1128, datë 05.08.2008 "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore".

Titulli i Gjetjes: **Parregullsi mbi zbatimin e procedurave ligjore të kryerjes së inventarizimit të pasurisë së institucionit për vitin 2018, 2019.**

Situata 1:

- Nga auditimi i dokumentacionit të inventarizimit, rezultoi se **për vitin 2018** komisioni i inventarizimit para fillimit të inventarizimit nuk ka mbajtur procesverbal me përgjegjësin material në kundërshtim me përcaktimet e pikës 83 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*"i ndryshuar.

- Komisioni ka vlerësuar paraprakisht se janë të papërdorshme nga inventari ekonomik 4 artikuj në vlerë fillestare 6,737,839 lekë. Komisioni i inventarizimit nuk ka mbajtur procesverbal, por rezultatet i ka pasqyruar vetëm në relacionin përmbledhës, i cili nuk është i miratuar nga titullari i institucionit duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 85 të

Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", i ndryshuar.

-Nga nëpunësi autorizues nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 95, 96 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

- Në vitin 2018 strukturat drejtuese të DRT-së, kanë vijuar procedurat për asgjësimin/tjetërsimin e aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit të mallrave të evidentuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit të vitit 2017. Referuar relacionit vlerësues datë 31.12.2017mbi realizimin e procesit të vlerësimit të aktiveve të propozuara jashtë përdorimit, janë vlerësuar për jashtë përdorimit:

-Inventar ekonomik nga llog.ek. "218" për 90 artikuj në vlerë fillestare 13,572,907 lekë, amortizimi i akumuluar 13,227,188 lekë dhe vlerë të mbetur 345,719 lekë.

-Instalime teknike, makineri e pajisje" nga llog.ek. 214 gjithsej 4 artikuj në vlerë fillestare 739,060 lekë, amortizimi i akumuluar 661,533 lekë dhe vlerë të mbetur 77,527 lekë.

- Nga komisioni i vlerësimit të aktiveve nuk është bërë vlerësimi i secilit aktiv si dhe nuk është hartuar procesverbali i vlerësimit, por është vijuar me hartimin e relacionit përmbledhës, në kundërshtim me pikat 95,104,105 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar.
- Komisioni i asgjësimit/tjetërsimit të aktiveve:

- ka asgjësuar inventar ekonomik për 40 artikuj me vlerë fillestare 1,398,903 lekë dhe vlerë të mbetur 272,017 lekë.

-ka vendosur të mos asgjësojë gjithsej 54 artikuj me vlerë fillestare 12,913,064 lekë dhe vlerë të mbetur 151,229 lekë, që janë objekt i VKM-së nr. 957 datë 19.12.2018 "*Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike*" dhe për të cilat cilëson që të vazhdohen procedurat e mëtejshme sipas legjislacionit nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse.

- Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse e cila duhej të mbikqyrte procesin e asgjësimit nuk ka zhvilluar procedurë ankandi, por ia ka dhënë për riciklim Shoqërisë "[redacted]" sh.p.k Katund i Ri Durrës, në kundërshtim me përcaktimet në pikën 109 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, i ndryshuar. Moskryerja e procedurave të ankandit në vlerën e mbetur 151,229 lekë përbën të ardhur të munguar, të paarkëtueshme për buxhetin e institucionit.
- Zyra e Financës ka kryer veprimin kontabël duke pakësuar aktivin e pasqyrave financiare në vlerë totale për 14,311,967 lekë përkatësisht llogarinë 218 "Inventar ekonomik" me vlerë fillestare 13,572,907 lekë dhe llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" gjithsej me vlerë fillestare 739,060 lekë referuar vetëm fletë daljes së magazinës, pa bërë

kontrollin dhe verifikimin e dokumentacionit autorizues dhe vërtetues, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 35,36 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar.

Situata 2:

- Nga auditimi i dokumentacionit të inventarizimit, rezultoi se **për vitin 2019** komisioni i inventarizimit para fillimit të inventarizimit nuk ka mbajtur procesverbal me përgjegjësin material në kundërshtim me përcaktimet e pikës 83 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar.

- Komisioni ka vlerësuar paraprakisht se janë të papërdorshme nga inventari ekonomik 5 artikuj në vlerë fillestare 6,950,839 lekë. Komisioni i inventarizimit nuk ka mbajtur procesverbal, por rezultatet i ka pasqyruar vetëm në relacionin përmbledhës, i cili nuk është i miratuar nga titullari i institucionit duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në pikën 85 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", i ndryshuar.

-Nga nëpunësi autorizues nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 95, 96 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

Kriteri: Udhëzimii Ministrisë së Financave nr. 30, datë 26.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Efekti: Institucioni përballet me riskun e mosmenaxhimit dhe keq përdorimit të aktiveve, duke mos vërtetuar cilësinë dhe gjendjen fizike të aktiveve në kohën e duhur.

Shkaku: Mos zbatimi i VKM nr 1128, datë 05.08.2008 "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore";Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008, i ndryshuar "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimi të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 26.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar në lidhje me administrimine mallrave të konfiskuara dhe me procesin inventarizimit të aktiveve deri në përfundimin e plotë të tij.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: 1.NA dhe NZ të marrin masat, për realizimin dhe monitorimin e procesit të inventarizimit të pasurisë së institucionit në të gjitha fazat si dhe të garantojnë pasqyrimin e saktë të gjendjes së aktiveve të institucionit në pasqyrat financiare vjetore.

2.NA në zbatim të menaxhimit financiar dhe kontrollit të marrë masat për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të një sistemi rregullash dhe procedurash të brendshme në lidhje me dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve të njësisë me qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi, keqpërdorimi dhe në çdo rast procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit të mbikqyren dhe konfirmohen nga strukturat e DPT-së.

3. Titullari i institucionit të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjesitë për moszbatimin e procedurës së ankandit për aktivet e vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimitnga komisioni i asgjësimit/tjetërsimit të aktiveve, moszbatimi i së cilës ka sjellë të ardhura të munguara, të paarkëtueshme për buxhetin e institucionit të vitit 2018, në shumën 151,229 lekë.

IV/4. ***Zbatimi i dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit me vlera të vogla, që nga planifikimi i nevojave, prokurimi marrja në dorëzim dhe zbatimi i kontratave për punime/mallra/shërbime nga Autoriteti Kontraktor; rregullshmëria e kryerjes së shpenzimeve të tjera, përvec shpenzimeve të cituara në pikën 2 të programit, si dhe saktësia e paraqitjes së tyre në pasqyrat financiare vjetore.***

Në zbatim të pikës 4, për periudhën objekt auditimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
-Regjistri i parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike.
-Dokumentacioni shoqërues, justifikues mbi kryerjen e prokurimeve.

Auditimi u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:
-Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar.
-Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".
-Ligji nr.110/2015, datë 15.10.2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".
-VKM nr.914, datë 19.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
-Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
-Udhëzimi nr.20 datë 17.11.2014 "Për një ndryshim në udhëzimin nr.30", datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
-Udhëzimi nr.24, datë 07.12.2016, Për një ndryshim në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
-Urdhërin Nr.33, datë 11.07.2013, "Për Gjurmët Standarde të Auditit për Prokurimin me Vlerë të Vogël dhe të Lartë", të Ministrisë së Financave.
-Udhëzimi nr.3, datë 8.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar.
-Udhëzime dhe manuale të APP-së.
-Rregullore e DRT.

<u>Për vitin 2018</u>.
Me shkresë nr.19659/5 prot, datë 31.01.2018 të DPT-së janë dërguar limitet mujore të shpenzimeve korente për DRT Shkodër.
Shpenzimet korente në vlerën 145,000,000 lekë për Drejtorinë Rajonale të Tatimeve (DRT) Shkodër të ndara me artikuj janë:
"Paga e shtesa",artikulli600 në vlerë 120,000,000 lekë.
"Sigurime shoqërore", artikulli 601 në vlerë 20,000,000lekë.

"Blerje mallra e shërbime", artikulli 602 në vlerë 5,000,000 lekë.
Gjatë vitit buxhetor 2018, janë kryer transferime dherialokime fondesh në artikullin 602, me një shtesë prej 3**,**500,000 lekë.
Në mënyrë analitike trendi i viteve 2017 dhe 2018 për art.602"Blerje mallra e shërbime", paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.43
Në lekë

Art	Zërat e shpenzimeve	Viti 2018				Diferenca me planin			Diferenca Fakt 2018-2017	
		Fakti 2017	Plani fillestar	Ndryshuar	Plani i ndryshuar	Fakti 2018	Në vlerë	Në %	Në vlerë	Në %
602	**Mallra dhe sherbime te tjera**	**5,660,739**	**5,000,000**	**3,500,000**	**8,500,000**	**8,249,506**	**(250,494)**	**-2,95**	**2,588,767**	**45.7**
6020	Materiale zyre etj,përgjithshme	24,464			117,000	116,110	-890	-0,76	91,646	47.4
6022	Shërbime nga te tretë	2,162,946			2,570,000	2,418,421	-151,579	-5,9	255,475	11.8
6023	Shpenzimetransporti	537,229			670,000	675,462	5,462	0,82	138,233	25.7
6024	Udhëtim i brendshëm	2,418,920			4,808,000	4,709,950	-98,050	-2	2,291,030	94.7
6025	Mirmbajtjetëzakonshme	486,680			200,000	199,873	-127	-0,04	(286,807)	-59
6029	Shpenzimetëtjera operative	30,500			135,000	129,690	-5,310	-3,9	99,190	42.5

Burimi: Të dhënat nga Zyra e Financës së Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse dhe përpunuar nga grupi i auditimit.

Duke e krahasuar me vitin 2017rezulton se, për vitin 2018 shpenzimet për art.602 "Blerje mallrash e shërbimesh" janë rritur në shumën 2,588,767 lekëose rritur 45,7% e cila vjen si rezultat rialokimit të fondeve për shpenzime udhëtim e dietë të punonjësvetë hetimit tatimor.
-Materiale zyre etj,përgjithshme (materiale pastrimi dhe shërbimi zyre) rezultojnë më shumë se viti 2017 për 91,646 lekë, ose rriturme 47.4%.
-Shërbime nga të tretë rezultojnë më shumë se viti 2017 për 255,475 lekë, ose rritur 11.8%.Në këtë grup shpenzimesh 49,9% e zënë shpenzimet për energji elektrike dhe 37,4% e zënë shpenzimet postare. Shpenzimet postare për vitin 2018 rezultojnë në shumën 899,445 lekë dhe krahasuar me vitin 2017 janë rritur në shumën 350,315 lekë ose 63.7%. Këto shpenzime justifikohen me dërgesat postare prej zyrëssë protokollit të institucionit subjekteve debitorepasi vetëm një subjekti debitor i dërgohen rreth 30 zarfe si njoftim, urdhër bllokime drejtuar zyrës hipotekës dhe 12 degëve bankare të nivelit të dytë e në rast pagese edhe 12 urdhër zhbllokimesi: njoftim vlerësimi, kërkesa për shlyerje detyrimesh, akt konstatime, gjoba, tëcilat hartohen nga Drejtoria e Borxhit,e Kontrollit, e Shërbimit, e Hetimit, e Finanacës si dhe shkresa të brendshme të institucionit.
-Shpenzime transporti, rezultojnë më shumë se viti 2017 për 138,233 lekë, ose rriturme 25.7%.
-Shpenzime udhëtimi, rezultojnë më shumë se viti 2017 për 2,291,030 lekë, ose rritur me94.7%, që i përkasin Drejtorisë së Hetimit dhe trajtuar më vete në këtë raport auditimi.
-Shpenzime të tjera operative, rezultojnë më shumë se viti 2017 për 99,190lekë, ose rritur me 42,5%.
Ndërsa për vitin 2018, krahasuar me një vit më parë këto zëra shpenzimesh operative rezultojnëmë pak për zërin:
-Mirëmbajtje të zakonshme zyre, rezultojnë më pak se viti 2017 për 286,807 lekë, ose pakësuar me 59 %.
Për vitin 2019.
Me shkresë nr.23016/3 prot, datë 14.02.2019 të DPT-së janë dërguar limitet mujore të shpenzimeve korente për DRT Shkodër.

Shpenzimet korente në vlerën 124,500,000 lekë për Drejtorinë Rajonale të Tatimeve (DRT) Shkodër të ndara me artikuj janë:

"Paga e shtesa", artikulli 600 në vlerë 100,000,000 lekë.
"Sigurime shoqërore", artikulli 601 në vlerë 18,000,000 lekë.
"Blerje mallra e shërbime", artikulli 602 në vlerë 3,500,000 lekë.
"Blerje mallra e shërbime", artikulli 602 në vlerë 3,000,000 lekë.

Gjatë vitit buxhetor 2019, nuk janëkryer transferime dherialokime fondesh për artikullin 602"Blerje mallra e shërbime".

Në mënyrë analitike trendi i viteve 2018 dhe 2019 për art.602"Blerje mallra e shërbime" paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.44

Në lekë

Art	Zërat e shpenzimeve	Viti 2019				Diferenca me planin			Diferenca Fakt 2019-2018	
		Fakti 2018	Plani fillestar	Ndryshuar	Plani i ndryshuar	Fakti 2019	Në vlerë	Në %	Në vlerë	Në %
602	**Mallra dhe shërbime të tjera**	**8,249,506**	**6,500,000**		**6,500,000**	**5,411,032**	**(1,089,968)**	**-16,7**	(2,838,474)	-34,4
6020	Materiale zyre etj,përgjithshme	116,110			56,000	25,860	(30,140)	-53,8	(90,430)	-77,7
6022	Shërbime nga te tretë	2,418,421			2,380,000	2,375,151	(4,849)	-0,2	(43,270)	-1,8
6023	Shpenzimetransporti	675,462			755,000	657,803	(97,197)	-12,8	(17,659)	-2,6
6024	Udhëtim i bredshëm	4,709,950			3,024,000	2,080,700	(943,300)	-31	(2,629,150)	-55,8
6025	Mirmbajtjetëzakonshme	199,873			200,000	197,880	(2,120)	-1,06	(1,993)	-1
6029	Shpenzimetëtjera operative(taksa)	129,690			85,000	73,638	(11,362)	-13,37	(56,052)	-43,2

Burimi: Të dhënat nga Zyra e Financës së Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse dhe përpunuar nga grupi i auditimit.

Duke krahasuar me vitin 2018 rezulton se, për vitin 2019 shpenzimet për art.602 "Blerje mallrash e shërbimesh" janëpakësuarnë shumën 2,838,474 lekë ose -34.4% e cila vjen si rezultat pakësimit të shpenzimeve për udhëtim e dietë të punonjësvetë hetimit tatimor.

-Materiale zyre etj, përgjithshme(materiale pastrimi dhe shërbimi zyre),rezultojnë më pak se viti 2018 në shumën 90,430 lekë, ose pakësuar në masën 77,7%.

-Shërbime nga të tretë rezultojnë më pak se viti 2018 për 43,270 lekë ose -1,8%. Në këtë grup shpenzimesh 50.7% e zënë shpenzimet për energji elektrike dhe 35,9% e zënë shpenzimet postare. Shpenzimet postare për vitin 2019 rezultojnë në shumën 852,695 lekë dhe krahasuar me vitin 2018 janë rritur në shumën 46,750 lekë ose 5%. Këto shpenzime justifikohen me dërgesat postare prej zyrëssë protokollit të institucionit subjekteve debitorepasi vetëm një subjekti debitor i dërgohen rreth 30 zarfe si njoftim, urdhër bllokime drejtuar zyrës hipotekës dhe 12 degëve bankare të nivelit të dytë e në rast pagese edhe 12 urdhër zhbllokimesi: njoftim vlerësimi, kërkesa për shlyerje detyrimesh, akt konstatime, gjoba, tëcilat hartohen nga Drejtoria e Borxhit,e Kontrollit, e Shërbimit, e Hetimit, e Finanacës si dhe shkresa të brendshme të institucionit.

-Shpenzime transporti, rezultojnë më pak se viti 2018 për 17,659 lekë, ose -2,6%.

-Shpenzime udhëtimi, rezultojnë më pak se viti 2018 për 2,629,150lekë, ose -55,8% , që i përkasin Drejtorisë së Hetimit.

-Mirëmbajtje të zakonshme zyre, rezultojnë më pak se viti 2017 për 1,993lekë, ose -1 %.

-Shpenzime të tjera operative, rezultojnë më pak se viti 2018 për 56,052 lekë, ose -43,2%.

- ***Auditimi me zgjedhje i dokumentacionit, lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit me vlera të vogla, që nga planifikimi i nevojave,***

prokurimi marrja në dorëzim dhe zbatimi i kontratave për punime/mallra/shërbime nga Autoriteti Kontraktor.

Auditimi është fokusuar në drejtim të:
-Parashikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut.
-Argumentimi ligjor i procedurave të prokurimit që ka zgjedhur enti prokurues. Realizimi i parimeve themelore të prokurimit publik, si transparenca, nxitja e konkurrencës, barazia e kandidatëve dhe përdorimi ekonomik dhe efektiv i fondeve publike.
-Zbatimi i procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit të prokurimit deri në shpalljen e fituesit.
-Kërkesat nga degët dhe programimi i nevojave për punë, mallra dhe shërbime.
-Regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve të hartuara nga Autoriteti Kontraktor.
-Arsyet mbi domosdoshmërinë e kryerjes së prokurimit dhe si ka ndikuar në vazhdimin e punës ky mosrealizim.
-Respektimi i afateve nga paraqitja e regjistrit deri në marrjen në dorëzim të mallrave/shërbimeve.
-Komisionet e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve.
-Auditim i procedurave të blerjeve me vlera të vogla për të evidentuar mundësinë nëse ka devijime nga programimi ose copëzim fondi për mosrealizim procedure tenderimi.

Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse përbëhet nga 3 sektorë dhe 9 punonjës, Zyra e Financës, Zyra e Administratës, Zyra Juridike.
Zyra e Financës përbëhet nga 2 punonjës, Zyra e Administratës Sektori i Administratës përbëhet nga 5 punonjës dhe Zyra Juridike përbëhet nga 1 punonjës. Sipas strukturës së miratuar Zyra Juridike përbëhet nga 2 punonjës prej të cilit një pozicion pune është i paplotësuar duke sjellë ngarkesë në funksionimin dhe realizimin e detyrave.
Bazuar në rregulloren e brendshme Nr.1482/2, datë 22.02.2017 "Për miratimin e Rregullores së Brendshme "Për funksionimin e administratës tatimore qendrore" objekti i punës së Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse është menaxhimi efikas dhe transparent të burimeve që financojnë veprimtarinë e DRT në zbatim të ligjit të buxhetit dhe ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, zbatimin e sistemeve të kontrollit për përdorimin e financimit buxhetor vjetor nga DRT si dhe mbështet nëpunësit autorizues të institucionit në vendimarrje duke i përcjellë informacion në lidhje me kostot në financimin buxhetor. Të tre sektorët në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë bashkërenduar punën për përdorimin sa më me efektivitet të buxhetit vjetor, të vënë në dispozicion të administratës, në përputhje me Ligjin e Buxhetit dhe Udhëzimet e Ministrit të Financave.

- **<u>Për vitin 2018</u>** nga strukturat e DRT-së Shkodër është hartuar rregjistri i parashikimit të prokurimeve publike për punë/mallra/shërbime në <u>15 raste në vlerën 4,166,667</u> lekë pa tvsh me burim financimi "Buxheti i shtetit", në art. 602 "Shpenzime operative" i cili është dërguar në DPT me shkresë nr. 600, datë 19.01.2018. DPT me shkresë nr.1959/1 datë 30.01.2018 ka miratuar rregjistrine parashikimit tëDRT-së Shkodër.

Në rregjistër janë të përcaktuara objekti i prokurimit, fondi limit i përgjithshëm, procedura e prokurimit, koha e zhvillimit dhe burimet financiare, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar dhe VKM nr.419, datë 29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe Udhëzimeve të APP-së.

Gjatë vitit 2018konstatohen ndryshime të vazhdueshme të regjistrit të parashikimit të prokurimeve (10) dhe nuk ka në asnjë rast argumentim të ndryshimeve, veprim në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 4/4, ku citohet: *"Autoriteti kontraktor ka të drejtë të bëjë ndryshime në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit, vetëm në raste të justifikuara". Konkretisht* janë bërë ndryshime në rregjistrin e parashikimit të prokurimeve publike, në shumën 2,916,667 lekë, sipas nevojave për grup shpenzimesh, përkatësisht sipas shkresave zyrtare të miratuara nga DPT si më poshtë:

Tabela nr.45

Në lekë

Nr	Objekti i prokurimit	Fondi përllogaritur ishte	Fondi përllogaritur bëhet	Ndryshimet	Shkresë, Nr. Datë e DPT-së.
1	Shpenzime për energji	1,083,333	1,250,000	+166,667	1959/12 01.06.2018
2	Shpenzime për postë	500,000	750,000	+250,000	1959/12 01.06.2018
3	Shpenzime udhëtimi dieta	1,369,167	2,619,167	+1,250,000	1959/12, 01.06.2018
4	Shpenzimesiguracion automjeteve	216,667	266,667	+50,000	1859/36, 24.10.2018
5	Shpenzime për energji	1,166,667	1,166,666	-50,000	1859/36, 24.10.2018
6	Shpenzime për energji	1,250,000	1,166,667	-83,333	1959/13, 14.11.2018
7	Shërbime telefonike	250,000	233,333	-16,667	1959/13, 14.11.2018
8	Shpenzime udhëtimi diete	2,619,167	3,869,167	+1,387,500	1959/13, 14.11.2018
9	Shpenzime taksa të paguara	83,333	70,833	-12,500	1959/13, 14.11.2018
10	Shpenzime gjyqësore	25,000	0	-25,000	1959/13, 14.11.2018
	Shuma			**2,916,667**	

Burimi: Të dhënat nga Zyra e Financës së Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse dhe përpunuar nga grupi i auditimit.

Pra, siç vërehet nga tabela e modifikimit të shpenzimeve të planifikuara në rregjistrin e parashikimeve të prokurimit publik zëri shpenzime për udhëtim e dieta zë 81% të totalit të shpenzimeve të ndryshuara dhe zëri shpenzimet postare zënë 15% të totalit të shpenzimeve të ndryshuara.

- DRT Shkodër për realizimin e procedurave të blerjeve me vlerë të vogël për gjatë vitit 2018 ka nxjerë urdhërin nr.1, datë 05.02.2018 "Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël" të përbërë nga tre persona, nga të cilët një punonjës në cilësinë e kryetarit të komisionit dhe dy punonjës në cilësinë e anëtarëve të komisionit.
- Janë hartuar dhe dërguar rregjistri i realizimit të prokurimeve publike çdo 4/mujor në përputhje me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe të nenit 7 "Realizimi i procedurave të prokurimit" pika 2, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar përkatësisht me shkresë nr. 4288 prot, datë 07.05.2018, shkresë nr.8270 prot, datë 04.09.2018 dhe shkresë nr.229 prot, datë 10.01.2019.
- Nëçdo procedurë blerje plotësohen deklaratat e konfliktit të interesit nga secili anëtar i komisionit të prokurimit.
- Autoriteti Kontraktor ka realizuar në total 14 raste në shumën 8,249,506 lekë nga 15 raste në shumën8,500,000 lekë qëështë plani i ndryshuar. Konkretisht:

- ka realizuar 8 raste nga 8 të programuara për blerje me vlerë të vogël në shumën 940,012 lekë me tvsh,(nga të cilat 8 procedura prokurimi për mallra/shërbime në vlerën 296,064 lekë;3 procedura prokurimi në vlerën 224,475lekë për siguracionine mjeteve të transportit; 3 procedura prokurimi në kufirin deri në 100,000 lekë pa tvsh në vlerën 365,973 lekë; 6 procedura prokurimi

në vlerën 53,500 lekëme rastetë emergjencës)*si dhe shpenzimet operative (energji, ujë, postë, telefon dhe taksë vendore, udhëtime të brendshme e dieta) në shumën 7,309,494 lekë me tvsh.*
DRT Shkodër me shkresë nr. 600 prot, datë 19.01.2018 ka dërguar në DPT dhe me shkresë nr. 1369 prot, datë 07.02.2018 ka depozitur në Degën e Thesarit Shkodër regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike të vitit 2018, pra ka hartuar dhe dërguar me vonesë(9/28 ditë me vonesë),në kundërshtim me VKM 914 neni 4 pika 1 ku citohet: "*Në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime, autoriteti kontraktor është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së. Ky regjistër duhet të përgatitet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga miratimi i ligjit për buxhetin.Një kopje e regjistrit të parashikimeve pas publikimit nga APP-ja duhet të dërgohet në degën e thesarit dhe në institucionin qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë*".

- **Për vitin 2019** Nga strukturat e DRT-së Shkodër është hartuar regjistri i parashikimit të prokurimeve publike për punë/mallra/shërbime në 12 raste në vlerën 5,416,666 lekë pa tvsh me burim financimi "Buxheti i shtetit, në art.602 "Shpenzime operative" i cili është dërguar në DPT me shkresë nr.792 prot, datë 28.01.2019. DPT me shkresë nr.5265/2 prot, datë 11.03.2019 ka miratuarregjistrin e parashikimit DRT-së Shkodër. Në rregjistër janë të përcaktuara objekti i prokurimit, fondi limit i përgjithshëm, procedura e prokurimit, koha e zhvillimit dhe burimet financiare, në përputhje me Ligjin nr.9643,datë20.11.2006"Për prokurimin publik",i ndryshuar, të VKM-së nr.914, datë29.12.2014"Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar dhe udhëzimeve të APP-së.
- Gjatë vitit 2019 nuk është bërë asnjë ndryshim në rregjistrin e parashikimit të prokurimeve publike.
- Titullari i DRT Shkodër ka nxjerrë Urdhëri nr.3, datë 12.02.2019 "Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël" për vitin 2019, të përbërë nga tre persona, nga të cilët një punonjës në cilësinë e kryetarit të komisionit dhe dy punonjës në cilësinë e anëtarëve të komisionit.
- Janë hartuar dhe dërguar rregjistri i realizimit të prokurimeve publike cdo 4/mujor në përputhje me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe të nenit 7 "Realizimi i procedurave të prokurimit" pika 2, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar përkatësisht me shkresë nr. 4085 prot, darë 10.05.2019 shkresë nr.8010 prot, datë 11.09.2019 dhe shkresë nr.166 prot, datë 09.01.2020, pra paraqitur brenda afateve kohore.
- Në cdo procedurë blerje plotësohen deklaratat e konfliktit të interesit nga secili anëtar i komisionit të prokurimit.
- Autoriteti Kontraktor ka realizuar në total 11 raste në shumën 5,411,032 lekë me tvsh nga 12 raste në shumën6,500,000 lekë që është plani i ndryshuar. Konkretisht:

- ka realizuar 5 raste nga 5 të programuara për blerje me vlerë të vogël në shumën 784,756 lekë me tvsh (nga të cilat 5 procedura prokurimi për mallra/shërbime në vlerën 192,000 lekë; 3 procedura prokurimi në vlerën 223,746 lekë për siguracionin e mjeteve të transportit; 3 procedura prokurimi në kufirin deri në 100,000 lekë pa tvsh në vlerën 223,740 lekë; 3 procedura prokurimi në vlerën 145,270 lekë me raste të emergjencës) *dhe shpenzimet operative (energji, ujë, postë, telefon dhe taksë vendore, udhëtime të brendshme e dieta) në shumën 4,626,276 lekë me tvsh.*

- DRT Shkodër me shkresë nr. 792 prot, datë 28.01.2019 ka dërguar në DPT dhe me shkresë nr.229/1 prot, datë18.02.2019 ka depozitur në Degën e Thesarit Shkodër regjistrin e

parashikimit të prokurimeve publike të vitit 2018, pra ka hartuar dhe dërguar me vonesë (18/39 ditë me vonesë), në kundërshtim me VKM 914 neni 4 pika 1 ku citohet: "*Në bazë të kërkesave për punë, mallra ose shërbime, autoriteti kontraktor është përgjegjës për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për procedurat e prokurimit publik, në përputhje me formën dhe mënyrën e parashikuar në udhëzimet e APP-së. Ky regjistër duhet të përgatitet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga miratimi i ligjit për buxhetin. Një kopje e regjistrit të parashikimeve pas publikimit nga APP-ja duhet të dërgohet në degën e thesarit dhe në institucionin qendror që vë në dispozicion fondet buxhetore, në rastin kur ka një të tillë*".

Titullii Gjetjes	**Shkelje e afateve kohore të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik në hartimin dhe dorëzimin eregjistrit të parashikimit të prokurimit publik.**
Situata:	➢ Gjatë vitit 2018 konstatohen ndryshime të vazhdueshme të regjistrit të parashikimit të prokurimeve (10) dhe nuk ka në asnjë rast argumentim të ndryshimeve, veprim në kundërshtim me nenin 4/4 tëVKM-së nr.914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. Shuma e ndryshimeve të bëra gjatë vitit është 2,916,667 lekë, si rrjedhim në total shpenzimet për mallra/shërbime sipas planit të ndryshuar janë 8,500,000 lekë dhe janërealizuar në shumën 8,249,506 lekë ose më pak nga plani i ndryshuar në shumën 250,494 lekë. ➢ DRT Shkodër me shkresë nr. 600 prot, datë 19.01.2018 ka dërguar në DPT dhe me shkresë nr. 1369 prot, datë 07.02.2018 ka depozitur në Degën e Thesarit Shkodër regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike të vitit 2018, pra ka hartuar dhe dërguar me vonesë (9/28 ditë me vonesë), në kundërshtim nenin 4 pika 1 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar. ➢ Në vitin 2019DRT Shkodër me shkresë nr. 792 prot, datë 28.01.2019 ka dërguar në DPT dhe me shkresë nr.229/1 prot, datë 08.02.2019 ka depozitur në Degën e Thesarit Shkodër regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike të vitit 2018, pra ka hartuar dhe dërguar me vonesë (18/39 ditë me vonesë), në kundërshtim me nenin 4 pika 1 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
Kriteri:	VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.
Efekti:	Moszbatimi i rregullave të prokurimit publik ka sjellë shkeljen e afateve kohore të hartimit, dorëzimit tëregjistrit të parashikimit të prokurimit publik**.**
Shkaku:	Moszbatimi i rregullave të prokurimit publik.
Rëndësia:	I mesëm.
Rekomandimi:	Drejtoria e Funksimeve Mbështetëse, të hartojë regjistrin e parashikimit të procedurave të prokurimit publik për punë/mallra/shërbime në bazë të kërkesave të mirë studiuara, të argumentojë çdo rast të ndryshuar si dhe dhe të respektojë afatet kohore të hartimit dhe dorëzimit të tij sipas rregullave të prokurimit publik.

➢ Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues, justifikues i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për periudhën e audituar, konstatohet se nga 34 procedura prokurimi të realizuara në shumën 1,724,768 lekë, janë realizuar në kushtet jo korekte të zbatimit të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, **gjithsej 30 procedura prokurimi në shumën 1,195,437 lekëose 69% e shumës gjithsej të procedurave të realizuara,** të detajuara si më poshtë:

-19 procedura prokurimi në shumën 634,427 lekëose 67% e shumës gjithsej të procedurave të realizuara nga 20 procedura prokurimi të realizuara në shumën 940,012lekë, në vitin 2018.

-11 procedura prokurimi në shumën 561,010 lekëose 71% e shumës gjithsej të procedurave të realizuaranga 14 procedura prokurimi të realizuara në shumën 784,756 lekë në vitin 2019.Konkretisht, të grupuara sipas problematikave:

➢ ***Gjithsej 11 procedura prokurimi në shumën 589,713 lekë të detajuara*: Në vitin 2018 për 8 procedura prokurimi në shumën 365,973 lekë dhe në vitin 2019 për 3 procedura prokurimi në shumën 223,740 lekë,**për tëcilat konstatohen:

a) Parregullsi në planifikimin e nevojave nga sektorët për mallra, punë dhe shërbime.

Kërkesat për mallra/punë/shërbime nuk janë hartuar nga degët përkatëse, por nga Drejtori i Funksioneve Mbështetëse i cili është edhe nëpunës zbatues i institucionit dhe nga Drejtori i Hetimit Tatimor të DRT-së për nevojat për pjesë këmbimi e riparim automjetesh, në kundërshtim me VKM-në nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*"nenin 40 pika 1ku citohet: "*Autoriteti kontraktor planifikon natyrën, sasitë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi. Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup – mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure*"si dhe pika 3"*Kur lind nevoja për punë, mallra ose shërbime, titullari i autoritetit kontraktor ose një zyrtar tjetër i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit ku përcaktohen objekti i prokurimit dhe sasia e tyre*".Pergatitja, aprovimi i pagesave dhe regjistrimi i tyre kryhen nga funksione te ndryshme

b) Mungesëe procesverbaleve të testimit të tregut dhe të argumentimit e dokumentimit në përllogaritjen e fondit limit. Komisioni i prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël ka funksionuar edhe si komision i testimit të tregut, por në shumicën e rasteve nuk janë përcaktuar çmimet për njësi apo sipas sipas zërave që do të prokurohen dhe nuk është përcaktuar nëse vlera e ofertave ekonomikejanë me/pa tvshnë kundërshtim menenin59 të VKM-së nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, *nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posacme. Në rastet kur, në përllogaritjen e fondit limit përdoret metoda e testimit të tregut, nuk është e domosdoshme të administrohen ofertat e marra në kuadër të këtij pricesi, por vetëm treguesit e cmimeve, të cilat dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël.*

c) Komisioni i prokurimit të blerjeve të vogla ka funksionuar dhe ka luajtur rolin edhe të komisionit të marrjes në dorëzim të mallit, konfirmuar kjo nga procesverbalet e marrjes në dorëzim të mallit të bashkëlidhura në procedurën e blerjeve apo shërbimeve. Procesverbali i marrjes në dorëzim është firmosur nga komisioni i blerjes me vlerë të vogël dhe nga përfaqësuesi i subjektit, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar,Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara, a) pika 42 "*Titullari i njësisë miraton urdhërin për ngritjen e komisjonit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues*". b) pika 43. *Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak*

se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale", c) pika 54 "*Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se fletëhyrja origjinaleka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proçes verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione të shpenzimeve për investimet, proçes-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, certifikatë origjinale dhe cilësie, fletë analize laboratorike, garanci malli etj*".

d) Nuk ka të administruar në dosjen e procedurës së prokurimit paraqitjen e vetëdeklaratës me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesiti cili bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit në kundërshtim me VKM nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 15 Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes "Përmbushja e kritereve të përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes, sipas parashikimeve të nenit 45 të LPP-së realizohet nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetëdeklarimi bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesi"*.

e) Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nuk është hartuar dhe nuk është plotësuar Relacioni përmbledhës sipas nr.914, datë 19.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar Neni 68 Raporti Përmbledhës *Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të afateve të ankimit përgatit një raport përmbledhës për procesin e shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave dhe ia dërgon për miratim titullarit të autoritetit kontraktor. Raporti përmbledhës duhet të përmbajë: objektin e prokurimit; përshkrimin e punëve/mallrave/shërbimeve; respektimin e kërkesave ligjore në procesin e hapjes së ofertave; çmimet/vlerën e ofertuesve pjesëmarrës; korrigjimin e gabimeve aritmetike dhe ofertat anomalisht të ulëta (nëse ka pasur të tilla); ofertuesit e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit; ofertuesit e kualifikuar; ofertuesin e renditur të parin; informacion nëse ka pasur ankesa dhe vendimmarrjen në lidhje me to, si dhe çdo informacion tjetër a korrespondencë që lidhet me vlerësimin e ofertave*".

f)Njësia e prokurimit (funksionale) nuk ka marrë pjesë në asnjë trajnim në fushën e prokurimeve, në kundërshtim me LPP dhe Manualin e Prokurimit ku përcaktohet se Njësia e prokurimit duhet të kryejë minimumi 1 trajnim në vit.

g) Mungesë e gjurmës standarte të auditit dhe të proceseve të prokurimeve me vlerë të vogël, në kundërshtim me pikën 3 të Urdhërit nr.33, datë 11.07.2013 të Ministrit të Financës "Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë*"* ku citohet*: " në referim të gjurmësstandarte të auditit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë, titullarët e njësive të qeverisjes qendrore, vendore dhe fondeve special të hartojnë gjurmët e auditit të detajuara për njësitë që drejtojnë*". Konkretisht, paraqiten me parregullsi urdhër shpenzimet si më poshtë:

1. Sipas Urdhër Shpenzimit nr.75, datë 18.05.2018 është likuiduar në shumën 22,260 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "Materiale pastrimi dhe shërbimi". Fatura tatimore nr.98, datë 15.05.2018 dhe fletëhyrje nr.39, datë 15.05.2018.

2. Sipas Urdhër Shpenzimit nr.154, datë 11.10.2018 është likuiduar në shumën 56,850 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "Materiale për pastrim dhe shërbim". Fatura tatimore seri 233858099, datë 09.10.2018 dhe fletëhyrje nr.60, datë 9.10.2018.

3. Sipas Urdhër Shpenzimit nr.157, datë 25.10.2018 është likuiduar në shumën 7,000 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "Pajisjen me sistem menaxhimi për realizimin e masave/ndërhyrjeve të menjëhershme në zyrat e shërbimit me qytetarët/biznesin". Fatura tatimore nr. 202, datë 05.10.2018 dhe fletëhyrje nr.62, datë 5.10.2018.

4. Sipas Urdhër Shpenzimit nr.182, datë 23.11.2018 është likuiduar në shumën 30,000 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "Blerje dokumentacioni". Fatura tatimore nr.66 datë 21.11.2018 dhe fletëhyrje nr.73, datë 21.11.2018.
5. Sipas Urdhër Shpenzimit nr.31, datë 06.03.2018 është likuiduar në shumën 9,600 lekë subjekti "[redacted]" me objekt vendosjen e "Këndit të biznesit të vogël". Fatura tatimore nr.60, datë 13.02.2018 dhe fletëhyrje nr.14, datë 13.02.2018.
6. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 42, datë 04.04.2018 është likuiduar në shumën 40,390 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "Shërbime të tjera" për unifikimin e sinjalistikës për të gjitha Drejtoritë Rrajonale. Fatura tatimore nr.30, datë 15.03.2018 dhe fletëhyrje nr.24, datë 15.03.2018.
7. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 153, datë 10.10.2018 është likuiduar në shumën 99,900 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "Shpenzime mirëmbajtje pajisje zyre dhe teknike". Fatura tatimore nr. 486, datë 08.10.2018.
8.Sipas Urdhër Shpenzimit nr.37, datë13.03.2018 është likuiduar në shumën 99,973 lekë subjekti "[redacted]" me objektvendosjen e "Rregullimin e ambienteve të institucionit, lyerje e të gjithë korridoreve, zyra e drejtorit rajonal dhe zyra e drejtorit të Hetimit Tatimor". Fatura tatimore nr.3, datë 08.03.2018.
9. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 182, datë 20.11.2019 është likuiduar në shumën 98,400 lekë subjekti "[redacted]" sh.p.k me objekt "Shpenzime mirëmbajtje objekti". Fatura tatimore nr. 98, datë 18.11.2019.
10. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 101, datë 24.06.2019 është likuiduar në shumën 99,480 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "Mirëmbajtje pajisje zyre dhe tenike". Fatura tatimore nr. 797, datë 20.06.2019.
11. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 163, datë 17.10.2019, është likuiduar në shumën 25,860 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "Shpenzime për materiale pastrimi e shërbimi". Fatura tatimore nr.18, datë 15.10.2019 dhe fletëhyrje nr. 41, datë 15.10.2019.

- ***Në vitin 2018 për 2 procedura prokurimi në shumën 49,990 lekë*** **nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nuk janë përcaktuar specifikimet teknike** në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, Neni 23 Specifikimet teknike, pika 4. "*Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevoje, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertë"* si dhe të Udhëzimit nr.3, datë 8.01.2018 "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, pika 5citohet: "*Përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës, përllogarit fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme*", Konkretisht:

1. Sipas Urdhër Shpenzimit nr.31, datë 06.03.2018 është likuiduar në shumën 9,600 lekë subjekti "[redacted]" me objekt vendosjen e "Këndit të biznesit të vogël". Fatura tatimore nr.60, datë 13.02.2018 dhe fletëhyrje nr.14, datë 13.02.2018

2. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 42, datë 04.04.2018 është likuiduar në shumën 40,390 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "Shërbime të tjera" për unifikimin e sinjalistikës për të gjitha Drejtoritë Rrajonale. Fatura tatimore nr.30, datë 15.03.2018 dhe fletëhyrje nr.24, datë 15.03.2018.

DRT Shkodër nga 13 automjete në vëna në dispozocion ka aktualisht 11 automjete, ngatë cilat:
- 1 autoveturë tip benz me targë SH1212D është në proces verifikimi për c'rregjistrim.
- 1 autoveturë tip Land Rover me targë TR2536E është hequr leje e qarkullimit me vërtetim nr. 9916 prot, datë 19.12.2018 nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria Rajonale Tiranë.
- 11 automjete janë në përdorim nga ana e DRT-së prej të cilave një automjet është në përdorim të Drejtorit të DRTShkodër dhe 10 automjete janë në përdorim të DHT Shkodër, për të cilat rezulton të jenë kryer shpenzime për mirëmbajtje, siguracione dhe kolaudime me qëllim mbajtjen në gjendje teknike dhe gatishmëri të tyre për kryerjen e veprimatrisë funksionale.

- **Nga shqyrtimi gjithsej i 13 procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të realizuara nëpërmjet sistemit elektronik në shumën 488,064 lekë për vitin 2018 dhe vitin 2019 për kryerjen e shërbimeve të rradhës apo të riparimit të defekteve të konstatuara për automjetet në pronësi dhe në përdorim nga institucioni*<u>në 12 procedura prokurimi në shumën 370,464 lekë</u>(në vitin 2018 për 7 procedura prokurimi në shumën 178,464 lekë dhe në vitin 2019 për 5 procedura prokurimi në shumën 192,000 lekë)*konstatohet se:

  - Nuk ka një mekanizëm kontrolli bazuar në informacionin mbi gjendjen teknike, raportet mbi dëmtimet dhe avaritë e automjeteve dhe veprimet që mund të ndërmeren për t'iu përgjigjur mbajtjes në gatishmëri të tyre.
  - Nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse nuk mbahen kartela për secilin automjet, personat e autorizuar për përdorimin e tyre, në mënyrë që të evidentohen dhe ndiqen kilometrat e përshkruar, sasia e karburantit të harxhuar, afatet për shërbimet periodike dhe defektet e kryera, vlera e riparimit të tyre etj.
  - Në asnjë nga rastet e riparimit të automjetit nuk rezulton të jenë depozituar pranë magazinës së institucionit pjesët e dëmtuara (që janë ndërruar) të këtij automjeti për të vërtetuar shërbimin e realizuar.
  - Parregullsinë procesverbalete testimit të tregut. Komisioni i prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël ka funksionuar edhe si komision i testimit të tregut, në kundërshtim menenin59 të VKM-së nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.
  - Procesverbali i marrjes në dorëzim është firmosur nga komisioni i blerjes me vlerë të vogël dhe nga përfaqësuesi i subjektit, në kundërshtim me përcaktimet në pikat 42,43,54 Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara, tëUdhëzimittëMinistrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.
  - Mangësi në administrimin në dosjen e procedurës së prokurimit të paraqitjessë vetëdeklaratës me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesiti cili bëhet nën përgjegjësinë e plotë të kandidatit ose ofertuesit në kundërshtim përcaktimet e nenit 15 të VKM nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*
  - Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nuk është hartuar dhe nuk është plotësuar relacioni përmbledhës sipas nenit 68 Raporti Përmbledhës të VKM nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

Nga grupi ynë i auditimit u kërkuan shkresa/urdhëra/autorizime për personat e ngarkuar për përdorimin e automjeteve nga DHT. Gjithashtu u kërkuan kartelat për secilin automjet, libri i

secilit automjet për të verifikuar dhe kontrolluar shërbimet periodike të radhës apo defektet e riparuara gjatë vitit, vlera e riparimit, kilometrat e përshkruara, normat e konsumit të karburantit, kartelat për zëvëndësimin e gomave, baterive dhe pjesëve të tjera me qëllim verifikimin, kontrollin e menaxhimittë fondeve buxhetore për këto grup shpenzimesh për të cilat nuk na u vu në dispozicion asnjë prej tyre.Detyra këto të Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse të përcaktuara në nenin 28 të Rregullores së Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhër nr.19, me nr.1482/2 prot, datë 22.2.2017 të Ministrit të Finanacave, "Për miratimin e Rregullores së Brendshme "Për Funksionimit e Administratës Tatimore Qëndrore". Konkretisht sipas nenit 35 specialisti i administratës, ka varësi direkte nga Drejtuesi i Strukurës së Funksioneve Mbështetëse dhe ka pëgjegjësi dhe detyrë, sipas pikës 1 ku citohet *"Sigurimi i bazës materiale të nevojshme me pajisje, kanceleri, energji elektrike, ujë, ngrohje, mirëmbajtje, karburant, etj. Vazhdimisht dhe në cdo fund viti nëpërmmjet përgjegjësit të financës, drejtorit të administratës dhe personeli*; pikës 2 ku citohet: *Siguron gadishmërinë teknike të automjeteve dhe gjeneratorit,* pikës 4 ku citohet: *Menaxhon kontratat me ofruesit e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe bën të mundur që të gjitha faturat ta kalojnë në kohë në Sektorin e Financës për likudim për të shmangur problem me furnizuesit e tyre*; pikës 11 ku citohet: *Harton dhe kërkon zbatimin e planit të shpërndarjes së mallrave gjëndje në magazinë me urdhër furnizimi.tyre*. Çdo njësi publike duhet të hartojë planin e mirëmbajtjes së aktiveve me qëllim planifikimin e fondeve të nevojshme si dhe sigurimin e efiçiencës në përdorimin e aktiveve.Në një program mirëmbajtjeje të planifikuar ky informacion përdoret për ti orientuar shpenzimet drejt punës parandaluese sesa drejt riparimit të avarive. Gjatë auditimit grupit tonë të auditimit nuk iu vu në dispozicion asnjë prej tyre. Për 12 procedurat e prokurimit nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore në pikën 4 të Udhëzimittë Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" ku citohet: Nga pikëpamja e menaxhimit aktivet e të gjitha niveleve të njësisë publike: c. *Të gjitha aktivet e vëna në përdorim brenda njësisë, pavarësisht nga vendndodhja e tyre (në përdorim të personelit, brenda ambienteve të organit qendror apo të njësive të vartësisë*). Përgjegjësia e Titullarit të njësisë publike, pika 5 citohet: "*Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi*"; Përgjegjësia e Nëpunësve Autorizues të gjithë niveleve të njësisë publike, pika 6 citohet: "*Mbi bazën e rregullave dhe procedurave të miratuara nga Titullari i njësisë publike, përgjegjësitë për menaxhimin e aktiveve duhet të shpërndahen nga Nëpunësi Autorizues në njësinë publike nëpërmjet një sistemi delegimesh dhe ndarje funksionesh me rregulla të qarta dhe të dokumentuara. Cdo individ duhet të jetë i qartë dhe i informuar plotësisht mbi përgjegjësitë e tij mbi aktivet e njësisë* "; pika 7 citohet "*Autorizues i të gjithë niveleve të njësisë publike janë përgjegjës për përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësive që mbulojnë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre dhe japin llogari në linjë hierarkike deri tek Nëpunësi Autorizues i njësisë publike*"; Përgjegjesitë e menaxhereve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publike, pika 10 citohet: "*Çdo menaxher, nëpunës apo punonjës i njësisë publike është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar te tyre sipas kompetencave që mbulon*"; pika12 citohet: "*Aktivet jepen në ngarkim të punonjësve të cilët kanë përgjegjësi ligjore për humbjet, dëmtimet e shpërdorimet, pasqyrimin me saktesi në dokumentacionin përkatës të të dhënave si dhe për gjendjen e lëvizjen e aktiveve që kanë në ngarkim*"; pika 23 Masat që duhet të

ndërmerren në raport me riskun për kufizimin e humbjeve financiare, mund të përfshijnë: e)*Riparim i menjëhershëm i dëmeve. Duhet të kryhen inspektime të rregullta dhe të ekzistojë një sistem për regjistrimin e dëmeve dhe për garantimin se veprimet e duhura po merren me shpejtësi. f)Shërbime të rregullta mirëmbajtjeje për minimizimin e avarive të mundshme. Për tu siguruar për efiçencën e aktiveve është e nevojshme të ekzistojnë sistemet përkatëse të kontrollit.g)Mirëmbajtja e planifikuar. Aktivet afatgjata materiale duhen mbikëqyrur rregullisht në drejtim të jetëgjatësisë së pjesëve përbërëse të*. Konkretisht, paraqiten me parregullsi urdhër shpenzimet si më poshtë:

1. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 33, datë 06.03.2018 është likuiduar në shumën 14,784 lekë subjekti "[redacted]" për "Shërbim, ndërrim filtra, vaj", për automjetin tip toyota me targë AA 275 PK. Fatura tatimore nr. 226148688, datë 01.03.2018, dhe fletëhyrje nr. 15 datë 01.03.2018.
2. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 53 datë 18.04.2018**,** është likuiduar në shumën 15,960 lekë, subjekti "[redacted]" për "Vendosje bateri 100AH" automjetit tip toyota me targë AA 275 PK. Fatura seri 22614891, datë 16.04.2018dhe fletëhyrje nr. 26 datë 16.04.2018.
3. Sipas Urdhër Shpenzimit nr.95 datë 25.06.2018, është likuiduar në shumën 37,440 lekë subjekti "[redacted]" sh. a me objekt "Shërbim, vendosje bateri 80 AH & 90AH" për automjetet tip Toyota me targë AA681LA dhe AA697LA. Fatura nr.137, datë 20.06.2018 dhe fletëhyrje nr. 47 datë 20.06.2018.
4. Sipas Urdhër Shpenzimit nr.120 datë 02.08.2018, është likuiduar në shumën 18,000 lekë, subjekti "[redacted]" me objekt "Shërbim, ndërrim filtra, vaj", automjetit tip Peogeot me targë AA370LI. Fatura nr. 560, datë 27.07.2018 dhe fletëhyrje nr. 53 datë 27.07.2018.
5. Sipas Urdhër Shpenzimit nr.140, datë 17.09.2018 është likuiduar në shumën 27,600 lekë, subjekti "[redacted]" me objekt "Ndërrim filtra, vaj, automjetit", për automjetin tip Peugeot me targë AA826LH. Fatura nr.683, seri 12646251, datë 07.09.2018 dhe fletëhyrje nr.57 datë 07.09.2018
6. Sipas Urdhër Shpenzimit nr.193 datë 05.12.2018 është likuiduar në shumën 47,880 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "Ndërrim filtra, vaj, etj" për automjetin tip Peugeot me targë AA 370. Fatura nr. 66 datë 20.11.2018 dhe fletëhyrje nr.72 datë 20.11.2018.
7. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 212, datë 24.12.2018 likuiduar në shumën 16,800 lekë subjekti "[redacted]"me objekt "Pjesë këmbimi goma, bateri" për automjetin tip Peugeot me targë AA138LK. Fatura nr.1028 datë 12.12.2018 dhe fletëhyrje nr.73/1, datë 12.12.2018.
8. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 135, datë 27.08.2019 është likuiduar në shumën 55,200 lekë subjekti "[redacted]" shpk me objekt "Pjesë këmbimi auto" për automjetet me targë AA697LA dhe AA 681LA. Fatura tatimore nr. 892, datë 23.08.2019 dhe fletëhyrje nr.29, datë 23.8.2019.
9. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 134, datë 26.08.2019 është likuiduar në shumën 57,600 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "Pjesë këmbimi auto" për automjetet me targëAA375LI dheAA 138LK dhe AA369LI. Fatura tatimore nr. 22, datë 13.08.2019 dhe fletëhyrje nr.28, datë 13.8.2019.
10. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 39, datë 08.03.2019 është likuiduar në shumën 36,000 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "Pjesë këmbimi auto" për automjetet me targë AA826LK dhe AA275PK. Fatura tatimore nr. 49, datë 26.02.2019 dhe fletëhyrje nr.6, datë 26.02.2019.
11. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 164, datë 30.10.2019 është likuiduar në shumën 25,200 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "Pjesë këmbimi auto" për automjetin me targëAA826LH. Fatura tatimore nr. 33, datë 21.10.2019 dhe fletëhyrje nr.42, datë 21.10.2019.

12. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 94, datë 19.06.2019 është likuiduar në shumën 18,000 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "Pjesë këmbimi auto", për automjetet AA370LI. Fatura tatimore nr. 14, datë 06.06.2019 dhe fletëhyrje nr.20, datë 06.06.2019.

Nga shqyrtimi gjithsej i 6 procedurave të prokurimit me vlerë të vogël të realizuara në raste emergjente në shumën 198,770 lekë për vitin 2018 dhe 2019 me objektriparime/shërbime tëautomjeteve, në 5 procedura prokurimi në shumën 185,270 lekë (*në vitin 2018 për 2 procedura në shumën 40,000 lekëdhe në vitin 2019 për 3 procedura në shumën 145,270 lekë)* janë konstatuar parregullsi në nënshkrimin e faturës së mallrave/shërbimeve nga personat e pranishëm për difektin e ndodhur të cilët kanë qenë prezent sipas procesverbalit të konstatimit dhe nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlerë të vogëlnë kundërshtim me Udhëzimin nr.3, datë 8.01.2018 "*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", i ndryshuar, pika 18 "*..Në çdo rast, faturat e mallrave, apo shërbimeve duhet të jenë të rregullta, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe duhet të nënshkruhen nga të gjithë personat (përfaqësues të institucionit) të pranishëm. Procesverbali i mbajtur midis personave të pranishëm së bashku me faturën përkatëse të nënshkruar prej tyre, i dorëzohen komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, të cilët mbajnë procesverbalin, sipas formularit standard Nr.4, bashkëlidhur, këtij udhëzimi, nënshkruajnë faturën dhe të gjithë dokumentacionin dhe ia dërgojnë Zyrës së Financës për likuidim*". Konkretisht, paraqiten me parregullsi urdhër shpenzimet si më poshtë:

1. Sipas Urdhër Shpenzimit nr.94 datë 25.06.2018, është likuiduar gjithsej 26,500 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "Vendosje bateri 80 AH dhe 90AH" për automjetet tip Toyota me targë AA826 LH dhe targë AA370LI. Faturë nr.17 datë 06.06.2018 në shumën 13,000 lekë dhe faturë nr.18 datë 11.06.2018 në shumën 13,500 lekë.
2. Sipas Urdhër Shpenzimit nr.122, datë 10.08.2018 është likuiduar në shumën 13,500 lekë, subjekti "[redacted]" me objekt "Riparim katalizatori" për automjetin tip ëolsvagen me targë AA697 LA. Fatura nr.01 seri 12646251, datë 07.08.2018.
3. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 114, datë 29.07.2019 është likuiduar në shumën 13,300 lekë subjekti "[redacted]" me objekt "riparim kondicioner dhe mbushje me gaz", për automjetin tip TAYOTA Rav.4 AA275PK. Fatura tatimore nr. 88datë 25.07.2019, pa nënshkruar nga personat e pranishëm dhe fletëhyrje nr.25, datë 25.07.2019.
4. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 147, datë 23.09.2019 është likuiduar në shumën 119,370 lekë subjekti " [redacted]"me objekt "riparim motori, pjesë këmbimi" për automjetin tip Peugeot me targë AA370LI.Fatura tatimore nr. 895, datë 06.09.2019.
5. Sipas Urdhër Shpenzimit nr. 47, datë 28.03.2019 është likuiduar në shumën 12,600 lekë subjekti "[redacted]"me objekt "Pompë uji për automjetin me targë TR1288E". Fatura tatimore nr.39datë 26.03.2019 dhe fletëhyrje nr.10, datë 26.03.2019.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjesi:
Z. [redacted] me detyrë ish Drejtor i DRT(për periudhën nga 01.01.2018 deri në datën 08.07.2019), z. [redacted] me detyrë Drejtor i DRT(për periudhën nga 16.07.2019 e në vazhdim), znj, [redacted] me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse në DRT Shkodër
Për sa më sipër mbahet Akt Konstatim nr.8, datë 02.03.2020.

Titulli i Gjetjes **Parregullsi në respektimine rregullave të prokurimit publik në procedurat të prokurimit për blerjet e voglatë cilat kanë shkaktuar shpenzime në kushtetë paligjshmërisë.**

Situata:

➢ Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues, justifikuesi procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për periudhën e audituar, konstatohet se nga 34 procedura prokurimi të realizuara në shumën 1,724,768 lekë,janë realizuar në kushtet jo korekte të zbatimit të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, **gjithsej 30 procedura prokurimi në shumën 1,195,437lekëose 69% e shumës gjithsej tëprocedurave të realizuara,** të detajuara si më poshtë:

✓ 19 procedura prokurimi në shumën 634,427 lekëose 67% e shumës gjithsej të procedurave të realizuara nga 20 procedura prokurimi të realizuara në shumën 940,012lekë, në vitin 2018.

o 11 procedura prokurimi në shumën 561,010 lekëose 71% e shumës gjithsej të procedurave të realizuaranga 14 procedura prokurimi të realizuara në shumën 784,756 lekë në vitin 2019.Konkretisht, të grupuara sipas problematikave:

Gjithsej për 11 procedura prokurimi në shumën 589,713 lekë të detajuara:*(*Në vitin 2018 për 8 procedura prokurimi në shumën 365,973 lekë dhe në vitin 2019 për 3 procedura prokurimi në shumën 223,740 lekë), për të cilat konstatohen parregullsitë si më poshtë:

a) Kërkesat për mallra/punë/shërbime nuk janë hartuar nga degët përkatëse, në kundërshtim me nenin 40 pika 1 dhe pika 3 eVKM-së nr.914, datë 19.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

b) Mungesë e procesverbaleve të testimit të tregut,të argumentimit dhe dokumentimit në përllogaritjen e fondit limit, në kundërshtim me nenin 59 të VKM-së nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

c) Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nuk është ngritur komisioni marrjes në dorëzim të mallit, në kundërshtim me pikat 42, 43 dhe pika 54 të Udhëzimittë Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

d) Nuk ka të administruar në dosjen e procedurës së prokurimit paraqitjen e vetëdeklaratës me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesiti në kundërshtim me *neni 15 Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes të* VKM-së nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar".*

e) Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara mungon relacioni përmbledhës sipas Nenit 68 të VKM-së nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar".*

f) Njësia e prokurimit (funksionale) nuk ka marrë pjesë në asnjë trajnim në fushën e prokurimeve, në kundërshtim me LPP dhe Manualin e Prokurimit ku përcaktohet se Njësia e prokurimit duhet të kryejë minimumi 1 trajnim në vit.

g) Nuk është hartuar lista e proceceve dhe gjurmët e audititnë procedurat e prokurimit të zhvilluara, në kundërshtim me pikën 3 të Urdhërit nr.33, datë 11.07.2013 të Ministrit të Financës "*Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë*".

Në vitin 2018 për 2 procedura prokurimi në shumën 49,990 lekë nuk janë përcaktuar specifikimet teknike në kundërshtim me Nenin 23 Specifikimet

teknike, pika 4 e Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe pika 5 e Udhëzimit nr.3, datë 8.01.2018 "*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", i ndryshuar.

- **Në 12 procedura prokurimi në shumën 370,464 lekë** *(në vitin 2018 për 7 procedura prokurimi në shumën 178,464 lekë dhe në vitin 2019 për 5 procedura prokurimi në shumën 192,000 lekë)*konstatohet se:

Nuk ka një mekanizëm kontrolli bazuar në informacionin mbi gjendjen teknike, raportet mbi dëmtimet dhe avaritë e automjeteve.

- Nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse nuk mbahen kartela për secilin automjet, si dhe nuk kaautorizime për personat që i përdorin ato.
- Në asnjë nga rastet e riparimit të automjetit nuk rezulton të jenë depozituar pranë magazinës së institucionit pjesët e dëmtuara (që janë ndërruar) të këtij automjeti veprime këto që bien ndesh mepikat 4, 5, 6, 7, 10, 12, 23 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar si dhe me pikat 1, 2, 4, 12 të nenit 35 të Rregullores së Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore.

- **Në 5 procedura prokurimi në shumën 185,270 lekë** (në vitin 2018 për 2 procedura në shumën 40,000 lekëdhe në vitin 2019 për 3 procedura në shumën 145,270 lekë)janë konstatuar parregullsi në nënshkrimin e faturës së mallrave/shërbimeve nga personat e pranishëm për difektin e ndodhur të cilët kanë qenë prezent sipas procesverbalit të konstatimit dhe nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlerë të vogël,në kundërshtim përcaktimin e pikës 18 tëUdhëzimit nr.3, datë 8.01.2018 "*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", i ndryshuar.

Kriteri: Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin Publik*", i ndryshuar.VKM nr.914, datë 19.12.2014; "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar";*Udhëzimii Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*"; Udhëzimin nr.3, datë 8.01.2018 "*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", i ndryshuar; Urdhërin e Ministrisë së Financave Nr.33, datë 11.07.2013, "*Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë*"; Rregullores së Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore.

Efekti: Devijim nga procedurat dhe rregullat e prokurimit publik.

Shkaku: Mos njohje e legjislacionit dhe kontrolle të dobëta në procesin e prokurimit.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: 1. Titullari i institucionit të analizojë situatën në lidhje me, realizimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, mosrespektimin e afateve kohore të hartimit dhe të dërgimit të

regjistrit të parashikimit të prokurimit publik për punë/mallra/shërbime, në DPT dhe në Degën e Thesarit, dhe të nxjerrë përgjegjësitë administrative.
2.Nëpunësi autorizues të ngrejë menjëherë komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve në zbatim të kërkesave të pikave 42,43,54 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.
3.NZ të garantojë zbatimin e gjurmës së auditimit për procedurat e prokurimit publik në zbatim të kërkesave të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të përcaktojë një program mirëmbajtjeje të planifikuar për mjetet e transportit të institucionit me qëllim orientimin e shpenzimeve drejt punës parandaluese dhe jo drejt riparimit të avarive, duke siguruar eficiencën e përdorimit të aktiveve.
4.Titullari i Institucionit, të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, me qëllim përmirësimin e punës së Njësisë së Prokurimit në drejtim të hartimit, dokumentimit dhe zbatimit të procedurave konform rregullave të prokurimit publik.

Menaxhimi i konsumit të karburantit për mjetet e transportit pranë DRT Shkodër për periudhën 01 Janar 2018 – 31 Dhjetor 2019.

Pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër janë në inventar dhe përdorim 13 automjete nga të cilat:
- Një automjet tip Benz me targë SH1212D është në proces për ç'rregjistrim sipas shkresës nr.3515 prot, datë 17.04.0218 drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Shkodër.
- Një automjeti tip Autoveturë i markës Land Rover me targë TR2536E i është hequr leja e përhershme e qarkullimit për arësye se është jashtë funksionit, sipas vërtetimit nr. 9916 prot, datë 19.12.2018 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, Drejtoria Rajonale Tiranë.
- Automjeti tip Peugeot AA370LI është në përdorim nga Drejtori i DRT-së Shkodër.
- Dhjetë (10) automjete të tjera janë në përdorim dhe të marra në dorëzim nga drejtorëtë Drejtorisë së Hetimit Tatimor Shkodër, sipas periudhave përkatësetë emërimit të tyre në detyrë.
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në datë 16.05.2016 ka njoftuar DRT-të, se është ndryshuar mënyra e shpërndarjes së karburantit dhe furnizimi do të bëhet nëpërmjet kartave elektronike të cilat do të jenë për çdo automjet sipas targave, sipas kontratës së lidhur në DPT, në vitin 2016. Nga DPT janë kërkuar targat e automjeteve, automjetet që nuk janë në gjendje pune, gjendja dhe përdorimi i gjeneratorit, kapaciteti e tyre dhe personat e autorizuar e të miratuar nga titullari i DRT-së për shpërndarjen elektronike të karburantit. Shpërndarja do të bëhet online dhe personi i autorizuar do të pajiset me një fjalëkalim nga ku do të mundësohet mbushja e kartave elektronike.
Personat e autorizuar dhe të miratuar nga titullari i DRT Shkodër, datë 19.05.2016, kanë qenë: z.[redacted] për DRT dhe znj.[redacted] për DHT.
-Me shkresë nr. 10293 prot, datë 27.07.2016 të Drejtorit Rajonal z.XXXXX drejtuar DPT-së, Drejtorisë së Administrimit dhe Sektorit të Administratës është kërkuar ndryshimi i personit të

autorizuar për Prokurimeve automjetin tip peogeot AA370LI; për kartën Gold (gjeneratori) nga z. [redacted] tek z. [redacted] për DRT dhe për automjetin tip ëolsvagen me targë TR3197F të DHT-së nga znj. [redacted] tek z.[redacted].
-Me shkresë nr.269 prot, datë 13.01.2017 drejtuar DPT-së, Drejtorisë së Administrimit dhe Prokurimeve, Sektorit të Administratës është kërkuar ndryshimi i personit të autorizuar nga z. [redacted] tek znj. [redacted] për automjetin tip wolsvagen me targë TR3197F, i cili kalon në përdorim të DHT-së. Pra personi i autorizuar për DRT për mbushjen e kartave elektronike është z.[redacted] për automjetin tip peogeot AA370LI dhe të kartës Gold(gjeneratori), ndërsa për DHT është znj. [redacted]
Sipas njoftimit datë 20.08.2019, në DPT është ndërruar përgjegjësia për shpërdarjen e karburantit në sistemin elektronik për Drejtorinë e Hetimit Tatimor Rajonal Verior tek znj. [redacted], e cila vazhdon deri në periudhën e audituar.

<u>Nga shqyrtimi i dokumentacionit për konsumin e karburantit për vitin 2018, rezulton se:</u>

- Gjendja kontabël e karburantit (naftë) në datë 01.01.2018 sipas kartelave të magazinës është <u>1,002</u> litra në vlerë 161,702.76 lekë.
- Nga verifikimi i fletë hyrjeve të DRT-së dhe fletë daljeve të DPT-së rezulton se janë bërë hyrje në DRT gjithsej 15,900 litra në vlerë 2,860,913.87 lekë, e konfirmuar me akt rakordim me DPT dhe e ndarë: 6,850 litra në vlerë 1,225,637.05 lekë për DRT dhe 9,050 litra për DHT në vlerë 1,635,276.8 lekë.
- Referuar fletë daljeve dhe kartelave të magazinës konsumi i karburantit (naftë) deri në 31.12.2018 është gjithsej 11,919 litra, në vlerë 2,119,337.76 lekë e ndarë: 2,869 litra në vlerë 484,051.72 lekë për DRT dhe 9,050 litra në vlerë 1,635,286.15 lekë për DHT.
- Si rezultat gjendja e karburantit <u>në magazinënë datë 31.12.2018është 4,983 litra</u> në vlerën903,274.26 lekë dhe i përket DRT.
- *Në datë 31.12.2018<u>në sistemin elektronik të kartave rezulton gjendje 6,480.51litra naftë(4,982.65 litra nga DRT dhe 1,497.86 nga DHT).</u>*
  - Nga krahasimi i gjendjes së sistemit elektronik të kartave përgjatë vitit 2018 dhe kartelave të magazinës rezulton se:

<u>Për DRT</u>: gjendja në magazinë në datën 01.01.2018 është 1,002 litra, janë bërë hyrje 6,850 litra dhe bërë dalje 2,869 litra. Pra, gjendja në magazinë në datën 31.01.2018 është 4,983 litra.Janë tërhequr me karta elektronike gjithsej 2,869 litra, në vlerën 484,053 lekë,nga të cilat:
- Për automjetin me targë AA370LI në sasinë2,429.85 litra në vlerën 428,730 lekë.
- Nga karta Gold (gjeneratori) janë tërhequr në sasinë439,5 litra në vlerën 77,789 lekë, nga e cila 300 litra është përdorur me urdhër të Drejtorit Rajonal z.[redacted] dhe janë përcaktuar sasia dhe targa e mjetit që do tëpërdoret. Për 139.5 litra nuk ka urdhër të përdorimit të kësaj karte. Përdorimi i kartës Gold (gjeneratori) është bërë me arësyetimin se, DRT ka vetëm një automjet në dispozion (AA370LI) dhe për furnizime me shtypshkrime në DPT ka përdorur automjetet e DHT-së.

<u>Për DHT</u>:për vitin 2018 janë bërë hyrje në magazinë 9,050 litra dhe bërë dalje 9,050 litra. Pra gjendja në magazinë në datën 31.01.2018 është 0 litra.

- Janë tërhequrnga programi i kartave elektronike gjithsej 7,552.14 litra për 11 automjetet në përdorim të tij.
  - ***Pra, nga magazina janë bërë dalje më tepër në sasinë 1,497.51 litra ose në vlerën282,452.52 lekë se sa nga programi i kartave elektronike.***

Krahasimi i gjendjes së karburantit (naftë), midismagazinës dhesistemit elektronik të përdorimit të kartave, për DRT dhe DHT për vitin 2018.

Tabelë nr.46

Nr	Emërtimi	Gjendja plus hyrjet e vitit 2018	Dalje nga Magazina të vitit 2018		Dalje nga sitemi elektronik të vitit 2018		Gjendja në magazinë 31.12.2018	Gjendja sipas sitemit 31.12.2018	Diferncca sistem- magazinë 31.12.2018	
			Sasi	Vlerë	Sasi	Vlerë			Sasi	Vlerë
1	Për DHT	9,050	9,050	1,635,286.80	7,552.14	1,330,357	0	1,497.86	(1,497.86)	(304,929.8)
2	Për DRT	7,852	2,869	484,051.72	2,429.85	428,730	4,983	5,422.15	(439.15)	(55,321.72)
	Shuma dalje		**11,919**	**2,119,328.52**	**9,981.99**	**1,759,087**	**4,983**	**6,920.01**	**(1,937)**	**(360,241.52)**
3	Karta Gold (Gjeneratori)				439,5	77,789		-439.5	439,5	77,789
	Totali	**16,902**	**11,919**	**2,119,328.52**	**10,421.49**	**1,836,876**	**4,983**	**6,480.51**	**(1,497.51)**	**(282,452.52)**

Burimi: Sipas të dhënave të Zyrës së Financës nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse dhe të printimeve elektronike Drejtoria e Hetimit Tatimor Shkodër dhe përpunuar nga grupi i auditimit.

Si konkluzion:

- Për vitin 2018 nga ana e DRT Shkodër është bërë dalje nga magazina gjithsej 11,919 litra naftë (2,869 litra DRT dhe 9,050 litra DHT), ndërsa nga sistemi elektronik janë tërhequr 10,421.49 litra (2,869.35 litra nga DRT dhe 7,552.14 litra nga DHT).
- Gjendja në sistemin elektronik në datën 31.12.2018 për DRT Shkodër rezulton 6,480.51 litra (e cila i përket4,982.65 litra DRT dhe 1,497.86 DHT), ndërsa gjendja në magazinë rezulton 4,983 litra. ***Pra, nga magazina janë bërë dalje më tepër në sasinë 1,497.51 litra ose në vlerën282,452.52 lekë se sa nga programi i kartave elektronike.*** DRT ka përdorur nga karta Gold (gjeneratori) 439.5litra karburant në vlerën 77,789 lekë, nga e cila 300 litra është përdorur me urdhër të Drejtorit Rajonal z.[redacted] dhe janë përcaktuar sasia dhe targa e mjetit që do të përdoret. Për 139.5 litra nuk ka urdhër të përdorimit të kësaj karte. Nga grupi ynë i auditimit u kërkua dokumentacioni vërtetues, shoqërues, justifikues mbi mënyrën e furnizimit, shpërndarjes, kontrollit, argumentimit të përdorimit të karburantit nga karta Gold (gjeneratori), për të cilën nuk u vu në dispozicion asnjë rast i përdorimit tëgjeneratorit. Kjo kartë ka përdorim vetëm për gjeneratorin dhe rezulton të jetë përdorur për furnizime shtypshkrimesh apo shërbime të tjera, me arësyetimin se drejtoria ka vetëm një mjet në përdorim dhe i duhej të përdorte mjetet e transportit në përdorim të DHT-së.
- Për përdorimin e kartës gold dhe të kartave të tjera nuk ka procedura të qarta.
- Konstatohet mos përputhje midis fletë daljeve të magazinës dhe tërheqjes nga sistemi elektronik nga personat e autorizuar. Kartelat e magazinës janë me korrigjime, mbahen vetëm në sasi dhe jo në vlerë dhe nuk janë të rakorduara printimet nga sistemi elektronik prej personave përgjegjës. Fletë daljet e magazinës në shumë raste janë me korrigjime dhe nuk kanë të bashkëlidhur asnjë dokument justifikues, vërtetues që të pasqyrojnë dokumentimin e lëvizjes dhe gjurmën e menaxhimit të karburantit, sipas përgjegjësive, në kundërshtim meUdhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik"pika* 38 ku citohet: "*Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve*"; pika 40 ku citohet: "*Magazinieri dorëzon tek nëpunësi përgjegjës për financat e njësisë nga një kopje origjinale për fletë hyrjet, faturën e furnizuesit (shitësit) si dhe fletë daljen, si dhe hedh në kartelat e magazinës lëvizjet përkatëse në sasi dhe në vlerë sipas afateve të përcaktuar nga njësitë publike në funksion të specifikës së aktivitetit të tyre*".

Nga shqyrtimi i dokumentacinit për konsumin e karburantit për vitin 2019, rezulton se:

- Gjendja kontabël e karburantit (naftë) në datë 01.01.2019 sipas kartelave të magazines është 4,983 litra në vlerë 903,274.26 lekë.
- Nga verifikimi i fletë hyrjeve të DRT-së dhe fletë daljeve të DPT-së janë bërë hyrje në DRT gjithsej 13,950 litra në vlerë 2,439,992.5 lekë, e konfirmuar me akt rakordim me DPT dhe e ndarë: 3150 litra në vlerë 1,553,892.5 lekë për DRT dhe 10,800 litra në vlerë 1,886,100 lekë për DHT.
- Referuar fletë daljeve dhe kartelave të magazinës konsumi i karburantit (naftë) deri në 31.12.2019 është gjithsej 13,600 litra në vlerë 2,387,658,96 lekë e ndarë: 2,800 litra në vlerë 501,554.6 lekë për DRT dhe 10,800 litra në vlerë 1,886,104.36 lekë për DHT.
- Në datë 31.12.2019gjendja kontabël rezulton 5,333 litra në vlerën 955,626.01 lekë dhe i përket DRT.
- Në datë 31.12.2019 në sistemin elektronik të kartave rezulton gjendje 5,450.66litra (5,333 litra nga DRT dhe 117.66 nga DHT), ***pra në sistemin elektronik rezulton 117.66 litra më tepër se sa gjendja e magazinës.***

Për DRT: Gjendja në magazinë në datën 01.01.2019 është 4,983 litra, janë bërë hyrje 3,150 litra dhe bërë dalje 2,800 litra. Pra gjendja në magazinë në datën 31.01.2018 është 5,333 litra.
Janë tërhequr nga programi i kartave elektronike gjithsej 2,800 litra, në vlerën 501,554.6 lekë, nga të cilat:
- Për automjetin me targë AA370LI janë tërhequr nga sistemi elektronik në sasinë2,570 litra në vlerën 450,370 lekë.
- Nga karta Gold (gjeneratori) janë tërhequr 230 litra në vlerën 40,160 lekë. Përdorimi i kartës Gold (gjeneratori) në 6 raste është bërë me urdhër të Drejtorit Rajonal z.[redacted], në të cilat nuk është përcaktuar sasia dhe targa e automjetit që do i përdorë, me arësyetimin se, DRT ka vetëm një automjet në dispozion (AA370LI) dhe për furnizime me shtypshkrime në DPT ka përdorur automjetet e DHT-së.

Për DHT, për vitin 2019 janë bërë hyrje në magazinë 10,800 litra dhe bërë dalje 10,800 litra. Pra gjendja në magazinë në datën 31.01.2018 është 0 litra.

- Janë tërhequr nga programi i kartave elektronike gjithsej 10,682.34 litra në vlerë 1,861,551.98 lekëpër 11 automjetet në përdorim të tij.
- ***Pra, nga magazina janë bërë dalje më tepër në sasinë 117.6 litra ose në vlerën 28,973lekë se sa nga programi i kartave elektronike***.

Krahasimi i gjendjes së karburantit (naftë), midismagazinës dhe sistemit elektronik të përdorimit të kartave, për DRT dhe DHT për vitin 2019.

Tabelë nr.47

Nr	Emërtimi	Gjendja 01.01.2019	Hyrjet 2019	Dalje nga Magazina për vitin 2019		Dalje nga sitemi elektronik Për vitin 2019		Gjendja sipas magazinës 31.12.2019	Gjendja sipas sistemit 31.12.2019	Diferncca sistem-magazina për vitin 2019	
				Sasi	Vlerë	Sasi	Vlerë	Sasi	Sasi	Sasi	Vlerë
1	Për DHT		10,800	10,800	1,886,100	10,682.34	1,868,152	0	117.66	(117.66)	(17,948)
2	Për DRT	4,983	3,150	2,800	501,554.6	2,570	450,370	5333	5,563	(230)	(51,184.6)
3	Karta Gold (Gjenerator)					230	40,160		(230)	230	40,160

	Totali	**4,983**	**13,950**	**13,600**	**2,387,654.6**	**13,482.34**	**2,358,682**	**5,333**	**5,450.66**	**(117,66)**	**(28,972.6)**

Burimi: Sipas të dhënave nga Zyra e Financës e Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse Shkodër përpunuar nga grupi i auditimit.

<u>Si konkluzion</u>:

Për vitin 2019nga ana e DRT Shkodër është bërë dalje nga magazina gjithsej 13,600 litra naftë (2,800 litra DRT dhe 10,800 litra DHT), ndërsa nga sistemi elektronik janë tërhequr 13,482.34 litra (2,800 litra nga DRT dhe 10,682.34 litra nga DHT).

Gjendja në sistemin elektronik në datën 31.12.2019 për DRT Shkodër, rezulton 5,450.66litra e cila i përket(5,333 litra DRT dhe 117.66 DHT), ndërsa në magazinëështë 5,333 litra, ***Pra, nga magazina janë bërë dalje më tepër në sasinë 117.6 litra ose në vlerën28,972.6 lekë se sa nga*** *programi i kartave elektronike****.***

DRT ka përdorur nga karta Gold (gjeneratori)230 litra karburant në vlerën 40,160 lekë e cila ka përdorim vetëm për gjeneratorin. Në 6 raste përdorimi i saj është bërë me urdhër të Drejtorit Rajonal z.[redacted], në të cilat nuk është përcaktuar as sasia dhe as targa e automjetit që do t'i përdorë.Nga grupi ynë i auditimit u kërkua dokumentacioni vërtetues, shoqërues, justifikues mbi mënyrën e furnizimit, shpërndarjes, kontrollit, argumentimit të përdorimit të karburantit nga karta Gold (gjeneratori), për të cilën nuk u vu në dispozicion asnjë rast i përdorimit të gjeneratorit. Kjo kartë ka përdorim vetëm për gjeneratorin dhe rezulton të jetë përdorur për furnizime shtypshkrimesh apo shërbime të tjera, me arësyetimin se drejtoria ka vetëm një mjet në përdorim dhe i duhej të përdorte mjetet e transportit në përdorim të DHT-së.

Për përdorimin e kartës Gold dhe kartave tëtjera nuk ka procedura të qarta.

Konstatohet mos përputhje midis fletë daljeve të magazinës dhe tërheqjes në sistemin elektronik nga personat e autorizuar. Kartelat e magazinës janë me korrigjime, mbahen vetëm në sasi dhe jo në vlerë dhe nuk janë të rakorduara me evidencat e printuara nga sistemi elektronik.Fletë daljet e magazinës në shumë raste janë me korrigjime dhe nuk kanë të bashkëlidhur asnjë dokument justifikues, vërtetues që të pasqyrojnë dokumentimin e lëvizjes, dhe gjurmën e menaxhimit të karburantit, sipas përgjegjësive, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik"*pika38 citohet: "*Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve*"; pika 40 ku citohet: "*Magazinieri dorëzon tek nëpunësi përgjegjës për financat e njësisë nga një kopje origjinale për fletë hyrjet, faturën e furnizuesit (shitësit) si dhe fletë daljen, si dhe hedh në kartelat e magazinës lëvizjet përkatëse në sasi dhe në vlerë sipas afateve të përcaktuar nga njësitë publike në funksion të specifikës së aktivitetit të tyre*".

Në mënyrë të përmbledhur konstatohet se për vitet 2018-2019:

Ka mospërputhje midis fletëdaljeve të magazinës për karburantin (naftë) dhe përdorimit tëtij nga programi i kartave elektronike. Konkretisht:

- <u>Për vitin 2018</u>, sipas fletëdaljeve të magazinës janë bërëdalje 11,919 litra në vlerën 2,119,328.52 lekë, ndërsa nga programi i kartave elektronike janë përdorur 10,421.49 litra në vlerën 1,836,876 lekë. ***Pra, nga magazina janë bërëdalje më tepër në sasinë 1,497.51 litra ose në vlerën282,452.52 lekë më shumë se sa nga programi i kartave elektronike.***
- <u>Për vitin 2019</u>, sipas fletëdaljeve të magazinës janë bërë dalje 13,600 litra në vlerën 2,387,654.6 lekë, ndërsa nga programi i kartave elektronike janë përdorur 13,482.3 litra në vlerën

2,358,682 lekë. ***Pra, nga magazina janë bërë dalje më tepër në sasinë 117.6 litra ose në vlerën 28,973 lekë më shumë se sa nga programi i kartave elektronike.***

- Në fund të periudhës audituese, në datën 31.12.2019, për DRT Shkodër gjendja në magazinë është 5,333 litra, ndërsa në sistemin elektronik të kartave rezulton 5,450.66litra (diferenca 117.6 litra).
- Kartelat e magazinës janë me korrigjime, mbahen vetëm në sasi dhe jo në vlerë dhe nuk janë të rakorduara me tërheqjet nga sistemi elektronik prej personave përgjegjës. Fletë daljet e magazinës në shumë raste janë me korrigjime, me fraksione dhe nuk kanë të bashkëlidhur asnjë dokument justifikues, vërtetues që të pasqyrojnë dokumentimin e lëvizjes së karburantit, gjurmën e menaxhimit të tij sipas përgjegjësive, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar pika* 38 citohet: "*Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave të aktiveve*"; pika 40 ku citohet: "*Magazinieri dorëzon tek nëpunësi përgjegjës për financat e njësisë nga një kopje origjinale për fletë hyrjet, faturën e furnizuesit (shitësit) si dhe fletë daljen, si dhe hedh në kartelat e magazinës lëvizjet përkatëse në sasi dhe në vlerë sipas afateve të përcaktuar nga njësitë publike në funksion të specifikës së aktivitetit të tyre*".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:`
Znj. [redacted] *me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse.*

- DRT ka përdorur nga karta Gold (gjeneratori) 669.5 litra karburant në vlerën 117,949 lekë. Për vitin 2018 janë përdorur 300 litra naftë, me urdhër të Drejtorit Rajonal, në të cilat janë përcaktuar sasia dhe targa e mjetit që do të përdoret, ndërsa për vitin 2019 në 6 raste janë përdorur me urdhër të Drejtorit Rajonal, por pa përcaktuar as sasinë dhe as targën e automjetit që do t'i përdorë. Karta Gold(gjeneratori) është përdorur për furnizime shtypshkrimesh apo shërbime të tjera**,** me arësyetimin se drejtoria ka vetëm një mjet në përdorim dhe i duhej të përdorte mjetet e transportit në përdorim të DHT-së,pornë asnjë rast nuk është bërë argumentimi dhe dokumentimi i përdorimit të saj. Në asnjë rast nuk ka qenë e nevojshme përdorimi i kësaj karte, pasi nga auditimi i gjendjes dhe lëvizjes së karburantit në magazinë, si dhe i përdorimittëprogramit elektronik të kartave vihet re se ka pasur gjendje karburanti me të cilin strukturat drejtuese do të realizonin kryerjen e shërbimeve të duhura pa përdorur kartën Gold (gjeneratori). Edhe në rastet e përdorimit të kësaj karte me urdhër të titullarit të institucionit konstatohet se është ndërruar destinacioni i përdorimit të saj, pasi kjo kartë ka përdorim vetëm për gjeneratorin, i cili në asnjë rast nuk rezultoi të jetë vënë në punë, veprim ky jo në përputhje me pikën 34 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar,* ku citohet: "*Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi*". Si përfundim, ***efekti financiar negativ në Buxhetin e Shtetit është në total në shumën* 117,949*lekë.***

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:`
z. [redacted] *me detyrë ish Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve (për periudhën nga 01.01.2018 deri në datën 08.07.2019), periudhë e cila përkon me përdorimin e kartës Gold(gjeneratori).*

- Për kartën Gold(Gjeneratori) dhe kartat e tjera nuk ka procedura të qarta të përdorimit dhe dokumentimit të tyre, në kundërshtim meUdhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011*"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar,*Përgjegjësia e

Titullarit të njësisë publikepika 5 ku citohet**: "***Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi*".

- Në asnjë rast nuk ka autorizim të përdorimit për automjetet të DRT-së, ku të përcaktohet drejtuesi i mjetit, targa e mjetit, destinacioni, periudha e lëvizjes, në kundërshtim meUdhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011*"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar,* Dokumentimi i lëvizjes së aktivevepika 35 ku citohet**: "***Dokumenta autorizues - janë ato dokumenta që autorizojnë kryerjen e një veprimi tëcaktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues. Të tilla janë urdhërat e blerjeve, kontratat, urdhëri për krijimin e komisioneve, urdhër për nxjerrje jashtë përdorimit, etj*".Drejtoria e Hetimit funksionon bazuar në Manualin e Procedurave të Hetimit. Në pikën 5.24 "Dokumentacioni administrative", përcaktohet se gjatë kryerjes së detyrës funksionale të veprimeve në terren, inspektorët duhet të jenë të pajisur me urdhëra pune. Urdhëri i punës është dokument administrativ dhe ligjor i cili urdhëron kryerjen e veprimeve në terren, në ambientin e aktivitetit të tatimpaguesit të identifikuar me NIPT nga strukturat e ZVTMA, por nuk argumenton e vërteton konsumin e karburantit sipas dispozitave ligjore. Ky urdhër pune lëshohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve; Drejtori i Hetimit Tatimor në DPT dhe DHT të Rajonit. *Në urdhër pune përvec objektit të punës, bazës ligjore, pjesëmarrësve në urdhër, automjetit në dispozicion, përcaktohet subjekti përkatës (tatimpaguesi i përcaktuar ose/dhe një listë tatimpaguesish të një veprimtarie të caktuar) që përshkruhet apo /dhe i bashkëlidhen urdhërit të punës si dhe territori ku do të kryhet inspektimi (i detajuar, vendi, adresa përkatëse për cdo subjekt, aksi rrugor i përcaktuar dhe vendi i pikës së kontrollit).*
- Në urdhërin e punës së kësaj drejtorie, sipas dokumentit të miratuar nga Drejtoria e Përgjthshme e Hetimit Tatimor,caktohet grupi i punës, por nuk cilësohet se kush do jetë drejtuesi i automjetit duke sjellë mangësi në hartimin, plotësimin e fletëudhëtimeve, të justifikimit të harxhimit të karburantit dhe të përgjegjësive ligjore që rrjedhin si drejtues i automjetit veprime që bien ndesh me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar* pika 35, "*Dokumenta autorizues - janë ato dokumenta që autorizojnë kryerjen e një veprimi tëcaktuar ekonomik e që i bashkëlidhet dokumentit vërtetues.*".
- Nga auditimi i fletë udhëtimeve të dorëzuara, rezulton se, nuk janë evidentuar saktësishtiteneraret që do të përshkruajnë automjetet për lëvizjet e brendshme dhe të jashtme.Nga fletë udhëtimet e dorëzuara në të shumtën e rasteve rezulton se lëvizjet e brendshme janë të plotësuara me kilometranjësoj fikse për çdo rast,pa përcatuar destinacionet e sakta dhe arrijnë dy/tre here më shumë se kilometrate përshkruaranëlëvizjet e jashtme,si dhejanëtë pa nënshkruara nga punonjësit e administratës për lëvizjet e kryera, veprime që bien ndesh me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar*dhe pika 36 ku citohet: "*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë, si dhe atë të mashtrimeve*".
- ✓ Konstatohet se për të njëjtin mjet dhe itenerar sasia e karburantit të konsumuar është i ndryshëm në ditë të ndryshmesi për lëvizjet e brendshme ashtu dhe të jashtme,si psh Shkodër-

Shkodër, rezulton të jetë e plotësuar nga i njëjti mjet me 30km, 50km, 60km, 40km, 45km; Shkodër-Rrethina me 95 km, 85km,75km, 105km,65 km, 60km, 80, 155km, 135km,140 km,120km, 73km, 139km, 149km etj; Shkodër-Tiranë me 100km, 120km, 140km,155 km etj; Shkodër- Bajram Curri me 240km, 200km; Shkodër-Kukës 240km,220km, Shkodër- Fushë Arrëz me 240km, 160 km, 215 km etj, duke mos përcaktuar drejtë kilometrat e përshkruara dhe sasinë e harxhuar të karburantit.

✓ Për mjetin e drejtorisë rajonale si drejtues mjeti ka nënshkruar drejtori rajonal.

✓ Për mjetet në dispozicion të DHT-së për muajt shkurt, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator të vitit 2018, nuk janë plotësuar fletë udhëtimet që të vërtetojnë lëvizjen e mjeteve e për rrjedhojë sasinë e karburantit të harxhuar. Këto fletë udhëtime në të shumtën e rasteve nuk janë nëshkruar për çdo lëvizje, por me një ose dy nënshkrime të përgjithshme, nga një punonjës si drejtues mjeti. Për vitin 2019 prej DHT-së janë dorëzuar fletë udhëtime vetëm për muajin janar që justifikohet sasia 449 litra nga 669 litra që rezulton të jetë tërhequr nga programi i kartave elektronike.

Sasia e shpenzuar e karburantit e pajustifikuar me fletë udhëtime, për vitin 2018

Tabela nr.48

Nr	MJETI	Shpenzuar sipas Sistemit Elektronik (në litra)	Shpenzuar sipas Fletë Udhëtimeve(në litra)	Diferenca e pa mbuluar me FletëUdhëtime(në litra)
1	AA697LA	869	282	(587)
2	AA681LA	900.01	299	(601.01)
3	AA138LK	713.04	177	(536.04)
4	AA375LI	675	202	(473)
5	TR3197F	288	159	(129)
6	TR3828E	0	62	62
7	AA275PK	1,913.99	527	(1,386.99)
8	AA826LH	544.8	303	(241.8)
9	AA369LI	610	169	(441)
10	TR1288E	1,038.3	204	(834.3)
	TOTAL	**7,552.14**	**2384**	**(5168.14)**

Burimi: Të dhënat nga fletëudhëtimet dhe printimet elektronike e dorëzuara nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse dhe DHTShkodërdhe përpunuar nga grupi i auditimit.

Sasia prej 5168.14 litra karburant (naftë) ose vlera 909,593 lekë (5168.14 litra x 176lekë/litër qëështë çmimi mesatar i blerjes për vitin 2018)është e pajustifikuar me fletë udhëtime.

Nga mosjustifikimi me fletë udhëtimi për sa më sipër për vitin 2018, sasia prej 5168.14 litra në vlerën 909,593lekëkarburant (naftë) përbënefekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit.

Sasia e shpenzuar e karburantit e pajustifikuar me fletë udhëtime, për vitin 2019.

Tabela nr.49

Nr	MJETI	Shpenzuar sipas Sistemit Elektronik në litra	Shpenzuar sipas Fletë Udhëtimeve në litra	Diferenca e pa mbuluar me Fletë Udhëtime në litra
1	AA697LA	1,732.01	80	(1,652.01)
2	AA681LA	1415	26	(1389)
3	AA138LK	1,029.92	40	(989.92)
4	AA375LI	1230	58	(1172)
5	TR3197F	130.2	19	(111.2)
6	TR3828E	55	0	(55)
7	AA275PK	1,891.01	142	(1,749.01)

8	AA826LH	935	0	(935)
9	AA369LI	1,571.2	31	(1,540.2)
10	TR1288E	693	53	(640)
	TOTAL	**10,682.34**	**449**	**(10,233.34)**

Burimi: Të dhënat nga fletëudhëtimet dhe printimet elektronike e dorëzuara nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse dhe DHTShkodër dhe përpunuar nga grupi i auditimit.

Sasia prej 10,233.34 litra karburant (naftë) ose vlera 1,782,834 lekë(nga totali i përdorimit të programittë kartave elektronike 10,682.34 litra ose 1,868,152 lekë- 449 litra ose 85,318 lekë justifikuar me fletë udhëtimi në muajin janar), është e pajustifikuar me fletë udhëtime.

➢ ***Nga mosjustifikimi me fletë udhëtimi për sa më sipër për vitin 2019, sasia prej 10,233.34 litra karburant (naftë) në vlerën 1,782,834 lekë përbën efekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit.***

Veprimet e mësipërmejanë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar Neni 9 : "*Përgjegjshmëria menaxheriale" është detyrimi i menaxherëve të njësive, që, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë. Përgjegjshmëria përfshin çështjet që lidhen me ndarjen e detyrave, zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të gjitha transaksionet financiare, bashkërendimin me shërbimet qendrore të harmonizimit, si dhe me vlerësimin dhe raportimin për sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Përgjegjshmëria menaxheriale përfshin, gjithashtu, përgjegjësinë për veprimet e kryera".* Neni 11 *Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha nive leve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për: 3. Garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në strukturat që ata drejtojnë, bazuar në rregullat e vendosura nga titullari i njësisë publike, si dhe i raportojnë nëpunësit autorizues përkatës për çdo dobësi të sistemit që duhet trajtuar. 4. Ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar" si dhe* me pikën 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
z. [redacted] me detyrë ish drejtor i DHT(për periudhën nga 01.01.2018-20.11.2018), z.[redacted] me detyrë ish drejtor i DHT(për periudhën nga(20.11.2018-11.01.2019 dhe për periudhën nga(20.05.2019-07.10.2019), z.[redacted] me detyrë ish drejtor i DHT(për periudhën nga(17.06.2019-02.07.2019), z.[redacted] me detyrë ish drejtor i DHT(për periudhën nga(09.07.2019-23.09.2019), z.[redacted] me detyrë drejtor i DHT(për periudhën nga(07.10.2019e në vazhdim).

✓ Nuk ka njësistem të kontrollit të brendshëm për përdorimin dhe menaxhimin e karburantit.

✓ Për periudhën e audituar nuk rezulton asnjë planifikim mbi sasinë e karburantit që do të përdoret nga institucioni për çdo mjet transporti sipas normativave të konsumit dhe sasinë e nevojshme të karburantit.

✓ Nuk ka proces-verbal testimi mjeti për përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për 100 km.Institucioni përdor normat e konsumit të vitit 2015 të përcaktuara nga Drejtoria e Administrimit të DPT-së.

✓ Nuk ka asnjë urdhër të brendshëm për disiplinimin e shpenzimeve të transportit, për administrimin dhe përdorimin e karburantit.

Nuk ka kontrolle të shpenzimeve të fondit për karburant që tëverifikojnë nëse fondet publikeshpenzohen me ligjshmëri, sipas qëllimit dhe afateve të përcaktuara, në përputhje me detyrimet e marra përsipër, veprime këto që bien ndesh me Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, neni 11 *Përgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisë Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha nive leve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë e i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për: 3. Garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në strukturat që ata drejtojnë, bazuar në rregullat e vendosura nga titullari i njësisë publike, si dhe i raportojnë nëpunësit autorizues përkatës për çdo dobësi të sistemit që duhet trajtuar. 4. Ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar;* neni 12 Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues 3. Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: *a) garantimin para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, efiçencës dhe efektivitetit; dh) dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi; f) ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar*"; nenit 16 Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit "*2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit*"; Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar nga Ministri i Financave me Urdhër nr 19 me nr.1482/2 prot, datë 22.2.2017 në nenin 30 Përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorit të DFM, pika 5 citohet: Ngre sisteme për ruajtjen dhe mbrojten e aktiveve dhe dokumetacionit nga humbjet, vjedhjet apo keqpërdorimi i tyre, pika 9 Garanton mbështetjen me logjistikën dhe infrastrukturën e nevojshme të aktivitetit të DRT-së.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
z.[redacted] me detyrë ish Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve (për periudhën nga 01.01.2018 deri në datën 08.07.2019), z. [redacted] me detyrë Drejtor Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve (për periudhën nga 16.07.2019 e në vazhdim),znj. [redacted] me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse.

Titulli i Gjetjes **Përdorimi i karburantit në kushtet jo korrekte të zbatimit të kuadrit ligjor të cilat kanë shkaktuar efekte negative në buxhetin e shtetit.**

Situata: **a) Për vitin 2018**gjendja e karburantit në datën 01.01.2018 është 1,002 litra. Janë bërë hyrje gjithsej 15,900 litra, janë bërë dalje 11,919 litra dhe si rrjedhimgjendja e karburantit në datë 31.12.2018 është 4,983 litra.Janë tërhequr nga programi i kartave elektronikegjithsej 10,421.49 litra (tërhequr më pak 1497,51 litra krahasuar me fletëdaljet e magazinës), nga e cila 5,168.14 litra në shumën 909,593 lekë është e pajustifikuar me fletë udhëtime dhe i përket automjeteve në dispozicion të DHT-së.

b) <u>Për vitin 2019</u> gjendja e karburantit në datën 01.01.2019 është 4,983 litra.Janë bërë hyrje gjithsej 13,950 litra, janë bërë dalje 13,600 litra dhe si rrjedhimgjendja e karburantit në datë 31.12.2019 është 5,333 litra.Janë tërhequr nga programi i kartave elektronike gjithsej 13,482.34 litra (tërhequr më pak 117.66 litra krahasuar me fletëdaljet e magazinës), nga e cila 10,233.34 litra shumën 1,782,834 lekë është e pajustifikuar me fletë udhëtime dhe i përket automjeteve në dispozicion të DHT-së.

♦ Kartelat e magazinës janë me korrigjime, mbahen vetëm në sasi dhe jo në vlerë dhe nuk janë të rakorduara me tërheqjet nga programi elektronikprej persove përgjegjës. Fletë daljet e magazinës në shumë raste janë me korrigjime, me fraksione dhe nuk kanë të bashkëlidhur asnjë dokument justifikues, vërtetues që të pasqyrojnë dokumentimin e lëvizjes së karburantit, gjurmën e menaxhimit të tij sipas përgjegjësive, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 38 dhe pikës 40 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 të*"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar.*

♦ Në lidhje me dokumentimin e harxhimt të karburantit nga mjetet në dispozicion të DHT-së për periudhën objekt auditimi është konstatuar se: për muajt shkurt, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator të vitit 2018, nuk janë plotësuar fletë udhëtimet që të vërtetojnë lëvizjen e mjeteve e për rrjedhojë sasinë e karburantit të harxhuar. Fletë e udhëtimit që i përkasin muajve të tjerë në të shumtën e rasteve nuk janë nënshkruar për çdo lëvizje, por me një ose dy nënshkrime të përgjithshme, nga një punonjës si drejtues mjeti. Për vitin 2019 prej DHT-së janë dorëzuar fletë udhëtime vetëm për muajin janar duke justifikuar vetëm sasinë prej 449 litra karburant nga 669 litra që rezulton të jetë tërhequr nga programi i kartave elektronike. Nga rakordimi i sasisë së karburantit të përdorur në programin e kartave elektronike me fletë udhëtimet e dorëzuara për mjetet e transportit në dispozicion të DHT-së konstatohet se për periudhën e audituar sasia totale prej **15,401.48 litra karburant (naftë) në shumën 2,692,427 lekë është e pajustifikuar me fletë udhëtime",** veprim ky në kundërshtim me përcaktimet në nenet 9, 11, 12, 16 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar si dhe pikës 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", konsiderohet efekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit.

c)DRT ka përdorur dhe dokumentuar për nevoja të institucionit 669.5 litra karburant në vlerën 117,949 lekë nga karta Gold (Gjeneratori), kartë e cila ka destinacion përdorimi vetëm për gjeneratorin. Në asnjë rast gjeneratori nuk rezultoi të jetë vënë në punë. **Përdorimi i 669.5 litra karburant(naftë) në vlerën 117,949 lekë,**në kundërshtim me përcaktimet e pikës 34 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik",* i ndryshuar, konsiderohet efekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit.

Kriteri: Ligji Nr.10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar.Udhëzimii Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar.*

Efekti: Moszbatimi i dispozitave ligjore të menaxhimit financiar dhe kontrollit të fondeve buxhetore sjell efekte negative në buxhetin e shtetit.

Shkaku: Mangësi në njohjen dhe zbatimin e ligjit për menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të marrë të gjitha masat për garantimin e gjurmës së auditimit për dokumentimin e shpenzimeve të karburantit (për automjetet dhe kartën GOLD) me qëllim përdorimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore, moszbatimi i së cilës ka sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit gjithsej në shumën 2,810,376 lekë nga e cila 117,949 lekë nga përdorimi jo sipas destinaconit i kartës GOLD(Gjeneratori) dhe 2,692,427 lekë nga mosjustifikimi me fletë udhëtimi nga automjetet në dispozicion të DHT-së**.**

Titulli i Gjetjes **Problematika në lidhje me dokumentimin e përdorimit dhe lëvizjes së automjeteve në pronësi të DRT- së.**

Situata: Nga auditimi u konstatua si vijon:

a)DRT Shkodër kaaktualisht në përdorim 11 automjetetë cilat nuk mbulohen me drejtues mjeti sipas strukturës së miratuar. Në këto kushte automjetet janë përdorur nga punonjës të ndryshëm të DRT, por në asnjë rast nuk ka autorizim të përdorimit për automjetet të DRT-së ku të përcaktohet drejtuesi i mjetit, targa e mjetit, destinacioni, periudha e lëvizjes, veprime që bien ndesh me përcaktimet e pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011*"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik",* i ndryshuar.

b) Në fletë udhëtimet e dorëzuara nuk janë evidentuar saktësisht iteneraret që do të përshkruajnë mjetet, si për lëvizjet e brendshme ashtu dhe të jashtme; kilometrat e përshkruara prej lëvizjeve të brendshme arrijnë dy/tre herë më shumë se kilometrat e përshkruara nga lëvizjet e jashtme dhe fletët e udhëtimit rezultojnë të panënshkruara nga punonjësit e administratës për lëvizjet e brendshme, veprim që bien ndesh me përcaktimet e pikës 36, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011*"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik",* i ndryshuar.

c) Për të njëjtin mjet dhe itinerar sasia e karburantit të konsumuar rezulton e ndryshme në ditë të ndryshme si për lëvizjet e brendshme ashtu dhe të jashtme.

d) Për periudhën e audituar nuk rezulton asnjë planifikim mbi sasinë e karburantit që do të përdoret nga institucioni për cdo mjet transporti sipas normativave të konsumit.

dh) Nuk ka proces-verbal testimi mjeti për përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për 100 km. Institucioni përdor normat e konsumit të vitit 2015 të përcaktuara nga Drejtoria e Administrimit të DPT-së.

e) Nuk ka asnjë urdhër të brendshëm për disiplinimin e shpenzimeve të transportit, për administrimin dhe përdorimin e karburantit.

f) Nuk ka kontrolle të shpenzimeve të fondit për karburant që të verifikojnë

nëse fondet publike shpenzohen me ligjshmëri, sipas qëllimit dhe afateve të përcaktuara, në përputhje me detyrimet e marra përsipër, veprime këto që bien ndesh me përcaktimet e neneve 11,12,16 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar

Kriteri: Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Efekti: Moszbatimi i dispozitave ligjore të menaxhimit financiar dhe kontrollit ka sjellë problematika në verifikimin e ligjshmërisë së shpenzimeve të karburantit.

Shkaku: Kontroll i dobët në dokumentimin dhe menaxhimin e shpenzimeve të karburantit.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi: **1.1.** Titullari i institucionit çdo fillim viti, të ngrejë një komision për testimin e konsumit të karburantit nga mjetet e transportit i cili të dokumentohet në një raport, duke përshkruar në rrugë konkrete normativën e konsumit të karburantit për çdo kategori mjet udhëtimi.

"Çdo vit, NA i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë esistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te NPA në MF. Kjo është një kërkesë e nenit 18, të Ligjit për MFK-në. Raporti duhet të dorëzohet deri në fund të shkurtit dhe mbulon vitin e kaluar financiar (janar-dhjetor). Ai dorëzohet së bashku me deklaratën e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, e cila është gjithashtu një kërkesë e nenit 18. Informacioni i dhënë në raportin vjetor duhet të jetë në

përputhje me deklaratën. Në fakt, deklarata ofron një përmbledhje të konkluzioneve të raportit vjetor.
Përmes raportit vjetor, subjektet e raportimit raportojnë te DH/MFK për funksionimin e sistemit të MFK-së sipas komponentëve të tij"

- **detyrimet e pikës nr. 17 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.28, datë 15.12.2011, "Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike".**

5. Nga auditimi i detyrimeve që burojnë në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale të titullarit të DRT Shkodër, parashikuar në pikën 8, neni 8, të Ligjit nr.10296 dhe nenin 4 dhe 30 tëRregullores për Funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017 konstatohet se kanë gjetur zbatim detyrimet që lidhen me:
-Përgatitjen e planit vjetor operacional për Drejtorinë Rajonale Tatimore, në përputhje me objektivat e përcaktuara në planin strategjik të administratës tatimore dhe menaxhimin e zbatimit tëtij;
-Përgatitjen e programeve mujore të punës sipas planit operacional të DRT;
-Miratimin e sistemit të rregullave e të procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve;
-Vendosjen e linjave të raportimit, që mundësojnë kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre.
Në lidhje me strukturën është përgjegjësi menaxheriale e titullarit propozimi i një strukture të përshtatshme organizative, pasi nga auditimi rezulton se në strukturën e miratuar mungon pozicioni i përgjegjësit të sektorit/zyrës së financës, detyrë që aktualisht e kryen Drejtori i Funksioneve Mbështetëse që njëkohësisht është edhe nënpunësi zbatues i institucionit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 (b), të nenit 22, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar me Ligjin nr.110/2015 datë 15.10.2015, ku shprehimisht citohet:

> *"Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjëstë mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin".*

Njësia nuk ka funksionin e auditimit të brendshëm dhe këto shërbime janë kryer nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të DPT. Auditimi i fundit i DPT, është realizuar sipas programit nr.5572/2, prot, datë 19.03.2018, ndërsa përfundimet janë dërguar me shkresën nr.5572/44 prot, datë 20.06.2018.

- ***Në vlerësimin e sistemit të kontrollit të buxhetit rezultoi se:***

Procedurat e buxhetimit nuk kanë ndjekur gjurmën standarde të parashikuar në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm.
Nga ana e NZ të DRT nuk është përgatitur dokumenti përfundimtar i buxhetit detyrim ky që rrjedh nga: Përcaktimet e pikës 3 të nenit 12 tëtë Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, ku shprehimisht citohet:

> *"Nëpunësit zbatues <u>të të gjitha niveleve të njësisë publike</u> përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:...përgatitjen e dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimin e punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të njësisë ku punojnë".*

Përcaktimet enenit 28 të Rregullores për Funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, ku shprehimisht citohet:

"Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse përgatit kërkesat shtesë për financim buxhetor për DRT duke marrë në konsideratë dhe argumentuar realisht nevojën për financim".

Përcaktimet enenit 19 tëRregullores për Funksionimin e Administratës Tatimore Qëndrore, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, ku shprehimisht citohet:

"Drejtoria e Buxhetit dhe Financës në DPT përgatit kërkesat buxhetore për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve duke marrë në konsideratë kërkesat e argumentuara të Drejtorive Rajonale Tatimore dhe Drejtorive në DPT, nivelin e realizimit të pritshëm të shpenzimeve dhe tavaneve të miratuara për hartimin e këtyre kërkesave".

❖ ***Nga analiza e sistemit të kontrolleve të kontabilitetit rezultoi:***

Janë hartuar rregullat bazë për organizmin kontabël dhe administrimin e pasurisë. Veprimet financiare janë autorizuar sipas rregulloreve dhe veprimet janë regjistruar e dokumentuar rast pas rasti. Procedurat e inventarizimit janë kryer cdo vit por si procedurat e inventarizimit dhe ato të vlerësimit për dalje jashtë përdorimit kanë rezultuar me parregullsi në hartimin e dokumentacionit në kundërshtim me përcaktimet e pikës 83 dhe 85 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", i ndryshuar.

6. Audituesit e KLSH-së konstatojnë se në DRT nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve, monitorimin e kontrolleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, sipas kërkesave të neneve 10, 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të Ligjit nr.10296/ 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar. Konkretisht në nenin 12 të Ligjit nr.10296/ 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar shprehimisht citohet:

"Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për:..identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë…"

Në nenin 21 të të Ligjit nr.10296/ 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, shprehimisht citohet:

"Për të minimizuar riskun e mashtrimit dhe të parregullsive, nëpunësit autorizues të njësive publike regjistrojnë dhe raportojnë masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe të parregullsive".

Në nenin 30 të Rregullores për Funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave, shprehimisht citohet:

"Drejtori i Funksioneve Mbështetëse harton regjistrin e riskut, vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që vënë në rrezzik arritjen e objektivave të Drejtorisë së Funksioneve Mbështetëse dhe realizon përmbledhjen në një regjistër të informacionit nga drejtoritë e tjera në DRT".

7. Grupi i auditimi konstaton se në institucion ka dhomë të serverave, administrimi i të dhënave kryhet nga Sektori i IT. Sistemi i teknologjisë së informacionit siguron një procedurë për hedhjen e të dhënave (data base) në një sistem rezervë, automatik e të sinkronizuar (backup), gjë që mundëson ruajtjen e një kopje të informacionit.

Përsa i takon mbrojtjes së informacionit të përdoruesve dhe kontrollit periodik të pajisjeve dhe sistemeve të instaluara, institucioni zbaton udhëzimet e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për këtë qëllim.

8. Nga ana e DRT Shkodër zbatohen rregullat dhe procedurat për mbrojtjen e aktiveve, për ruajtjen, administrimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, detyrim i parashikuar në nenin 8, germa "ç", të Ligjit nr.10296/2010. Në pajtim me detyrimet e pikës nr.5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, titullari i njësisë publike ka autorizuar inventarizimin cdo vit të pasurisë shtetërore.Konstatohet se, nga ana e Nëpunësit Zbatues, është hartuar regjistri i aseteve, detyrim nga pika nr.26, kreu III, e Udhëzimit të MF nr. 30, date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar. Gjithashtu, në zbatim të kërkesave të kreut IV, paragrafi 74, të Udhëzimit të MF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, janë iniciuar procedurat e inventarizimit të pasurisëdhe të drejtave e detyrimeve 1 herë në vit, sipas urdhrave të veçantë të Titullarit të Institucionit.

9. Nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e nenit 12**,** të Ligjit nr.10296/2010, mbi përgjegjësitë menaxheriale të nëpunësit zbatues për garantimin e gjurmës së auditimit, ku shprehimisht përcaktohet:

"Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare dhe të tjera dhe garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi".

Grupi i auditimit sjell në vëmendje se:

- Sipas cilësimeve të pikës nr.19, neni 4 të Ligjit nr.10296/2010:

"Gjurma e auditimit" përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. "

- Sipas kreut 3.3. "Aktivitetet e kontrollit" të Manualit të MFK

"Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen eecurisë së një proçesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe isntitucioneve të jashtme. Përveç kësaj, gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një proçesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

Analiza e Komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe KB:

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm.

a. Vendosja e objektivave

Për periudhën objekt auditimi, DRT ushtron veprimtarinë mbështetur në Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar si dhe në

Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për funksionimin e administratës tatimore qëndrore".
Zhvillimi i MFK-së kërkon gjithashtu zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme. Drejtoritë e vecanta nuk kanë hartuar regjistër risku dhe për më tepër Drejtori i Funksioneve Mbështetëse që njëkohësisht është edhe NZ nuk ka hartuar regjistrin përmbledhës për DRT, detyrim ky që rrjedh nga zbatimi i kërkesave të nenit 12 të Ligjit nr.10296/ 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar dhe nenit 30 tëRregullores për Funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave.
Konstatohet se nivelet menaxheriale nuk kanë zhvilluar trajnime të dedikuara mbi njohuritë për menaxhimin financiar dhe kontrollin.

b. Etika personale dhe profesionale.
Lidhur me respektimin e etikës nga punonjësit e DRT Shkodër, konstatohet se këto norma janë përcaktuar në Kodin e Etikës për punonjësit e Administratës Tatimore Qëndror, konform përcaktimeve të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 20 "Mjedisi i kontrollit", pika 2, germa " a" dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 "Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)", paragrafi "Integriteti dhe vlerat etike**".**

c. Struktura organizative.
Për periudhën objekt auditimi institucioni ka ushtruar funksionet nëpërmjet strukturës organizative, miratuar me: Urdhrin e Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 "Për miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore";
Urdhrin nr.49, datë 27.02.2019 "Për disa ndryshime në Urdhrin e Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 "Për miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore", si dhe Urdhrin nr.171, datë 13.05.2019. Konstatohet një numër i konsiderueshëm emërimesh dhe largimesh nga detyra përgjatë periudhës së auditimit.

d. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.
Punonjësit e institucionit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar dhe me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995"Kodi i Punës", i ndryshuar.

e. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.
Procedurat për emërimet dhe largimet nga puna rezultojnë të jenë kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe vendimi i marrë rast pas rasti i është përcjellë zyrtarisht Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër. Referuar rregullores së funksionimit të administratës tatimore qëndrore, miratuar me Urdhrin e Mininistrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, është detyrë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT të ndjekë, zbatojë dhe sigurojë procedura për rekrutim, zhvillimin profesional dhe motivimin e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim arritjen e objektivave të institucionit. Është po kjo drejtori e cila përgatit akt-emërimet, akt-largimet dhe kontratat e punës për të gjithë

punonjësit e Administratës Tatimore në bazë të kërkesave ligjore në vijim të vendimeve të Departamentit të Administratës Publike dhe të Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe menaxhon procedurat e rekrutimit dhe të emërimit, të ngritjes në detyrë dhe lëvizjes paralele në përputhje me Ligjin për Statusin e Shërbimit Civil, Ligjin e Proçedurave Tatimore, Kodin e Punës dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave dhe akteve të tjera nënligjore.
Manuali i MFK, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave, nr.108, datë 17.11.2016,

❖ Në lidhje me strukturat organike ka vendosur si parakushte :

• Një procedure transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve;
•Kritere dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent;
•Një sistem trajnimi dhe kualifikimi që synon t'i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur;
•Një sistem për vlerësimin e performancës që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt;

Detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse të njësisë, janë të përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit. Për kryerjen e aktivitetit normal, institucionit i nevojiten disa ndryshime në organikë, duke shtuar pozicionin e përgjegjësit të financës, detyrë të cilën e kryen NZ.
Nga ana e DRT Shkodër nuk ka një planifikim të nevojave për punonjës me kontratë të përkohshme, nuk është realizuar një procedurë transparente për rekrutimin në punë të tyre, nuk janë hartuar kriteredhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale për kandidatët, si dhe nuk janë hartuar përshkrimet e punës për secilin pozicion pune, ndonëse në këtë drejtori janë punësuar në total për vitet 2018-2019, 52 punonjës pagesa e të cilëve në shumën totale prej 12,733,133 lekë, prej të cilave 7,074,945 lekë paguar në vitin 2018 dhe 5,658,188 lekë në vitin 2019, konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.
Nga ana e DRT Shkodër, rezulton të jenë kryer vlerësime vjetore të punës për punonjësit, lidhur me detyrat që ata kryejnë, në përputhje me përcaktimet e rregullores se brendshme.Procesi i vlerësimit të punës për punonjësit me status të nënpunësit civil është bërë 2 herë në vit dhe i është përcjellë zyrtarisht DPT me shkreësën nr.5932/1, datë 04.07.2018 "Vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën janar-qershor 2018"; me shkresën nr.11591/1, datë 07.01.2019 "Vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën 01.07.2018- 31.12.2018"; me shkresën nr.5209/2, datë 04.07.2019 "Vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën janar-qershor 2019"; me shkresën nr.11134/1, datë 07.01.2020 "Vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën 01.07.2019-31.12.2019";
Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale DPT disponon plane të trajnimeve (sidomos për legjislacionin tatimor), dhe disponon një data-base mbi trajnimet dhe kualifikimet e stafit të institucionit publik, për periudhën e audituar nga KLSH. Sa më sipër, kanë gjetur zbatim kërkesat e pikas nr. 3/1 , nënçështja "Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore", të Kapitullit III të Manualit të MFK 2016. Nga auditimi u konstatua se, nga institucioni nuk janë kryer trajnime për gjithë stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe eficencës së punës dhe menaxhimin e fondeve publike së njësisë menaxhuese.

2.Vlerësimi i riskut *(a bën njësia vlerësim risku, a është i plotë dhe përditësohet, a është i bazuar ne analiza etj).*

-Nga auditimi i kryer për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave, rezulton se në institucionin e DRT Shkodër, nuk janë identifikuar risqet që kërcënojnë objektivat nuk është hartur regjistri i risqeve, nuk është caktuar koordinatori i risqeve dhe mungon një plan veprimi për menaxhimin e risqeve në fushat e këtij institucioni.

Auditimi konstaton se:

Për vetë natyrën e këtij institucioni, koncepti i "Menaxhimit të Riskut" dhe vendosjes së kontrolleve si përgjigje ndaj tij, mbetet një çështje që kërkon vëmendjen e posaçme nga drejtuesit e DRT Shkodër.

3.Aktivitetet e kontrollit: *(a janë ndarë si duhet detyrat, a ka funksione të papajtueshme që kryhen nga i njëjti person, a dokumentohen si duhet të plota, të sakta e të kuptueshme transaksionet, a ka rregulla se si ruhen asetet, si përdoren si nxirren jashtë përdorimit, etj).*

Nga misioni i auditimit vërehet se ekziston një përcaktim dhe ndarje e qartë e detyrave dhe përgjegjësive lidhur me menaxhimin e aktiveve, por struktura aktuale nuk i përgjigjet mbulimit të të gjitha funksioneve të parashikuara, duke krijuar konflikt interesi dhe mbivendosje detyrash. Psh, Drejtori i Funksioneve Mbështetëse që njëkohësisht është dhe NZ i institucionit ka rezultuar që të jetë pjesë e integruar e procedurave të prokurimit me vlera të vogla, që nga procesi i planifikimit të nevojave, prokurimi, marrja në dorëzim, kryerja e transaksionit financiar si dhe kontabilizimi i shpenzimeve dhe reflektimi i tyre në pasqyrat financiare të institucionit.

U konstatua se ekzistojnë dhe zbatohen procedurat përkatëse të shpallura mbi administrimin material të aktiveve dhe për cdo vit NA ka autorizuar kryerjen e inventarizimit të pasurisë shtetërore.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që kanë si qëllim reduktimin e risqeve me synim arritjen e objektivave. Në DRT proceset kryesore të punës operacionale dhe financiare janë të shkruara në strukturën organike dhe në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e institucionit. Nëpunësi autorizuar në bazë të ligjit për buxhetin merr përsipër angazhimet për realizimin e programit buxhetor afatmesëm. Transaksionet financiare kryen në bazë të rregullave të vendosura nga Ministria e Financave dhe për çdo transaksion zbatohet rregulli i firmës së dyfishtë.

Regjistrimet kontabël kryen me anë të programit financiar "ALPHA".

4. Informacioni dhe Komunikimi (a ka rregulla të shkruara ku bazohet komunikimi brenda njësisë, si zbatohen ato).

Drejtuesi i DRT Shkodër, përgjegjësit e sektorëve dhe NZ i njësisë nuk zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar.

Titullari informohet nga drejtuesit e drejtorive, me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve dhe raporteve të ndryshme. Nëpërmjet raportimit tek eprori i drejtpërdrejtë, sigurohet dhe komunikimi mbi parregullsitë dhe problemet.

Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me shkrim, dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme.

Funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm nga lart poshtë ka shfaqur probleme, të cilat janë reflektuar në parregullsitë e konstatuara në procedurat e: prokurimit me vlera të vogla; inventarizimit të pronës shtetërore; në autorizimin dhe dokumentimin e shpenzimeve për udhëtim e dieta brenda vendit; në pagesat e punonjësve; në procedurat e rekrutimit të punonjësve me kontratë të përkohshme, në dokumentimin e harxhimit të karburantit, etj.
Informimi është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen me cilësi të detyrave të ngarkuara dhe i duhet komunikuar titullarit dhe nëpunësve të tjerë në formën dhe kohën e duhur për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive.
Sistemi i IT-së, eshtë i pajisur me një sistem rezervë (back-up) i cili garanton hedhjen e të dhënave dhe ripërfitimin e tyre, në rast aksidenti për shërbimet financiare. Institucioni komunikon në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashme.

5.Monitorimi*(a ka një sistem të monitorimit të përditshëm të të gjitha operacioneve të punës, a janë të specifikuara se cili autoritet është i ngarkuar për monitorimin dhe kujt i raporton).*

Në DRT Shkodër është ngritur një sistem monitorimi, i pasqyruar në ndarjen e detyrave midis hallkave, ku janë specifikuar përgjegjësitë e drejtuesve për mbikëqyrjen e zyrave që mbulojnë. Nivelet më të ulëta drejtuese në bazë të ligjit dhe strukturës, raportojnë tek niveli më i lartë.

Në institucion, titullari i njësisë informohet vazhdimisht nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të informacioneve, evidencave të ndryshme dhe raporteve periodike (javore, mujore dhe tremujore), me shkrim, apo verbalisht.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:
Në DRT Shkodër funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ka shfaqur probleme dhe për ta përmirësuar atë në të ardhmen kërkohet një vëmendje e shtuar për implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Në lidhje me këtë cështje, nga grupi i auditimit u mbajt Akt Konstatimi, nr.2, datë 20.02.2020, protokolluar në DRT me nr.331/4, datë 21.02.2020.

Titulli i Gjetjes:	**Problematika të shfaqura në funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.**
Situata:	Për periudhën objekt auditimi grupi i auditimit ka konstatuar problematika në funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si vijon: a)Aktet dhe dispozitat që rregullojnë funksionimin e institucionit (rregullorja dhe struktura e miratuar), nuk janë në koherencë midis tyre pasi, ndryshimet strukturore të DRT Shkodër nuk janë reflektuar me ndryshime të rregullores. Gjithashtu struktura aktuale e DRT-së, nuk i përgjigjet mbulimit të të gjitha funksioneve të parashikuara, duke krijuar konflikt interesi dhe mbivendosje detyrash. Psh, Drejtori i Funksioneve Mbështetëse që njëkohësisht është dhe NZ i institucionit ka rezultuar që të jetë pjesë e integruar e procedurave të prokurimit me vlera të vogla, që nga

procesi i planifikimit të nevojave, prokurimi, marrja në dorëzim, kryerja e transaksionit financiar, kontabilizimi i shpenzimeve dhe reflektimi i tyre në pasqyrat financiare të institucionit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 (b), të nenit 22, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar ku shprehimisht citohet: *"Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin".*

b) Nga ana e DRT Shkodër nuk janë përgatitur dhe nuk janë dorëzuar brenda afateve ligjore Pyetësorët e Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për vitin 2018 dhe 2019, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 18, të Ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar dhe pikat nr.4 dhe 6, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.28, datë 15.12.2011.

c)Procedurat e buxhetimit nuk kanë ndjekur gjurmën standarde të parashikuar në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm. Nga ana e NZ të DRT nuk është përgatitur dokumenti përfundimtar i buxhetit veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 të nenit 12 tëtë Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010; nenit 28 tëRregullores për Funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore; nenit 19 tëRregullores për Funksionimin e Administratës Tatimore Qëndrore, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017.

d)Në DRT nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale për: Identifikimin e risqeve që kërcënojnë objektivat e institucionit; Krijimin e regjistrit të risqeve; Caktimin e koordinatorit të risqeve dhe mungon një plan veprimi për menaxhimin e risqeve në fushat e këtij institucioni, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e neneve 10, 11 /2, 12 /3, 9.4 /c dhe 21 të Ligjit nr.10296/ 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar; nenit 30 tëRregullores për Funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017.

e)Nuk kanë gjetur zbatim detyrimet e nenit 12**,** të Ligjit nr.10296/2010, i ndryshuar, mbi përgjegjësitë menaxheriale të nëpunësit zbatues për garantimin e gjurmës së auditimit**.**

f)NA, NZ dhe drejtuesit e tjerë të strukturave të DRT-së Shkodër nuk zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimin dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin.

Kriteri: Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.

Manualit të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Rregullore për Funksionimin e Drejtorive Rajonale, miratuar me Urdhrin

Mininistrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017.
Urdhri i Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016 "Për miratimin e strukturës dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore", i ndryshuar.

Ndikimi: Shpenzime në kushtet e paligjshmërisë.

Shkaku: Mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: DRT të marrë masa për implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, duke synuar vendosjen e procedurave dhe rregullave të qarta për parandalimin e fenomeneve negative, verifikimeve, autorizimeve, ndarjen e detyrave sipas funksioneve dhe roleve të çdo nëpunësi, zhvillimin e dedikuar profesional të punonjësve me qëllim garantimin e përdorimit me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Afati për zbatimin e rekomandimit: **Menjëherë dhe në vijimësi**

IV/6. Trajtimi i ankesës protokolluar në KLSH me nr.138, prot, datë 27.01.2020

Pranë KLSH, me nr.138, prot, datë 27.01.2020ka ardhur një denoncim i bërë edhe në portalin www.shqipëriaqëduam.al dhe www.stopinformalitetit.al, për subjektet [redacted] dhe Babani MG, subjekte që ushtrojnë aktivitetin në juridiksionin e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër. Situata për të cilën është bërë ky denoncim, paraqitet si vijon:

- Shoqëria [redacted] shpk me NUIS [redacted] është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Gjykatën e Tiranës me vendimin nr.12679, datë 11.10.1995;
- Me vendimin nr.2, datë 29.06.2009, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë [redacted], ka vendosur të rrisë kapitalin nga 28,821,104 lekë në 42,871,000 lekë, rritje kjo e ardhur nga fitimi i pashpërndarë i cili është destinuar për rritje kapitali;
- Në datë 24.06.2017, Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë [redacted], ka vendosur të rrisë përsëri kapitalin me 153,929,000 lekë, shumë kjo që përfaqëson fitimin e shoqërisë për vitin 2016, duke e cuar kapitalin e shoqërisë bëhet 196,800,000 lekë;
- Ortaku i vetëm i shoqërisë z.[redacted],zotëruesi 100% i kuotave në datë 07.08.2019, ka marrë vendimin për zvogëlimin e kapitalit në shumën 30,800,000 lekë. Kapitali pas zvogëlimit është 166,000,000 lekë;

- Në datë 04.09.2019, z.[redacted], i dhuron të 100 kuotat me vlerë 166,000,000 lekë, z.XXXXX, i cili pas dhurimit bëhet ortaku i vetëm i shoqërisë [redacted], veprim ky i rregjistruar në QKB.

Gjithashtu z.[redacted], aksioner i shoqërisë [redacted] shpk, në datë 04.09,2019, i dhuron z.[redacted], kuota në masën 50% me vlerë 13,900,000 lekë. Në letë r citohet se, në të dy rastet e sipërcituara z.[redacted] nuk ka paguar tatim mbi të ardhurat.

Ky denoncim u protokollua në DRT Shkodër nga grupi i auditimit, me nr.1600, datë 17.02.2020.

Në përgjigje të këtij denoncimi vjen reagimi i Drejtorit Rajonal të Tatimeve Shkodër, i cili me shkresën nr. 1600/1, datë 18.02.2020, vë në dispozicion të grupit të auditimit praktikën shkresore të ndjekur nga DRT Shkodër në lidhje me rastin e sipërcituar.

- Për këtë rast ka paraqitur kërkesë për vlerësim tatimor Drejtoria e Hetimit Tatimor Rajoni Verior Shkodër me shkresën nr.1927, datë 07.11.2019;
- Në vijim të kësaj kërkese Drejtori Rajonal i është drejtuar për interpretim Drejtorisë Ligjore dhe Teknike në DPT, me shkresën nr.10068/1, datë 11.11.2019;
- DPT me shkresën nr.20904/1, datë 31.12.2019, protokolluar në DRT Shkodër me nr.7, datë 06.01.2020, ka dhënë këtë interpretim:

- Për dhurimet e formave të tjera të ndryshme nga pasuria e paluajtshme, sic mund të jenë dhurime të aksioneve/kuotave, në dispozitat e legjislacionit tatimor në fuqi nuk ka përcaktime eksplicite. Për këtë, kur mungojnë përcaktimet eksplicite, duhet gjykuar në logjikën e taksimit të ndershëm, në mënyrë që të minimizohen hapsirat e shmangies duke siguruar shpërndarje korrekte të barrës tatimore mbi tatimpaguesin;

- Personit të cilit i dhurohen aksionet/kuotat, nuk bëhet përgjegjës për ndonjë tatim, por ai do të jetë subjekt i tatimit nëse i shet këto kuota dhe realizon fitim kapital prej tyre. Në rastin e dhurimit të aksioneve/kuotave, vlera nominale e aksionit/kuotës që do të përfitohet nga përfituesi i dhurimit do të jetë vlera nominale ose e blerjes së aksionit/kuotës nga dhuruesi i aksionit/kuotës dhe jo vlera e aksionit /kuotës në momentin e dhurimit;

DPT kërkon nga DRT Shkodër të analizohet personi që "dhuron" aksionet/kuotat, në drejtim të verifikimit të rritjes së kapitalit, verifikimit nëse ky kapital shtesë dhe kjo kuotë është me burim fitimin e pashpërndarë, apo ka ndodhur rritje kapitali e mëvonshme, apo kemi të bëjmë me rivlerësim aktivesh dhe rezervë kapitali. Këtë kërkesë për verifikim DPT e mbështet në përcaktimet e Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku tagrin për kontroll dokumentacioni dhe kontroll transaksionesh të kryera nga tatimpaguesi e ka Drejtoria Rajonale ku ai është i regjistruar.

- Drejtori Rajonal i Tatimeve Shkodër në shkresën drejtuar Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni Verior Shkodër, me nr.10068/2, datë 07.01.2020, i paraqet interpretimin e DPT për këtë cështje, duke theksuar se:
- *Për dhurimet e formave të tjera të ndryshme nga pasuria e paluajtshme, sic mund të jenë dhurime të aksioneve/kuotave, në dispozitat e legjislacionit tatimor në fuqi nuk ka përcaktime eksplicite;*
- *Personit të cilit i dhurohen aksionet/kuotat, nuk bëhet përgjegjës për ndonjë tatim, por ai do të jetë subjekt i tatimit nëse i shet këto kuota dhe realizon fitim kapital prej tyre. Deri në këtë moment nuk ka shitje të aksioneve/kuotave;*
- *Për personin i cili dhuron aksione/kuota aktet nënligjore nuk e klasifikojnë si të tatueshëm fitimin kapital nga dhurimi i kuotave.*

Konkluzioni i nxjerrë nga DRT Shkodër është se për këtë transaksion të kryer nuk kanë lindur detyrime tatimore. Me këtë shkresë DRT Shkodër e konsideron të mbyllur trajtimin e kësaj cështjeje.

Grupi i auditimit kërkoi nga DRT Shkodër të analizonte rritjen e kapitalit të tatim paguesit [redacted] me NUIS [redacted] deri në vlerë n 27,800,000 lekë, në drejtim të verifikimit nëse ky kapital shtesë dhe kjo kuotë është me burim fitimin e pashpërndarë, kërkesë kjo e DPT-së lënë me shkresë n nr.20904/1, datë 31.12.2019, e parealizuar deri në momentin e auditimit.
Në përgjigje të kërkesës së grupit të auditimit, DRT Shkodër, me shkresën nr.1600/2, datë 26.02.2020, informon si vijon:

- Vlera e kapitalit themeltarnë datë 31.01.2012, datë në të cilën është themeluar Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "[redacted]" është **5,000,000** lekë.
- Me Vendimin nr.1, datë 25.06.2013, Asambleja e ortakë ve të shoqërisë "[redacted]" ka vendosur që fitimin neto në fund të vitit 2012 në shumë n **3,666,145** lekë ta kalojë në rezerva të tjera dhe nuk ka miratuar shpë rndarje dividenti.
- Me Vendimin nr.3, datë 30.06.2014, Asambleja e ortakë ve të shoqë risë ka vendosur që fitimin neto në fund të vitit 2013 në shumë n **5,498,344** lekë ta kalojë në rezerva kapitali dhe nuk ka miratuar shpë rndarje dividenti.
- Me Vendimin nr.4, datë 26.06.2015, Asambleja e ortakë ve të shoqë risë ka vendosur që fitimin neto në fund të vitit 2014 në shumë n **6,730,601** lekë ta kalojë në rezerva kapitali dhe nuk ka miratuar shpë rndarje dividenti.
- Me Vendimin nr.2, datë 21.06.2016, Asambleja e ortakë ve të shoqërisë ka vendosur që fitimin neto në fund të vitit 2015 në shumën **3,658,814** lekë ta kalojë në rezerva të tjera.
- Me Vendimin nr.1/1, datë 24.06.2017, Asambleja e ortakëve të shoqërisë ka vendosur kalimin e fitimeve dhe rezervave në kapital në shumën **22,800,000** lekë. Kapitali themeltar shtohet me **22,800,000** lekë dhe arrin në shumën 27,800,000 lekë, i cili zotërohet 50% nga ortaku [redacted] dhe 50% nga ortaku [redacted], në pjesë të barabarta nga 13,900,000 lekë secili.
- Me Vendimin nr.3, datë 30.06.2018, Asambleja e ortakëve të shoqërisë ka vendosur miratimin e fitimit të vitit 2017 në shumën **6,476,163** lekë i cili shpërndahet: 176,163 lekë shkon pë r rezerva ligore; 3,300,000 lekë për rezerva investimi dhe 3,000,000 lekë shpërndarje dividenti.
- Me Vendimin nr.2019/1, datë 19.07.2019, Asambleja e ortakëve të shoqërisë ka vendosur që fitimin e vitit 2018 në shumën **8,663,072** lekë ta shpërndajë : 663,072 lekë në rezerva të tjera dhe 8,000,000 lekë shpërndarje dividenti.

Sic shihet Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "[redacted]", që nga themelimi i saj në vitin 2012 e deri vitin 2019, ka shpërndarë vetëm 2 (dy) herë dividentë : Në vitin 2018 në shumë n 3,000,000 lekë dhe në vitin 2019 në shumë n 8,000,000 lekë.
Nga të dhënat e sistemit të tatimeve rezulton se:

- Në Korrik 2018 është deklaruar shpërndarje dividenti në shumën 3,000,000 lekë , për të cilën në datë 20.08.2018, është paguar tatim në shumën 450.000 lekë.
- Në Korrik 2019 është deklaruar shpërndarje dividenti në shumën 8,000,000 lekë , për të cilën në datë 25.08.2019, është paguar tatim në shumën 640.000 lekë.

Shoqëria [redacted] shpk me NIPT [redacted], është subjekt që ushtron aktivitetin në juridiksionin e Drejtorisë së Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe mbështetur nëpërcaktimet e Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,tagrin për kontroll dokumentacioni dhe kontroll transaksionesh të kryera nga tatimpaguesi e ka Drejtoria ku ai është i regjistruar. Për këtë arsye nga DRT Shkodër nukështë kryer asnjëanalizë në drejtim të verifikimit të rritjes së kapitalit të kësaj shoqërie.

Grupi i auditimit nuk mund shprehet në lidhje me përgjegjësinë për trajtimin që DRT Shkodër i ka bërë kësaj cështje, pasi interpretimin ligjor e ka dhënë vetë DPT, ku në shkresën nr. nr.20904/1, datë 31.12.2019, protokolluar në DRT Shkodër me nr.7, datë 06.01.2020, shprehimisht citon:

"*-Për dhurimet e formave të tjera të ndryshme nga pasuria e paluajtshme, sic mund të jenë dhurime të aksioneve/kuotave, në dispozitat e legjislacionit tatimor në fuqi nuk ka përcaktime eksplicite. Për këtë, kur mungojnë përcaktimet eksplicite, duhet gjykuar në logjikën e taksimit të ndershëm, në mënyrë që të minimizohen hapsirat e shmangies duke siguruar shpërndarje korrekte të barrës tatimore mbi tatimpaguesin;*

-Personit të cilit i dhurohen aksionet/kuotat, nuk bëhet përgjegjës për ndonjë tatim, por ai do të jetë subjekt i tatimit nëse i shet këto kuota dhe realizon fitim kapital prej tyre. Në rastin e dhurimit të aksioneve/kuotave, vlera nominale e aksionit/kuotës që do të përfitohet nga përfituesi i dhurimit do të jetë vlera nominale ose e blerjes së aksionit/kuotës nga dhuruesi i aksionit/kuotës dhe jo vlera e aksionit /kuotës në momentin e dhurimit".

Opinioni i grupit të auditimit:

Të ardhurat nga dhurimi i aksioneve **janë të ardhura të tatueshme**, bazuar kjo në përcaktimet e pikës g të nenit 8 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat ", i ndryshuar, ku shprehimisht citohet:

> *"Të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë".*

Si dhe në faktin që, Ligji nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat ", i ndryshuar në nenin 8/1 "Të ardhura të përjashtuara", nuk e ka përjashtuar në mënyrë eksplicite këtë lloj të ardhure.

V. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të auditimin rezultuan gjetje me rekomandimet përkatëse si më poshtë vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave rezultoi se ky sektor megjithëse ka një sërë detyrash funksionale për periudhën objekt auditimi ka rezultuar me mungesa në organikë (e konkretisht të përgjegjësit të sektorit dhe të një specialisti) pra ka funksionuar pa drejtues dhe të një specialisti, pra dy mungesa në organikë, nga 4 sipas organikës së miratuar gjë që ka ndikuar në përmbushjen të detyrave

funksionale në kohë dhe në respektim të dispozitave ligjore. Nga auditimi i punës së këtij sektori u evidentuan mangësi në lidhje me ndjekjen e detyrimeve në rrugë administrative në drejtim të bashkive debitore referuar mungesë së shkresave drejtuar bashkive debitore në kohën e krijimit. Mos arkëtimi në kohë i detyrimeve tatimore ndikon edhe në raportimet e kryera në DPT për realizimin e të ardhurave mujore, tre mujore dhe vjetore dhe si rrjedhojë në të ardhurat vjetore të realizuara nga taksa dhe tatime të derdhura në buxhetin e shtetit, veprime që bien ndesh me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 " Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. (Trajtuar më hollësisht në faqen 35-37 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 1. Titullari i Institucionit të marrë masat që deri në plotësimin e strukturës, të ndajë përgjegjësitë në punonjësit e tjerë me qëllim eliminimin e mangësive të konstatuara.

Deri në fund të vitit 2020.

2. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi u konstatua gjendje e lartë e detyrimeve debitorëve, detyrime të cilat kryesisht të krijuar nga viti 2008 e në vazhdim, të cila mbahen në DRT Shkodër jashtë sistemit informatik C@T (sistem informatik i të dhënave sipas tatimpaguesve) por që janë të regjistruara në kontabilitetin e DRTShkodër, referuar të dhënave nga pasqyrat financiare viti 2018 dhe të vitit 2019, e konkretisht të llogarisë 468 "*Debitorë të ndryshëm*", sipas burimeve të krijimit, kështu:

Në pasqyrat financiare viti 2018, llogaria 468 "*Debitorë të ndryshëm*", është në vlerën 19,603,327 lekë, (Aneksi nr.1) detyrime që sipas burimeve të krijimit përbëhen nga:

a. Detyrime të pa arkëtuara ndër vite në shumën prej 11,913,051 lekë nga viti 2005, të mbajtura jashtë sistemit informatik tatimor C@TS, detyrime të përbëra për tatim mbi të ardhurat personale (për 1 subjekt), detyrim mbi tatim fitimin (për 1 subjekt),detyrime për TVSh(për 2 subjekte), detyrime për kontribute të sigurimeve shoqërore (për 145 subjekte).Theksojmë se detyrimet e mësipërme janë detyrime, gjoba dhe penalitete të cilat nuk janë arkëtuar deri tani pasi janë subjekte që rezultojnë pa nipt, të çregjistruar nga QKR. Gjithashtu theksojmë se për mungesë dokumentacioni në DRT Shkodër për këto subjekte nuk ka bërë të mundur hedhjen e këtyre detyrimeve në sistemin informatik C@TS të DPT.

b. Detyrime në shumën prej 5,026 lekë (1% i pa derdhur), në favor të DRT Shkodër, si agjent tatimor e cila përfaqëson grande nga transferime të pa arkëtuara për detyrime nga institucione si Bashkia Shkodër dhe Fushë Arrës për 1% e në lidhje me arkëtimin pagesën e tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogël.

c. Detyrimi në shumën prej 7,685,250 lekë për pulla takse pranë të tretëve (gjendje në fund të vitit e papërdorur në gjykata, prokuroria, bashki të Qarkut të Shkodrës (zyra e gjendjes civile), në zbatim të kërkesave të ligjit nr.9975, datë 28.02.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.26, datë 04.09.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, të cilat përfitojnë si agjentë tatimorë, komisione në masën prej 5% (zyra e gjendjes civile) dhe gjyqësorit (nga pulla takse) në masën 5% dhe 10% që duhet të derdhin detyrimin ndaj DRT në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Drejtësisë nr.33, datë 29.12.2014 " Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore e ministrisë së drejtësisë", "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor shtetëror", prokurorisë dhe noterisë, pasi përfitojnë 10% komisione nga shërbimi që kryhet në gjykatë, prokurori. Detyrimi në vlerë në fund të vitit 2018 është në vlerë 7,685,250 lekë dhe i përket viteve 2017-

2018 për 10 subjekte, detyrim i cili është me shpresë arkëtimi pasi arkëtohet në vijimësi nga përdorimi i pullave gjatë vitit 2019.
Në fund të vitit 2019, detyrimeve debitorëve janë në shumën prej *18,167,500 lekë (Aneksi 1/1), referuar të dhënave të llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm" sipas pasqyrave financiare viti 2019 në DRT, e krahasuar me gjendjen në fund të vitit 2018 ka pësuar rënie në shumën prej 1,435,827 lekë ose 7,3% dhe që ka ardhur si pasojë*
a. Shtesës së detyrimeve në shumën prej 26,599 lekë, të krijuara nga viti 2017-2019, të cilat janë grande nga transferime të pa arkëtuara për detyrime për 1% e TFTH mbi biznesin e vogël dhe që i përkasin 282 subjekte që i përkasin 5 bashkive (Bashkitë Shkodër, Koplik, Fushë Arrëz, Pukë dhe Vau Dejës). Të ardhurat nga tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël të arkëtuara nga DRT, i përket Bashkisë Shkodër në shumën prej 12,965 lekë, Bashkisë Koplik në shumën prej 5,384 lekë, Bashkisë Fushë Arrëz në shumën prej 1,264 lekë, Bashkisë Pukë në shumën prej 552 lekë, Bashkisë Vau Dejës në shumën prej 6,434 lekë. Ky detyrim është e ardhur për DRTShkodër në cilësinë e agjentit tatimor në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9975, datë 28.02.2008 " Për taksat kombëtare", i ndryshuar si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.32, datë 31.12.2013 " Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", e pa arkëtuar deri më 31.12.2019.
b. Uljes së detyrimit për pulla takse, në shumën 6,227,850 për vitin 2017-2019 për 12 subjekte tatimpagues, e cila përfaqëson detyrimin e pa derdhur për furnizim pulle nga institucionet të drejtësisë Qarku Shkodër dhe të zyrave të gjendjes civile pranë bashkive për përdorimin e taksës së pullës nga të tretët për akte administrative dhe certifikata të gjendjes civile. Ky detyrim i përket pullave deklaruar të pa përdorura gjendje në fund të vitit 2019.
Konstatohen mos veprime nga DRT Shkodër nëpërmjet Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave për mbledhjen dhe ndjekjen e detyrimeve, procedura administrative në drejtim të institucioneve përgjegjëse debitore në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9928 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", i ndryshuar e cila sjell efekte negative në të ardhurat e DRT Shkodër. (Trajtuar më hollësisht në faqen 120-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 2.1. Të meren masa urgjente nga DRTShkodër në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në DPT për trajtimin e gjendjes së lartë të debitorëve të cilat mbahen jashtë sistemit informatik ndër vite dhe të detyrimeve të tjera të rezultuara gjendje në pasqyrat financiare në fund të vitit 2019 duke kryer analizat dhe nxjerrë përgjegjësitë individuale për veprimet dhe mosveprimet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Rekomandimi 2.2. DRT Shkodër nëpërmjet strukturës së përkatëse (Sektorit të Analizës dhe të Kontabilitetit të Ardhurave), të ndërmarrë iniciativa e duhura administrative dhe ligjore në drejtim të arkëtimit të detyrimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe të ndjekë arkëtimin e detyrimit (për taksë pulle e pa përdorur në fund të vitit 2018 dhe 2019) në shumën 6,161,250 lekë,që përfaqëson të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Deri në muajin korrik të vitit 2020.

3. Gjetje nga auditimi: Në DRT Shkodër u konstatua mos lëvrim të mallrave të konfiskuara nga Drejtoria e Hetimit Tatimor në DRT Shkodër nga viti 2012 në Drejtorinë e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit (DPRMSh), sipas dispozitave ligjore. Nga auditimi rezultoi se në DRT Shkodër gjenden mallra të konfiskuara nga viti 2012, dhe të bëra hyrje pa fletë analize në magazinë më 31.12.2019 në vlerë prej 282,737,52 lekë të përbëra nga ar në sasi 93.4 gram,

argjend në sasi prej 303 gram dhe sermë në sasi prej 497 gram. Këto mallra të konfiskuara nga viti 2012 nuk janë kaluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008 "Për rezervat materiale të shtetit", neni 2/pika 16, pasi në DRTShkodër nuk janë kryer në kohë këtyre mallrave analizave duke dokumentuar nëpërmjet hartimit të fletëanalizës dhe demonstruar vërtetësinë që mallrat janë arë, argjend,sermë dhe përqindjen e tyre. Nga DRT Shkodër është kryer një korrespondencë në vitin 2018 por pa zgjidhje ndërmjet DPT dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore e cila ka në misionin e saj kryerjen e analizat kimike dhe fizike të mineraleve. Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 112/2016, datë 03.11.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 " Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë " dhe akteve nënligjore si UMF nr.7, datë 10.01.2017" Për disa shtesa në UMF nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në R Shqipërisë ", aktualisht nuk parashikohen nga viti 2017 e në vazhdim më sekuestrim të mallrave për veprime apo mosveprime të tatimpaguesve, agjentëve tatimor, etj, që bien në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 i ndryshua dhe akteve nënligjore të tij pasi përbëjnë shkelje tatimore administrative dhe kategorizohen në dënime administrative. (Trajtuar më hollësisht në faqen nr.146-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 3. DRT Shkodër të mara masa për lëvrimin e mallrave të sekuestruara në DPRMSH. Në rast se, gjatë dorëzimit konstatohet se mallrat nuk i përgjigjen cilësimeve të bëra në momnentin e konfiskimit, cështja të adresohet në organet kompetente në mënyrë që të nxiren përgjegjësitë administrative dhe ligjore ndaj personat përgjegjës sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Menjëherë.

4.Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi grupi i auditimit ka konstatuar problematika në funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si vijon:

a.Aktet dhe dispozitat që rregullojnë funksionimin e institucionit (rregullorja dhe struktura e miratuar), nuk janë në koherencë midis tyre pasi, ndryshimet strukturore të DRT Shkodër nuk janë reflektuar me ndryshime të rregullores. Gjithashtu struktura aktuale e DRT-së, nuk i përgjigjet mbulimit të të gjitha funksioneve të parashikuara, duke krijuar konflikt interesi dhe mbivendosje detyrash. Psh, Drejtori i Funksioneve Mbështetëse që njëkohësisht është dhe NZ i institucionit ka rezultuar që të jetë pjesë e integruar e procedurave të prokurimit me vlera të vogla, që nga procesi i planifikimit të nevojave, prokurimi, marrja në dorëzim, kryerja e transaksionit financiar, kontabilizimi i shpenzimeve dhe reflektimi i tyre në pasqyrat financiare të institucionit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 3 (b), të nenit 22, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar ku shprehimisht citohet: *"Veprimtaritë e kontrollit përmbajnë, minimalisht: b) ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin".*

b. Nga ana e DRT Shkodër nuk janë përgatitur dhe nuk janë dorëzuar brenda afateve ligjore Pyetësorët e Vetëvlerësimit, Deklarata dhe Raporti për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për vitin 2018 dhe 2019, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 18, të Ligjit nr.10296, datë 08. 07. 2010, i ndryshuar dhe pikat nr.4 dhe 6, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.28, datë 15.12.2011.

c. Procedurat e buxhetimit nuk kanë ndjekur gjurmën standarde të parashikuar në Udhëzimin nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standard të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm. Nuk

kanë gjetur zbatim detyrimet e nenit 12**,** të Ligjit nr.10296/2010, i ndryshuar, mbi përgjegjësitë menaxheriale të nëpunësit zbatues për garantimin e gjurmës së auditimit**.**
d. NA, NZ dhe drejtuesit e tjerë të strukturave të DRT-së Shkodër nuk zotërojnë informacion të mjaftueshëm për qëllimin dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 198-209 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 4. Titullari i Institucionit, të marrë masa për njohjen dhe implementimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, duke synuar vendosjen e procedurave dhe rregullave të qarta për parandalimin e fenomeneve negative, verifikimeve, autorizimeve, ndarjen e detyrave sipas funksioneve dhe roleve të çdo nëpunësi, zhvillimin e dedikuar profesional të punonjësve me qëllim efektivitetin e sistemeve te kontrollit.

Menjëherë dhe në vijimësi.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan parregullsi në procedurat e inventarizimit të pasurisë për vitet 2018 dhe 2019**.** Më konkretisht:
a. Komisionet e inventarizimit në të dy vitet, para fillimit të inventarizimit nuk kanë mbajtur procesverbal me përgjegjësin material, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 83 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*"i ndryshuar.
b. Në përfundim të procesit të inventarizimit, komisioni i inventarizimit në vitin 2018, ka identifikuar si të papërdorshëm nga inventari ekonomik 4 artikuj në **vlerë fillestare 6,737,839 lekë** dhe në vitin 2019 ka identifikuar si të papërdorshëm nga inventari ekonomik 5 artikuj në **vlerë fillestare 6,950,839** lekë. Komisioni i inventarizimit, në të dy vitet nuk ka mbajtur procesverbal, por rezultatet i ka pasqyruar vetëm në relacionin përmbledhës, i cili nuk është i miratuar nga titullari i institucionit duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet në pikën 85 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar.
c. NA nuk ka ngritur komision për vlerësimin e aktiveve, të identifikuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit, as në vitin 2018 dhe as në vitin 2019, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikave 95 dhe 96 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 148-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 5. NA dhe NZ të marrin masat, për realizimin dhe monitorimin e procesit të inventarizimit të pasurisë së institucionit në të gjitha fazat si dhe të garantojnë pasqyrimin e saktë të gjendjes së aktiveve të institucionit në pasqyrat financiare vjetore.

Në vijimësi.

6. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me përdorimin e automjeteve në pronësi të DRT dhe dokumentimin e lëvizjes së tyre, nga auditimi u konstatua se DRT Shkodër ka aktualisht në përdorim 11 automjete**,**të cilat nuk mbulohen me drejtues mjeti sipas strukturës së miratuar. Në këto kushte automjetet janë përdorur nga punonjës të ndryshëm të DRT, por në asnjë rast nuk ka autorizim të përdorimit për automjetet të DRT-së ku të përcaktohet drejtuesi i mjetit, targa e mjetit, destinacioni, periudha e lëvizjes, veprime që bien ndesh me përcaktimet e pikës 35, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011*"Për menaxhimin e aktiveve në*

njësitë e sektorit Publik", i ndryshuar.Në fletë udhëtimet e dorëzuara nuk janë evidentuar saktësisht iteneraret që do të përshkruajnë mjetet, si për lëvizjet e brendshme ashtu dhe të jashtme; kilometrat e përshkruara prej lëvizjeve të brendshme arrijnë dy/tre herë më shumë se kilometrat e përshkruara nga lëvizjet e jashtme dhe fletët e udhëtimit rezultojnë të panënshkruara nga punonjësit e administratës për lëvizjet e brendshme, veprim që bien ndesh me përcaktimet e pikës 36, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011*"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik",* i ndryshuar.Për të njëjtin mjet dhe itinerar sasia e karburantit të konsumuar rezulton e ndryshme në ditë të ndryshme si për lëvizjet e brendshme ashtu dhe të jashtme.
Për periudhën e audituar nuk rezulton asnjë planifikim mbi sasinë e karburantit që do të përdoret nga institucioni për cdo mjet transporti sipas normativave të konsumit.Nuk ka proces-verbal testimi mjeti për përcaktimin e normës së konsumit të karburantit për 100 km. Institucioni përdor normat e konsumit të vitit 2015 të përcaktuara nga Drejtoria e Administrimit të DPT-së.Nuk ka asnjë urdhër të brendshëm për disiplinimin e shpenzimeve të transportit, për administrimin dhe përdorimin e karburantit.Nuk ka kontrolle të shpenzimeve të fondit për karburant që të verifikojnë nëse fondet publike shpenzohen me ligjshmëri, sipas qëllimit dhe afateve të përcaktuara, në përputhje me detyrimet e marra përsipër, veprime këto që bien ndesh me përcaktimet e neneve 11,12,16 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 176-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 6.1 Titullari i Institucionit çdo fillim viti, të ngrejë një komision për testimin e konsumit të karburantit nga mjetet e transportit i cili të dokumentohet në një raport, duke përshkruar në rrugë konkrete normativën e konsumit të karburantit për çdo kategori mjet udhëtimi.

Rekomandimi 6.2 Strukturat drejtuese të cilat janë përgjegjëse për përdorimin e mjeteve të transportit dhe rrjedhimisht edhe të argumentimit të përdorimit të karburantit të hartojnë fletë udhëtimet duke evidentuar destinacionet përfundimtare të udhëtimit në rrethet përkatëse, mbështetur në specifikat e tyre për inspektim (pra destinacione larg qendrave urbane), me synim shmangien e interpretimeve jo të bazuara në dokumente dhe jo korrekte me aktet ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në 3 (tre) raste punonjësit janë paguar me pagë grupi jo në përputhje me nivelin e diplomës duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit në total në shumën 515,244 lekë, nga të cilat: 203,639 lekë në vitet 2016-2017, 181,573 lekë në vitin 2018, 122,997 lekë në vitin 2019, dhe 8035 lekë në vitin 2020. Më konkretisht:
a.**Në 2 (dy) raste** punonjësit janë paguar me pagë grupi, jo në përputhje me nivelin e diplomës, duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 190,972 lekë.
-z.[redacted], është paguar me pagën e grupit 14,000 lekë, pagë që i korrespondon nivelit të diplomës Master Shkencor dhe jo me pagën e grupit 10,000 lekë që i korrespondon nivelit të diplomës Bachelor që ai zotëron, pra z.[redacted] është paguar më tepër në shumën 132,245 lekë. Shuma 132,245 lekë (50,028 lekë në vitin 2017, 54,576 lekë në vitin 2018 dhe 27,641 lekë në vitin 2019) e përfituar nga z.[redacted] si diferencë midis pagës së grupit, në kundërshtim me

përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, lidhja 2, ku përcaktohet vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar, konsiderohet dëm në Buxhetin e Shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet.
-z.[redacted], është paguar me pagën e grupit 14,000 lekë, pagë që i korrespondon nivelit të diplomës Master Shkencor dhe jo me pagën e grupit 10,000 lekë që i korrespondon nivelit të diplomës Bachelor që ai zotëron, pra z. [redacted] është paguar më tepër në shumën 58,727 lekë. Shuma 58,727 lekë (24,608 lekë në vitin 2017 dhe 34,119 lekë në vitin 2018) e përfituar nga z.[redacted] si diferencë midis pagës së grupit në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, lidhja 2, ku përcaktohet vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar, konsiderohet dëm në buxhetin e shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet.
b. **Në 1 (një) rast** punonjësi z.[redacted] është paguar me pagë grupi 10,000 lekë, ndërkohë që rezulton i pa pajisur me diplomë duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit në shumën totale 324,272 lekë, për periudhën 02.08.2016-31.01.2020. Shuma 324,272 lekë, (36,866 lekë në vitin 2016, 91,137 lekë në vitin 2017, 92,878 lekë në vitin 2018, 95,356 lekë në vitin 2019 dhe 8,035 lekë në vitin 2020) e përfituar nga z.[redacted] në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, konsiderohet dëm në buxhetin e shtetit dhe si e tillë duhet të rikthehet.*(Trajtuar më hollësisht në faqen62-65;73-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 1. DRT Shkodër të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 515,244 lekë, sa përfituar padrejtësisht nga z.[redacted] në shumën 132,245 lekë; z.[redacted] në shumën 58,727 lekë dhe z.[redacted] në shumën totale 324,272 lekë, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, ...".

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve për udhëtime e dieta në vlerën 6,353,100 lekë,u konstatuan parregullsi në respektimin e dispozitave ligjore në shumën 777,735 lekë, konsideruar dëm në buxhetin e shtetit. Më konkretisht:
a. 27 punonjës në 34 shërbime të kryera janë paguar për shpenzime udhëtimi (fjetje në hotel) mbi bazën e dokumentacionit financiar të parregullt (fatura tatimore për fjetje në hotel të pa vulosura nga shitësi i shërbimit, të panënshkruara nga punonjësi dhe shitësi i shërbimit) *duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit në shumën 654,500 lekë, (prej të cilave 589,000 lekë në vitin 2018 dhe 65,500 lekë në vitin 2019),* veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 4 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar si dhe pikës 36 të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
b. Gjatë vitit 2019, 10 punonjës në 3 shërbime të kryera kanë tejkaluar me nga 1 ditë secili qëndrimin me shërbim jashtë vendit të punës (vërtetuar kjo me faturë tatimore fjetje në hotel një ditë më shumë sesa është urdhëruar në urdhrin e punës). Këto ditë duhet të rezultonin mungesë në listëprezencë dhe listëpagesë por, ndërkohë punonjësit rezultojnë të jenë paguar me ditë të plota pune nga sektori i financës, *duke shkaktuar dëm në buxhetin e shtetit, në vitin 2019, në shumën 123,235 lekë. (Trajtuar më hollësisht në faqen 84-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 2. DRT Shkodër të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për të mundësuar arkëtimin në buxhetin e shtetit të shumës 777,735 lekë, përfituar padrejtësisht nga 29 punonjës të DHT (sipas tabelës nr.26), në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.10296, datë

08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, VKM-së nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar, si dhe Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

Menjëherë.

3. Gjetje nga auditimi: U konstatuan parregullsi nëprocedurat për vlerësimin e aktiveve të evidentuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit të vitit 2017 dhe të asgjësuara/tjetërsuara në vitin 2018 të cilat kanë sjellë 151,229 lekë të ardhura të munguara, për buxhetin e institucionit. Më konkretisht:
Komisioni i vlerësimit të aktiveve nuk ka kryer vlerësimin për aktivet e identifikuara si të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit, si dhe nuk ka hartuar procesverbal vlerësimi, por ka hartuar vetëm një relacion përmbledhës, në të cilin evidentohen për nxjerrje jashtë përdorimit: Inventar ekonomik nga llog.218 për 90 artikuj në vlerë fillestare 13,572,907 lekë, amortizimi i akumuluar 13,227,188 lekë dhe vlerë të mbetur 345,719 lekë dhe Instalime teknike, makineri e pajisje" nga llog.214 gjithsej 4 artikuj në vlerë fillestare 739,060 lekë, amortizimi i akumuluar 661,533 lekë dhe vlerë të mbetur 77,527 lekë, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikave 95,104 dhe 105 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*"i ndryshuar.
Komisioni i asgjësimit/tjetërsimit të aktiveve i kryesuar nga përfaqësues të DPT-së, nga 94 artikuj të evidentuar për nxjerrje jashtë përdorimit ka asgjësuar vetëm 40 artikuj me vlerë fillestare 1,398,903 lekë dhe vlerë të mbetur 272,017 lekë dhe nuk ka kryer asgjësimin e 54 artikujve me vlerë fillestare 12,913,064 lekë dhe vlerë të mbetur 151,229 lekë, që janë objekt i VKM-së nr. 957 datë 19.12.2018 "*Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike*", por në relacion shprehet se procedurat e mëtejshme sipas legjislacionit do të ndiqen nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse.
Për 54 artikujt të cilët komisioni nuk i asgjësoi, Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse nuk ka zhvilluar procedurë ankandi, por ia ka dhënë për riciklim Shoqërisë "[redacted]" sh.p.k Katund i Ri Durrës, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 109 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*, i ndryshuar. *Moskryerja e procedurave të ankandit në vlerën e mbetur 151,229 lekë përbën të ardhur të munguar, të pa arkëtueshme për buxhetin e institucionit.*
Zyra e Financës ka kryer veprimin kontabël duke pakësuar aktivin e pasqyrave financiare në vlerë totale për 14,311,967 lekë përkatësisht llogarinë 218 "Inventar ekonomik" me vlerë fillestare 13,572,907 lekë dhe llogarinë 214 "Instalime teknike, makineri e pajisje" gjithsej me vlerë fillestare 739,060 lekë referuar vetëm fletë daljes së magazinës, pa bërë kontrollin dhe verifikimin e dokumentacionit autorizues dhe vërtetues, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikave 35 dhe 36 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*" i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 148-160 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 3.1. Titullari i Institucionit të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e procedurës së ankandit për aktivet të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit, moszbatimi i së cilës ka sjellë të ardhura të munguara, të paarkëtueshme për buxhetin e institucionit të vitit 2018, në shumën 151,229 lekë.

Menjëherë.

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan strukture e paplotësuar e DRT Shkodër në masën 28% ose 36 vende të lira pune në fund të vitit 2018 dhe 15% ose 19 vende të lira pune në fund të vitit 2019. Ndërkohë konstatuam parregullsi në 12 procedura rekrutimit, që përfshin të gjitha nivelet menaxheriale duke shkaktuar shpenzim në kushtet e paligjshmërisë në total në shumën 12,244,690 lekë, nga të cilat 2,795,401 lekë për vitet 2016-2017; 5,059,718 lekë për vitin 2018, 4,331,398 lekë për vitin 2019 dhe 58,173 lekë në vitin 2020.

Në 1 (një) rast procedura e emërimit të nivelit të lartë menaxherial nga Ministri i Financave, për ***z.*** [redacted] (i cili zotëron diplomë të nivelitBachelor), në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DRTRV, ka rezultuar, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës....." lidhja 6/8, ku si kriter minimal i diplomës së shkollës së lartë, për efekt pranimi në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë në DRT, është 1, që do të thotë kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë dhe paga e paguar për të, për periudhën 05.02.2018-12.11.2018, ***në shumën 995,564 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.***

Në 3 (tre) raste procedurat e rekrutimit të nivelit të mesëm menaxherial kanë rezultuar me diplomë të nivelit Bachelor, në kundërshtim me përcaktimet VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave tënëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet eministrive të linjës,...", lidhja 6/8, ku si kriter minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt pranimi në pozicionin e përgjegjësit të sektorit në DRT, është 1 ose 2, që do të thotë kandidati duhet të zotërojë diplomë të nivelit të dytë, ose diplomë master profesional si dhe përcaktimet e rregullores "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhepaga e paguar për punonjësit ([redacted]), nga momenti i emërimit, ***në shumën 3,753,681 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë nga të cilat: 1,904,675 në vitin 2017; 1,440,189 lekë në vitin 2018 dhe 408, 817 lekë në vitin 2019***.

Në 1 (një) rast procedura e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial ka rezultuar **pa diplomë**, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr.187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet eministrive të linjës,..." dhe e gjithë pagesa e bërë për periudhën 02.08.2016- 31.01.2020, ***në shumën 2,336,875 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë pasi punonjësi është emëruar në detyrë i padiplomuar, nga të cilat:*** 224,108 lekë paguar në vitin 2016;666,618 lekë paguar në vitin 2017; 690,964 lekë paguar në vitin 2018; 697,012 lekë paguar në vitin 2019 dhe 58,173 lekë paguar në vitin 2020.

Në 2 (dy) raste procedurat e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial kanë rezultuar ***jo në përputhje me kriterin e diplomës dhe kriterin e vjetërsisë në punë*** përcaktuar në Rregulloren "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit e

strukturave të hetimit tatimor", miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve nr.65, datë 04.10.2017, ndryshuar me Urdhrin nr.65/1, datë 02.02.2018, pasi z.XXXX, në momentin e rekrutimit në punë ka qenë i pajisur me diplomë *të nivelit Bachelor, me vjetërsi në punë 6 muaj dhe* z. XXXXX rezulton i diplomuar *në nivelin Bachelor, me 0 vite vjetërsi në punë.*Paga e paguar në total për punonjësit *(XXXXXX)* ***në shumën 1,539,091 lekë konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë, nga të cilat: 287,227 lekë në vitin 2018 dhe 1,251,864 lekë në vitin 2019.***
Në 2 (dy) raste procedurat e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial kanë rezultuar ***jo në përputhje me kriterin e diplomës*** përcaktuar në rregulloren e sipërcituar. Paga e paguar në total për të dy punonjësit ([redacted]) ***në 510,554 lekë nga të cilat: 142,000 lekë në vitin 2018 dhe 368,554lekë në vitin 2019, konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.***
Në 3 (tre) raste procedurat e rekrutimit të nivelit të ulët menaxherial kanë rezultuar ***jo në përputhje me kriterin e vjetërsisë në punë,*** përcaktuar në rregulloren e sipërcituar, pasi znj. [redacted] në momentin e rekrutimit rezulton me 10 muaj vjetërsi në punë, z.[redacted] me vetëm 4 muaj vjetërsi. Dhe z.[redacted] pa vjetërsi. Paga e paguar në total për të tre punonjësit **([redacted]) në shumën 3,108,925 lekë nga të cilat: 1,503,774 lekë në vitin 2018 dhe 1,605,151 lekë në vitin 2019, konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë.***(Trajtuar më hollësisht në faqen 55-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 1.1: Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të kalojë në një proces shqyrtimi tërësor, gjithë databazën e të punësuarve të DRT-së, për të vlerësuar saktësinë dhe rregullshmërinë e trajtimit financiar të çdo punonjësi si dhe përllogaritjes së komponentëve që përbëjnë pagën, të tilla si: nivelin e diplomës, shtesa për efekt pozicioni, vjetërsinë në punë etj, me qëllim menaxhimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Rekomandimi 1.2. Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të plotësojë dosjet personale të punonjësve me kontratë me kopje të diplomës dhe librezës së punës, për efekt të llogaritjes së elementëve të pagës, pasi për punonjësit me Status të Nëpunësit Civil të dhënat personale janë të administruara në sistemin HRMIS.

Rekomandimi 1.3. DRT Shkodër në bashkëpunim me DPT të fillojnë procedurat ligjore për largimin nga detyra të z. [redacted], i emëruar në detyrë ndonëse rezulton i padiplomuar.

Rekomandimi 1.4. DRT në bashkëpunim me DPT të kryejnë një analizë të kujdesshme në lidhje me nevojat për kapacitete njerëzore dhe profesionale.

Menjëherë dhe në vijimësi.

2. Gjetje nga auditimi: Për punonjësit me kontratë të përkohshme janë paguar në total për të dy vitet **12,733,133 lekë,** prej të cilave, 7,074,945 lekë në vitin 2018 dhe 5,658,188 lekë në vitin 2019, pagesë e cila konsiderohet shpenzim në kushtet e paligjshmërisë, pasi në procedurat e planifikimit, emërimit, evidentimit dhe matjes së punës së punonjësve me kontratë të përkohshme janë konstatuar parregullsi, si vijon:
Nevojat për staf ndihmës nuk kanë kaluar fazën e planifikimit. Drejtoria Rajonale Tatimore nuk ka argumentuar dhe nuk ka mbështetur me evidencë kërkesën për staf ndihmës, si në numër ashtu edhe në pozicionet e punës ku do të punësohen.
DPT ka kryer emërimet në punë për vitin 2018 bazuar vetëm në lista emërore, njëra prej të cilave është dërguar me email nga DRT ditën e hartimit të Vendimit të Drejtorit të PT për emërimin në punë të 21 punonjësve të shërbimit, për një periudhë 1 mujore, ndërkohë që për

vitin 2019 janë emëruar në punë 23 punonjës me kontratë të përkohshme pa pasur asnjë lloj planifikimi dhe evidence mbështetëse. Nuk ka evidentim dhe dokumentim të punës së realizuar nga këta punonjës.(*Trajtuar më hollësisht në faqen 78-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 2. Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të marrë masa për planifikim real dhe të mirë studiuar të nevojave për staf ndihmës me qëllim, eliminimin e praktikave të rekrutimit të punonjësve me kontratë të përkohshme pa justifikuar nevojat për këtë kategori hartimin e kërkesave të argumentuara dhe të mbështetura me evidencë të mjaftueshme; hartimin e përshkrimeve të punës për çdo pozicion pune që do të mbulohet nga punonjësit me kontratë të përkohshme, me qëllim menaxhimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi.

3. Gjetje nga auditimi: Parregullsi në respektimin e dispozitave ligjore për shpenzimet për udhëtime e dieta të cilat kanë rezultuar me shpenzim në kushtet e paligjshmërisë në shumën 6,353,100 lekë, nga të cilat 4,294,600 lekë në vitin 2018 dhe 2,058,500 lekë në vitin 2019. Më konkretisht:

a. **Në asnjë rast** "Shpenzimet e udhëtimit" (për strukturën e Hetimit Tatimor për Rajonin e Veriut), nuk janë autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT ose nga Drejtori i DRT Shkodër, kompetencë kjo e deleguar nga Ministri i Financave me Autorizimin nr.7448/1, datë 25.05.2018, për vitin 2018 dhe me Autorizimin nr.6159/1, datë 11.04.2019, për vitin 2019, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Kreut V, pika 2, germa a), paragrafi (i), të VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar.

b.**Në 130 raste ose në 95% të rasteve,** janë kryer shpenzime për udhëtim e dieta, **në kushtet e paligjshmërisë në shumën 6,353,100 lekë** nga të cilat, 4,294,600 lekë në vitin 2018 dhe 2,058,500 lekë në vitin 2019, të pambështetur me dokumentacion vërtetues për kryerjen e detyrës, veprim ky në kundërshtim me: Përcaktimet e Udhëzimit nr.22225, datë 16.07.2015, të ish Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve; Përcaktimet e pikës 5.24 "Dokumentacioni administrativ", të Manualit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së.

c.**Në 22 raste, ose në 16% të rasteve** janë konstatuar parregullsi në hartimin e urdhrave të punës të nxjerrë nga Drejtori i Hetimit Tatimor në DPT. Më konkretisht, në urdhër nuk përcaktohet territori ku do të kryhet shërbimi, por në mënyrë të përgjithshme citohet sipas rastit: në territorin e DHT Rajoni Jugor; Qëndro, Verior, në territorin e Shqipërisë…, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 5.24 "Dokumentacioni administrativ", të Manualit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 84-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 3.1. DRT Shkodër të forcojë kontrollin e brendshëm në drejtim të garantimit të gjurmës së auditimit për shpenzimet e udhëtimit, me qëllim eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike.

Rekomandimi 3.2. DHTRV të përmirësojë punën në drejtim të saktësimit në urdhrat e punës të destinacionit të inspektimit, detyrim ky që rrjedh nga zbatimi i Manualit të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, miratuar me Urdhrin nr.93/1, datë 05.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së. Ky

përcaktim ka impakt të drejtpërdrejtë në përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit dhe normativave të harxhimit të karburantit.

Menjëherë dhe në vijimësi.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua përdorimi i karburantit në kushtet jo korrekte të zbatimit të kuadrit ligjor të cilat kanë shkaktuar efekte negative në buxhetin e shtetit.
Sasia e karburantit të përdorur për automjetet në dispozicion të DHT, sipas sistemit të kartave elektronike ka rezultuar për vitin 2018,10,421.49 litra, nga e cila 5,168.14 litra në shumën 909,593 lekë është e pajustifikuar me fletë udhëtimi dhe për vitin 2019 ka rezultuar 13,482.34 litra, nga e cila 10,233.34 litra në shumën 1,782,834 lekë është e pajustifikuar me fletë udhëtimi.
Në lidhje me dokumentimin e harxhimit të karburantit nga mjetet në dispozicion të DHT-së për periudhën objekt auditimi është konstatuar se: për muajt shkurt, prill, maj, qershor, korrik, gusht, shtator të vitit 2018, nuk janë plotësuar fletë udhëtimet që të vërtetojnë lëvizjen e mjeteve e për rrjedhojë sasinë e karburantit të harxhuar. Fletë e udhëtimit që i përkasin muajve të tjerë në të shumtën e rasteve nuk janë nënshkruar për çdo lëvizje, por me një ose dy nënshkrime të përgjithshme, nga një punonjës si drejtues mjeti. Për vitin 2019 prej DHT-së janë dorëzuar fletë udhëtime vetëm për muajin janar duke justifikuar vetëm sasinë prej 449 litra karburant nga 669 litra që rezulton të jetë tërhequr nga programi i kartave elektronike. Nga rakordimi i sasisë së karburantit të përdorur në programin e kartave elektronike me fletë udhëtimet e dorëzuara për mjetet e transportit në dispozicion të DHT-së konstatohet se për periudhën e audituar sasia totale prej 15,401.48 litra karburant (naftë) në shumën 2,692,427 lekë është e pajustifikuar me fletë udhëtime", veprim ky në kundërshtim me përcaktimet në nenet 9, 11, 12, 16 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar si dhe pikës 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", konsiderohet efekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit.
DRT ka përdorur dhe dokumentuar për nevoja të institucionit 669.5 litra karburant në vlerën 117,949 lekë nga karta Gold (Gjeneratori), kartë e cila ka destinacion përdorimi vetëm për gjeneratorin. Në asnjë rast gjeneratori nuk rezultoi të jetë vënë në punë. Përdorimi i 669.5 litra karburant (naftë) në vlerën 117,949 lekë, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 34 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik",* i ndryshuar, konsiderohet efekt financiar negativ në Buxhetin e Shtetit. (*Trajtuar më hollësisht në faqen 176-197 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 4. Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse të marrë të gjitha masat për garantimin e gjurmës së auditimit për dokumentimin e shpenzimeve të karburantit (për automjetet dhe kartën GOLD) me qëllim përdorimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore,moszbatimi i së cilës ka sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit gjithsej në shumën 2,810,376 lekë nga e cila 117,949 lekë nga përdorimi jo sipas destinacionit i kartës GOLD(Gjeneratori) dhe 2,692,427 lekë nga mosjustifikimi me fletë udhëtimi nga automjetet në dispozicion të DHT-së**.**

Menjëherë dhe në vijimësi.

5. Gjetje nga auditimi: Parregullsi në respektimin e dispozitave ligjore në realizimin e procedurave të prokurimit publik për punë/mallra/shërbime.
I. Shkelje të afateve kohore të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik në hartimin dhe dorëzimin e regjistrit të parashikimit të prokurimit publik.

a.Gjatë vitit 2018 janë konstatuar (10 herë) ndryshime të regjistrit të parashikimit të prokurimeve, ndryshime të cilat në asnjë rast nuk shoqërohen me relacion argumentues, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 4/4 të VKM-së nr.914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

b.Për vitin 2018, DRT Shkodër ka dërguar në DPT me 9 ditë vonesë regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike të vitit 2018, dhe në Degën e Thesarit Shkodër me 28 ditë vonesë. E njëjta situatë paraqitet edhe në vitin 2019 ku DRT rezulton të ketë hartuar dhe dërguar 18 dhe 39 ditë me vonesë regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike të vitit 2019, në DPT dhe në Degën e Thesarit Shkodër, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 4 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

II. Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël është konstatuar se: nga 34 procedura prokurimi të realizuara në shumën 1,724,768 lekë, janë realizuarjo në përputhje me përcaktimet e kuadrit ligjor në fushën e prokurimeve publike30 procedura prokurimi në shumën 1,195,437 lekë të cilat konsiderohen efekt negativ në buxhetin e institucionit,të detajuara si më poshtë:

Në 11 procedura prokurimi në shumën 589,713 lekeprej të cilave,8 procedura prokurimi në shumën 365,973 lekë janë realizuar në vitin 2018 dhe 3 procedura prokurimi në shumën 223,740 lekë janë realizuar në vitin 2019janëkonstatuar si vijon:

Kërkesat për mallra/punë/shërbime nuk janë hartuar nga degët përkatëse, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 dhe pikës 3 të nenit 40 të VKM-së nr.914, datë 19.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

Mungesë e procesverbaleve të testimit të tregut dhe të argumentimit e dokumentimit të përllogaritje së fondit limit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 59 të VKM-së nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar.

Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara nuk është ngritur komisioni marrjes në dorëzim të mallit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikave 42, 43 dhe 54 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar.

Në dosjen e procedurës së prokurimit nuk gjendet i administruar vetë deklarimi me shkrim i kandidatit ose ofertuesit, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e nenit 15 të VKM-së nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar".*

Në të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara mungon relacioni përmbledhës sipas kërkesave të nenit 68 të VKM-së nr.914, datë 19.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar".*

Njësia e prokurimit (funksionale) nuk ka marrë pjesë në asnjë trajnim në fushën e prokurimeve, në kundërshtim me LPP dhe Manualin e Prokurimit ku përcaktohet se, Njësia e prokurimit duhet të kryejë minimumi 1 trajnim në vit.

Në 2 procedura prokurimi të realizuara në vitin 2018, në shumën 49,990 lekënuk janë përcaktuar specifikimet teknike, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e pikës 4 të nenit 23 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin Publik*", i ndryshuar, si dhe përcaktimet e pikës 5 të Udhëzimit nr.3, datë 8.01.2018 "*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", i ndryshuar.

Në 12 procedura prokurimi në shumën 370,464 lekë, prej të cilave,7 procedura prokurimi në shumën 178,464 lekë janë realizuar në 2018 dhe 5 procedura prokurimi në shumën 192,000 lekë janë realizuar në vitin 2019, janëkonstatuar si vijon:

Nuk ka një mekanizëm kontrolli bazuar në informacionin mbi gjendjen teknike, raportet mbi dëmtimet dhe avaritë e automjeteve.
Nga Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse nuk mbahen kartela për secilin automjet, si dhe nuk ka autorizime për personat që i përdorin ato.
Në asnjë nga rastet e riparimit të automjetit nuk rezulton të jenë depozituar pranë magazinës së institucionit pjesët e dëmtuara (që janë ndërruar) të këtij automjeti veprime këto që bien ndesh me përcaktimet e pikave 4, 5, 6, 7, 10, 12 dhe 23 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" i ndryshuar si dhe me përcaktimet e pikave 1, 2, 4, 12 të nenit 35 të Rregullores së Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore.
Në 5 procedura prokurimi në shumën 185,270 lekë, prej të cilave, 2 procedura në shumën 40,000 lekë janë zhvilluar në vitin 2018 dhe 3 procedura në shumën 145,270 lekë janë zhvilluar në vitin 2019, janë konstatuar parregullsi në nënshkrimin e faturës së mallrave/shërbimeve nga personat e pranishëm për defektin e ndodhur të cilët kanë qenë prezent sipas procesverbalit të konstatimit dhe nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlerë të vogël, veprim ky në kundërshtim përcaktimin e pikës 18 të Udhëzimit nr.3, datë 8.01.2018 "*Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike*", i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 160-176 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandimi 5.1. Titullari i Institucionit të analizojë situatën në lidhje me realizimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, mosrespektimin e afateve kohore të hartimit dhe të dërgimit të regjistrit të parashikimit të prokurimit publik për punë/mallra/shërbime, në DPT dhe në Degën e Thesarit, dhe të nxjerrë përgjegjësitë administrative.

Rekomandimi 5.2. Nëpunësi Autorizues të ngrejë menjëherë komisionin e marrjes në dorëzim të mallrave/shërbimeve në zbatim të kërkesave të pikave 42,43,54 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", i ndryshuar .

Rekomandimi 5.3. NZ të garantojë zbatimin e gjurmës së auditimit për procedurat e prokurimit publik në zbatim të kërkesave të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, me qëllim përdorimin me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore, moszbatimi i së cilës ka sjellë efekt negativ në buxhetin e shtetit gjithsej në shumën 1,195,437 lekë.

Rekomandimi 5.4. Titullari i Institucionit, të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, me qëllim përmirësimin e punës së Njësisë së Prokurimit në drejtim të hartimit, dokumentimit dhe zbatimit të procedurave konform rregullave të prokurimit publik.

Menjëherë dhe në vijimësi.

"*Përsa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi*"

KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DRT	Drejtoria Rajonale Tatimore
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.

MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
TFTH	Tatim mbi Fitimin e Thjeshtuar
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Finacave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
ISSAI	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
C@TS	Sistemi informatik i Tatimeve
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.